

ENVER HOXHA

VEPRA

22

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

22

TETOR 1961 – DHJETOR 1961

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1976**

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 22-të

Vëllimi i 22-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin dokumente të tremujorit të fundit të vitit 1961, shumica e të cilave `botohen për herë të parë.

Thelbi kryesor i përbajtjes së këtij vëllimi është shpallja e luftës së hapur të PPSH kundër revizionistëve hrushovianë, në përgjigje të sulmeve që ata bënë botërisht dhe të presloneve të shumëlojshme të tyre kundër Partisë e popullit tonë.

Grupi i N. Hrushovit, pasi kishte prerë të gjitha kreditë, duke organizuar bllokadën e egër ekonomike, pasi kishte prishur në mënyrë të njëanshme të gjitha marrëveshjet dhe kishte kurdisur një radhë makinacionesh «për ta përjashtuar» Shqipërinë nga «kampi socialist» dhe nga Traktati i Varshavës, u hodh në sulme dhe në shpifje të hapura kundër PPSH dhe RPSH: Më 17 tetor 1961, nga tribuna e Kongresit XXII të PK të BS, N. Hrushovi sulmoi botërisht PPSH dhe bëri thirrje të hapur kundërrevolucionare për të mbytur Shqipërinë socialiste dhe për të rrëzuar udhëheqjen e saj mark-siste-leniniste, kurse në dhjetor 1961, preu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, akt ky i pashembullt

armiqësor në marrëdhëniet midis vendeve socialiste dhe kundër RPSH dhe popullit shqiptar.

Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar këto sulme dhe akte thellësishët armiqësore nuk i gjetën në besasi. Përkundrazi, PPSH e kishte pregatitur plotësisht vjeten dhe popullin për këtë gjendje, që pritej të vinte, si dhe për përgjigjen e vendosur që u duhej dhënë sulmeve të hapura të revizionistëve hrušovianë ndaj vendit tonë. Dokumentet e botuara në këtë vëllim na japid një tablo të gjallë të lustës parimore të PPSH e të popullit shqiptar kundër revizionistëve sovjetikë, për të qëndruar si kurdoherë në rrugën e marksizëm-leninizmit dhe për të vazduar me konsekuencë luftën politike e ideologjike deri në demaskimin dhe shpartallimin e plotë të grupit të Hrushovit dhe të revizionizmit hrušovian.

Një analizë të thellë shkencore mbì baza të patundura marksiste-leniniste shoku Enver Hoxha u bëri problemeve më të mprehta ndërkombëtare në përgjithësi dhe marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike në veçanti në Fjalimin që mbajti më 7 Nëntor 1961 me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PPSH. Nëpërmjet këtij Fjalimi historik, që përfshihet në këtë vëllim, ai demaskoi publikisht tradhtinë e udhëheqësve sovjetikë me N. Hrušovin në krye, vijën e tyre antimarksiste, revizioniste, kapitullante, që kishte sjellë përçarjen e kampit socialist, të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe prishjen e marrëdhënieve sovjeto-shqiptare.

Dokumentet që përfshihen në këtë vëllim tregojnë qartë se në kundërshtim me synimet e me shpresat e armiqve imperialisto-revizonistë, komunistët dhe po-

pulli shqiptar shtrënguan edhe më shumë radhët rrreth Partisë dhe Komitetit Qendror me shokun Enver Hoxha në krye. Këto dokumente na jepin një pasqyrë të plotë të unitetit të shëndoshë të radhëve të Partisë dhe të popullit rrreth Partisë, i cili në kushtet e krijuara u çelikos akoma më shumë, të besimit të patundur për të kapërcyer përmes luftës së vendosur e pa kompromis të gjitha vështirësitë e krijuara, të gatishmërisë së përgjithshme për të punuar, për të luftuar dhe për të fituar në kushtet e bllokadës imperialisto-revizoniste. Materialet që bodojnë në këtë vëllim shprehin qartë vendosmërinë e PPSH dhe të popullit shqiptar për t'i bërë ballë presionit të egër të revolucionistëve hrušovianë; për të mos rënë në kthetrat e borgjezisë ndërkombëtare, së cilës, pas akteve banditeske të Hrušovit iu ngjallën shpresat se Shqipëria do të binte në prehrin e saj; për të kryer me nder të gjitha detyrat politike, ekonomike, kulturore dhe të mbrojtjes së atdheut, duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta.

PPSH ishte e ndërgjegjshme se kishte përpara një luftë të ashpër, të gjatë dhe të vështirë, po kurrë nuk do të përkulej e nuk do të thyhej, sepse ishte plotësisht e bindur se kështu mbronte marksizëm-leninizmin. Ajo kishte besim të plotë në fitore, sepse me të ishte e drejta, me të ishin popujt dhe komunistët revolucionarë të mbarë botës, të cilët e mbështetën dhe e përkrahën vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Ky besim i Partisë u vërtetua shumë shpejt. Si rezultat i bindjes së thellë të komunistëve dhe të mësave për drejtësinë dhe për rëndësinë historike të luftës që zhvillonte Partia jonë, si rezultat i mobilizimit

dhe i vrullit revolucionar të të gjithë popullit, u plotësua me sukses plani i viti 1961, u forcua akoma më tepër astësia mbrojtëse e atdheut, u rritën në një shkallë më të lartë gatishmëria dhe entuziazmi i masave për të punuar e për të luftuar si një repart në rrëthim.

Por vështirësitë nuk kishin marrë fund. Përkundrazi, në vitin 1962 ato do të ishin më të mëdha e më të rënda si rezultat i shtimit të presioneve dhe të synimeve armiqësore e antishqiptare të fuqive imperialisto-revizoniste. Shoku Enver Hoxha, duke i paralajmëruar Partinë dhe popullin për këto vështirësi, i pregatiti ata politikisht dhe moralisht për të shkuar në luftë e në punë me besim të patundur në fitoren mbi imperializmin dhe revizionizmin. Duke vënë në dukje rëndësinë që ka njojja e vështirësive objektive, ai theksonte se nuk është e drejtë t'u flasësh masave vetëm për to. «Në qoftë se do të veprohej kështu, do të gabonim, sepse do të krijonim artificialisht një gjendje të rëndë, pesimiste, që do të ishte shumë e dëmshme. T'u thuash masave të vërtetën do të thotë t'u flasësh atyre edhe për sukseset e mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat, t'u flasësh edhe për perspektivat, të cilat nuk janë aspak premtimë boshe, por janë e ardhshmja e sigurt e bazuar në planet tonë, në ligjet e zhvillimit të shoqërisë sonë, në punën e popullit tonë». Kjo ide përshkon si një fill i kuq një tok fjalimesh e bisedash mbajtur gjatë kësaj periudhe nga shoku Enver Hoxha në rrëthe e në qendra pune të vendit tonë që ai vizitoi.

Megjithëse kanë kaluar 15 vjet që kur janë shkruar

dokumentet e këtij vëllimi, ato kanë rëndësi të madhe aktuale dhe përbëjnë një burim të ri fryshtëzimi për komunistët, dhe punonjësit, për edukimin marksist-le-ninist dhe mobilizimin revolucionar të tyre në lustë për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë.

PPSH LINDI, JETOI E JETON NË RRETHIM ARMIQËSOR, LUFTON DIE FITON NË BETEJA KUNDER FRONTIT TË GJERË REVIZIONIST

Fjala në Plenumin V të KQ të PPSH

12 tetor 1961

Të dashur shokë,

Sot jemi mbledhur për të gjykuar mbi letrën e fundit që na ka dërguar Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ju e lexuat këtë letër. Le të diskutojmë dhe të vendosim në këtë Plenum mbi përgjigjen që duhet t'i dërgojmë udhëheqjes sovjetike¹.

Sic e konstatuat dhe vetë nga leximi i letrës, për të cilën ju, me siguri do të shfaqni mendimin tuaj, çdo ditë që kalon, duket gjithnjë e më qartë, se me çfarë njerëzish kemi të bëjmë, se çfarë njerëzish kanë ardhur në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe

¹ Më 24 gusht 1961 KQ I PK të BS i dërgoi një letër KQ të PPSH, përbajtja e së cilës ishte fund e krye me shpifje e me akuzë kundër PPSH dhe udhëheqjes së saj. (Shih përgjigjen e kësaj letre në «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 92. Tiranë, 1970).

të shtetit sovjetik. Vetë kjo letër dëshmon se, në krye të Bashkimit Sovjetik, ka ardhur një grup renegatësh të marksizëm-leninizmit, kanë ardhur revizionistë me damkë, njerëz pa kurrfarë principi, që manipulojnë pa asnjëfarë skrupuli shantazhe, kërcënime, presione, shpifje, mashtrime, me një fjalë përdorin të gjitha manovrat e mjetet e borgjezisë më reaksionare.

Hrushovi dhe grupi i tij në këtë letër heqin gati çdo maskë që mund të mbulojë fytyrën e tyre tradhtare. Nuk është vështirë të kuptohet se këtë akt dëshpërimi, ata nuk e bëjnë nga e mira. Tradhtia i detyron të jenë konsekuentë në mendimet dhe në veprat e tyre. Drejtësia e vijës së Partisë sonë, qëndrimi i saj marksist-leninist, parimor, i papërkulur në besimin e plotë për triumfin e kauzës së saj të drejtë, që është njëkohësisht kauza e gjithë komunizmit ndërkombëtar, e bëjnë Hrushovin dhe grupin e tij trockist revizionist të zbulojnë lodrën, e bëjnë t'i cirren dhe t'i digjen atij dhe shokëve të tij maskat e ndryshme që përdorin.

Sipas letrës së fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, del se mosmarrëveshjet në mes Partisë sonë dhe atyre s'kanë as karakter ideologjik dhe as politik, se qëndrimet e drejta të Partisë sonë përshkohen fund e krye nga «një frymë armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik dhe partisë së tij», se Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu për ta janë njerëz të dyshimtë, të lidhur me agjenturat e fshehta imperialiste!

Për ta argumentuar këtë «zbulim sensacional» Hrushovi dhe banda e tij radhitin një sërë «faktesh decizive», siç i lexuat në letër, që s'kanë nevojë as për

komentin më të vogël. Ne i kemi jetuar të gjitha ngjarjet që prej Bukureshtit e deri sot, më saktë, që pas vdekjes së shokut Stalin e deri sot. Gjatë kësaj kohe ne kemi vepruar me drejtësi dhe me urtësi në rrugën marksiste-leniniste. Ne kemi ndjekur në mënyrë aktive ngjitjen dhe ardhjen në fuqi të klikës revizioniste të Hrushovit, kemi reaguar *kreshendo* e fuqimisht përmbrojtjen e Partisë sonë, të vijës së saj të drejtë, kemi mbrojtur me besnikëri fitoret e socializmit në vendin tonë, lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë. Këtë luftë parimore s'e kemi ndarë kurrë nga lufta jonë konsekuente përmbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të kampit socialist, të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së Lenin-Stalinit.

Pikërisht përmbrëtja e këtë luftë parimore, përmbrëtja e këtë luftë të lavdishme në mbrojtje të marksizëm-leninizmit që ne zhvillojmë, na ka luftuar klika renegate e Titos dhe tani edhe e Hrushovit. Kjo luftë e Partisë sonë flet vetë me veprat e saj të guximshme revolucionare dhe ne krenohemi që luftojmë me besnikëri dhe pa u përkulur asnjëherë, si ushtarë të saj.

Ku mund ta atakojë vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë klika tradhtare e Hrushovit? Asgjékundi. Vija politike e ideologjike e Partisë sonë është e pastër si kristali, është e qartë si drita e diellit, ashtu siç është marksizëm-leninizmi. Por lufta e bandës renegate të Hrushovit nuk drejtohet vetëm kundër Partisë së Punës të Shqipërisë; kjo është një pjesë e luftës që Hrushovi dhe grupei i tij i kanë shpallur vetë Bashkimit Sovjetik, kampit të socializmit, marksizëm-leninizmit. Hrushovi dhe grupei i tij e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin

dhe bëjnë punën e borgjezisë reaksionare, punën e imperializmit. Kush ka arritur ta kuptojë këtë gjë, ai është i armatosur, ai di dhe do të dijë t'u bëjë ballë furtunave, që do shpërthejnë mbi ne, se furtuna do të ketë! Këtë e kanë kuptuar mirë Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror, prandaj s'kemi frikë nga furtunat, u qëndrojmë atyre me guxim dhe në mos sot nesër do të dalim fitimtarë.

Ato që do të radhit më poshtë, në vija të përgjithshme, kanë qenë objekt i sa e sa analizave të gjera të Partisë sonë në kongreset, në plenumet, në konferencat dhe në aktivet e saj. Është fakt se Partia jonë qysh në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kuptoi se po ngrinte krye tradhtia në kokën e kampit të socializmit, në kokën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë sikur u godit në zemër, kur renegati Hrushov sulmoi J. V. Stalinin. Tronditja jonë s'ishte as sentimentale, as subjektive. Ne e ndiemë dhe e kuptuam se këtej kishte fill tradhtia, se po goditej leninizmi, po sulmohej me egërsi e me dinakëri nga një grup revizionistësh diktatura e proletariatit dhe po minohej ndërtimi i socializmit në Bashkimin Sovjetik. Re të zeza kalonin mbi kampin e socializmit dhe mbi botën. Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror nuk u gabuan, shtrënguan radhët dhe filluan rezistencën, e cila sot është shndërruar në një luftë të papajtueshme në mes Partisë sonë marksiste-leniniste dhe tradhtarëve revisionistë, Hrushov-Tito e kompani. Shkurorëzimi i leninizmit nga këta tradhtarë u zhvillua në të gjitha aspektet si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe

jashtë tij në planin e komunizmit ndërkombëtar dhe në arenën e politikës botërore. Ne as harruam dhe as nënveftësuam rrezikshmërinë e madhe të këtyre grupave armike, që zhvillonin dhe përhapnin tradhtinë, nën maskën e marksizëm-leninizmit.

Grupi i Hrushovit fshihte tradhtinë prapa forcës dhe prestigjit kolosal botëror të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Nën këtë maskë dhe nën këtë forcë revisionisti Hrushov, me ndërmjetësinë e miqve të tij, likuidoi udhëheqësit e shëndoshë marksistë-leninistë në partitë komuniste e punëtore të vendeve të demokracisë populllore të Evropës, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe këtu jo pse nuk u orvat, por se s'pati sukses në orvatjet e tij, pra jo se s'deshi, por se s'mundi. Këtu te ne i hasi sharra në gozhdë. N. Hrushovi dhe miqtë e tij, domethënë ata që solli në udhëheqje të shtetit dhe të partisë në vendet e demokracisë populllore të Evropës, rehabilituan kudo, në Bashkimin Sovjetik, në Hungari, në Poloni, në Bullgari e gjetkë, të gjithë trockistët, buharinistët, zinovievitët, titistët, renegatë e kundërrevolucionarë të tjerë, agjentë të imperializmit. Vetëm në Shqipëri nuk u shkoi, s'patën sukses. Kjo ishte një disfatë tjetër për renegatin Hrushov.

Pas kësaj, Hrushovi dhe pasuesit e tij, në kor e me radhë njëri pas tjetrit, rehabilituan shokun e tyre të zemrës dhe të idealeve, Titon dhe grupin e tij tradhtar. S'është nevoja të zgjatem për këtë çështje, por renegati Hrushov u përpoq të na fuste edhe ne në kor e në radhë. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti i saj Qendoror s'e hëngrën atë gjellë me helm, vazhduan

luftën e tyre të papërkulur e parimore dhe fituan. Kjo ishte një disfatë tjetër për revizionistin Hrushov. Në pamundësi të bënte ndryshe, ai na «buzëqeshte» për të na vënë këmbën, në ndonjë të kthyer.

Hrushovi dhe pasuesit e tij, duke marrë nëpër këmbë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kurdisën trillime e shpifje, sa i errësuan fitoret e periudhës së kaluar të Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik, sipas tyre, filloi «të rrojë, të lulëzojë, të triumfojë» vetëni pas ardhjes në fuqi të këtij sharlatani, që e filloi karrierën me fjalimet lumë, me korrespondencat bajate, me udhëtimet jashtë dhe brenda vendit. Nën këtë zhurmë dhe tam-tame, nën këtë demagogji të tmerrshme, tradhtia vepronte me ngut; pëlhura e merimangës hrushoviane endej kudo, brenda dhe jashtë vendit të Sovjetëve. Udhëheqje të partive komuniste të vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe shumë udhëheqje të partive komuniste e punëtore të vendeve perëndimore, i janë gjunjëzuar Hrushovit dhe i mbajnë ison.

«Në frymën e re» u përbysën format e ndërtimit të ekonomisë në Bashkimin Sovjetik. Të vjetrat ishin «staliniane, të pafrytshme, të papërshtatshme, dogmatike, frenuese». Industria në Bashkimin Sovjetik duhej «ringjallur» se gjoja kishte mbetur pas, kurse në vendet e demokracisë popullore duhej «frenuar», pse ishin bërë «plane të fryra staliniane». Kujtoni në këtë drejtim kritikat e propozimet e Hrushovit që ne të merreshim vetëm me agrumet dhe në dritën e evenimenteve të sotme, e konkretisht në dritën e bllokadës që po na bëhet neve, del qartë se ku e ka pasur qëllimin

N. Hrushovi: të na gjunjëzonte edhe ekonomikisht. Ç'kuptim marrin tani, në dritën e presioneve të shumëlllojta që po na bëhen «bashkëpunimi», «bashkërendimi», Këshilli i Ndihmës. Ekonomike -Reciproke dhe organizma të tjera të krijuara në kampin socialist, që drejtohen nga një klikë e tillë tradhtarësh të marksizëm-leninizmit? Ç'kuptim të tmerrshëm merr tani mbrojtja e përbashkët ushtarake dhe Traktati i Varshavës, kur udhëhiqet nga një bandë tradhtarësh të marksizëm-leninizmit siç janë Hrushovi dhe shokët e tij? Të gjitha këto organizma ishin të drejta, ishin pozitive, ishin në favor të forcimit të kampit socialist në rrëthana të tjera, por nën dritën e ngjarjeve aktuale, nga të cilat demaskohet qëllimi i vërtetë i Hrushovit e kompani, këto bëhen shumë të rrezikshme. A kanë përfituar vendet tona nga kjo mënyrë bashkëpunimi? Sa rronte Stalini dhe zbatoheshin parimet marksiste-leniniste të bashkëpunimit vëllazëror është gabim dhe e padrejtë të thuhet jo. Ne kemi përfituar, por njëkohësisht kemi qenë vigjilentë, duke qenë kurdoherë të hapur, të dashur, *loyalë* me të gjithë miqtë. Kur erdhën në fuqi Hrushovi dhe grupi i tij këto parime u shkelën, atëherë u zbulua lodra e tyre e ndyrë, dhe, nga qëndrimi i drejtë e parimor i Partisë së Punës të Shqipërisë, kalbësira ra erë dhe, që të mos bëhej sëmundje ngjittëse për ata që s'e kishin kuptuar akoma si duhet këtë lodër të rrezikshme, Hrushovi me Mikojanin e shokët e tyre vendosën t'u bien Partisë së Punës të Shqipërisë, Qeverisë Shqiptare dhe udhëheqjes së tyre për t'i shkatërruar.

N. Hrushovi dhe shokët e tij, duke trumbetuar

«ndërtimin e komunizmit», «mbrojtjen e marksizmit», «unitetin e kampit socialist», trumbetuan me të madhe edhe politikën e tyre të «bashkekzistencës», të «pages», të «botës pa armë, pa ushtri e pa luftëra» etj. Për këto nuk do të zgjatem, se kemi folur edhe herë të tjera. Por cilat janë konkluzionet e një politike të tillë oportuniste dhe revizioniste? Të vihen popujt në gjumë, të shuhet vigjilanca e tyre ndaj kërcënimit imperialist, t'i jepet këtij kohë të armatoset deri në dhëmbë dhe të armatosë edhe satelitet e tij, të shuhet lufta revolucionare e partive komuniste e punëtore në botë, të dobësohet lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të botës.

Fjalë të mëdha e bombastike nga Hrushovi sa të duash, akrobacira sa të duash, ç'thotë sot, nuk thotë nesër. Por në një gjë Hrushovi ka qenë konsekuent: «miqësi», «miqësi» me çdo kusht me imperialistët dhe në radhë të parë me imperialistët amerikanë. Titoja s'ka bërë më shumë se Hrushovi në këtë drejtim. Por veprimet e Titos janë demaskuar gjatë këtyre viteve, kurse këtyre, që po bën e po thotë Hrushovi, akoma s'u ka dalë boja, sepse ato bëhen nga udhëheqësi i shtetit sovjetik, udhëheqësi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, bëhen gjoja nga «një marksist i madh», «i pakorruptuar», «politikan suple, elastik». Në gjithë këtë gamë qëndrimesh mbi politikën e jashtme, Hrushovi ka përdorur autoritetin e Bashkimit Sovjetik për të mbuluar tradhtinë. Kuptohet lehtë se ai në veprimet e tij do të përpinqej të mos shkonte hapur në grazhdin e imperializmit si titistët, por pas çdo ngritjeje të përkohshme të zërit «ndaj veprimeve agresive të imperializmit», vinte periudha e gjatë e qetësisë, e buzëqeshjes,

ë lajkave me imperialistët. Dhe kjo, ta merr mendja, justifikohej me parullat: «Duhet të bëjmë bisedime», «ne s'jemi dogmatikë si Stalini», «ne duhet të bëjmë kompromise» etj., etj.

C'rezultate dha «politika e ndritur e brendshme» e Hrushovit? Në gjithë frontin, në bujqësi e në industri, ai dështoi, por fajin ua hodhi të tjerëve, të cilët ai i spastroi. C'rezultate dha «politika e ndritur e jashtme» e Hrushovit? Kampin socialist N. Hrushovi e përcau. Uniteti tani nuk ekziston. Por shumica dërrmuese e komunistëve të botës lufton për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit me intensitet jo të njëllojtë, në kushte jo të njëjta, por diku të vështira, e diku shumë të vështira. Shumica dërrmuese ka nuhatur se çështjet nuk ecin drejt, nga dikush pengohen. Komunistët e vërtetë e kanë kuptuar ose e ndiejnë erën e tradhtisë së madhe në shkallë ndërkontaktare kundër komunizmit nga revizionistët modernë. Nën maskën e pseudoqetësisë, zjarri revolucionar është ndezur brenda në lëvizjen komuniste ndërkontaktare, në vetë partitë komuniste dhe punëtore të botës. Prandaj lufta heroike e Partisë së Punës të Shqipërisë s'është një luftë e izoluar, e veçuar, po një luftë internacionaliste për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Revizionizmi modern, Hrushovi dhe ortakët e tij e kanë ndierë me kohë tërmetin, toka u digjet nën këmbë, prandaj përpiken me çdo mjet të shuajnë zjarrin që do t'i përpjek. Mbledhja e Bukureshtit s'ishte një gjë e rastit. Atje u bë ndeshja e parë në shkallë ndërkontaktare në mes të marksistëve dhe të revizionistëve modernë.

Hrushovi dhe klika e tij revizioniste, në shkallë ndërkombe tar, sulmoi Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës që mbronte marksizëm-leninizmin dhe që ishte bërë pengesa kryesore me potencial të madh ndërkombe tar kundër tradhtisë së grupit të tij. Ai u orvat, por pa sukses, ta vinte komunizmin ndërkombe tar përra para kësaj alternative: ose Partia Komuniste e Kinës t'i gjunjëzohej atij, të tradhtonte marksizëm-leninizmin, të futej në rrugën e tij, ose të hidhej jashtë lëvizjes komuniste dhe të luftohej si «renegade», si «përçarëse», si «luftënxitëse» etj., etj. Në Bukuresht Partia heroike Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë i thanë: «Ndal!» grupit të N. Hrushovit, renegat i marksizëm-leninizmit e përçarës i kampit të socializmit.

Nuk po hyj në detaje, pse për të gjitha këto jujeni në dijeni. Mbledhja e Moskës ishte ndeshja e dytë e ashpër në mes të marksistëve dhe të revizionistëve modernë. Në ballë të luftës ishin Partia jonë dhe Partia Komuniste e Kinës. Maska Hrushovit iu corr. Komunizmi ndërkombe tar kuptoi më mirë se çfarë po ngjet në gjirin e tij, kudo filloi reflektimi serioz. Demagogjia e Hrushovit ra nga altari, varkës së tij filloi t'i futet mirë ujët, që nuk mund të zbrazet kova-kova.

Filluan edhe rreziqet serioze për klikën e Hrushovit, të cilat tani po pregetitet t'i përballojë, por me shumë vështirësi. Rreziqet për të janë bërë të mëdha. Ai tani gjendet përballë disfatës së turpshme dhe të pashmangshme. Kjo nuk do të thotë aspak se fitorja jonë, fitorja e marksizëm-leninizmit mbi tradhtarët do të jetë e shpejtë, e lehtë. Jo, lufta do të jetë e gjatë, e vështirë, me sakrifica, por fitorja do të jetë e Partisë sonë, fitorja

do të jetë e marksizëm-lenismit. Ne duhet të kalitemi, të preqatitemi për një luftë të gjatë e të pamëshirshme kundër armiqve që kanë në duar forca kolosale ekonomike dhe ushtarake, që akoma maskohen dhe do të maskohen, që kanë zanat dredhitë, shpifjet, intrigat, spiunazhin, diversionin etj., që kanë ndihmë direkt dhe në mënyrë të maskuar nga imperializmi, nga borgjezia reaksionare, nga tradhtarët dhe nga plehrat që hedh tej shoqëria. Por ne kemi popullin me vete, kemi Partinë si çeliku, kemi drejtësinë, kemi të fortë diktaturën e proletariatit, kemi busullën e pagabueshme, marksizëm-lenismin, kemi guximin, trimërinë dhe s'u trembcmi sakrificave. Prandaj fitorja është jona!

S'do të zgjatem mbi ç'na kanë bërë dhe po na bëjnë klika revizioniste e Hrushovit dhe miqtë e shokët e tij të vendeve të demokracisë popullore të Evropës. Ju ato i dini. Praktikisht të gjitha marrëdhëniet ata i kanë prerë. Bllokadë totale. As imperialistët s'kanë arritur të bëjnë një bllokadë të tillë të perfekcionuar kundër një vendi socialist që është armik i betuar i tyre. Revisionistët hrušovianë e bënë kundër nesh. Por duhet ta keni të qartë kuptimin e bllokadës kundër vendit tonë. Pse e bëjnë? Sepse kanë frikë të madhe nga Partia e Punës e Shqipërisë, nga vija e saj e drejtë, e cila u shton zjarrin dhe hallet brenda në partitë dhe në popujt e tyre, që i mbajnë në errësirë, që i gënjejnë, që i mashtrojnë me shpifje. Por më kot, era e freskët u hyn nga dyert e dritaret. Duke u shpallur luftë të pamëshirshme Partisë sonë marksiste-leniniste, Komitetit tonë Qendror, udhëheqësve tanë, ata kanë për qëllim të bëjnë orvatjen e fundit që do të thotë «ose dorëzo-

huni, ose do t'ju mbytim». As kërcënimi i parë dhe as i dyti nuk do të kenë sukses, klikën e Hrushovit e pret disfata.

Letra që lexuat ka dy qëllime: për konsum të brendshëm dhe për konsum të jashtëm, ndërkombe tar. Pavarësisht se ata nuk shënojnë në fund të letrës si zakonisht se «këtë dokument ua komunikojmë edhe partive të tjera», por sigurisht ua kanë komunikuar.

E para, ata s'kanë fare turp dhe as që preokupohen se demaskohen në sy të Partisë sonë duke gënjer hapur me mohimet e tyre skandaloze sa të thonë se në Bukuresht «s'ngjau asgjë, se atje nuk u atakua asnë partit» pra, sipas tyre ne, shqiptarët «gënjejmë dhe shpifim». Kjo kryesisht është për konsumin e jashtëm, për të gënjer të tjerët, duke thënë se «s'është e vërtetë që ne kemi atakuar Partinë Komuniste të Kinës». Hrushovi përdor shpifje e taktika që s'mund të gënjejnë njeri, veçse naivët.

E dyta, përsa u përket të gjitha poshtërsive që kanë bërë kundër nesh dhe që janë të faktuara, ata i rrum-bullakosin pa pikë skrupuli dhe pür to fajtorë na bëjnë ne. Dhe kjo është për konsumin e jashtëm, e përmble-dhur dhe e lehtë që të përdoret nga propagandistët e tyre, të cilët punojnë për demaskimin e Partisë së Punës të Shqipërisë në partitë e tjera motra.

E treta, sipas tyre, mosmarrëveshjet në mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe grupit të Hrushovit s'kanë as karakter politik, as ideologjik. Por atëherë ç'karakter kanë? Nga letra e udhëheqjes sovjetike del se te ne paska një punë armiqësore nga agjentë të fshehtë të imperializmit që veprojnë kundër Partisë së

Punës të Shqipërisë (kulti i individit, familjariteti në Komitetin Qendror, shtypja e demokracisë, pushkatimi i «heronje» etj., etj.) dhe në planin ndërkombëtar (likuidimi i demokracisë popullore në Shqipëri, bashkimi me Perëndimin, legata italiane po dyfishohet dhe lufta kundër Bashkimit Sovjetik, kampit të socializmit, kundër unitetit). Këto shpifje bëhen edhe për konsum të brendshëm, por sidomos për konsum të jashtëm.

Për vendin tonë duan të përdorin parullën e jezuitit: «Shpif, shpif përherë, se diçka mund të mbetet». Por ata e dinë fare mirë çfarë efekti do të bëjnë këto shpifje në popull dhe në Partinë tonë dhe çfarë urrejtje e thellë dhe e ligjshme do të ngjallet për këtë grup renegatësh. Por kjo aq u bën, ata e dinë që janë të djegur te ne. Këto ata i hedhin si ushqim për revizionistët e maskuar që ndodhen te ne, për tradhtarët, për renegatët dhe agjentët, të cilët merren nga revizionistët sovjetikë haptas në mbrojtje.

Çështja e depërtimit të revizionizmit në një numër partish komuniste dhe punëtore është një preokupim i madh për të gjitha partitë e vërteta komuniste e punëtore të botës dhe, kundër këtij depërtimi, ato luftojnë me vigjilencë dhe me ashpërsi marksiste. Por historia e partive komuniste dhe punëtore të botës naka mësuar se, kur shuhet vigjilanca revolucionare, armiqjtë veprojnë, duke organizuar grupe e rryma dhe deri në uzurpimin e udhëheqjes së partisë e të shtetit. Shembull kemi ish-Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe tani Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Udhëheqja revizioniste sovjetike, për të shpëtuar

nga demaskimi, i del punës përpëra dhe na akuzon ne, si «agjentë të imperializmit». Kështu veprojnë revizionistët hrushovianë me të gjithë ata udhëheqës partie, qofshin brenda në Bashkimin Sovjetik, qofshin jashtë Bashkimit Sovjetik, që s'u binden direktivave dhe vijës së tyre.

Jo vetëm kush nuk radhitet me grupin e Hrushovit do të pësojë «fatin e udhëheqësve shqiptarë», të cilët i akuzon si «agjentë të imperializmit», por në letër lënë të kuptohet se të gjithë ata që do të ngrenë krye kundër këtyre «agjentëve të imperializmit», do të cilësohen si martirë dhe heronj të komunizmit ndërkombetar!

Eshtë pra i qartë qëllimi i letrës së tyre për konsum të jashtëm dhe përmblidhet në këto gjëra: në qoftë se ndonjë udhëheqës i ndonjë partie komuniste e punëtore ngrë krye, atëherë ai është «agjent i imperializmit». Prandaj zgjidh e merr. Në rast se ngrenë krye kundër Hrushovit, atëherë letra u bën thirrje Liri Belishovave, Koço Tashkove, Maqo Çomove, Panajot Plakëve dhe të tjerë tradhtarëve që të ngrihen kundër këtyre «agjentëve të imperializmit» dhe të mos kenë frikë, se ata do t'i mbrojë Hrushovi dhe do t'i quajë «heronj të komunizmit». E tillë është kjo letër provokuese e shkruar nga provokatorë, që armë kanë shpifjet, shantazhet, kërcënimet, krimet.

Të vjen shumë keq dhe është e tmerrshme që këta provokatorë dhe kriminelë veprojnë nën emrin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por megjithatë, kjo s'do t'u sjellë fitime gjatë. Këta demaskohen me veprat e tyre. Banda e Hrushovit është futur thellë në llumin e tradhtisë, prandaj ata s'mund të veprojnë dhe s'mund

të mendojnë veçse si tradhtarë; çdo veprim i tyre është i helmatisur dhe komprometues për ta.

Shikoni, shokë, me kujdes letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atje s'do të gjeni asgjë me logjikë të shëndoshë, çdo gjë është bazuar në shpifje dhe në rrugë policore. Argumentet e tyre janë po ato që kanë përdorur klika e Titos dhe e Rankoviçit me shokë, pa marrë as mundimin më të vogël për t'i maskuar, të paktën nga forma. Ç'tregon kjo? Degjenerim nga njëra anë dhe unitet të plotë me titistët nga ana tjeter. As degjenerimi as uniteti i tyre me titizmin s'na çuditin. Këtë gjë e kishim parashikuar, por tash çdo ditë që kalon, kjo vërtetohet me fakte e me dokumente të reja që na i japin ata vetë.

Puqja e revisionistëve hrushovianë me titizmin është tash e konsumuar, kjo ka marrë fund, pavarësisht nga disa «forma» false që nxjerrin nganjëherë. Në shumë drejtime ata veprojnë solidarë me titistët. Shumë herë Titoja ia ka ngatërruar disi punët ortakut të tij Hrushov, por ky e ka rregulluar shpejt ngutjen e Titos, i cili e nxit të dalë tashmë hapur. Revizionizmi modern është mbulesa e tyre e përbashkët, është brendia e tyre, ideologjia e tyre. S'kanë asnje rëndësi disa «thumba» që ata i hedhin herë pas here Titos në projektprogramin e tyre, ose në ndonjë artikull; ata s'vuajnë nga këto forma, janë marrë vesh me kohë që veprime të tilla u duhen për t'u maskuar. Jemi, pra, përballë një fronti të gjerë revisionist. Revizionizmi në fuqi s'është më siç ishte, ai s'është vetëm në Jugosllavi. Sot revisionistët modernë janë në fuqi në Bashkimin Sovjetik, në Poloni, në Gjermaninë Lindore, në Bullgari, në Hungari etj.

Luftën nuk do ta kemi të lehtë, prandaj, na duhet, Parti e popull, të jemi shumë vigjilentë, në gatishmëri dhe në unitet të plotë, me nerva të qetë e të çeliktë. Në këtë luftë s'jemi vetëm, jemi me miliona komunistë dhe ligjet e marksizëm-lcninizmit veprojnë kudo me intensitet. Jemi vërtet të rrethuar nga armiq, por dhe me këtë rrethim jemi mësuar; lindëm në rrethim, jetuam në rrethim dhe rrethimin do ta çajmë patjetër. Në këtë luftë, të pabarabartë, kur aktualisht revisionistët modernë i kanë drejtuar armët kundër nesh, do të ketë edhe nga ata që do të lodhen. Ne e kemi për detyrë të mos i lëmë të rrëzohen. Do të ketë edhe nga ata që do të lëkunden. Ne e kemi për detyrë t'u forcojmë bindjen. Do të ketë gjithashtu edhe nga ata që do të gjunjëzohen. Të përpinqemi të gjunjëzohen sa më pak. Por lufta i ka këto dhe luftën s'e kemi filluar sot, ajo ka 20 vjet që ka filluar dhe vazhdon për ne komunistët shqiptarë. Dhe sa më tepër e sa më mirë luftojmë për kauzën e madhe të Partisë dhe të popullit, të socializmit dhe të komunizmit, aq më mirë dhe aq më të fortë do ta ndiejmë veten.

Shikoni si ecin përpara Partia dhe populli, pa u trembur, pa u përkulur, pa kurrfarë paniku, me besim në fitore. A tregon kjo shenjat e një të sëmuri? Të kundërtën! Shikoni me ç'vrull të madh, entuziazëm dhe vetëmohim të pashoq po punohet, po ndërtohet, po realizohen gjithë këto vepra. A tregon kjo shenjën e degjenerimit? Të kundërtën! Shikoni në çfarë lartësie, në çfarë qartësie politike dhe ideologjike qëndrojnë, mendojnë dhe veprojnë Partia dhe populli ynë. A është kjo e rastit, a është kjo e përkohshme? E kundërtat!

Në luftë e në zjarr kaliten, mprehen, Parti dhe popull. Në çdo kthesë historike ka pasur njerëz që kanë devijuar nga rruga e drejtë e Partisë, që e kanë tradhtuar Partinë, por ajo i ka fshirë pa mëshirë nga rruga e saj e drejtë, i ka flakur tej plehrat, pa hezituar aspak. E kuptojmë fare mirë ç'qëllim ka «demokratizimi» i Hrushovit, demokraci për renegatët, për tradhtarët, për spiunët, për revisionistët, pra, liberalizëm, që t'u pregetitet më lehtë dhe më shpejt varri partisë, atdheut, socializmit dhe komunizmit. Ne as na tremb, as na gënjen demagogjia e klikës së Hrushovit. Ne luftojmë për të sotmen dhe për të ardhshmen, me flamurin e marksizëm-leninizmit, të papërkultur e të panjollosur. Na quajnë «stalinistë». E kemi për ndër! Na quajnë «dogmatikë», na quajnë «nacionalistë», na quajnë «sektarë», na quajnë gjithashtu edhe «revisionistë», tash na bënë dhe «agjentë të imperializmit». Nga armiku ne nuk presim lëvdata, po na lavdëroi ai duhet të rishikojmë punën tonë se mos kemi gabime. Ne jemi në rrugë të drejtë, s'kemi shkelur e nuk do të shkelim kurrë në dërrasë të kalbur, për këtë arsyе na sulmon armiku.

Prandaj, shokë, në momente të tilla të vështira, duhet të mprehim vigjilencën dhe punën ta ngremë në nivelin e duhur, asnjë lëshim, asnjë zbutje ndaj armiqve. Partinë, popullin duhet t'i mbrojmë me heroizëm, me pjekuri, me gjakftohtësi. Armiqtë do të përdorin lloj-lloj mënyrash, të mos gënjehem kurrë nga buzë-qeshjet e tyre të rastit. Ata i ka zënë gangrena revisioniste, ata s'kanë shërim, likuidimi i tyre do të spastrojë rrugën tonë të fitores. Ata do të orvaten të

na gënjejnë, të na frikësojnë, të na bëjnë shantazhe. Askush të mos gënjetet, askush të mos frikësohet. Cilido të mendojë nënën Parti, të trokasë te zemra e saj e çeliktë, bujare, e drejtë, e gjerë për fëmijët e saj; në qoftë se për një moment ndonjëri lëkundet, ose sëmu-ret, ajo si kurdoherë do ta nxjerrë të shëruar në breg.

Të gjithëve të mos na hiqen për asnjë moment nga mendja, nga kujtesa, vuajtjet shekullore të popullit tonë, heroizmat, sakrificat, gjaku i derdhur rrëke nga shokët që na u vranë e na vriten në krye të detyrës, të mos harrojmë për asnjë çast djersën që kanë derdhur e po derdhin populli e Partia, për të ndërtuar lumturi-në e begatinë e njerëzve tanë, të brezave të ardhshëm të Shqipërisë së re. Të mos harrojmë për asnjë çast se kemi gjithashtu përgjegjësi para lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kemi detyra për t'i kryer dhe t'i kryej-më me ndër.

Sic e shohim, jeta e komunistëve shqiptarë nuk ka qenë dhe nuk është e rehatshme. Por s'ka gjë, ajo është e lavdishme, pse është një jetë luftarake, revolucionare, një jetë që meriton me të vërtetë të jetohet. Barutin ta mbajmë të thatë dhe barut në zemër e në duar kemi aq, në mos më shumë nga sa na nevojitet, prandaj, me një vigjilencë të ngritur në kulm, të mbajmë ngrehur pushkën, po ashtu të mbajmë fort kazmën, të punojmë me vrull, të mos i lëmë ato kurrë pas dore. Popullit, në luftë dhe me luftë, në punë dhe me punë duhet t'ia krijojmë, duhet t'ia sigurojmë mirëqenien.

Armiqtë na kanë krijuar vështirësi të mëdha në lëmin ekonomik, ata do të vazhdojnë edhe më tej. Ne do të luftojmë me të gjitha forcat tona, por populli i

madh kinez e Partia Komuniste e Kinës, si miq besnikë, do të na ndihmojnë pa u kursyer. Ne komunistët shqiptarë, kudo që jemi, kudo që punojmë, t'i kemi parasysh situatat e reja dhe t'i kryejmë me përgjegjësi detyrat. Të jemi shembull në çdo punë, të tregohemi kurdoherë të pjekur, gjakftohtë, të guximshëm, të ashpër kundër armikut, të jemi mjekët e të sëmurëve, të jemi mësuesit e të paditurve, të jemi punëtorë të palodhur dhe udhëheqës të urtë, të jemi komunistë të vërtetë, me një fjalë, komunistë të një lufte të madhe.

Partinë ta ruajmë, ta ruajmë, ta ruajmë, me dashuri, me dhëmishuri, me vigilencë, pse atje drejtohen shigjetat e armiqve; të ruajmë si sytë e ballit unitetin e saj, pse atje drejtohen shigjetat e armiqve, të ruajmë kuadrot e Partisë dhe të pushtetit nga shigjetat e helmatisura të armiqve, t'i ruajmë nga dredhitë e tyre, nga shpifjet e tyre. Të jemi të lidhur ngushtë me popullin, të rrojmë thjesht, tok me të, të ndajmë me të gëzimet dhe hidhërimet, si në kohët më të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare.

Të gjitha këto janë ngritur nga Partia në një nivel të lartë, akoma më lart të ngrihen, akoma më fort të kaliten. Hrushovianët na e kanë shumë frikën. Nga ne do ta pësojnë, pse s'jemi vetëm, me ne është ushtria shumëmillionëshe e marksistë-leninistëve të botës. Le të diskutojmë, pra, shokë, mbi këto situata, le të marrim vendimet e duhura, të bëhen këto plenumë të Komitetit Qendror një shkollë e madhe teoriko-politike për aksion, për kuadrot e Partisë sonë, le të armatosemi për betejat që do të kemi përpara.

Partinë tonë dhe Komitetin Qendror nuk i frikë-

sojnë dhe nuk i lëkundin letrat e Hrushovit dhe të pasuesve të tij. Partinë tonë dhe Komitetin e saj Qendror nuk i frikësojnë bllokadat, ata nuk tremben as nuk tronditen pse Valter Ulbrihti nuk i ftoi Partinë dhe Qeverinë tonë në Berlin, me rastin e festës kombëtare, por ftoi Jugosllavinë titiste. Kjo s'na habit. Një fjalë e urtë popullore thotë: «Thuamë me kë rri, të të them cili je». Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Komitetin e saj Qendror s'i tronditin aspak veprimi i revizionistëve hrushovianë që nuk e ftuan Partinë tonë në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Hrushovi mendon se po na izolon, po na poshteron, po na diskrediton. Ai gabohet, ai demaskohet, ai është në pozita të vështira dhe të rënda.

Ne jemi të pregatitur për çdo situatë. Për ne nuk është i papritur çdo veprim armiqësor i tyre. Ne e kemi të qartë vijën që na caktoi Kongresi ynë IV. Ne do ta zbatojmë atë me përpikëri. Ne do t'i japim klikës së Hrushovit, hap pas hapi, grushtet që meriton. Revizionizmi modern, kjo agjenturë e imperializmit dhe e borgjezisë reaksionare botërore, që është bërë rrreziku kryesor në lëvizjen komuniste botërore, duhet luftuar pa lëkundje, pa mëshirë, deri në fund, deri në shpartallimin e tij të plotë.

Partia jonë është në pararojë të kësaj lufte të lavdishme. Ne do t'i kryejmë detyrat tona me nder, pa marrë parasysh asnje sakrificë.

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

*Batohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PARTIA JONE RINOHET VAZHDIMISHT, ATE E PERTERIT RINIA

*Nga fjala nē mbledhjen e përbashkët të Plenumit
të Komitetit të Partisë dhe të Plenumit të Komitetit
të Bashkimit të Rinisë të Rrethit të Durrësit*

14 tetor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe të Partisë dhe të rinisë,

Ju përshëndes në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe ju uroj suksese akoma më të mëdha në punën tuaj! Ju vetë e thatë këtu, nëpërmjet shokëve që folën, se edhe në këtë rreth Partia ka kryer një punë të madhe. Kështu ndodh në gjithë vendin tonë, këtë e thonë i madh e i vogël. Sa ndryshim ka në mes jetës së rinisë së sotme dhe asaj të mëparshmes, ky ndryshim është si nata me ditën. Ditët e bardha që gjëzojmë sot i sollën Partia, marksizëm-leninizmi, i sollën lufta dhe përpjekjet e popullit, në ballë të të cilit u vunë të rinjtë e të rejat, punëtorë, fshatarë, shkollarë.

Sigurisht, pa Partinë populli ynë do të ishte në robëri, në errësirë dhe në vuajtje. Atë e shpëtoi via e Partisë, e cila ka qenë kurdoherë e drejtë dhe e pag-

buar. Këtë të vërtetë Nikita Hrushovi na e merr së prapthi e na thotë se Lenini ka theksuar se s'ka parti marksiste që të mos gabojë. Por për të gjithë ne është e qartë se kur themi që Partia jonë nuk ka gabuar, duam të theksojmë se nuk kemi gabuar në vijë, nuk jemi larguar kurrë nga pozitat marksiste-leniniste. Partia jonë ka vepruar në një vend të vogël e të rrethuar nga kapitalistë dhe revizionistë, ajo kurdoherë ka vënë të gjitha forcat e saj për të mbrojtur çështjen e popullit. Sikur Partisë sonë t'i kishte shkarë këmba nga vija marksiste-leniniste nuk do të ishte këtu ku është sot. Partia jonë e mësoi marksizëm-leninizmin në luftë dhe në praktikë, e mësoi atë në jetë dhe në libra, e mësoi nga eksperienca e vet, nga eksperienca e Partisë Bolshevike dhe e gjithë lëvizjes komuniste ndërkontinentare.

Lufta që ka bërë Partia jonë ka qenë një shkollë e madhe dhe e lavdishme. Nën udhëheqjen e Partisë janë arritur gjithë këto suksese. Ju bëtë këtu bilancin e pasur të punës suaj. Të gjitha sukseset në vendin tonë u arriten në saje të vijës së drejtë të Partisë, që pasqyron aspiratat e popullit dhe mbështetet fuqimisht nga populli. Kjo vijë e drejtë e Partisë sonë mbështetet njëkohësisht edhe nga të gjitha ato parti komuniste e punëtore, që udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi, nga idetë e përpunuara nga Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Njerëzit nuk lindin të formuar me botëkuptimin marksist. Marksizëm-leninizmi mësohet gjatë jetës, mësohet në libra, por mësohet edhe në luftë, në praktikë. Librat e marksizëm-leninizmit janë të hapur për të gjithë ata që duan ta mësojnë, që nga punëtori më i

thjeshtë e deri te ndonjë borgjez, në rast se ky dëshiron të braktisë klasën e vet, të përmirësohet dhe të ndërrojë rrugë. Pra, marksizëm-leninizmi nuk është privilegji i disa njerëzve, por fener ndriçues për të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës, për të gjithë njerëzit përparimtarë, ai preqatit ideologjikisht partitë e klasës punëtore dhe është një burim i pastershëm frymëzimi dhe forcë e madhe për të ecur kurdoherë përpara.

Nikita Hrushovi, për të diskredituar partitë që janë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, shpif kundër tyre. Pikërisht këtë bën ai dhe grapi i tij edhe kundër Partisë sonë. Si antimarksist që është Hrushovi çuditet e thotë: «Kush është kjo Partia e Punës e Shqipërisë që guxoi të na kritikojë ne?». Pikëpamje të tilla të N. Hrushovit janë thellësisht shoviniste dhe Partia jonë i dallon mirë ato se nuk është pa eksperiencë. Anëtarët e saj flasin tani me kompetencë. Dhe jo vetëm anëtarët e Partisë. Shoqja që foli këtu, ndoshta është pa parti, por ajo foli tamam si një komuniste e vërtetë, që i kuption çështjet jashtëzakonisht mirë dhe është e vendosur ta mbrojë me të gjitha forcat vijën e Partisë së saj. Ne pamë të dilte këtu në tribunë edhe një rekord-mene, që më parë ruante lopët. Ajo foli shumë mirë dhe foli për problemet e popullit më mirë se ata politikanët borgjezë të vendit tonë që hiqeshin të ditur dhe bënин demagogji, por që në kohën e tyre jepnin para me fajde dhe e shitën atdheun te fashistët italianë e gjermanë. I tillë është marksizëm-leninizmi, ai është libër i hapur për të gjithë njerëzit.

Partia jonë nuk është më e re dhe e vogël, ajo

është e madhe dhe e pjekur nga çështja që mbron. Qofsh i madh ose i vogël, çështja e madhe e komunizmit është e përbashkët për të gjithë komunistët. Marksizëm-leninizmi nuk njeh të madh e të vogël, të gjithë janë të barabartë para tij. Ne kurrë nuk e kemi mohuar dhe as e mohojmë eksperiencën që kemi marrë nga Partia e Leninit dhe e Stalinit. Ne e dimë se Partia Bolshevikë lindi dhe u rrit në furtuna, për një kohë të gjatë ajo mbeti vetëm, por më në fund i çau dallgët e armiqve dhe doli fitimtare. Mirëpo sot në krye të saj ka ardhur një grup renegatësh të çështjes së madhe të komunizmit. Sot lëvizja komuniste ndërkombëtare po kalon situata të vështira, sepse kundër saj vepron revizionizmi modern. Po forca e klasës punëtore dhe e marksizëm-leninizmit do t'i përmbyssë patjetër tradhtarët e marksizëm-leninizmit në mos sot, nesër.

Partia jonë, në saje të vijës së saj të drejtë mark-siste-leniniste diti t'ia ndryshojë faqen vendit tonë. Ajo diti ta edukojë popullin me një patriotizëm të madh dhe të thellë, t'ia bëjë të qartë përsë lufton dhe ku shkon, ajo ia ka hapur kështu sytë gjithë popullit. Jo vetëm kaq, por Partia i ka dhënë popullit edhe mjetet që duhen për të ndërtuar jetën e tij të lumtur. Ne nuk duhet të mburremi, komunistët nuk e kanë zakon këtë, por e vërteta është se gjatë këtyre 17 vjetëve në Shqipëri janë arritur suksese të mëdha në industri, në bujqësi, në arsim dhe në kulturë. Këto i ka bërë populli shqiptar me vitalitetin e tij të mrekullueshmë, me entuziazmin e tij të madh, me zgjuarsinë e tij, nën udhëheqjen e Partisë. Pa Partinë, pa popullin shqiptar, pa përpjekjet dhe heroizmin e tij, këto rezultate nuk mund

të arriheshin vetëm me ndihmat që mund të na jepnin të tjerët.

Pra, rezultatet kryesisht janë arritur në saje të përpjekjeve që ka bërë populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Ndihmën e Bashkimit Sovjetik ne kurrë nuk e kemi mohuar dhe nuk e mohojmë. Atë nuk na e ka dhënë Hrushovi, por na e kanë dhënë me zemër të hapur populli vëlla sovjetik, klasa punëtore sovjetike, Josif Stalini. Në kohën e Stalinit BS na dha kredi për të ngritur një sërë veprash, disa prej të cilave u përfunduan pas vdekjes së tij. Një pjesë e këtyre kredive na u falën dhe ne shprehëm mirënjojen për këtë. Por më vonë u kuptua se kjo falje ishte bërë me qöllim. Partia dhe populli ynë ditën t'i përdorin si duhet këto ndihma dhe t'i japid popullit të mira materiale. Pikërisht nga një punë e tillë e madhe dhe e drejtë e Partisë, nga ky heroizëm i madh për çështjen e Partisë dhe të popullit u arrit të ngrihet niveli i jetesës dhe të lulëzojë vendi ynë. Edhe në të ardhshmen jeta e popullit tonë do të shkojë gjithnjë duke u përmirësuar. Si mendoni ju, shoqe të tregtisë, mund ta them tanë sekretin? Besoj se kam të drejtë ta them atë 10 minuta përpara. Sonte do të ulen përsëri çmimet.

Pra, gjatë kësaj periudhe u ngrit në vendin tonë industria socialiste, që i shërben ngritjes së nivelit të jetesës të popullit. Me ndërtimin e veprave të reja industria do të fuqizohet edhe më shumë gjatë këtij pësëvjeçari. Minierat tona gjithashtu do të forcohen e do të zgjerohen edhe më tepër. Gjeologët tanë janë të rinj, por ata i zbulojnë pasuritë e nëntokës. Ju keni dëgjuar se në Kukës janë zbuluar burime të reja bakri dhe

vazhdojnë punimet për zbulime të tjera të mëtejshme. Me specialistët çekë ne kishim zbuluar hekur-nikelin e Pishkashit, kurse tanët zbuluan fusha të reja, nga të cilat ne mund të sigurojmë më shumë mineral hekuri në vit, përveç Pishkashit. Por nëntoka jonë ka akoma minerale jashtëzakonisht të vlefshme. Të gjitha këto do të shfrytëzohen për mirëqenien e popullit shqiptar.

Në bujqësi janë bërë gjithashtu përparime. Unë nuk dua të zgjatem për këtë sektor, sepse ju i dini fare mirë gjendjen dhe detyrat që na shtrohen.

Edhe në arsim e kulturë janë bërë përparime të mëdha. Para së gjithash, kujdes i veçantë, i është kushtuar arsimimit të rinisë, por edhe më të rriturit në moshë e kuptojnë se pa dituri dhe pa arsim nuk mund të ecet përpara, se tani ka ardhur një kohë që duhet të mësojnë të gjithë. Prandaj kudo mësohet dhe punohet për ta bërë jetën e popullit sa më të mirë dhe të kultuar. Arsimi tani jo vetëm është zgjeruar shumë, por do të vijë dita që njerëzit nuk do të mjaftohen vetëm me shkollën 7-vjeçare. Nuk do të jetë larg koha, kur në masë, edhe te ne, të rinjtë e të rejat, pa përjashtim, do të mbarojnë shkollën e mesme.

Vija e Partisë sonë është e lavdishme. Partia është si nëna, ndërsa fëmija është rinia jonë. Nëna bën çdo përpjekje që fëmija e saj të bëhet i ndershëm, patriot dhe i zoti për punë. Rinia është e ardhshmja, prandaj në qoftë se tani në vendin tonë kemi një rini të mirë dhe patriote, kjo i detyrohet shumë Partisë. Por Partia e di se, që të mos vdesë e të mos sklerozohet, duhet të vijë vazhdimisht në dejt e saj gjak i ri. Njerëzit lindin, rriten, plaken dhe në fund vdesin. Ky është ligji i

natyrës, kurse Partia jonë si Parti komuniste rinohet vazhdimesht, atë e përtërit rinia, prandaj ajo tregon kujdesin më të madh për rininë.

Në kemi një rini të mrekullueshme. Kjo ndodh sepse populli ynë ka lindur e ka rritur një rini, që ruan dhe zhvillon traditat dhe virthet e tij më të mira. Nga një popull me virthete të larta si ky yni, patjetër do të dilte një rini me karakter të tillë. Kjo shihet jo vetëm në kohën tonë, por edhe në të kaluarën. Njerëz të ndryshëm kanë shkruar për vendin tonë. Një nga ata, që ka shkruar, është edhe shkrimitari përparimtar anglez Bajroni. Ai ka bërë poemën «Çajld Harold». Këtu ai me simpati të thellë flet për Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilët i njuhur në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Po me një simpati të thellë, me dashuri dhe respekt për trimërinë, zakonet dhe virthet e shqiptarëve Bajroni flet edhe në letrat që u dërgonte nënës dhe miqve të tij gjatë udhëtimeve që bëri në viset tona. Kur udhëtoja nëpër Shqipërinë e Jugut, thotë ai, në një nga këto letra, më zuri nata në një fshat, vajta në një shtëpi, ku më dhanë të haja dhe të pija, më dhanë krevat për të fjetur, më shërbyen për t'u larë, sipas zakonit. Kur ika, nxora paratë, por i zoti i shtëpisë më tha me krenari se «dua të më duash, jo të më paguash».

Populli shqiptar ka pasur tradita të mira dhe këto i ka ruajtur Partia, me këto tradita të larta ajo ka edukuar dhe edukon rininë tonë. Rinia jonë ka bërë dhe bën heroizma në luftë dhe në punë. Gjatë luftës ajo e tregoi veten, po kështu edhe pas Çlirimit. Disa shokë përmendën këtu aksionet që ka bërë rinia. Këto aksione nuk u ndalën kurrë, ato vazhdojnë dhe do të vazhdojnë.

Ndërtimi i socializmit nuk është një punë e lehtë dhe pa sakrifica, përkundrazi është një punë e vështirë, më e rëndë se Lufta Nacionalçlirimtare. Disa prej jush, që janë në këtë sallë, kanë luftuar, disa më të rinj jo, sepse në atë kohë as kishin lindur. Ka pastaj të tjerë që tani janë rreth 30 vjeç, por atëherë ishin fare të rinj, ata mund të thonë: «Ah, si nuk mundëm edhe ne të luftonim!». Jo, ata s'kanë pse ta thonë këtë, sepse luftën e bëjnë tani, bile edhe më të ndërlikuar. Atëherë detyra kryesore për ne ishte të zinim shtigjet dhe t'i binim armikut, kurse sot duhet të punojmë, të mësojmë, të vigjëlojmë, të zbulojmë e të kapim edhe armiq. Për këtë arsyе ne themi se puna për ndërtimin e socializmit është një punë sa e lavdishme, aq edhe e vështirë.

Punës me rininë duhet t'i kushtohet kujdes më i madh. Për këtë u bë edhe mbledhja e përbashkët e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Komitetit Qendror të BRPSH, e cila ka një rëndësi të veçantë. Për këtë arsyе, Partia vendosi që edhe në rrethe të bëhen mbledhje të përbashkëta të plenumit të komitetit të Partisë dhe të komitetit të BRPSH.

Sikurse u tha këtu, shumë nga ju i kanë realizuar detyrat që ju janë ngarkuar dhe keni arritur rezultate të mira. Ne duhet të jemi modestë, prandaj duhet thënë se ka midis nesh edhe njërz me të meta, që nuk i kanë rezultatet e duhura në punë. Tani nuk është më ajo kohë, kur të vjetrit nuk ua jepnin lehtë zanatin të rinjve, tani më të vjetrit ua japid me dëshirë zanatin të rinjve.

Pra duhet treguar kujdes i madh për rininë, atë duhet ta rritim të shëndoshë e të pastër qysh në fëmijëri

dhe për këtë Partia na i ka dhënë të gjitha mundësitë. Mund të ketë nëna ose baballarë që nuk i kuptojnë çështjet pedagogjike, se nuk kanë ngritjen e duhur në këtë drejtim, por çështja është te interesimi për fëmijët, që ata të venë në shkollë, të mësojnë mirë, të jenë të pastër e të ndershëm, të duan atdheun dhe Partinë. Kjo ka rëndësi të madhe. Domethënë ta edukojmë brezin e ri me tiparet e njeriut të ri, me moralin komunist dhe me traditat e shkëlqyera të popullit shqiptar. Po t'ia arrijmë kësaj, atëherë kurrën e kurrës nuk do të ketë mortje Partia jonë, sepse në Parti do të vijnë njerrëz të kalitur e të devotshëm për atdheun e për socializmin. Kjo çështje duhet të jetë preokupacion jo vetëm i komunistëve, por edhe i njerëzve pa parti, i nënave dhe i baballarëve.

Organizata e rinisë është e fuqishme, ajo ka në gjirin e saj të rinj të vendosur për çështjen e Partisë dhe të popullit, patriotë dhe punëtorë të palodhur, por ka të rinj, që ne duhet t'i vëmë më mirë në lëvizje për ndërtimin e socializmit, për racionalizimet, për kursimet, për të mësuar sa më mirë dhe sa më thellë shkençën dhe që të gjitha këto t'i vënë në shërbim të popullit. Organizata e rinisë duhet të luftojë edhe kundër mbeturinave mikroborgjeze jo vetëm në radhët e saj, por edhe në popull. Ne jemi realistë, dhe si të tillë nuk mund të themi se ndërgjegjja jonë është spastruar nga këto mbeturina. Të gjithë kemi nga një gjë të vogël përbrenda që duhet ta zhdukim. Ta bësh këtë nuk është një gjë e lehtë. Për këtë duhet zhvilluar një luftë e përditshme në rrugën marksiste-leniniste, prandaj çdo mëngjes duhet të rishikojmë punën dhe veten to-

në dhe të bëjmë kundër këtyre mbeturinave një luf-
të të vendosur.

Por me gjithë këto, me gjithë rrethimin kapitalist
dhe revizionist, me gjithë presionin armik që ushtro-
het ndaj Shqipërisë, rinia jonë është e paprekur nga
sëmundjet e pikëpamjet dekadente borgjezo-revizio-
niste, që po përhapen në Bashkimin Sovjetik edhe në
mjaft vende të demokracisë populllore. Në kemi një rini
të pastër, sepse në Shqipëri rinia jeton dhe lufton në rrug-
ë të shëndoshë, në rrugën marksiste-leniniste. Ajo nuk
është një rini e çoroditur, megjithëkotë, duhet të punoj-
më që ta forcojmë gjithnjë e më shumë organizatën e saj.

Forcimi i organizatës së rinisë dhe i rinisë në përgjithësi duhet të bëhet nëpërmjet punës. Ne themi se
puna është nder, sepse duke punuar lulëzojnë të gjitha
virtytet e mira, ndërsa atje ku ka përtaci, atje ku nuk
punohet, zhvillohen veset më të këqija. Ne ndryshuam
programet e shkollave, për të bërë lidhjen e teorisë me
praktikën, për të lidhur mësimin me jetën. Ndryshimet
në programet e shkollave kanë për qëllim që rinia
të mos ndahet nga puna, por përkundrazi të edukohet
me atë frymë që ajo ta dojë punën me gjithë shpirt, të
kuptojë se në punë do të kalitë veten e saj. Sot ne
shohim më kënaqësi se nxënësit dhe nxënëset e shko-
llave tonë kanë mundësi, që krahas lëndëve teorike të
bëjnë njëkohësisht edhe punë praktike në fabrikat që
kemi ngritur, pranë kopshteve shkollore apo në fushat
e kooperativave, në qytete dhe në fshatra. Shkollat eksperimentalë që kemi ngritur vërtetojnë në praktikë
se programi i ri që kemi aprojuar është mbi baza të
shëndosha. Në të ardhshmen do të kemi nxënës më

shumë, do të kemi edhe kërkesa më tepër nga nxënësit, por do të kemi edhe industri më të madhe, sepse plani ynë i tretë pësëvjeçar, i cili do të realizohet patjetër, parashikon të ngrihen me dhjetëra e 'dhjetëra kombinate, fabrika e ndërmarrje të reja dhe rinia jonë do të ketë mundësi të zbatojë në shkollat tonë këtë orientim të ri të drejtë të Partisë.

Një porosi kisha për ju, shokë të organizatës së rinisë. Të mos jeni sektarë, organizata juaj të bëhet një organizatë masash. Ju tani keni një masë të madhe të rindsh të organizuar, por shikoni që jashtë radhëve tuaja qëndrojnë shumë të rindj me nivel të ngritur politik, që tregojnë një patriotizëm të madh dhe punojnë mirë. Pse i lini këta jashtë organizatës? Në qoftë se ju i lini këta jashtë organizatës, bëni një faj të rëndë. Duke qëndruar edhe jashtë organizatës ata përsëri do të jenë patriotë, përsëri do të punojnë, përsëri do të thyejnë rekorde, por duke qenë në organizatë keni mundësi t'i organizoni më mirë për ngritjen e tyre politike dhe ideologjike, t'i futni më lehtë në brigadat e punës socialiste, t'i bëni të ndjekin më me zell shkollën, të mbajnë qëndrim më përparimtar ndaj emancipimit të nënave e të motrave të tyre, të jenë revolucionarë të vërtetë. Prandaj ka rëndësi të madhe çështja që të mos lihen jashtë organizatës së rinisë ata të rindj dhe ato të rreja që i kanë të gjitha këto cilësi të mira. Këtë vërejtje e kisha sidomos për të rejat, veçanërisht për ato të fshatit. Janë për t'u lavdëruar aktet e larta të shoqeve tonë të reja që e kanë flakur tej fanatizmin. Ja, drejtoresha e shkollës së Vorozhenit është me të vërtetë një shembull i shkëlqyer, ajo me vullnet dhe

energji e çau fanatizmin dhe si ajo ka me qindra dhe mijëra gra e vajza të tjera.

Fanatizmi te ne nuk është më një sëmundje e rëndë. Po të marrim, për shembull, Poloninë, që hiqet si vend i zhvilluar dhe socialist, feja është shumë e përhapur dhe i ka rrënjetë të thella, atje njerëzit besojnë në masë, bile edhe «komunistët». Vetë shteti e inkurajon atë, dhe kjo është më e keqja. Ndërsa te ne ndodh krejt ndryshe. Por, sidoqoftë, edhe te ne feja ka lënë gjurmët e saj. Sot, ka pleq në Kavajë që nuk besojnë, por ka edhe të tillë që besojnë akoma, prandaj një punë e zgjuar dhe e durueshme duhet bërë nga Partia dhe nga organizatat e rinisë, sidomos me ata të rinj e të reja që akoma nuk kuptojnë dëmin e madh që sjeillin mbeturinat fetare për të ecur përpara. Pikërisht për këtë duhet të bëhet një luftë e vazhdueshme gjer në çrrënjosjen e tyre të plotë.

Komunistët kurdoherë duhet të jenë në ballë dhë të japid shembullin e tyre në punë. Por edhe rinia, përkrah tyre, duhet të jetë në ballë dhe të mos shkëputet nga komunistët, të luftojë në një radhë me ta për të mirën e saj dhe të atdheut. Ju e shikoni se vendi ynë ecën përpara, përparon dhe çdo pengesë kapërcehet me sukses, por duhet të kuptojmë se situatat aktualisht janë mjaft të vështira.

Në radhë të parë situatën e vështirëson imperializmi amerikan bashkë me satelitët e tij, të cilët luftën e kanë në gjak. Nga ana tjetër janë teoritë e Nikita Hrushovit. Ai jo vetëm ka gabuar, por me teoritë e tij revizioniste, përpinqet të mashtrojë partitë e tjera komuniste e punëtore dhe njerëzit përparimtarë në

botë, duke predikuar nga të katër anët se tani gjoja imperializmi amerikan dhe imperializmi në përgjithësi është zbutur dhe ka ndryshuar natyrën. Kjo është esenca e vijës së tij antimarksiste. Krerët e imperializmit Hrushovi i konsideron si njerëz që e duan paqen dhe që gjëzojnë besimin e plotë të popujve të vet. A duhet të thuhen këto fjalë nga Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik? Jo, nuk duhet të thuhen. Po pse i thotë atëherë ato N. Hrushovi, mos vallë ai është budalla? Jo, ai nuk është budalla. Atëherë përse e bën ai një gabim të tillë? Ai e bën sepse pikëpamjet e tij janë revisioniste dhe ai vetë si i tillë ka besim te krerët e imperializmit. Ne nuk pajtohem me qëndrimet e tilla antimarksiste, sepse jemi marksistë, kurse Hrushovi me shokë thonë fjalë të mira për Ajzenhaucrin ose për Kenedin, sepse duan të pajtohen me imperializmin, pra janë oportunistë. Këtë punë ata e bëjnë duke hedhur poshtë tezat e Leninit mbi imperializmin. Hrushovi flet për Leninin, por tezat e tij ai i ka vënë nën këmbë, është verbuar e nuk e sheh rrezikshmërinë e imperializmit.

Ne kemi të drejtë kur themi se socializmi është më i fortë se imperializmi. Ky është një fakt i pamohueshmëm. Të marrim si shembull Shqipërinë. A nuk është Shqipëria socialiste njëqind dhe një mijë herë më e fortë se Shqipëria e paraluftës? Kjo s'ka asnje dyshim. A nuk flasin për këtë përparimet kolosale që kemi bërë, kurse ritmet e zhvillimit te ne kanë lënë pas mjaft vende kapitaliste? Vendet kapitaliste përkohësisht mund të jenë përpëra në disa drejtime, sepse prej kohësh kanë grumbulluar pasuri të mëdha duke

pirë gjakun e popujve të tyre dhe të popujve të tjerë që i mbajnë nën zgjedhë, por e ardhshmja i përket sozializmit dhe komunizmit dhe do të vijë koha që imperializmi të zhdukët nga faqja e dheut. Megjithatë derisa imperializmi ekziston, ne duhet ta njohim objektivisht rrezikun e tij, jo si N. Hrushovi që e nënvlefëson armikun. Këtë ai e bën sepse është revisionist, ai kërkon të vëré popujt në gjumë, duke përhapur parullën se ne jemi të fortë dhe kapitalizmin do ta mundim me «garën paqësore ekonomike».

Më poshtë shoku Enver Hoxha foli mbi disa probleme të lëvizjes komuniste e punëtore dhe të situatës ndërkombëtare. Ai vuri në dukje qëndrimet oportuniste të N. Hrushovit ndaj imperializmit dhe pasojat negative që shkaktuan këto në disa parti komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste, theksoi veprimet komplotiste të tij në Mbledhjen e Bukureshtit dhe të Moskës, shpifjet dhe akuzat që bëri kundër J. V. Stalinit me qëllim që të shkurorëzonte leninizmin, kundërshtimet e PPSH me N. Hrushovin që përpinqej të rehabilitonte klikën e Titos, akrobacitë e tij në politikën e jashtme, në çështjen e traktatit me Gjermaninë etj. Pastaj shoku Enver Hoxha tha:

Sikurse thashë, në ballë të kësaj lufte të madhe kundër revizionizmit sovjetik janë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Kinës. Por nuk jemi vetëm ne. Partitë komuniste e punëtore kush më parë e kush më pas po fillojnë të reflektojnë. Kjo luftë nuk është për një ose dy vjet, kjo është patjetër një luftë e gjatë. Ka parti të tjera që e kanë kuptuar kush ka të drejtë dhe na thonë: «Ju keni të drejtë dhe jo

Nikita Hrushovi», por akoma nuk flasin kundër tij. Ka edhe nga ato parti, udhëheqjet e të cilave ndaj tij kanë disa rezerva, kurse ka të tjera që janë të lidhura ngushtë me Nikita Hrushovin. Pra bëhet një luftë e dyfishtë: luftë kundër kësaj klike renegatësh dhe luftë për të bindur të tjerët për rrugën e drejtë.

Ju e shikoni në gazetat tonë që flitet vazhdimisht për unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombejtare. Ne do të luftojmë me këmbëngulje në këtë drejtim, kurse Hrushovi me shokë luftojnë për të sjellë përcarjen. Ne nuk i kemi dhënë dhe nuk do t'i japim armë imperializmit, por në rast se Nikita Hrushovi e heq këtë maskë dhe na sulmon haptazi, atëherë edhe ne do t'i përgjigjemi hapur¹. Nga mbledhja e Traktatit të Varshavës ata na përzunë, në mbledhjen që u bë me ministrat e mbrojtjes na lanë jashtë, në festën e përvjetorit të çlirimt të RD Gjermane nuk na ftuan. Me këto gjëra nuk na poshterojnë, por demaskojnë veten, sepse populli i tyre pyet ku janë përfaqësuesit e RP të Shqipërisë. Nikita Hrushovi përgjigjet se ata e kanë vënë veten jashtë kampit socialist, se nuk deshën të na jepnin bazën ushtarake të Vlorës. Por këtë nuk mund ta thotë haptazi, sepse edhe në këtë çështje ai ka pasur qëllime të errëta ndaj RPSH. Nikita Hrushovi u mundua të bëjë ashtu si veproi Titoja njëherë e një kohë, për të sjellë divizonet e tij në Shqipëri, po me manovra të tillë neve na është djegur lëkura një herë, prandaj Partia jonë e pa në rrugë të drejtë çështjen e bazës ushtarako-detare të Vlorës.

¹ Shih në këtë vëllim f. 55.

Ne, shokë, jemi të fortë dhe të pamposhtur sepse, ashtu si në organizatën e rrethit tuaj, në gjithë Partinë ka një unitet të çeliktë. Këtë unitet ne duhet ta ruajmë. Armiqtë do ta atakojnë udhëheqjen me qëllim që ta ndajnë nga Partia. Nikita Hrushovi na akuzon për kult të individit me qëllim që të krijojë hendek në mes udhëheqjes dhe Partisë, pastaj të vërë në jetë komplotet e tij, ashtu siç e ka zakon. Në qoftë se udhëheqja bën gabime Partia duhet ta kritikojë, ndërsa intrigat e armiqve ajo duhet t'i dijë dhe t'u tregojë vendin e tyre. Prandaj duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë unitetin. Të metat në punë t'i kritikojmë, kurse për çështjen e madhe të jemi të gjithë grusht, ta mbajmë lart e më lart flamurin e Partisë se jemi të rrethuar nga armiq.

Në këtë situatë duhet gjakftohtësi dhe trimat, në çdo situatë, sado e vështirë të jetë, janë kurdoherë gjakftohtë, armiqve nuk u bëjnë asnje lëshim. Situatat janë të vështira, por ato do të kapërcehen patjetër duke zbatuar fort vijën e Partisë.

Një detyrë tjeterë është që të mbahet gjallë ky entuziazëm i madh që përshkon popullin tonë, këtë patriotizëm dhe pjekuri të madhe të tij ta kalitim edhe më tepër. Patjetër, në këtë situatë ne duhet të luftojmë me vendosmëri kundër çdo shfaqjeje të huaj se kështu mbrojmë Partinë dhe popullin. Lufta që bëjmë ne, marksistët, kundër grupit revisionist të N. Hrushovit nuk është diçka e vogël, ajo është një gjë e madhe. Por në qoftë se ne realizojmë planet dhe puna jonë ecën përrpara, kjo tregon se si në Parti edhe në popull nuk ka asnje lëkundje. Kjo tregon se Partia e ka edukuar popullin që të mendojë drejt politikisht dhe ideologji-

kisht. Kurse revizionistët bëjnë të gjitha përpjekjet për ta çoroditur popullin dhe sidomos për të korruptuar rininë, për ta degjeneruar atë moralisht e politikisht.

Çështja kryesore për ne është të mobilizojmë të gjitha forcat për të realizuar planet ekonomike sepse kjo është një thikë për armiqtë. Mirë u tha këtu: të punojmë për të mirën e popullit dhe për inat të armiqve. Në njerëzit tanë ka energji të mëdha që bëjnë të kapércehen të gjitha vështirësitë.

Rruga jonë, shokë, është e drejtë, ajo do të na sjellë patjetër ditë të mira, por vështirësi do të kemi, prandaj të qëndrojmë të bashkuar, t'i përvishemi punës, të jemi vigjilentë, të përpiqemi t'i sqarojmë të gjithë, të përpiqemi që armikut të mos i lëmë asnje njeri. Kjo është një detyrë e madhe dhe e vështirë për Partinë, por atë duhet ta kryejmë dhe popullit t'i japim ato që i kemi premtuar, bile edhe më shumë.

Me kaq po e mbyll fjalën time. Ju uroj suksese gjithnjë më të mëdha në punën tuaj! Unë do t'i transmetoj Komitetit Qendror se te komunistët dhe te rinia e rrethit të Durrësit pashë, si kurdoherë, një entuziazëm të madh e të papërshkruar, një besnikëri të patundur marksiste-leniniste ndaj Partisë dhe popullit, ndaj Komitetit Qendror të Partisë. Unë do ta siguroj për këtë Komitetin Qendror dhe jam i bindur se Partia ka në rrethin e Durrësit një organizatë të çeliktë dhe të vendosur për të kryer deri në fund detyrat e shumta të Partisë, detyrat që na ka vënë populli. Partia ka një rini të lavdishme dhe heroike, e cila ecën në traditat luftarake të rinisë komuniste, që ishte në ballë të

Luftës Nacionalçlirimtare dhe që sot, vazhduesja e saj, BRPSII, lufton në ballë të frontit të ndërtimit të socializmit, për mbrojtjen e çështjes së Partisë, të lirisë, të pavarësisë së atdheut dhe të marksizëm-leninizmit!

Botohet për herë të parë me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

AKTIVIZIMI I GRAVE NË PUNËT E KOOPERATIVËS ÇON PËRPARA PRODHIMIN

*Nga biseda në takimin me një grup fshatarësh
të kooperativës bujqësore të Bajzës
të rrethit të Shkodrës*

17 tetor 1961

Një grup fshatarësh të kooperativës bujqësore «Enver Hoxha» nga rrethi i Shkodrës erdhën më 16 tetor në Tiranë, të dërguar nga asambleja e kooperativës për t'i uruar shokut Enver 53-vjetorin e ditëlin-djes. Midis tyre ishte kryetari i kooperativës dhe sekretari i organizatës-bazë të Partisë.

Shoku Enver i priti ata mjast ngrohtë, i pyeti për punët e kooperativës dhe për prodhimet e këtij viti, sidomos për prodhimin e drithërave të bukës, për rendimentet e arritura, për problemin e ujitjes, për zhvillimin e blegtorisë, të arsimit dhe të kulturës. Në mënyrë të veçantë ai u interesua për pjesëmarrjen e grave në punët e kooperativës.

Shoku Enver Hoxha, pasi dëgjoi përgjigjet e kryetarit të kooperativës, tha:

Unë gëzohem shumë për rezultatet që keni arritur.

Kam dëshirë të vizitoj kooperativën tuaj dhe ju premtoj se do të vij. Vërtet ju keni suksese në punën tuaj, por keni edhe të meta e vështirësi. Përsa u përket dëmtimeve që kanë pasur kooperativat e rrëthit tuaj në duhan, Byroja Politike e Komitetit Qendror ka menduar që ta lehtësojë pak fshatarësinë e rrëthit të Shkodrës për këtë vit nga disa detyrime. Prandaj është e nevojshme të merren masa qysh tani për luftimin e sëmundjes së duhanit në të ardhshmen, sepse këtë vit u dëmtua prodhimi i kësaj kulture në gjithë Republikën, duke u sjellë pasoja edhe vetë prodhuesve edhe ekonomisë në përgjithësi.

Si të gjithë edhe ju e keni kuptuar rëndësinë dhe vlerën që ka pjesëmarrja sa më e gjerë e gruas në të gjitha fushat e jetës, prandaj të keni kujdes që të tërhiqni sa të jetë e mundur më shumë gra në punët e kooperativës, sepse, duke aktivizuar të gjitha forcat, kooperativa do të ketë suksese më të mëdha, do të ecë shumë më shpejt përpara. Gruaja shqiptare ka një karakter të fortë, është e zgjuar jo më pak se burri. Në të kaluarën ajo ka qenë e shtypur, por tani që fitoi lirinë ka shpërthyer si vulkani, punon dhe mëson. Prandaj në qoftë se gruaja përkrahet në të drejtat e saj, nëse i jepet arsimi dhe punët që i përshtaten, zhvillimi i saj do të influencoje në përparimin e shoqërisë. Me përparimin dhe me zhvillimin e shpejtë të gruas, breqat e ardhshëm të vendit tonë do të jenë më të zotë, sepse do të kenë edhe eksperiencën tonë. Për të siguruar këtë pjesëmarrje, gruas duhet t'i krijohen edhe kushte. Për këtë arsyе është e domosdoshme t'i kushton kujdes hapjes së çerdheve e të kopshteve për fëmijët e

anëtarëve të kooperativës, gjë që do të lehtësojë nënën edhe të punojë, edhe të mësojë, natyrisht këto të bëhen sipas mundësive, të mos kërkohet që të bëhen gjëra të mëdha.

Në situatën që çshtë krijuar në Shqipëri, gruaja është një forcë e madhe edhe në mbrojtjen e atdheut, dhe ajo nuk ka nevojë t'i bësh agitacion në këtë detyrë të madhe që ka një kuptim politik shumë më të lartë.

Për ngritjen e gruas në përgjegjësi kooperativa juaj nuk ka shumë rezultate. Natyrisht kjo nuk është një punë e lehtë, çështja është të punoni e të prepatiteni në këtë drejtim, në mos pastë gra të afta këtë vit për t'i ngritur në përgjegjësi, i prepatitni dhe i vini vitin e ardhshëm, natyrisht po ta meritojnë vendin që do t'u jepet, por për këtë duhet punuar, se kjo punë ka rëndësi të madhe për shoqërinë tonë socialiste.

Në fund, shoku Enver Hoxha u uroi mysafirëve shëndet, punë të mbarë dhe lumturi në familje.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**PARTIA KA LUFTUAR E LUFTON QE GRUAJA
TË JETË E LIRE, E PAVARUR, E NDERUAR
DHE E ZHVILLUAR SI DHE BURRI**

*Fjala me të rejat e dalluara të rrëthit të Lezhës
në Pallatin e Brigadave*

17 tetor 1961

Të dashura shoqe,

Mirë se erdhët këtu në Tiranën tuaj, në kryeqytetin e Shqipërisë socialiste, mirë se erdhët në këtë pallat që është pronë e gjithë popullit shqiptar, pra edhe juaja! Këtë pallat kishte filluar ta ndërtonte armiku i popullit shqiptar, Ahmet Zogu, i cili 15 vjet me radhë, e shtypi, e ropi, e la në mjerim e në vuajtje popullin dhe, kur u rrezikua Shqipëria nga fashizmi italian, iku dhe e la atë në fatin e vet. Më vonë e vazhduan ndërtimin e këtij pallati fashistot italianë, të cilët mblorehën rrëth e qark vetes bejlerët, bajraktarët e të tjerë të shitur e bashibozukë dhe të gjithë këta së bashku, sikurse nën regjimin e mbretit Zog, shtypnin e grabitnin popullin akoma më shumë. Këtë pallat ata e ndërtuan për të banuar mbreti i Italisë, kur të vinte në Shqipëri, dhe të hante e të pinte në kurriz të popullit

shqiptar. Mirëpo kjo nuk u shkoi, sepse përfaqësuesit më të mirë dhe besnikë të popullit tonë, të klasës punëtore e të fshatarësish, domethënë prindërit, vëllezërit ose burrat tuaj u ngritën në këmbë, krijuan Partinë, rrokën armët dhe u ranë fashistëve italianë dhe tradhtarëve të vendit.

Komunistët dhe partizanët shqiptarë nuk i janë asnjë ditë të qetë fashistët italianë. As mbreti i Italisë nuk e gjëzoi dot këtë pallat. Edhe në ato pak ditë që erdhi në Shqipëri i doli përparrë një djalosh i ri, patriot shqiptar dhe i bëri atentat. Jo vetëm kaq, por ky pallat, siç dihet është goditur me top nga partizanët atë ditë që bënte mbledhjen e parë «Këshilli i Regjencës» dhe tradhtarët, që ishin brenda, nuk shihnin nga shkonin, kush e kush përpinqej të largohej sa më parë që të shpëtonte kokën. Prandaj ne sot e quajmë këtë pallat Pallati i Brigadave se na kujton brigadat partiçane, dhe e përdorim pëpritje të gjera të miqve e të njerëzve të popullit.

Luftha që zhvilluan Partia dhe populli ishte e madhe. Italianët dhe gjermanët, bejlerët dhe agallarët, ne i mundëm dhe Partia solli për herë të parë në fuqi popullin. Shumë nga ju mbase nuk kanë qenë fare atëherë, por prindërit tuaj kanë luftuar, nënët tuaja, kur vinin partizanët në fshat të lagur e të uritur, nuk an-koheshin kurrë se nuk kishin bukë, por e ndanin përgjysmë atë pak krohdë me kripë që kishin. Nuk ishte aq çështja e bukës, se sa rëndësi të madhe kishte për ne, në atë kohë, zemra e ngrohtë e popullit, dashuria e madhe e nënave për Partinë.

Armiku ishte shumë më i madh në numër dhe në armatime nga ne. Po si arritëm ne ta mundim? Kjo u

arrit se Partia ishte me popullin dhe populli me Partinë, u ngritën të tërë në këmbë dhe kësaj force të pamposhtur askush nuk mundi t'i rezistojë.

Në Luftën Nacionalçlirimtare kryesorja e të gjithave ishte çlirimi i Shqipërisë dhe marrja e pushtetit në duart e popullit, vendosja e diktaturës së proletariatit. Edhe kjo u sigurua, sepse me atë do të bëheshin realitet të gjitha këto që i gjithë sot.

Një nga veprat më të mëdha që bëri Partia është çlirimi juaj, çlirimi i gruas shqiptare. Gratë, tani në vendin tonë, kanë të gjitha të drejtat që kanë edhe burrat. Gruaja në Shqipëri ka të drejtë të votojë, të punojë, të shkojë në shkollë e në mbledhje, të këndojet, të dalë pa perse e pa çarçaf, të bëhet inxhinier, mjeke, traktoriste etj., etj. Kjo është një fitore e madhe për popullin shqiptar. Ju duhet ta kuptoni ç'rol të madh luani në Shqipërinë e re. Pa gruan asgjë nuk shkon përpara.

Pa gruan nuk mund të ketë jetë. Gruaja edhe te ne është një forcë e madhe në shoqëri, por atë e kishin lënë prapa regjimet e kaluara të klasave shfrytëzuese e gjakpirëse. Ato thoshin se gruaja duhet të qëndrojë në shtëpi dhe të punojë tërë ditën si kalë, kurse Partia thotë se nuk është i drejtë një trajtim i tillë i gruas. Gruaja duhet të jetë po aq e nderuar dhe e lirë sa edhe burri, se edhe asaj duhet t'i hapen të gjitha dyert e aktivitetit politiko-shoqëror dhe kulturor. Kjo është një çështje e madhe për të cilën ka luftuar dhe lufton Partia. Këtë gjë në të kaluarën nuk mund ta kuptonin burrat, sepse te ata ishin rrënjosur koncepte dhe mentalitete të tjera. Pra duhej punuar që ata ta kuptonin

dhe shumica dërrmuese e tyre tani e kanë të qartë se pa pjesëmarrjen e gjerë të gruas nuk mund të ndërtohetjeta e begatshme. Në familje gruaja luan rolin kryesor, përveç rolit të saj të madh, që lind fëmijët. Tani gruaja punon kudo në fabrika e në kooperativa bujqësore, është e pavarur ekonomikisht dhe është e nderuar. Futja e gruas në punë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, se tani ajo punon vetë dhe ka personalitetin e saj. Prandaj kjo drejtësi e madhe që i dha Partia gruas e bën atë që të jetë e lirë. Ja, për shembull, sot në fshat zotësia dhe puna e gruas i kanë dhënë hov punës në kooperativat bujqësore. Këtë gjë duhet ta kuptojnë mirë burrat.

Të gjithë u kënaqëm kur, në Kongresin V të BGSH, në raportin që mbajti shoqja Vito Kapo tha se 46 përqind e vajzave të Lezhës janë me shkollë. Ju lumtë juve të rejave të Lezhës! Kjo tregon se ju përparoni, ecni përpura. Edhe kooperativat bujqësore të rrethit tuaj janë mjaft të përparuara, prandaj prej tyre duhet të mësojnë shumë edhe kooperativat bujqësore të rretheve të tjera të Shqipërisë. Ju jeni kultivuese të mira të misrit, tokat i keni vërtet të përshtatshme për këtë kulturë, por rendimentet që merrni kanë të bëjnë shumë edhe me punën tuaj. Janë mundësitë që ju të bëni më shumë, prandaj duhet të përpileni që të mësoni më tepër për ta kultivuar akoma më mirë kulturën e misrit. Kështu ju do të bëheni rekordmene të dëgjuara të misrit. Ju keni marrë iniciativa shumë të mira përritjen e shpendëve, prandaj ju, gratë dhe vajzat e Lezhës jeni bërë një shembull i mirë në këtë drejtim.

Ju duhet të ecni në traditat e popullit shqiptar se

jeni nga ato anë ku ka jetuar dhe ka luftuar Skënderbeu, jeni nga vendi ku është bërë Kongresi historik i Lezhës për të lidhur e për të bashkuar popullin shqiptar kundër rrebeshit otoman. Lufta e Skënderbeut ka qenë një luftë e lavdishme, së cilës i këndon me krenari jo vetëm populli ynë, po edhe shumë popuj, se lufta e popullit të vogël shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut bëri që të mbrohej e gjithë Evropa nga pushtimi turk. Pra, rrëthi juaj ka tradita të mëdha historike, të cilat janë trashëguar brez pas brezi. Në Luftën Nacionalçlirimtare krahina e Lezhës ka qenë me Partinë, dhe populli i kësaj krahine ka luftuar krah për krah me të gjithë popullin shqiptar për këto ditë të bukura që gëzojmë sot.

Ne ishim në Kongresin V të BGSH, ku shoqet tuaja diskutuan për punën e madhe që kanë bërë dhe përdetyrat që kanë përpara. Ky vrull i madh entuziazmi që zien brenda në këtë sallë që jeni ju sot, ziente edhe atje. Një dashuri e madhe për Partinë manifestohet te të gjitha gratë dhe të rejat e vendit tonë. Mallëngjehet njeriu kur dëgjon se edhe vajza e mbyllur malësore nga Nikaj-Merturi i Tropojës, «ku ha pula strall», siç thotë populli, tha përpara kongresit se si ajo, nga një vajzë e mjeruar e një fshati të largët dhe shumë të prapambetur, shkelmoi çdo pengesë e mbeturinë të së kaluarës, kaloi trimërisht pyjet, pa pasur frikë për të ndjekur shkollën 7-vjeçare. Ajo tregoi në kongres se Partia i dha bursë për të vazhduar liceun artistik, të cilin e mbaroi dhe tanë cuca e Nikaj-Merturit na është bërë këngëtare dhe u këndon heroizmave të popullit, të grave shqiptare dhe të Partisë, që ndërtojnë jetën e re, socializmin. Si kjo vajzë ka sot me mijëra në Shqi-

përinë tonë dhe kushedi sa të tilla ka edhe në rrithin e Lezhës, gra dhe vajza të lavdishme të popullit tonë, që nuk ia kanë bërë dy fjalën Partisë, por kanë ndjekur dhe ndjekin shkollat fillore, 7-vjeçare, bile jam i sigurt, se midis jush ka edhe me shkollë të mesme ose të lartë.

Shkolla ka rëndësi të madhe si për burrat dhe për gratë. Mos kujtoni se shkolla është vetëm për burra. Ajo të hap sytë, të mëson si të punosh, të krijosh dhe të jetosh mirë. Ju bëni punëdore të bucura, por nuk mjafton të bëni vetëm punë të tilla. Tani ju punoni edhe në kooperativat bujqësore, ku ka brigada që merrn me kultivimin e misrit, të frutave, me blegtorinë etj. Prandaj ju duhet të dini si duhet mbjellë, si u duhet bërë shërbimi bimëve ose bagëtive. Në fshat ka djem e vajza që duhen mësuar; tani në çdo krahinë ka spitale e maternitete, pra ju duhet të punoni edhe në këta sektorë. Kush kryen shkollën për një profesion të caktuar, ai i shërben më mirë atdheut si inxhinier, agronom, zooteknik, veteriner etj. Të gjithë duhet të ndjekin shkollat dhe, kur të mbarojnë, të shkojnë të punojnë ku të jetë nevoja për ta bërë më të mirë jetën e popullit.

Shikoni sa ka ndryshuar rrathi juaj brenda një kohe të shkurtër! Njerëzit tani jetojnë më mirë. Shihni sa të bucura janë kostumet që mbani, prandaj t'i ruani ato që të mos zhduken. Është mirë që çdo vajzë të ketë nga një kostum kombëtar, sepse nuk ka gjë më të bukur sesa të ruash traditat e mira të popullit, kështu na mëson Partia. Në ditët e zakonshme të punës duhet të visheni me rroba të lehta. Për veshje të tilla tani kemi kombinatin e tekstileve «Stalin», që prodhon teknike të

bukura. Në këtë kombinat punojnë vajza si ju, por ju tani jeni më të përparuara se ato kur nisën punën në fillim. Gjatë këtij pesëvjeçari do të ngrihet në Berat një kombinat tjetër edhe më i madh, që do të prodhojë tekstile akoma më të bukura, veçanërisht për gratë. Do të ngrihen gjithashtu fabrika të reja për trikotazhe, uzina për përpunimin e kromit, të bakrit, për prodhimin e plehrave kimike, për të cilat ne kemi shumë nevojë. Prandaj merrni me mend sa kuadro do të na duhen për të drejtuar këtë industri të madhe që jemi duke ngritur.

Partia për gratë ka hapur të gjitha dyert e shkollave, prandaj ju këshillon që t'i ndiqni ato, se do të ketë sektorë ku të gjitha ose shumica do të janë gra si për shembull në arsim, në shëndetësi, në industrinë tekstile etj. Këtë Partia do ta bëjë, sepse gratë janë po aq të zonjat sa edhe burrat. Partia ka vendosur që në shëndetësi, mjekët, farmacistët, dentistët, ndihmësmjekët e infermierët në shumicën dërrmuese të janë gra dhe vajza, sepse ato kanë më shumë dashuri, dhemshuri dhe kujdes për njerëzit, sidomos për të sëmurët. Me këtë dua të them se ndjenja humanitare e mjekut e lehtëson mjast sëmundjen. Edhe në tregti shumicën e punonjësve do t'i kemi gra, sepse Partia mendon se këtë punë gratë e kryejnë si burrat, në mos më mirë, sepse kanë edhe një cilësi që shpesh u mungon burrave, gratë janë nikoqire, u dhimbset më shumë malli. Këtë e themi me prova, sepse në tregti na ngjasin edhe gjëra të papëlqyera, dëmtime e vjedhje të pasurisë socialiste që në shumicën dërrmuese i bëjnë burrat dhe jo gratë. Partia ka theksuar vazhdimesh që tregtia jonë të jetë sa më e kulturuar, t'i shërbeshet po-

pullit sa më mirë, pastër dhe në mënyrë sa më të kulturuar.

Edhe në kooperativat bujqësore gratë përbëjnë një forcë të madhe, pa pjesëmarrjen e tyre, ato nuk ecin dot përpresa. Prandaj gratë dhe vajzat kooperativiste që shquhen në punë, Partia duhet t'i ndihmojë që nga radhët e tyre të dalin sa më shumë skuadërkomandante, brigadiere, kryetare kooperativash. Sot për sot ne kemi shumë pak gra në krye të kooperativave bujqësore, kurse mjast prej tyre mund ta bëjnë këtë punë ashtu si edhe burrat. Ju duhet të keni besim në forcat tuaja se jeni të forta, të zonjat dhe Partinë e keni me vetc. Kur t'ju ngrenë në përgjegjësi në kooperativë mos kini frikë, merreni në dorëzim dhe drejtogeni kooperativën, i vini edhe burrat një çikë në zap. Në një aktiv në Durrës, një vajzë nga Vorozeni i Kavajës, një fshat ku ka shumë fanatizëm, tha se me vështirësi të madhe mbaroi shkollën fillore. Me vështirësi akoma më të mëdha mbaroi edhe 7-vjeçaren. Pastaj familja e detyroi të mos shkonte në shkollë të mesme, por Partia e ndihmoi, kreu shkollën pedagogjike, tanë është drejtoreshë shkolle dhe kolegët e saj e respektojnë. Te ne të tilla gra dhe vajza ka shumë. Ato e kanë kuptuar rolin që duhet të luajnë në shoqëri, i dinë të drejtat e mëdha që u ka siguruar Partia dhe përpiken t'i shfrytëzojnë drejt ato.

Mirëqenia e popullit vazhdimisht përmirësohet,jeta te ne bëhet më e lumtur. Ulja e fundit e çmimeve i ka gëzuar që të gjithë. Partia edhe në të ardhshmen do të ndjekë këtë vijë. Por, që niveli i jetesës të ngrihet, kërkohet që të gjithë të punojnë. Burrat duhet ta kuptojnë se gratë janë një forcë e madhe jo vetëm

për punë në bujqësi e për të ruajtur bagëtitë, po edhe të mësojnë në shkollë. Kur të bëhet kjo, përparimet që do të arrijmë do të jenë më të mëdha, sepse kemi një popull të mrekullueshëm, kemi një Parti si çeliku, kemi miq në të gjithë botën, që na duan dhe na ndihmojnë.

Populli shqiptar është trim, ka Partinë trime, të pjekur e të zgjuar. Në qoftë se ndonjë armik do të guxojë të ngrëjë dorën kundër Shqipërisë, ai do të thyhet. Në botë ka njerëz që nuk na e duan të mirën, siç janë imperialistët dhe revisionistët. Ata kanë luftuar dhe luftojnë me të gjitha mjetet kundër nesh, por me gjithëkëtë Shqipëria rron, lulëzon dhe ecën përpara.

Tani ka dalë edhe një armik tjetër shumë i rrezikshëm, Nikita Hrushovi, që është në udhëheqje të Bashkimit Sovjetik. Ky përpinqet me të gjitha forcat ta dëmtojë Shqipërinë, po do të dështojë si armiqtë e tjerë. N. Hrushovi mundohet që populli sovjetik të mos mësojë për asnjë sukses të popullit tonë, por e vërteta nuk ndalet dot, ajo çan malet. Populli sovjetik, në mos sot, nesër do ta marrë vesh të vërtetën. Populli dhe Partia jonë i kuptojnë dredhitë e Nikita Hrushovit, të këtij revisionisti të rrezikshëm, prandaj do të vazhdojnë t'ia çjerrin më tej maskën.

Shqipëria ka bërë përparime të mëdha. Industrinë e kemi të fuqishme dhe po tejkalojen planet, në bujqësi jemi shumë më mirë nga viti i kaluar, shkollat tona ecin në rregull. Ne këtë vit po zbulojmë minerale të vlefshme, që do të pasurojnë ekonominë tonë. Të gjitha këto pasuri i zbuloi Partia dhe shokët tuaj që më parë kanë qenë barinj dhe analfabetë, kurse tani janë bërë

gjeologë nga më të mirët. Edhe malësitë tona janë zona të pasura me minerale. Në këto vende, në një të ardhshme jo të largët, do të ndërtohen qytete të mrekullueshme. Atje tani nuk ka hekurudha, por do të arrijë patjetër treni, do të ngrihen shkolla të mëdha, hotele, shtëpi pushimi, që do t'i trashëgoni, ju, rinia, e ardhshmja e vendit tonë.

Shihni forcën e madhe të popullit, zgjuarsinë e tij. Mendja e tij e mprehtë dhe duart e tij të arta të drejtuara me zotësi nga Partia po bëjnë mrekullira. Prandaj e ardhshmja e vendit tonë është e bukur dhe e begatshme. Kush i prek fitoret tona, ai me siguri do të thyejë kokën.

Partia na thotë se me ata që gabojnë, duhet të punojmë, t'u vihen në dukje gabimet dhe të ndihmohen që t'i ndreqin ato. Nuk ka njeri që të punojë e të mos bëjë gabime, por Partia me durim e me urtësi ta bindë për gabimet që bën. Kurse atë që kërkon t'i bëjë varrin popullit, atë që tradhton popullin, Partia nuk e fal, sepsejeta e popullit për Partinë është e shtrenjtë, prandaj atë nuk mund ta sakrifikojmë për armiqtë.

Ju bëtë shumë mirë që erdhët për të parë Tiranën tuaj të dashur, që e ka ndërtuar populli. Ka shumë nga ju që, sigurisht, vijnë për herë të parë, por mund të ketë midis jush edhe shoqe që kanë ardhur dy-tri herë këtu, por çdo herë që vijnë shohin ndryshime. Pa na pyetni ne që e kemi njojur Tiranën qysh para Çlirimt? As që ka krahasim me Tiranën sot. Tani këtu ju shihni pallate, uzina e fabrika të shumta, muzeume e hotele, parqe e monumente, rrugë të gjelbëruara e shkolla, teatro e kinema etj. Përpara Tirana ishte si një fshat

ku të mbulonte balta, nuk kishte as shkolla, as pallate të mëdha dhe as parqe të bukura. Të gjitha që shikoni sot i ndërtoi populli me Partinë në krye.

Nga ju mësova, se, për të vizituar Tiranën, vijnë punëtoret dhe kooperativistet më të mira, ato që realizojnë dhe tejkalojnë normat, ato që bëjnë më shumë ditë-pune. Ky kusht është i drejtë, dhe nga kjo garë do të rritet shumë numri i punëtoreve e i kooperativisteve pararojë të rrethit tuaj dhe, krahas kësaj, do të rritet edhe numri i atyre që do të meritojnë ta shohin kryeqytetin. Kjo do të jetë një nxitje për ta vizituar sa më shpesh Tiranën. Këtu do të keni mundësi edhe të shkëmbeni eksperiencë me shoqet e gratë e shumta pararojë të kryeqytetit. Vizita duhen organizuar edhe nëpër qytete të tjera, që gratë të njihen me sukseset e vendit tonë. Prandaj unë ju këshilloj nga ana e Partisë që ta vazhdoni këtë rrugë.

Partia ju do t'ju ndihmojë me të gjitha forcat, do t'i ndihmojë kooperativat bujqësore me kredi që të forconi ekonominë kolektive, sidomos blegtorinë. Ju mbillni pak duhan në Lezhë dhe këtë vit kjo kulturë u dëmtua rëndë, sidomos zona e Shkodrës, por Partia ka menduar ta lehtësojë fshatarësinë.

Ndihma më e madhe që Partia do t'i japë fshatarësish janë plehrat kimike. Për këtë qëllim ne po ndërtojmë dy uzina të mëdha dhe, kur të përfundojnë ato, do të kemi pleh në sasira më të mëdha. Ne do të arrijmë patjetër rendimente më të larta në prodhimet bujqësore. Ju që kultivoni misrin merrni rendimente të mira, po kur të keni edhe pleh, atëherë do të shihni sa misër do të merrni. Këtë do ta arrijmë patjetër. Kë-

shtu ka vendosur Partia për të mirën e të gjithë popullit tonë.

Punoni me të gjitha forcat, se puna është ndër. Kurrë mos u kursemi, të punoni dhe të punoni mirë e njëkohësisht edhe të mësoni. Kjo është porosia që ju jep Partia. Për të lehtësuar punën e grave kryesia e kooperativës dhe organizata-bazë e Partisë duhet të kujdesen për të ngritur kopshte e çerdhe për fëmijë, sepse në to ka mundësi të mëdha për edukimin e tyre si duhet. Nuk është e domosdoshme të ngremë për to ndërtesa të mëdha, por tani në fillim t'i hapim me sende të vogla e të thjeshta dhe ndonjë nga ju të shkojë e të merret me fëmijët. Nuk i kushton shumë një çerdhe kooperativës, se fitimet që do të rrjedhin prej saj do të jenë të mëdha. Atje fëmijët do të rriten më mirë dhe gruaja do të lehtësohet për të marrë pjesë më shumë në prodhim. Fëmijët janë e ardhshmjë e vendit tonë, prandaj ata duhet t'i rritim mirë, të edukuar e të mësuar, të shëndoshë dhe patriotë.

Një punë shumë e mirë për lehtësimin e gruas është edhe ndërtimi i furrës kolektive në çdo kooperativë, ajo jo vetëm çliron gruan nga një punë e rëndë e përditshme, por edhe ndihmon që të bëhet ekonomi në drith. Kështu Partia mendon t'ju lehtësojë ju edhe në shumë drejtime të tjera.

Prandaj, të dashura shoqe, unë bashkë me shokët e mi jemi shumë të gjuar që erdhët për të parë Tiranën si dhe që morët iniciativën për t'u takuar edhe me ne. Ne marrim forca kur takohemi me popullin, dhe shohim se Partia jonë ka edukuar gra, vajza, një rini trime, entuziaste e patriote. Prandaj ju uroj nga

zemra shëndet dhe lumturi, gëzim në jetë dhe suksese
në punë!

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë!

Rroftë rinia jonë heroike!

Rrofshin gratë dhe të rejat patriote e revolucionare
të Lezhës!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

T'U JAPIM PËRGJIGJEN E MERITUAR SULMEVE TË HAPURA TË REVIZIONISTËVE SOVJETIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

20 tetor 1961

Siq e dini shokë, revisionistët sovjetikë na sulmuan hapur. Ata vazhduan sulmet kundër nesh. Lidhur me këto sulme të udhëheqjes revizioniste sovjetike, kam një propozim mbi mënyrën se si do të veprojmë më tej ndaj tyre.

Gjer tani ne kemi mbajtur qëndrim të drejtë marksist-leninist ndaj udhëheqjes sovjetike, duke mos i nxjerrë përpara opinionit publik botëror mosmarrëveshjet që kemi me të. Por këto mosmarrëveshje i denoncoi botërisht Hrushovi, i cili na sulmoi, duke shkelur kështu normat leniniste të marrëdhënieve në mes partive si dhe vendimet e Mbledhjes së Moskës të vitit 1960. Aktualisht ne gjendemi përpara sulmeve të hapura të komplotisëve, të cilat i mori vesh i gjithë opinioni

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi qëndrimin e mëtejshëm ndaj udhëheqjes revizioniste sovjetike.

publik botëror. Është e drejta jonë që edhe ne t'u përgjigjemi këtyre sulmeve revisioniste. Për Partinë tonë mbaroi etapa e mbajtjes rezervë, etapë në të cilën ne kishim bërë propozime për zgjidhjen e çështjeve, prandaj duhet që edhe ne sulmeve të tyre t'u japim përgjigjen e merituar. Në qoftë se shokët janë dakord, propozoj të bëjmë një deklaratë¹ në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe ta batojmë në shtyp, ku të theksojmë qëndrimin tonë në këto situata.

Dihet se në Bukuresht u bë komploti nga N. Hrushovi. Ky komplot i bërë nga ai me shokë kundër interesave të lëvizjes komuniste e punëtore botërore vazhdon: tani revisionistët sovjetikë po na sulmojnë brenda dhe jashtë vendit të tyre. Në kushte të tillë Partia e Punës e Shqipërisë duhet të mbrohet, prandaj kush të dojë nga partitë e tjera le ta mbrojë Partinë tonë, se kështu mbron marksizëm-leninizmin.

¹ Kjo deklaratë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë u botua në gazetën «Zëri i popullit», më 21 tetor 1961.

Deklarata ishte përgjigja e menjëhershme, e vendosur dhe e guximshme ndaj sulmeve të poshtra antimarksiste dhe anti-shqiptare që bënë botërisht N. Hrushovit dhe lakejtë e tij kundër PPSH në Kongresin XXII të PK të BS. Ajo theksonte se përpara sulmit të organizuar të N. Hrushovit, PPSH «me fakte e dokumente do t'i bëjë të njohur gjithë lëvizjes komuniste e punëtore si dhe gjithë opinionit publik ndërkombëtar, se si qëndron e vërteta mbi marrëdhëniet midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, se nga ç'anë është e drejta dhe do të demaskojë veprimet antimarksiste e antishqiptare të N. Hrushovit dhe të grupit të tij». (Shih «Dokumente kryesore të PPSH», vell. IV, f. 153-155. Tiranë, 1970).

Pasi lexohet projektdeklarata, për të cilën diskutojnë dhe shfaqen të një mendimi të gjithë shokët e Byrosë Politike, shoku Enver Hoxha vazhdon:

Hrushovi përpinqet të mobilizojë gjithë komunizmin ndërkombe tar kundër Partisë sonë, po edhe ne kemi të drejtë ta bëjmë një gjë të tillë për të demaskuar Hrushovin dhe revizionizmin sovjetik. Di Hrushovi t'i bëjë llogaritë, po dimë edhe ne të llogaritim, se kemi Partinë e popullin tonë, me ne janë edhe vetë popujt sovjetikë, janë komunistët revolucionarë sovjetikë, janë populli dhe komunistët kinezë, janë popujt dhe komunistët e vërtetë në mbarë botën.

Fakti është se të dalësh i vetëm kundër Hrushovit dhe pasuesve të tij nuk është e lehtë, por ne do ta bëjmë këtë, sepse e vërteta duhet mbrojtur, Partia duhet mbrojtur, marksizëm-leninizmi duhet mbrojtur. E dimë se kundër nesh do të shpifen shumë gjëra, por ne do të vazhdojmë me guxim rrugën tonë të drejtë marksiste-leniniste. Me qëndrimin revolucionar që mbajmë, ne mbrojmë Partinë tonë, lirinë dhe pavarësinë e atdheut, popullin shqiptar dhe fitoret e tij. Por Partia e Punës e Shqipërisë e ndien si detyrë të saj internacionaliste të luftojë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombe tar. T'u themi Partisë dhe popullit se kjo luftë do të jetë e gjatë dhe e vështirë, po luftërat dhe vështirësitë ne nuk na kanë përkulur dhe nuk do të na përkulin kurrë dhe se fitorja do të jetë jona, do të jetë e marksizëm-leninizmit.

Ka dy mënyra për të vepruar në luftë kundër revizionistëve sovjetikë: njëra është të shkruhen artikuj dhe tjetra është të botohen dokumentet e Partisë

sonë. Ne edhe artikuj të bëjmë, por më duket se botimi i dokumenteve është varianti më i mirë, veç kjo do bërë që nga fillimi, nga dokumentet e para, në mënyrë që çdo njëri të ketë një ide të plotë se si janë zhvilluar ngjarjet. Prandaj, të fillojmë botimin e dokumenteve tona dhe, në mos sot, nesër, t'i botojmë të tëra në shtyp...

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim, sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Byrosë Politike të
KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

RENDI I DITES — MOMENT KYÇ I PUNËS SË ORGANIZATËS-BAZE TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 tetor 1961

Për problemet e planit folën shokët e tjerë sekretarë, prandaj unë nuk kam ndonjë vërejtje të veçantë. Vetëm doja të theksoja një çështje: zgjedhjen dhe caktimin e rendit të ditës në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë.

Çështja e pjesëmarrjes efektive të komunistëve në mbledhjet e organizatës-bazë duhet të kihet mirë parasysh si nga ana e komiteteve të Partisë të rretheve, ashtu edhe nga ana e sekretarëve osc e byrove të organizatave-bazë. Nuk mund të quhet e rregullt ajo mbledhje partie, në të cilën ka komunistë që mungojnë vazhdimisht.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e organizatës së Partisë në rrethin e Vlorës dhe të Durrësit për realizimin e detyrave të planit, të kursimeve dhe për zbatimin e vendimeve të Sekretariatit të KQ të PPSH për plotësimin e normave dhe gjallërimin e lëvizjes për shpikje e racionalizime.

Suksesi i mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë varet shumë nga problemi që do të merret në diskutim. Prandaj komitetet e Partisë duhet të ndihmojnë vazhdimisht sekretarët ose byrotë e organizatave-bazë për zgjedhjen e problemeve që do të vihen në rendin e ditës. Pika që vihet në rendin e ditës pasqyron momentin kyç dhe nevojat urgjente ku duhet të mobilizohet organizata-bazë e Partisë. Këtë gjë e dinë dhe duhet ta dinë mirë sekretari i organizatës-bazë ose byroja, prandaj është e domosdoshme që rendit të ditës t'i kushtohet rëndësia e duhur. Në asnjë mënyrë nuk duhet të ndodhë që çështjet kyç të lihen mënjanë dhe t'u jepet rëndësi çështjeve të vogla, që kanë rëndësi të dorës së dytë e të dorës së tretë, të cilat shumë herë përbëjnë objektin kryesor të diskutimit në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë. Kjo ngjet për arsyen se ka rutinë, rendi i ditës caktohet pa u thelluar, shpeshherë shikohet se afroi koha për të bërë mbledhjen dhe mendohet vetëm sa për të zbatuar rregullin se mbledhja duhet bërë patjetër. Ky është një qëndrim shumë negativ.

Sekretari ose byroja e organizatës-bazë të Partisë në fshat, në ndërmarrje apo në çdo institucion, e dinë mirë ku janë pikat e dobëta, ku duhen marrë masa serioze dhe çfarë masash duhen marrë, prandaj në rendin e ditës të mbledhjes së organizatës-bazë caktohet pikërisht ai problem që është më kryesor. Duke diskutuar rreth problemit kryesor, organizatës-bazë të Partisë i jepet mundësia që të luftojë dhe të kritikojë të gjithë ata që nuk ecin mirë, por njëkohësisht duhet të marrë edhe masa konkrete për të zhdukur dobësítë.

Me një plan të tillë të menduar mirë duhet të punojë organizata-bazë.

Çështjet që ngritën këtu shokët Hysni dhe Haki janë shumë të vlefshme për ju, shokë të komiteteve të Partisë, prandaj organizoni nga një mbledhje të shkurtër në ndërmarrjet e ndryshme të qyteteve tuaja, i shtroni këto probleme për të ngjallur iniciativën, të merren edhe masa për të hartuar planet e punës për çështjet që diskutuan në këtë mbledhje të Sekretariatit.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

MBLEDHJET E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË NË USHTRI TË JENË LUFTARAKE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 tetor 1961

Në ushtri ka rëndësi të madhe realizimi i programeve politiko-ushtarake, për të cilat bëhen përpjekje. Por krahas kësaj duhet t'u kushtohet rëndësi edhe çesh-tjeve të punës së Partisë. Nuk e kam fjalën për të gjithë kompleksin e këtyre çesh-tjeve, por vetëm për mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë. Edhe në ushtri janë të gjitha mundësitë që mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë të jenë luftarake dhe me një brendi të lartë edukative, morale e politike.

Ju, shokë komunistë, që jeni në ushtri, ndodheni të grumbulluar e të organizuar më mirë se kudo, detyrat tuaja kryesore janë detyrat ushtarake dhe politike, për zbatimin e të cilave ju luftoni çdo ditë. Por një

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi gjendjen e punës politike dhe të Partisë në Korpusin e 7-të të këmbësorisë si dhe mbi zbatimin e vendimit të Sekretariatit të KQ të PPSH për repartet xheniere».

herë në muaj ju shkoni edhe në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë. Çdo anëtar i Partisë te ju shumë gjëra i ka të qarta ose i sqarohen gjatë muajit, por duhet të luftohet edhe kundër atyre rasteve të mos-interesimit për mbledhjen e organizatës-bazë. Juve, kuadrove të ushtrisë, që keni një kulturë dhe eksperiencë të madhe, ju përket detyra që mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë në ushtri të mos i lejoni të bëhen formale dhe mekanike, pa gjallëri. Prandaj, para se të shkoni në mbledhjen e organizatës, ju duhet të preqatiteni mirë. Për shembull, kur organizata-bazë e Partisë ka për të shqyrtuar çështjen e disiplinës, kjo të mos bëhet në formën e një leksioni, ku të thuhen vetëm disa fjalë të thata për ndonjë nga shokët që ka thyer disiplinën. Meqenëse ju, kuadro të Partisë në ushtri, jeni njerëz me kulturë të gjerë, keni mundësi që referimin mbi problemin e disiplinës ta preqatitni mirë, duke e ilustruar me shembuj nga Lufta Nacionalçlirimtare, nga periudha e ndërtimit të socializmit dhe nga reparti ushtarake. Kështu do të jetë më e qartë se ç'do të thotë disiplinë në punë, në fabrikë, ç'do të thotë disiplinë proletare, ç'do të thotë disiplinë në kohë të vështira, ose disiplinë në kohën e betejave të mëdha historike. Në këtë mënyrë ju do të tërhiqni interesimin e njerëzve dhe njëkohësisht do t'i edukoni si duhet ata, do t'u hapni perspektiva të gjera, mbledhjet do të jenë tërheqëse dhe ai që ka thyer disiplinën, do të kuptojë se ç'pasoja sjell kjo dhe çfarë të mira sjell disiplina e ndërgjegjshme.

Çështjet që ju ngrini në organizatën-bazë të Partisë mund t'i shoqëroni me shumë gjëra nga njojuritë

tuaja. Po të shtrohen mirë problemet në organizatën-bazë të Partisë, të gjithë komunistët do të vijnë me dëshirë të madhe. Suksesi i mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë, pra, varet nga ju.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Në
ndihmë të Ushtrisë Popula-
lore», vëll. II, f. 434.
Tiranë, 1975*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes
së Sekretariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE RUHET E TE MIREMBAIHET ME KUJDES MAKINERIA USHTARAKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 tetor 1961

Në këtë material, ju, shokë të ushtrisë, nuk figuroni fare. Mirépo probleme të tilla keni edhe ju. Mendoj që këto çështje të shikohen edhe nga ana juaj, edhe ju të harxhon i jashtëzakonisht pak vegla këmbimi dhe makinat e automobilat tuaj të vihen në gatishmëri me shpenzime sa më të vogla.

Dihet se ju jeni në kushte më të mira. Në qoftë se automobili ushtarak bën 150 mijë kilometra dhe pastaj futet në oficinë, kjo nuk është aspak e rregullt. Makinat që janë në dispozicion të ndërmarrjeve të ndërtimit futen nëpër ujëra, përrenj, gropë, në pyje etj., kurse ato të ushtrisë këtë nuk e kanë të zakonshme.

Natyrisht, shoferët ushtarakë mund të mos kenë stimuj materialë, por kjo s'do të thotë që të mos men-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi lëvizjen e 100-600 miljeshit në sektorin automobilistik.

dohet për stimuj moralë. Kam mendimin që për ata, të cilët ruajnë dhe mirëmbajnë automobilat, tanksat, avionet ose anijet, të përdoret edhe ndonjë mjet stimulues, si ndonjë distinktiv etj. dhe t'u jepet atyre që tregojnë më shumë kujdes për ruajtjen e mijeteve ushtarake.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Në
ndihmë të Ushtrisë Popu-
llore», vëll. II, f. 436.
Tiranë, 1975*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes
së Sekretariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KOOPERATIVAT BUJQESORE T'I FORCOJMË DHE NIVELIN E JETESËS TË FSHATAREVE TË MOS E DOBESOJMË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 tetor 1961

Edhe unë mendoj të kemi kujdes për pakësimin e numrit të bagëtive të oborrit kooperativist. Kjo çështje duhet parë nga pikëpamja politike dhe ekonomike, nëse na lejon situata aktuale që të shkurtojnë anëtarët e kooperativave bujqësore bagëtitë në masën që propozohet. Po kështu duhet të mbajmë parasysh edhe faktin se mund të bëhen dhe skartime të bagëtive, prandaj unë mendoj të mos e pakësojmë tani numrin e bagëtive të oborrit kooperativist.

Ne kemi disa vështirësi në drejtim të forcimit ekonomik të kooperativave bujqësore. Është e domosdoshme që kooperativat t'i forcujmë dhe nivelin e jetesës të kooperativistëve të mos e dobësojmë. Natyrisht, po

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi ndryshimet në Statutin e Kooperativave Bujqësore.

t'i lëmë shumë bagëti kooperativistit, ai do të interesohet më tepër për ato sesa për punët e kooperativës. Nga ana tjetër, për t'i mbajtur me ushqim bagëtitë e tij, ndonjëri mund të vjedhë edhe barin e kooperativës, të dëmtojë kullotat kolektive etj., por me disa masa që mund të marrin, këto mund të evitohen.

Eshtë pozitive që kooperativistët çdo vit e më shumë po e kuptojnë rëndësinë e ekonomisë kolektive. Në këtë drejtim po luftohet nga Partia për edukimin e fshatarësisë me qëndrimin socialist ndaj punës dhe pronës shoqërore, prandaj gradualisht po shtohen ditët e punës të bëra në ekonominë kolektive, po shtohet emulacioni, po hapen më shumë sipërfaqe tokash të reja etj. Pra po ecet drejt forcimit të mëtejshëm të kooperativave bujqësore. Por është e kuptueshme gjithashtu që kooperativistët të interesohen edhe për ekonominë e tyre personale, sepse të ardhurat që sigurojnë nga puna në kooperativë, nuk u mjaftojnë, prandaj marrin diçka edhe nga oborri kooperativist, të ardhura në të holla ose prodhime në natyrë. Në kushtet e sotme kur kooperativat akoma nuk plotësojnë nevojat e përditshme të anëtarëve të tyre, mendoj se masat për shkurtimin e numrit të bagëtive të oborrit kooperativist do të krijonin pakënaqësi te fshatarët. Kjo ndodh edhe sepse në ndërgjegjen e tyre ka rrënje të thella prona private. Kryesorja është se, duke ulur numrin e bagëtive të oborrit kooperativist, anëtarët e kooperativës do të kenë vështirësi për mish, qumësht, gjalpë, kos, djathë etj. Prandaj unë nuk jam i mendimit tani për tani të veprojmë për pakësimin e krerëve të lopëve, të deleve, të dhive e të zgjojve të bletëve. Bletët, bile,

më duket e kotë tē pérpiqemi t'ua kufizojmë fshatarëve, sepse nga zhvillimi i tyre nuk do tē kemi ndonjë humbje.

Mund tē marrim masa vetäm pér kafshët e transportit. Këto kafshë nuk janë aq shumë tē nevojshme pér ekonomitë individuale sesa pér ekonomitë kolektive. Kafshët e transportit fshatarët i duan vetäm sa pér tē shkuar në pazar, kurse, po t'i marrë kooperativa këto kafshë, puna mund tē organizohet edhe më mirë, duke ecur me plan si pér plotësimin e nevojave tē transportit pér kooperativën, edhe pér nevojat individuale tē kooperativistëve. Pér shembull, transportimin e druve pér çdo anëtar mund ta organizojë më mirë dhe më me ekonomi kooperativa, sepse dihet që një familje kafshën personale nuk e shfrytëzon sa duhet, ndodh që me ditë tē tëra e mban në katua pa bërë asnijë punë, kurse kooperativa e përdor atë çdo ditë. Duke ia shitur kafshën personale kooperativës, fshatari merr një shumë tē mirë tē hollash në dorë pér plotësimin e nevojave tē tij. Statuti ekzistues i lejon një kooperativisti tē mbajë pér nevojat personale 1 deri 2 lopë ose buallica, 15-20 dhen e dhi, si dhe 1 deri 2 viça. Në qoftë se do tē vendoset ndonjë zvogëlim në numrin e bagëtive tē oborrit kooperativist mendoj që kjo tē bëhet me kujdesin më tē madh. Ndërsa pér zgjaket e bletëve dhe shpendët nuk jam i mendimit tē ketë kufizim.

*Botohet pér herë tē parë sipas
tekstit tē nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike tē KQ tē PPSH
që gjendet në AQP*

PARTIA JONË NUK KA AS ILUZIONIN MË TË VOGËL PËR GRUPIN E HRUSHOVIT

Shënime nga biseda me një mik të huaj

28 tetor 1961

Ne, shumë herë e kemi paraqitur pikëpamjen e Partisë sonë në lidhje me marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Në këtë çështje jemi udhëhequr kurdoherë nga interesi i të dyja palëve dhe nga interesi i përgjithshëm i unitetit të komunizmit ndërkombëtar, i revolucionit dhe i socializmit. Partia jonë ka treguar kurdoherë gjakftohtësi dhe është mbështetur fuqimisht në parimet e marksizëm-leninizmit për zgjidhjen e drejtë të këtyre mosmarrëveshjeve, megjithëse ajo ka pasë formuar bindjen me kohë se kishte të bënte me grupin e Nikita Hrushovit, i cili është një grup antimarksist.

Çdo ditë që kalon vërteton katërcipërisht pikëpamjen e drejtë të Partisë sonë mbi Hrushovin, që është një revizionist me damkë. Bile me deklaratën e tij të fundit, të bërë në datën 17 tetor përpara Kongresit XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushovi e hoqi krejtësisht maskën e vet,

duke treguar kështu para gjithë komunizmit ndërkom-bëtar se ai është jo vetëm një antimarksist, një trockist, revisionist i tërbuar, por ai u vu në një radhë me nje-rëzit e Departamentit Amerikan të Shtetit, me klikën e Titos, me Venizellosin e të tjerë si ky, për të organ-izuar kundërrevolucionin në Shqipëri, me qëllim që të rrëzojë pushtetin popullor dhe udhëheqjen e Partisë e të shtetit shqiptar. Pra, për Partinë e Punës të Shqi-përisë Nikita Hrushovi është një nga krerët më të rrezikshëm kundërrevolucionarë në shërbim të borgje-zisë së madhe dhe të imperializmit ndërkom-bëtar për likuidimin e socializmit në vendet tona dhe për t'i prerë rrugën fitores së komunizmit në botë. Këtë pikëpamje të Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e luan topi, atë nuk e luajnë as raketat. Partia e Punës e Shqipërisë do të mbrojë marksizëm-leninizmin, do të mbrojë po-pullin shqiptar, pavarësinë e atdheut, internacionaliz-min proletar, socializmin dhe komunizmin. Nikita Hru-shovi dhe grupi i tij tradhtar i prenë urat me ne dhe u bashkuan me imperialistët për të likuiduar vendin tonë. Me ne ata janë në luftë dhe luftën ne do ta përballojmë.

Disa thonë se tani ne do të izolohemi. Ne nuk jemi të këtij mendimi. Shqipëria nuk do të izolohet kurrë, sepse ka miq në të gjithë botën, se çështja për të cilën lufton është e drejtë dhe e drejta fiton kurdoherë. Përkundrazi, Nikita Hrushovi do të izolohet. Logjika e tradhtisë atë do ta çojë akoma më tej, logjika mark-siste-leniniste atë do ta demaskojë. Kështu e kupton Partia e Punës e Shqipërisë këtë çështje me rëndësi të madhe kombëtare dhe ndërkom-bëtare. Ne do të kemi

vështirësi, por do t'i kapërcejmë ato me sukses. Ne nuk do të gënjehemë kurrë nga demagogjia e Nikita Hrushovit dhe e grupit të tij tradhtar, ne nuk do të konfondojmë kurrë grupin e Nikita Hrushovit me Bashkimin Sovjetik. Lufta jonë e drejtë në këtë drejtim do të bindë edhe ata që tani nuk janë të bindur për drejtësinë e vijës së Partisë sonë.

Gjithashtu, revizionistët sovjetikë na akuzojnë për kult të individit. Ne e kemi thënë dhe e themi se në vendin tonë nuk ka kult të individit. Është e kuptueshme për të gjithë se teza e drejtë marksiste-leniniste për luftën që duhet t'i bëhet kultit të individit, u shfrytëzua nga Hrushovi dhe përdoret me qëllim për të rrëzuar udhëheqësit e shëndoshë marksistë-leninistë të partive të tjera e për të sjellë në fuqi komplotistë kundërrevolucionarë si veten e tij.

Përsa i përket çështjes së Stalinit, Partia jonë ka pikëpamjet e veta, të cilat i ka shprehur vazhdimisht. Edhe sikur Stalini të ketë bërë disa gabime, këto janë fare të vogla përparrë veprës së tij dhe shërbimeve të mëdha që u ka sjellë revolucionit, socializmit, komunizmit, Bashkimit Sovjetik dhe vendeve tona. Lufta që Nikita Hrushovi i ka bërë hapur Stalinit është lufta e një renegati ndaj një marksisti të madh. Ne e kemi mbrojtur dhe do ta mbrojmë fuqimisht J. Stalinin.

Në lidhje me grupin «antiparti» në Bashkimin Sovjetik ne kemi pikëpamjet tona, veçanërisht për disa pjesëtarë të këtij grapi të ashtuquajtur antiparti. Por pikëpamjet tona ne nuk i kemi shfaqur dhe nuk do t'i shfaqim, për arsyet se kjo gjë është një çështje e brendshme e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kurse

çështja e Stalinit nuk është një çështje e brendshme vetëm e Bashkimit Sovjetik. Mirëpo, Hrushovi, siç ka shpifur për Sëalinin ose për udhëheqjen e Partisë sonë, se gjoja është e shitur te imperializmi, ashtu ka thurur intriga edhe për udhëheqës të tjerë të BS, që nuk ishin me vijën e tij.

Ju duhet të dini se Nikita Hrushovi, ka botuar në gazetën «Pravda» të datës 16 tetor 1961 një pllakatë, ku tregohet se imperializmi po i vë zjarrin Shqipërisë. Për këtë pllakatë Qeveria jonë protestoi pranë ambasadës sovjetike në Tiranë, por ajo e hodhi poshtë protestën tonë. Në datën 17 tetor Nikita Hrushovi i bëri thirrje popullit shqiptar që të ngrihet në kundërrevolucion. Plakata dhe thirrja kundërrevolucionare e Nikita Hrushovit janë në shërbim të imperializmit dhe kanë një domethënje të caktuar: «I vini zjarrin Shqipërisë, se unë, Hrushovi, jam me ju dhe do t'ju ndihmoj që ta digjni krejt këtë vend!». Por imperializmi dhe Nikita Hrushovi duhet ta dinë mirë se vendi i shqiponjave nuk digjet lehtë. Sulmeve të armatosura të imperializmit dhe të shërbëtorëve të tij, shqiptarët do t'u përgjigjen me kundërsulme të armatosura.

Siç e shikon, vija e Hrushovit është një vijë e tërë e një renegati të marksizëm-leninizmit, prandaj Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka as iluzionin më të vogël për të dhe grupin e tij antimarksist.

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbalit
që gjendet në AQP*

TE DEMASKOHET DIE TE LUFTOHER ME DURIM DHE ME PRINCIPIALITET VEPRIMTARIA ANTIMARKSISTE DHE ANTISHQIPTARE E REVIZIONISTËVE MODERNE

*Letër dërguar të gjitha komiteteve të Partisë
të rretheve*

1 nëntor 1961

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror konstaton me kënaqësi se lidhur me ngjarjet e fundit, komitetet e Partisë të rretheve janë si duhet në krye të situatës dhe po bëjnë një punë të mirë sqaruese me Partinë dhe me masat e popullit.

Kudo Partia dhe populli i kanë kuptuar drejt qëllimet e sulmit të hapur të N. Hrushovit kundër Partisë dhe vendit tonë dhe kanë aprovuar deklaratën e Komitetit Qendror mbi këtë çështje¹. Kjo del qartë edhe nga telegramet e shumta që i kanë ardhur dhe vazhdojnë t'i vijnë Komitetit Qendror nga të katër anët e Shqipërisë. Qëndrimi i drejtë parimor dhe i vendosur

¹ Shih në këtë vëllim shënimin f. 56.

i Partisë, si dhe puna e mirë e organizatave të Partisë për sqarimin e masave kanë bërë që të shtrëngohen edhe më shumë radhët tona, të forcohet uniteti i Partisë dhe lidhjet e popullit me Partinë. Komiteti Qendror ju porosit që ta vazhdoni këtë punë edhe në të ardhshmen, të forconi Partinë dhe të zgjeroni punën me masat, pse këtu qëndron forca jonë.

Njëkohësisht, Komiteti Qendror e quan të arsyeshme të térheqë vëmendjen tuaj mbi disa çështje që, në kushtet e tanishmë, kanë një rëndësi të madhe për Partinë dhe duhet t'ju orientojnë në punën tuaj të përditshme:

1) Puna politike e Partisë në këto momente duhet të ngrihet lart, të zgjerohet, duke përfshirë masat më të gjera dhe të jetë bindëse, konkrete, e qartë. Ajo duhet të synojë në demaskimin e veprimtarisë antimarksiste dhe antishqiptare të N. Hrushovit, të demaskohen qëllimet e tij kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër miqësisë sonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe kundër Partisë dhe vendit tonë. Të demaskohen tezat e tij revizioniste, të demaskohen edhe metodat e tij antimarksiste.

Por njëkohësisht Partia nuk duhet të lërë pas dore për asnjë moment detyrat që ka përpara në fushën e ekonomisë për realizimin e planit. Situata e krijuar dhe gjithë puna politike e Partisë duhet të shërbejnë për një mobilizim edhe më të madh në punë si në industri, ndërtim, transport etj., për të realizuar sa më mirë planet, ashtu edhe në bujqësi, për të përfunduar sa më shpejt dhe në kushte sa më të mira mbjelljet,

për t'i dhënë atdheut më shumë drithë, pambuk, panxhar etj. Rezultati i gjithë punës së Partisë duhet të duket pra në dy drejtime: në aprovin e vijës së Partisë e në forcimin e unitetit të popullit me Partinë dhe në mobilizimin e gjithanshëm në punë për realizimin e planit të shtetit si në fushën e ekonomisë, ashtu edhe në atë të arsimit e të kulturës.

2) Duke demaskuar veprimtarinë antimarksiste të N. Hrushovit dhe të atyre që e pasojnë, duhet të mbajmë kurdoherë parasysh vijën e përgjithshme të Partisë sonë, të mos lejojmë që, duke u rrëmbyer nga momenti, të cenohet qëndrimi i Partisë për çështjet më kryesore të politikës së saj.

a) Goditjen kryesore duhet ta drejtojmë kurdoherë kundër imperializmit dhe në mënyrë të veçantë kundër imperializmit amerikan. Armiku kryesor ka qenë, është dhe mbetet imperializmi. Kjo duhet të jetë e qartë jo vetëm për ju dhe për masën e Partisë, por edhe për gjithë popullin. Kështu, në konferencat politike dhe në bisedat me popullin duhet të mos harrohet, por përkundrazi të dalë e qartë dhe e kuptueshme kjo çështje. Sigurisht ju e kuptioni se duke demaskuar fort imperializmin kjo shërben për të ngritur vigjilencën e masave, shërben njëkohësisht për të demaskuar edhe revizionizmin e vetë Hrushovin, sepse ashtu si nuk mund të luftohet kundër imperializmit pa luftuar kundër revizionizmit, nuk mund të luftohet me sukses edhe revizionizmi pa luftuar në radhë të parë imperializmin.

b) Duhet të vazhdojë lufta për demaskimin deri në fund të revizionizmit jugosllav, i cili ka qenë dhe mbetet një rrezik real për vendin tonë. Prandaj në luftën

kundër revizionizmit modern goditjet duhet të vazhdojnë të drejtohen me forcë kundër revizionizmit jugosllav, të demaskohen tezat e titistëve, të tregohet roli i tyre përçarës, të flitet për domosdoshmërinë e kësaj lufte deri në demaskimin e plotë të tyre. Ju e kuptioni gjithashtu se duke demaskuar fort revizionizmin jugosllav, aleat i ngushtë i revizionizmit hrushovian, demaskojmë edhe vetë N. Hrushovin.

Duhet ta kemi të qartë se në këto momente, kur Partia jonë po angazhohet në një luftë të gjatë e të vështirë me revizionizmin e N. Hrushovin, nuk duhet t'u japim shkas armiqve të Partisë që ta paraqitin çështjen sikur gjoja Partia jonë tanë nuk flet kundër imperializmit ose kundër revizionizmit jugosllav. Një gjë e tillë do t'i shërbente grupit të N. Hrushovit për të luftuar Partinë tonë, për të shpifur kundër saj.

c) Duhet të bëjmë kurdoherë dallimin midis rengatit Hrushov e atyre që e pasojnë dhe popujve e komunistëve të vërtetë sovjetikë, të mos ngatërrohen, në asnjë mënyrë, qëndrimi dhe lufta armiqësore që bën Hrushovi kundër Partisë sonë me miqësinë dhe respektin që kemi ne për popujt sovjetikë dhe Partinë Bolshevikë të Leninit e të Stalinit. Kjo është një çështje thelbësore e vijës së përgjithshme të Partisë sonë. Mos harroni se armiqtë e jashtëm, imperialistët, revisionistët jugosllavë, revizionisti Hrushov dhe ata që e pasojnë, si dhe elementët armiq brenda vendit, duke përfshirë këtu edhe agjentët e tyre, janë të interesuar për këtë, mund të bëjnë edhe provokacione në këtë drejtim, duan të na shtyjnë në një gabim të tillë. Por kjo nuk do të ndodhë kurrë dhe nuk duhet të ndodhë

në asnjë rast. Partia dhe masat e popullit tonë duhet të jenë të qarta, ta kuptojnë drejt, të veprojnë me bindje të plotë për të ruajtur miqësinë me popujt sovjetikë, se kjo është vija e Partisë sonë dhe kështu e do interes i përgjithshëm i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo nuk është taktikë, por kjo ka qenë dhe është në themel të gjithë vijës së përgjithshme të Partisë sonë marksiste-leniniste. Në çdo situatë, në çdo stuhi e furtunë, populli dhe Partia jonë kanë qenë dhe janë miq besnikë të popujve të Bashkimit Sovjetik, që bënë Revolucionin e parë Socialist në botë, që na ndihmuam për çlirim e atdheut tonë. Tradhtari i marksizëm-leninizmit, N. Hrushovi dhe grupi i tij kanë për qëllim të dëmtojnë e të sabotojnë miqësinë tonë me popujt sovjetikë, të cenojnë besimin tonë te popujt dhe te komunisët e Bashkimit Sovjetik, por ne kurrë nuk do të biem në këtë grackë të armiqve të marksizëm-leninizmit.

c) Të vazhdojë, ashtu si dhe më parë dhe të përforcohet puna për edukimin internacionalist të Partisë dhe të masave. Të flitet, pra, për unitetin e vendeve socialiste, për unitetin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për miqësinë me popujt e vendeve të tjera socialiste, për luftën e partive komuniste e punëtore të të gjithë botës. Të mos harrojmë se armiqtë e socializmit, imperialistët, revisionistët jugosllavë dhe renegati Hrushov me ata që e pasojnë, do të donin që të na largonin nga pozitat e internacionizmit. Por edhe kjo nuk do të ndodhë kurrë. Mbrojtja dhe respektimi i parimit të internacionizmit proletar kanë qenë, janë dhe mbeten një nga detyrat kryesore të Partisë sonë. Vetë lufta kundër revizionizmit të Hrushovit është një

shprehje e lartë e internacionalizmit të Partisë sonë marksiste-leniniste.

Duke pasur parasysh se tani në mbledhjet e ndryshme, në konferencat dhe bisedat me popullin, në shtyp dhe kudo, demaskohet hapur veprimtaria tradhtare e N Hrushovit, zbatimi i këtyre porosive ka një rëndësi të veçantë. Komiteti Qendror është i bindur se organizatat e Partisë dhe të gjithë komunistët do të tregohen, ashtu si deri tani, edhe në të ardhshmen në nivelin e detyrate të tyre.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

NJËZET VJET JETË DHE LUFTË REVOLUCIONARE

*Fjalim në mbledhjen solemne kushtuar 20-vjetorit
të themelimit të PPSH*

7 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe,

I gjithë populli ynë, i madh e i vogël, feston me gëzim në këto ditë dy data të shënuara: 20-vjetorin e themelimit të Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë dhe 44-vjetorin e fitores së Revolucionit të madh Socialist të Totorit.

Nuk është aspak e rastit që ne i festojmë ato së bashku. Këto dy ngjarje të shquara — triumfi i Revolucionit të madh të Totorit në Rusi më 7 Nëntor 1917 dhe themelimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë më 8 Nëntor 1941, pleksen ngushtë me njëra-tjetërën në historinë e popullit tonë, janë dy pikë-nyje në fatet historike të atdheut tonë.

Për shekuj me radhë ka luftuar me heroizëm e me vullnet të paepur populli shqiptar për lirinë e për të drejtën që të ekzistojë si komb, për tokën dhe për kushte më të mira jetese, për liritë e për të drejtat njerë-

zore, për përparimin shoqëror, për gjuhën amtare, për kulturën e zakonet kombëtare. Me shkronja të arta janë shkruar në historinë e popullit tonë luftërat shumëvjeçare të heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, si dhe përpjekjet për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare, që u kurorëzuan me ngritjen e flamurit në Vlorë nga Ismail Qemali. Në këtë luftë të gjatë e të vështirë historike ai ka pasur disfata dhe fitore. Por asnjëherë në të kaluarën fitoret e tij nuk kanë qenë të qëndrueshme e të plota, sepse vendin e pushtuesve të vjetër e zinin pushtues të rinj barbarë, sepse me gjakun dhe me djersën e popullit punonjës, me frytet e luftës e të fitoreve të tij, majmeshin e pasuroheshin klasat sunduese, pasanikët e bejlerët, një formë shfrytëzimi zëvendësohej me një tjetër.

Në të kaluarën populli ynë nuk ka pasur një udhëheqje të aftë e të vendosur deri në fund, për të udhëhequr me sukses luftën dhe përpjekjet e tij. Ai e gjeti një udhëheqje të tillë vetëm kur u krijuau Partia Komuniste e Shqipërisë (sot Partia e Punës). Partia jonë ngriti lart me krenari e me një forcë të re flamurin e lavdishëm të patriotëve e të luftëtarëve të shquar për interesat kombëtare të atdheut tonë dhe për interesat jetike të vegjëlisë — flamurin e Naimit e të Mqedës, të Çajupit e të Migjenit, të Çerçiz Topullit e të Bajram Currit, të Mihal Gramenos e të Avni Rustemit, të Ali Kelmendit, të Riza Cerovës e të qindra të tjerrëve, bëri realitet ëndrrat e tyre të bukura për një Shqipëri të lirë e të lumtur. Udhëheqjes së urtë të Partisë ia detyron, para së gjithash, populli ynë fitoret më të mëdha që ka arritur gjatë gjithë historisë së tij

të lavdishme shumëshekullore: çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe vendosjen e pushtetit popullor, ndërtimin me sukses të socializmit në atdheun tonë. Udhëheqja nga Partia jonë e Punës është garancia e sigurt edhe për fitoret e adhshme të popullit tonë në rrugën e mbrojtjes së pavarësisë e të sovranitetit të atdheut tonë socialist, në rrugën e ndërtimit të plotë të socializmit e të komunizmit në Shqipëri.

Në të kaluarën populli ynë nuk ka pasur asnjë mbështetje të fortë e besnike në arenën ndërkombëtare, që të përkrahej e të ndihmohej në luftën kundër agresionit imperialist si dhe për të kapërcyer prapambetjen e thellë ekonomiko-shoqërore e kulturore, në të cilën e kishin zhytur Shqipërinë pushtimet e huaja dhe sundimi i klasave shfrytëzuese, reaksionare e prapanike. Populli ynë e fitoi një mbështetje të tillë me triumfin e Revolucionit të madh Socialist të Totorit, me lindjen e shtetit të parë socialist në botë, të Bashkimit Sovjetik.

Triumfi i Revolucionit të Totorit çeli një epokë të re në historinë e njerëzimit, epokën e shembjes së imperializmit e të likuidimit të sistemit kolonial, epokën e triumfit të socializmit e të komunizmit në botë. Ai u dha një shtytje të fuqishme luftës revolucionare të klasës punëtore ndërkombëtare kundër rendit kapitalist dhe luftës çlirimtare të popujve të shtypur kundër zgjedhës imperialiste. Raporti i forcave në botë filloj të ndryshojë dita-ditës më shumë në favor të socializmit e të popujve liridashës dhe kundër kapitalizmit e imperializmit.

Nën influencën e fuqishme e jetëdhënëse të ideve

të Totorit të madh u përtërit me një hov të ri lëvizja çlirimtare antiimperialiste e demokratike edhe në Shqipëri, hodhi rrënje e u zhvillua lëvizja punëtore e komuniste, mbi bazën e së cilës u krijuat më pas Partia Komuniste e Shqipërisë. Lufta e Ushtrisë së Kuqe të lavdishme me J. Stalinin në krye kundër Gjermanisë naziste dhe ndihma e përkrahja internacionaliste e Bashkimit Sovjetik pas Çlirimit të vendit ishin ndër ata faktorë të jashtëm, që i dhanë mundësi popullit tonë të mobilizojë të gjitha forcat dhe energjitet e tij krijuar revolucionare, që të çlirohet nga robëria fashiste dhe të ecë i sigurt përpara në rrugën e socializmit. Këtu i ka rrënjet miqësia e thellë e popullit tonë me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik. Këtë miqësi të sinqertë popujsh e farkëtoi Partia jonë në çastet më të vështira të luftës së përbashkët kundër murtajës fashiste, kur atdheu ynë rënkonte nën thundrën e push-tuesve fashistë italianë e gjermanë dhe kur hordhitë hitleriane ndodheshin para dyerve të Leningradit, të Moskës e të Stalingradit, ajo u mbrujt me gjakun e pastër të partizanëve shqiptarë dhe të ushtarëve heronj të Ushtrisë së Kuqe, u kalit e u forcua më tej në luftën e përbashkët për ndërtimin e socializmit e të komunizmit dhe për paqen në botë. Një miqësi të tillë nuk kanë qenë, nuk janë e nuk do të janë në gjendje kurrë ta prishin as manovrat e imperialistëve, as intrigat e kli-kës renegate të Titos dhe as shpifjet, presionet, shantazhet e bllokadat e Nikita Hrushovit. Duke festuar 44-vjetorin e Revolucionit Socialist të Totorit, të revolucionit, që tronditi nga themelet botën e vjetër dhe hodhi themelet e botës së re, Partia dhe populli ynë u

dërgojnë urimet më të mira popujve dhe komunistëve vëllezër sovjetikë për fitoren e çështjes së madhe të komunizmit.

Shokë dhe shoqe,

Themelimi i Partisë së Punës të Shqipërisë u bë në një nga momentet më kritike në historinë e popullit të vogël e të shumëvuajtur, por heroik shqiptar. Re të zeza kishin pllakosur në atë kohë mbi atdheun tonë, Shqipërinë. Pas periudhës së errët të regjimit feudoborgjez të Zogut, mbi popullin tonë të shtypur e të shsrytëzuar, të uritur, të gjakosur e të tradhtuar, por të papërkulur si malet tona kreshnike, u vërsulën armiq akoma më të egër e më të rrezikshëm — pushtuesit fashistë. Robëria fashiste rrezikoi vetë ekzistencën e kombit tonë. Një rrezik vdekjeje u körcënohej në atë kohë gjithë popujve liridashës të botës: Gjermania hitleriane, e inkurajuar dhe e ndërsyer nga politika kapitulluese e fuqive të mëdha imperialiste, pasi nënshtroi me zjarr e me hekur shumë vende të Evropës, u sul si bishë e tërbuar kundër atdheut të socializmit — Bashkimit Sovjetik.

Në ato ditë të rënda për popullin dhe për atdheun tonë të shumëvuajtur, në errësirën e thellë që mbulonte vendin, lindi një shkëndijë e gjallë, nga e cila u ndez zjarri i pashuar i luftës çlirimtare, që i shiu si rrëbesh pushtues e tradhtarë, lindi Partia jonë.

Partinë Komuniste të Shqipërisë e krijuan komunistët shqiptarë, ajo lindi si rezultat dhe si kurorëzim i luftës së deriatëhershme të klasës punëtore të vendit tonë, i lëvizjes çlirimtare dhe i përpjekjeve të popullit

shqiptar. Pikërisht lëvizja punëtore e komuniste, që, ekzistonte në vendin tonë qysh përpara pushtimit fashist, megjithëse jo shumë e zhvilluar dhe e formuar, është baza mbi të cilën u formua Partia jonë.

Politika thellësish antipopulllore e kapitulluese e regjimit satrap të Zogut, që kishte shtuar pa masë varfërinë e vuajtjet e popullit, që shtypte në mënyrë barebare çdo gjë përparimtare dhe që e kishte shitur vendin te të huajt, pushtimi fashist më pas, i cili rrëmbeu lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin tonë dhe që vuri në rrezik vetë ekzistencën e popullit tonë si komb, të gjitha këto kishin rritur në kulm pakënaqësinë e mësive të gjera popullore dhe kishin krijuar një situatë të thellë revolucionare në vendin tonë. Populli donte bukë, donte tokë, donte të gjëzonte të drejtat elementare të njeriut, donte liri për atdheun e tij. Por populli nuk kishte udhëheqje. Në këto kushte, komunistët e shëndoshë, që bënин pjesë në grupet e atëherershme komuniste, lanë mënjanë grindjet dhe interesat e ngushta të grupeve dhe filluan një veprimitari të gjallë e të vendosur për krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftën e armatosur kundër fashizmit ishte një nxitje tjetër e fuqishme, që shpejtoi krijimin e Partisë sonë. Sulmi i pabesë i hordhive hitleriane kundër Bashkimit Sovjetik, atdheut të socializmit, mikut e përkrahësit të të gjithë të shtypurve e të shfrytëzuarve dhe të gjithë popujve, ishte një thikë në zemër për çdo komunist, për klasën punëtore ndërkombëtare, për mbarë njerëzimin përparimtar. Por, në të njëjtën kohë, hyrja e Bashkimit të fuqishëm

Sovjetik në luftë hapte për popullin tonë, si dhe përtë gjithë popujt e robëruar nga fashizmi, perspektivën e sigurt të çlirimit nga robëria fashiste.

Partia jonë lindi si një parti marksiste-leniniste dhe u ngrit sipas parimeve leniniste të ndërtimit të partisë. Qysh në fillim ajo bëri flamur të saj marksi-zëm-leninizmin, idetë ngadhnjimtare të Revolucionit të madh Socialist të Tectorit, nga ato u udhëhoq dhe i mbrojti kurdoherë me besnikëri, pa bërë kurrë lëshime në parimet. Nuk kishin mbaruar kuadrot e Partisë sonë shkolla të larta e universitete, as nuk ishin ata filozofë zyrash, por në përpjekje me valët e pamëshirshme të jetës, në mundime e në luftë me armiqtë e Partisë e të popullit, për çlirimin e atdheut dhe përndërtimin e socializmit, ata u bindën për drejtësinë dhe për forcën jetëdhënëse të mësimeve të marksizëm-leninizmit, i përvetësuan këto mësime, u brumosën me to dhe u bënë të aftë për t'i zbatuar në kushtet konkrete historike të atdheut tonë, për të përpunuar në çdo moment e rrethanë një vijë politike të drejtë.

Partia jonë lindi si parti e luftës për interesat jetike të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve, për interesat kombëtare të popullit tonë. Ajo doli nga gjiri i popullit punonjës, me popullin u rrit e u kalit, me të ndau vuajtje e gëzime, me popullin dhe për popullin u hodh në zjarr e në flakë, duke u gjendur kurdoherë në radhët e para të luftës, te populli gjeti forcë e mbështetje në momentet më të vështira. Ajo trashëgoi dhe zhvilloi më tej traditat më të mira të popullit tonë heroik: trimërinë, guximin dhe këmbënguljen e paepur në luftën për arritjen e qëllimit dhe në kapërci-

min e vështirësive, urrejtjen për armiqtë, besnikërinë e patundur dhe respektin për miqtë e vërtetë, ndershëmërinë dhe dashurinë për të drejtën. Populli ynë, nga vetë eksperienca e tij, nga vetëjeta dhe nga faktet, u bind se në Partinë e Punës ai ka prijësen e tij besnikë deri në fund, të aftë për ta udhëhequr atë me sukses nga fitorja në fitore drejt së ardhshmes së ndritur, mbrojtësen e paepur të interesave të tij. Prandaj, ai është i bashkuar si një trup i vetëm me Partinë dhe s'ka forcë e intrigë në botë që të mund ta thyejë këtë bashkim të çeliktë. Sepse në flamurin e saj ka pasur të shkruara gjithnjë interesat jetike të popullit, Partia jonë ka mundur të mbajë kurdoherë një vijë të përgjithshme të drejtë edhe në rrethanat më të ndërlikuara, sepse ka qenë kurdoherë e lidhur me masat si mishi me koskën, ajo ka mundur t'u bëjë ballë rrebesheve dhe sulmeve më të tërbuara të armiqve.

Partia jonë lindi si një repart luftarak i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo ka ecur kurdoherë përkrah me lëvizjen komuniste botërore dhe kampin socialist, si pjesëtare e denjë e këtyre, në luftën e përbashkët kundër fashizmit dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, për paqen dhe për lirinë e popujve, duke kryer me nder në çdo kohë e situatë detyrat e veta internacionale.

E themeluar mbi këto baza të shëndosha, Partia jonë përcaktoi qysh në fillim një program të qartë, që, si një fener ndriçues, hapi perspektivën dhe u bë flamur lufte për popullin tonë: lufta e paprerë e pa kompromis kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, grumbullimi dhe organizimi i popullit për

kryengritje të përgjithshme të armatosur, me qëllim që të arrihej çlirimi i plotë i vendit dhe t'i pritej rruga çdo sundimi imperialist në Shqipëri; shkatërrimi nga themeli i pushtetit të vjetër antipopullor të pushtuesit fashist e të klasave shfrytëzuese, ngritja e këshillave nacionalçlirimtare si embrioni i pushtetit popullore dhe vendosja e regjimit të demokracisë popullore në atdheun tonë; kryerja pas Çlirimit të vendit e transformimeve të mëdha shoqërore dhe ekonomike në interes të popullit dhe zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme për Asamblenë Kushtetuese, që do të vendoste formën e regjimit. I tillë ishte programi më i afërt i Partisë sonë, programi i revolucionit antiimperialist, antifeudal e demokratik, i cili bazohej në mësimet e marksizëm-leninizmit, duke marrë njëkohësisht parasysh kushtet e veçoritë historike konkrete të vendit tonë.

Si parti marksiste-leniniste, si parti revolucionare e klasës punëtore, Partia jonë kishte në programin e saj më të largët futjen e Shqipërisë në rrugën e socializmit, ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste në atdheun tonë.

Po për Partinë tonë ka qenë e qartë se nuk kishte ndonjë hendek të pakapërcyeshëm midis këtyre dy programeve, se ato nuk ishin të ndara me ndonjë mur, se ato ishin dy hallka të një zinxhiri të vetëm, që plotësonin njëra-tjetrën. E ndriçuar nga mësimet leniniste mbi shndërrimin e revolucionit demokratik në revolucion socialist, Partia jonë pati kurdoherë të qartë perspektivën, nuk harroi për asnjë çast se fitorja vendimtare e popullit tonë, me klasën punëtore dhe Partinë e saj komuniste në krye në Luftën Nacionalçlirimtare, ishte kushti i

domosdoshëm për fitoret e mëtejshme të popullit tonë, për futjen e tij në rrugën e socializmit.

Me një vijë të tillë të drejtë marksiste-leniniste, Partia udhëhoqi me siguri dhe shpuri në fitore Luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë, duke manovruar me vendosmëri e pa lëkundje nga pozita të drejta në çdo rrethanë, sado e ndërlikuar që të ketë qenë.

Thirrjes së Partisë për luftë të armatosur e pa kompromis kundër pushtuesit e tradhtarëve iu përgjigj me një hov të madh patriotik e revolucionar i gjithë populli shqiptar: klasa punëtore heroike e vendit tonë, e cila me gjithëse e vogël në numër u bë udhëheqësja e denjë e revolucionit popullor; fshatarësia punonjëse e etshme për tokë e liri, aleatja besnike dhe e fuqishme e klasës punëtore; inteligjenca patriote e përparimtare, që lufkonte për lirinë dhe kulturën tonë kombëtare; rinia jonë e lavdishme me zemrën e saj flakë, që gjithë pasionin dhe energjitet e saj rimore, pa kursyer as jetën, ua kushtoi çështjes së shtrenjtë të çlirimt dëshvishimit të ëndrrës shekullore të popullit tonë të shumëvaujtur për një jetë të lumtur; gratë trime të Shqipërisë, që flakën tej me vendosmëri çarçaf e fanatizëm dëshvishimi të rrëmbyen armët për të luftuar krah për krah me burrat për lirinë e atdheut dhe për të drejtat e veta; të gjithë njerëzit e ndershëm, patriotë e antifashistë, që mbi intercsat e tyre personale vinin interesat e larta të atdheut. Të gjitha këto forca të mëdha popullore, nën udhëheqjen e Partisë, u bashkuan në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar. Ky front nuk ishte një bashkim i parisë së vendit dhe as një koalicion partish të ndryshme politike, por një organizatë e drejtpërdrejtë e

të e vetë masave të gjera punonjëse e patriote nën udhëheqjen e një partie të vetme, të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që shprehte interesat jetike të popullit punonjës. Në themelin e këtij fronti të gjerë popullor qëndronte aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore, aleancë që përbënte bazën shoqërore të ushtrisë politike të revolucionit popullor në vendin tonë.

Nën udhëheqjen e Partisë, lufta çlirimtare në vendin tonë u ndez me një hov të papërmbajtshëm dhe u shndërrua në kryengritje të përgjithshme të armatosur të mbarë popullit. Ashtu si ai topi i vogël prej dëbore, që, duke u rrokullisur tatëpjetë malit, rritet dalngadalë e shndërrrohet në ortek të fuqishëm, i cili fshin me rrëmbim çdo gjë që gjen përpara dhe trondit si tërmët male dhe fusha, ashtu nga guerrilet e çetat e para partizane, që ishin në filkim të vogla në numër, duke u shtuar dita-ditës me bijtë dhe bijat më të mira të popullit, u krijuar Ushtria e fuqishme partizane Nacionalçlirimtare, e cila më 1944 numëronte mbi 70 mijë luftëtarë të organizuar në brigada, në divizione e korparmata. Ajo ishte një ushtri me të vërtetë popullore, që lindi nga gjiri i popullit dhe luftoi për popullin. Populli e rriti atë me gjak të ri, e ushqeu dhe e mbathi, e mbajti dhe e përkrahu pa rezerva në luftën e vështirë me pushtuesit fashistë italianë e gjermanë dhe tradhtarët e vendit. Me parullat luftarake të Partisë «Liria nuk dhurohet, por fitohet me luftë e me gjak» dhe «Vdekje fashizmit — Liri popullit!», ushtria jonë partizane luftoi me një heroizëm të pashoq, me gjakun e saj shkroi faqe të reja të lavdishme në historinë e

popullit tonë luftëtar e liridashës. Më 29 Nëntor 1944, kur Ushtria e Kuqe, duke shpartalluar hordhitë hitleriane, u jepte mundësi popujve jugosllavë etj., të fitonin me luftën e tyre lirinë, duke krijuar në këtë mënyrë kushte më të mira objektive për çlirimin e Shqipërisë, partizanët tanë trima çliruan plotësisht atdheun tonë nga pushtuesit e nga tradhtarët. Dhjetëra mijë dëshmorë, komunistë e patriotë pa parti, dhanë jetën në këtë luftë të shenjtë e të lavdishme, me gjakun e tyre të kulluar i hapën popullit tonë rrujan për të ecur përpëra drejt jetës së lumtur, socializmit dhe komunizmit. Le të nderojmë, shokë dhe shoqe, kujtimin e tyre, që do të rrojë për shekuj i ndritur e me lavdi!

Partia Komuniste e Shqipërisë qëndroi kurdoherë e patundur në radhët e para të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë, pa lejuar kurrrë kompromise në parimet e lëkundje përballë armikut. Komunistët ishin kurdoherë në vendin më të rrezikshëm, duke frymëzuar me shembullin e tyre gjithë luftëtarët për liri. Në krye të detyrës ranë me heroizëm shumë nga drejtuesit dhe bijtë më të mirë të Partisë.

Krahas luftës së paepur kundër pushtuesve fašistë italianë e gjermanë, Partia bëri një punë të madhe për të demaskuar para gjithë popullit tradhtinë e klasave shfrytëzuese, të feudalëve e të borgjezisë së madhe dhe organizatat e tyre, «Ballin Kombëtar» e «Legalitetin», që ishin vënë në shërbim të pushtuesve, si dhe orvatjet e imperialistëve anglo-amerikanë për të përcarë e për të penguar Luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë. Duke i qëndruar besnikë programit të saj të qartë marksist-leninist, Partia nuk lejoi kurrë

që organizatat tradhtare, pa hedhur asnjë pushkë kundër fashizmit, të mashtronin popullin, të zinin pozita në pushtet pas Çlirimit të vendit.

Në saje të qëndrimit të drejtë klasor të Partisë sonë, të taktikës së saj të vendosur, me çlirimin e vendit, tërë pushteti kaloi plotësisht qysh në fillim në duart e klasës punëtore në aleancë me të gjitha masat punonjëse e patriote të vendit, në duart e një partie të vetme, të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ky ishte kushti themelor që i lejoi vendit tonë të futet pa vonesë, në rrugën e zhvillimit socialist.

Çlirimi i vendit dhe vendosja e pushtetit popullor shtroi detyra të reja të mëdha e të vështira para Partisë dhe popullit tonë, për të çuar deri në fund revolucionin popullor, për të rindërtuar vendin e shkatatruar nga lufta dhe për ta çuar atë përpara në rrugën e ndërtimit socialist.

Megjithëse Shqipëria ishte një vend i prapambetur bujqësor, me mbeturina të theksuara të feudalizmit, Partia nuk ngurroi për asnjë moment që ta orientonte atë drejt ndërtimit socialist, duke kapërcyer fazën e kapitalizmit të zhvilluar. Kushtet e brendshme dhe ndërkombëtare ishin të favorshme për këtë. Nga njëra anë, klasat shfrytëzuese kishin pësuar një disfatë të thellë politike gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe tërë pushteti kishte kaluar në duart e klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, në krye të pushtetit qëndronte një parti e vetme, Partia Komuniste, e aftë dhe e vendosur deri në fund për të zhdukur çdo mbeturinë të së kaluarës dhe për ta çuar vendin drejt socializmit. Nga ana tjetër, prapambetja e thellë ekonomike e kul-

turore e vendit nuk ishte një pengesë e pakapërcyeshme për futjen e vendit tonë drejtpërdrejt në rrugën e zhvillimit socialist, në kushtet kur ekzistonte Bashkimi Sovjetik, i cili ishte i gatshëm ta ndihmonte pa kursyer vendin tonë.

Në këtë periudhë Partia jonë goditi pa mëshirë e pa lëkundje vijën oportuniste të Sejfulla Malëshovës, e cila shpinte drejt zhvillimit të gjerë të kapitalizmit dhe nënshtrimit të vendit ndaj imperializmit. Orientimi i Partisë, për futjen e menjëherershme të vendit në rrugën e zhvillimit socialist, ishte i vetmi orientim i drejtë, sepse vetëm ndërtimi i socializmit mund ta shpëtonte një herë e përgjithmonë popullin punonjës nga shfrytëzimi e nga vuajtjet dhe të krijonte kushte më të mira jetese për të, vetëm futja në rrugën e socializmit krijonte mundësi të favorshme për kapërcimin e shpejtë të prapambetjes së thellë që kishte trashëguar vendi ynë nga regjimet e kaluara antipopullore, vetëm futja në rrugën e socializmit mund ta shpëtonte një herë e përgjithmonë vendin tonë nga depërtimi e sundimi i kapitalit të huaj, ta bënte atdheun tonë me të vërtetë të pavarur nga fuqitë imperiale jo vetëm politikisht, por dhe ekonomikisht.

Nën udhëheqjen e Partisë, brenda një periudhe të shkurtër, në vendin tonë u kryen me sukses transformime antiimperialiste, antifeudale e demokratike, të cilat në kushtet tona u pleksën ngushtë me transformimet e para socialiste, u shëruan plagët e luftës dhe u krijuan kushtet e favorshme për të filluar ndërtimin socialist.

Partisë sonë në këtë periudhë iu desh të bënte një

luftë të ashpër, për jetë a vdekje, kundër ndërhyrjes brutale, veprimtarisë armiqësore dhe sulmeve të egra të klikës titiste ndaj Partisë dhe vendit tonë, si dhe kundër veprimtarisë trockiste e minuese të agjentit të saj, Koçi Xoxes dhe shokëve të tij, që kishin vënë Partinë nën kontrollin e organeve të sigurimit, që ai vetë drejtonte, që kishin shkelur në mënyrë flagrante ligjshmërinë socialiste dhe normat leniniste në Parti, që preqatitnin aneksimin e Shqipërisë në Republikën Federative të Jugosllavisë. Partia mundi të dalë fitimtare në këtë luftë të vështirë, sepse u qëndroi besnikë deri në fund parimeve të marksizëm-leninizmit dhe nuk u largua prej tyre as para sulmeve, shpifjeve, presioneve e shantazheve më të tërbuara të klikës tradhtare të Beogradit. Një ndihmë shpëtimtare në këtë luftë i dhanë Partisë sonë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik dhe J. V. Stalini, të cilët në letrat e njohura mbi gjendjen në Partinë Komuniste të Jugosllavisë demaskuan para botës fytyrën e vërtetë të kësaj klike renegatësh.

Partia jonë, e ndriçuar nga mësimet jetëdhënëse të të madhit Lenin dhe nga eksperienca e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, përpunoi gjithashtu programin e qartë të ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë, të prapambetur e të rrethuar nga të katër anët nga ujqit kapitalistë e revisionistë. Ky program, që u kristalizua, sidomos në Kongresin I të Partisë Komuniste të Shqipërisë në nëntor të vitit 1948, që u zhvillua më pas në Kongresin II dhe III të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe gjeti mishërimin e tij në planet pesëvjeçare të zhvillimit ekonomik e kulturor

të vendit tonë, parashikonte: industrializimin socialist të vendit, riorganizimin e bujqësisë mbi baza socialiste, kryerjen e revolucionit socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale të popullit.

Partia e udhëhoqi me sukses hap pas hapi realizimin e këtij programi të ndërtimit socialist, pa u larguar për asnjë moment nga pozitat e marksizëm-leni-nizmit dhe duke e zbatuar atë në përshtatje me kushtet konkrete të vendit tonë. Në çdo kohë ajo ka ditur të zbulojë e të zgjidhë drejt kontradiktat e zhvillimit socialist në vardin tonë, të përcaktojë hallkën themelore të ndërtimit socialist në këtë ose në atë periudhë, ta konkretizojë atë në planet ekonomike dhe të mobilizojë forcat e masave punonjëse për zgjidhjen e saj të drejtë.

Brenda një periudhe historike shumë të shkurtër prej rreth 17 vjetësh, vendi ynë, nën udhëheqjen e urtë të Partisë, likuidoi prapambetjen e thellë që kishte trashëguar nga e kaluara dhe u shndërrua nga një vend agrar krejt i prapabetur, gati krejt pa industri dhe me një bujqësi primitive, në një vend agraro-industrial. U krijuan degë të tëra të industrisë, siç janë industria tekstile, industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore, industria mekanike, mori një zhvillim të gjerë industria e nxjerrjes dhe e përpunimit të naftës e të mineraleve të dobishme etj.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar (1951-1955) u ndërtuan rreth 150 objekte të rëndësishme industriale e social-kulturore, mbi 250 të tjera u ngritën gjatë pesëvjeçarit të dytë (1956-1960). Para syve tanë, atje ku më parë ishin fusha, kodra të zhveshura apo këneta,

u ngritën dhjetëra e dhjetëra vepra të mrekullueshme, që përbëjnë sot krenarinë e popullit tonë. Me duart e arta të klasës punëtore e të të gjithë punonjësve dhe me ndihmën internacionale të miqve tanë, në radhë të parë të Bashkimit Sovjetik, u ngritën kombinati i tekstileve «Stalin», kombinati i sheqerit «8 Nëntori», kombinati i drurit «Nako Spiru», fabrika e madhe e çimentos «Lenin», uzinat e përpunimit të naftës, fabrika e pasurimit të bakrit, minierat e hekur-nikelit, të kromit, të bakrit, të qymyrgurit etj., hidrocentralet «Lenin» e «Karl Marks» dhe rrëth 400 kilometra vija të tensionit të lartë, mjaft fabrika për përpunimin e rrushit, të frutave e të perimeve, për fermentimin e duhanit, për prodhimin e materialeve të ndërtimit e dhjetëra vepra të tjera të rëndësishme. Vazhdojnë me ritme të shpejtë punimet për ndërtimin dhe për përfundimin e hidrocentraleve në Shkopet e në Bistricë, të kombinatit ushqimore «Ali Kelmendi», të kombinatit të mishit etj.

Populli shqiptar, dikur i ndrydhur e i paditur, që gjithmonë shikonte me zili vendet e tjera, që gjithçka e priste nga Evropa, që nga gota e ujit e deri te vajguri, tani, me pushtetin e tij populor dhe nën udhëheqjen e Partisë, po krijon me duart e veta një jetë të re. Prodhimi i përgjithshëm industrial në vendin tonë është rritur 25 herë në krahasim me paraluftën. Ajo që u prodhua nga industria e vendit gjatë gjithë vitit 1938, tani prodhohet nga industria jonë e re socialiste vetëm në 15 ditë. Vetëm në rrëthin e Fierit, i cili është kryesisht një rrëth bujqësor, prodhimi industrial është sot rrëth 1,6 herë më i madh nga prodhimi i përgjithshëm industrial i gjithë Shqipërisë në vitin 1938.

Në industrializimin socialist Partia jonë është udhëhequr nga parimi marksist-leninist i zhvillimit të mjeteve të prodhimit me ritme më të shpejta, prandaj i është dhënë rëndësi zhvillimit, në radhë të parë, të industrisë së rëndë, sidomos industrisë minerare, zhvillimit të bazës energjitike të vendit etj. Por duke pasur parasysh vëçoritë e vendit tonë të vogël, me mundësi të kufizuara forcash njerëzore e mjetesh materiale e financiare, gjë që bënte të pamundur ngritjen e të gjitha degëve të industrisë së rëndë, si dhe nevojat e ngutshme të popullit tonë për mallra konsumi, krahas industrisë së rëndë janë zhvilluar edhe degë të ndryshme të industrisë së lehtë e ushqimore.

Sukseset e mëdha të arritura në vendin tonë në industrializimin e vendit, përbëjnë një hap të madh historik në ndërtimin e socializmit dhe një bazë të shëndoshë për zhvillimin e mëtejshëm e më të shpejtë të atdheut tonë në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë sociale.

Me sukses përfundoi në vija të përgjithshme edhe transformimi socialist i fshatit tonë. Në këtë çështje kaq të rëndësishme e kaq delikate të ndërtimit socialist, Partia jonë është udhëhequr në mënyrë konsekuente nga mësimet e Leninit. Ajo ndoqi me rreptësi rrugën e bashkimit vullnetar të ekonomive fshatare individuale në kooperativa bujqësore, si dhe të organizimit të ndërmarrjeve të mëdha bujqësore.

Në përputhje me këtë orientim të drejtë të Partisë sonë, në dhjetë vjetët e parë pas Çlirimit u bë një punë e gjithanshme dhe e thellë për të sqaruar e për të bindur fshatarësinë për epërsitë e ekonomisë

së madhe kolektive, u realizuan një sërë masash të rëndësishme për sigurimin e bazës materialo-teknike të prodhimit të madh bujqësor, për prebatitjen e kuadrove të nevojshëm bujqësorë, për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore ekzistuesc, në mënyrë që të shërbenin si model e si provë bindëse për masat e fshatarësisë punonjëse të pakoperuar, u ndoq me konsekuençë kursi i Partisë për aleancën e shëndoshë me fshatarësinë e varfér e të mesme dhe për kufizimin ekonomik e izolimin politik të kulakëve etj. Kur kushtet u poqën, Partia, në Plenumin e Komitetit Qendror në dhjetor 1955 dhe më pas në Kongresin III në maj 1956, dha orientimin për shpejtimin e ritmeve të kolektivizimit të bujqësisë. Siç konstatoi Kongresi IV i Partisë, vendimi i Kongresit III u realizua para afatit. Në fillim të vitit 1961 në vendin tonë numërohej afro 1 500 kooperativa bujqësore, të cilat së bashku me ndërmarrjet bujqësore zinin mbi 86 për qind të sipërfaqeve të mbjella të Republikës. Kolektivizimi i bujqësisë në vendin tonë pati veçoritë e tij dalluese: ai u bë në kushtet e ekzistencës së pronës private mbi tokën, por të cilën fshatari pronar nuk mund ta shiste, ta blinte ose ta linte peng; ai u bë pothuajse pa forma ndërmjetëse të kooperimit, duke kaluar drejtpërdrejt nga ekonomia e vogël private në artelin bujqësor të tipit socialist; ai u bë duke krijuar, krahas procesit të kooperimit, bazën materialo-teknike të prodhimit të madh kolektiv.

Krahas kolektivizimit të bujqësisë, Partia dhe push-teti ynë popullor, me pjesëmarrjen aktive të fshatarësisë punonjëse të vendit tonë, kanë bërë një punë

kolosale për zhvillimin e forcave prodhuese në fshat. Krahina të tëra të atdheut tonë, ku më parë mushkonja e malarja kishin vendosur mbretërinë e tyre të helmatisur, janë bërë sot zona pjellore e të shëndetshme. U bonifikuan e u sistemuan Maliqi, Bedeni, Rrushkulli, Borshi, Mifoli, Lapardhica, Vrina, Vurgu, Roskoveci, Myzeqeja, Tërbuji, Thumana, Zadrima etj., u hapën qindra kilometra kanale ujitëse. Dhjetëra mijëra hektarë tokë u fituan nga tharja e kënetave dhe masat për përmirësimin e tyre, mijëra hektarë të tjerë u shtuan nga hapja e tokave të reja.

Një kujdes të posaçëm i ka kushtuar Partia mekanizmit të bujqësisë. Në fillim të këtij viti ne kishim 4 510 traktorë, të kthyer në 15 kuaj-fuqi, si dhe një sasi të konsiderueshme makinash e mekanizmash të tjera bujqësore. Në zonat e punueshme me traktorë rrëth 85 për qind e lërimeve, 49 për qind e mbjelljeve, 36 për qind e korrijeve, 64 për qind e shirjeve etj., kryhen me mjete të mekanizuara, gjë që jo vetëm ka shtuar rendimentin dhe ka përmirësuar cilësinë e punimeve, por edhe ka lehtësuar shumë punën e rëndë të fshatarit tonë. Shteti ynë e ka ndihmuar fuqimisht fshatarësinë punonjëse që të zhvillojë forcat prodhuese e të ngrëjë ekonominë. Vetëm gjatë pesëvjeçarit të dytë ai i ka dhënë asaj mbi 4 miliard lekë kredit agrar. Të gjitha këto janë gjëra që as mund të ëndërroheshin në fshatin shqiptar të kohës së paraçlirimit, ku par mënda e drurit ishte i vetmi mjet dhe ku sundonin mjerimi, varfëria, prapambetja dhe kërbaçi i beut e i agait.

Në saje të kolektivizmit të bujqësisë, të masave të rëndësishme të Partisë e të pushtetit popullor për

zhvillimin e forcave prodhuese në fshat, si dhe në saje të punës vetëmohuese të fshatarësisë punonjëse të vendit, janë arritur suksese të mira në shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtoriale. Megjithëqë vitet e fundit s'kanë qenë të mbarë për bujqësinë, prodhimi bujqësor në vitin 1960, në krahasim me paraluftën, është rritur mbi 1,6 herë. Me planin e tretë pesëvjeçar bujqësia e vendit tonë futet në fazën e zhvillimit me ritme akoma më të shpejta, nëpërmjet rritjes së shpejtë të rendimenteve të kulturave bujqësore, të kalimit nga bujqësia ekstensive në bujqësinë intensive.

Mbi bazën e rritjes së vazhdueshme të prodhimit industrial e bujqësor, të shtimit të potencialit ekonomik të vendit, ka ardhur duke u ngritur pareshtur niveli i jetesës të popullit tonë, gjë që përbën qëllimin e ndërtimit socialist dhe ligjin më të lartë të gjithë veprimtarisë së Partisë sonë të Punës. Si një e kaluar e hidhur kanë mbetur tanë në kujtesën e popullit tonë papunësia, varfëria e mjerimi i thellë, kërcënimi i urisë, puna e rëndë prej skllavi për një kothere bukë, fëmijët e zhveshur e të zbatur, kasollet e rrënuara, sëmundjet kronike dhe tmerret e tjera, që karakterizonin në një të kaluar jo të largët vendin tonë dhe që shoqëronin hap pas hapi njeriun punonjës tërë jetën, nga djepi gjer në varr. Tani papunësia është zhdukur përgjithmonë, punonjësit tanë gjëzojnë të drejtën e punës, të pushimit vjetor të paguar, të pensionit për paaftësi e vjetërsi në punë, të shërbimit mjekësor dhe të arsimit falas. Hidhni sytë rreth e qark në qytetet e në fshatrat tona dhe do të shihni se ato janë shndërruar në një kantier ndërtimi, ku çdo ditë ngrihen dhjetëra e dhjetëra banesa të reja

për popullin. Vetëm gjatë vitit 1960 në qytetin e Tiranës janë shpenzuar nga shteti ynë, për të ndërtuar apartamente banimi, rrëth 2 herë më shumë mjete nga ç'janë shpenzuar në vitin 1938 në tërë Shqipërinë për të gjitha llojet e ndërtimeve. Në fshatin tonë, të tymosur nga pisha e kandili, po futet çdo ditë e më shumë drifa elektrike. Të ardhurat kombëtare, që janë treguesi kryesor i rritjes së mirëgenies së një vendi dhe që në atdheun tonë socialist shpërndahen në përqindjen dërrmuese për nevojat e përditshmë të punonjësve, janë rritur mbi 4 herë në krahasim me paraluftën, kanë ardhur vazhdimisht duke u rritur paga reale e punëtorëve, e nëpunësve dhe të ardhurat reale të fshatarësisë. Për këtë dëshmon më së miri fakti që, në dhjetëvjetëshin 1951-1960 fshatarët me mjetet e tyre kanë ndërtuar afro 47 mijë shtëpi të reja, pa llogaritur këtu ndërtimet e bëra në fshat nga shteti dhe nga kooperativat bujqësore. Dëshmi e gjallë për rritjen e mirëgenies së punonjësve janë gjithashtu uljet e çmimeve. Që nga viti 1950 deri në vitin 1960 në vendin tonë janë bërë njëra pas tjetrës 9 ulje çmimesh, nga të cilat popullsia ka një përfitim vjetor mbi 7 miliard e 900 milion lekë. Vetëm disa ditë më parë u bë dhe ulja e re e çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë, nga e cila populli ynë ka një përfitim vjetor prej 800 milion lekësh.

Ne jemi plotësish të ndërgjegjshëm se, për shkak të prapambetjes së thellë dhe të varfërisë që pat trashëguar vendi ynë nga e kaluara jo e largët, na mbetet akoma shumë për të bërë në drejtim të rritjes së mirëgenies materiale të punonjësve, se në jetën e tyre ka akoma mjaft mungesa. Por kjo nuk na tremb

e nuk na dekurajon. Bazat tani janë hedhur për të ecur kurdoherë përparrë në ngritjen e mëtejshme të nivitet të jetesës së popullit. Pengesat dhe vështirësitë e përkohshme nuk do të na ndalin dot në rrugën tonë.

Një revolucion i thellë socialist është bërë dhe vazhdon të bëhet me ritme të shpejta në vendin tonë në fushën e ideologjisë e të kulturës. Vendi ynë, që jo shumë kohë më parë konsiderohej si vendi më i prapambetur në Evropë, ku mbi 80 për qind e popullsisë ishte analfabete, ku nuk kishte asnjë teatër profesionist, ka ndryshuar rrënjosht. Padituria ia ka lëshuar vendin dijes, errësira — dritës. Tani vendi ynë është bërë jo vetëm një kantier i madh ndërtimi, por dhe një shkollë e madhe, ku në çdo pesë veta njëri mëson. Të marrim si shembull rrëthim e Tropojës. Në vitin 1938 atje kishte gjithsejt 11 shkolla fillore me 575 nxënës dhe asnjë shkollë 7-vjeçare, kurse tani atje ka 48 shkolla fillore me 2 230 nxënës, 11 shkolla 7-vjeçare me 720 nxënës dhe një shkollë të mesme 11-vjeçare.

Arti e kultura po bëhen çdo ditë e më shumë pronë e masave të gjera të popullit. E si mund të imagjinonin baballarët tanë, bile dhe shumë nga ndërtuesit e sotëm të socializmit që janë në moshë të shkuar, se edhe në Shqipërinë e vogël, të shtypur, të zhytur në mjerim dhe në errësirën e thellë të padipes, do të lulëzonte kaq shpejt një jetë e kulturuar, do të krijoheshin opera e kinematografia kombëtare, ndërsa një rrjet i gjerë shtepish leximi e vattrash kulture do të depërtonte edhe në skajet më të largëta të maleve tona! Për herë të parë në historinë e atdheut tonë janë ngritur në vend Universiteti Shtetëror i Tiranës e institute të tjera

të larta, ku tani mësojnë mbi 9 000 studentë dhe prej tyre diplomohen çdo vit rreth 900 kuadro me arsim të lartë. Në vendin tonë, nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, është krijuar e po rritet dita-ditës një shtresë e gjerë e inteligjencës popullore, e dalë kryesisht nga radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse, e lidhur ngushtë me popullin dhe me interesat e tij jetike, e brumosur me botëkuptimin marksist-leninist dhe besnikë ndaj çështjes së madhe të socializmit e të komunizmit. Sukseset tona në fushën e revolucionit kulturor përbëjnë një ndër fitoret e rëndësishme historike të ndërtimit socialist në vendin tonë, të arritura nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës.

Si rezultat i triumfit të marrëdhënieve socialiste dhe në saje të punës së palodhur edukative të Partisë, të shtetit tonë dhe të organizatave të masave, një revolucion i vërtetë është kryer e po thellohet çdo ditë e më tepër në ndërgjegjen e punonjësve tanë. Marksizëm-leninizmi, ideologjia sunduese në vendin tonë, po rrënjoset gjithnjë e më shumë në ndërgjegjen e punonjësve, të cilët po shkunden vazhdimisht nga mbeturinat e ideologjive të vjetra, që na kanë mbetur trashëgim nga e kaluara. Dëshmja më e gjallë e revolucionit socialist në ndërgjegjen e njerëzve në atdheun tonë është qëndrimi i ri socialist ndaj punës e shoqërisë, që shprehet në përhapjen e gjerë të garave socialiste, në lëvizjen e mrekullueshme të brigadave të punës socialiste e në mjaft lëvizje të tjera të dobishme, në patriotizmin e zjarrtë të popullit tonë që duket në mobilizimin e entuziazmin e tij, në punën për lulëzimin e atdheut tonë socialist, në gatishmërinë revolucionare të tij për të

mbrojtur me vendosmëri fitoret tona nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm, si dhe në një sërë shfaqjesh të tjera të ndërgjegjes socialiste të punonjësve, që karakterizojnë në çdo hap jetën tonë të përditshme.

Sic e dini, Kongresi IV historik i Partisë sonë, i cili i zhvilloi punimet e veta në shkurt të këtij viti, mbi bazën e analizës së transformimeve socialiste që janë kryer në vendin tonë në të gjitha fushat, arriti në konkluzionin se te ne ka përfunduar tanimë me sukses ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit. Është zhdukur ekonomia shumëformëshe, marrëdhëniet socialiste në prodhim kanë triumfuar si në qytet, ashtu edhe në fshat.

Si rezultat i likuidimit të plotë të ekonomisë kapitaliste dhe i zhdukjes së prodhimit të vogël të mallrave, i vendosjes së pronës socialiste mbi mjetet e prodhimit në të gjithë sektorët, në vendin tonë u likuiduan klasat shfrytëzuese si klasë dhe shfrytëzimi i njeriut nga njeriu. Në vendin tonë ekzistojnë tanë vetëm dy klasa mike — klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, si dhe shtresa e inteligjencës populllore, të cilat, nën udhëheqjen e klasës punëtore e të Partisë së saj të Punës, kanë në duart e veta pushtetin dhe çojnë përrpara ndërtimin socialist të vendit. Është krijuar e po forcohet dita-ditës më shumë uniteti moralo-politik i popullit tonë, i cili është garancia për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e Republikës Populllore të Shqipërisë nga çdo armik. Ndërtimi me sukses i bazës ekonomike të socializmit është një fitore e madhe historike e popullit tonë, e arritur nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kongresi IV i Partisë përcaktoi rrugën e mëtejshme të zhvillimit socialist të atdheut tonë, në përputhje me veçoritë konkrete të vendit. Ai tregoi se tani vendi ynë hyn në një etapë të re të ndërtimit socialist — në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, të shndërrimit të vendit tonë në një vend industrialo-agrar e më pas në një vend industrial të përparuar, me një kulturë masive të zhvilluar dhe me një nivel të lartë jetese për popullin. Hallka kryesore për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë është ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit. Hapat e parë për krijimin e saj janë bërë gjatë dy planeve të mëparshme pesëvjeçare, ndërsa plani i tretë pesëvjeçar, siç u përcaktua në Kongresin IV të Partisë, do të jetë një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit.

. Plani i tretë pesëvjeçar hap perspektiva të mëdha për ecjen e vendit tonë përpara me ritme akoma më të shpejta në rrugën e ndërtimit socialist. Në fushën e industrializimit socialist, që përbën hallkën themelore për ndërtimin e plotë të bazës materialo-teknike të socializmit në vendin tonë, do të bëhen hapa të rëndësishëm për zhvillimin e gjerë të degëve ekzistuese dhe për ngritjen e degëve të reja të industrisë sonë kombëtare, sidomos të industrisë së rëndë. Të tilla janë për shembull industria kimike për prodhimin e plehrave azotike e fosfatike, metalurgjia e hekur-nikelit, elektro-metalurgjia e bakrit etj. Gjatë këtij pesëvjeçari do të ndërtohen dhe do të vihen në shfrytëzim plotësisht ose pjesërisht mbi 400 objekte të mëdha industriale e

social-kulturore. Ndër to ka vepra të tillë të rëndësishme, si uzina për prodhimin e superfosfatit, uzina e metalurgjisë së zezë për prodhimin e çelikut të petëzuar, termocentrali i fuqishëm prej 75 mijë kilovatësh e shumë të tjera.

Perspektiva të mëdha hap pesëvjeçari i tretë edhe në fushën e bujqësisë, të rritjes së mirëqenies materiale të popullit, të zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit kulturor, si dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore të vendit tonë. Realizimi i tij me sukses do ta bëjë atdheun tonë akoma më të bukur, më të begatshëm e më të fortë dhe do të hedhë bazat e shëndosha për ta shndërruar Shqipërinë në një shtet të lumtur e të pasur socialist në brigjet e Adriatikut. Me një popull të tillë heroik, siç është populli shqiptar, me një parti të tillë të vendosur marksiste-leniniste, siç është Partia jonë e Punës, detyrat madhështore që shtroi Kongresi IV i Partisë do të realizohen para afatit, vendi ynë do të ecë i sigurt e ngadhnjmëtar gjithmonë përpara, drejt jetës së lumtur. Çdo orvatje për të na penguar në rrugën tonë do të dështojë me turp para vendosmërisë dhe vrullit tonë revolucionar.

Të ndriçuara e të frysmezuara nga vendimet e qarta të Kongresit IV të Partisë, masat e gjera punonjëse të atdheut i janë përveshur punës me një vrull e entuziazëm të paparë ndonjëherë për të realizuar e për të tejkaluar detyrat e planit të shtetit për vitin 1961, që është viti i parë i pesëvjeçarit të tretë. Një emulacion i fuqishëm socialist ka shpërthyer kudo në vendin tonë për nder të jubileut të lavdishëm, 20-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, për ta pritur

këtë festë të madhe me duar plot, me sa më shumë suksese.

Klasa punëtore heroike e vendit tonë, e mobilizuar për ndër të 20-vjetorit të themelimit të Partisë, e ka realizuar planin e prodhimit të përgjithshëm industrial për 9 muajt e parë. të këtij viti 106,6 për qind, duke prodhuar, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, 8,6 për qind më shumë, ose mbi 1 miliard e 900 milion lekë më tepër. Me forcat e gjeologëve tanë të zotë e patriotë është tejkaluar plani i kërkimeve gjeologjike, që kanë një rëndësi kaq të madhe për realizimin me sukses të planit të tretë pesëvjeçar. Përshtëndesim në mënyrë të veçantë fitoren e rëndësishme të kolektivit punonjës të ndërmarrjes gjeologjike të Kukësit, që zbuloi rezerva të konsiderueshme të mineralit të bakrit! Janë tejkaluar shifrat e planit për rritjen e rendimentit të punës dhe për uljen e kostos. Vetëm nga ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë, të Ministrisë së Minierave e të Gjeologjisë dhe nga kooperativat e artizanatit, në gjashtëmuajrin e parë të këtij viti, u kursyen 270 milion lekë. Rezultate të mira janë arritur nga punonjësit e industrisë edhe në rritjen e assortimenteve të prodhimit, sidomos për prodhimin në vend të pjesëve të këmbimit, për ndreqjen e tyre, si dhe për prodhimin e mjaft veglave, pajisjeve e makinerive. Është tejkaluar plani i ndërtimeve dhe, në krahasim me nëntëmuajrin e vitit të kaluar, vëllimi i tyre është rritur 26 për qind.

Suksese të mira ka arritur gjatë këtij viti fshatarësia jonë kooperativiste. E mobilizuar për realizimin e detyrave të planit, ajo kreu, në një kohë më të shkur-

tër se në vitin e kaluar dhe me një cilësi më të mirë, mbjelljet pranverore dhe fushatën e korrjeve, duke treguar më tepër kujdes për kryerjen e shërbimeve kulturore. Tani ajo po vazhdon me sukses fushatën e mbjelljeve të vjeshtës. Me gjithë thatësirën e madhe të periudhës qershori-shtator, e cila dëmtoi kulturat bujqësore, si rezultat i rritjes së prodhimeve bujqësore e blektorale, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u grumbulluan më shumë: drithëra buke 80 për qind, pambuk 150 për qind, perime 47 për qind, patate 105 për qind, fruta 173 për qind, rrush 77 për qind, qumësht rreth 12 për qind, mish 5 për qind, lesh 9 për qind, vezë rreth 3 për qind etj.

Qarkullimi i mallrave me pakicë, në krahasim me nëntëmujorin e vitit të kaluar, ka arritur 102,8 për qind.

Rezultatet e kënaqshme që kanë arritur punonjësit tanë, të mobilizuar për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit IV të Partisë dhe për nder të 20-vjetorit të themelimit të Partisë, janë një garanci e shëndoshë për realizimin para afatit të planit të vitit 1961. Ato janë një shenjë e qartë, që tregon se populli ynë është i vendosur deri në fund të ecë përpara i patundur në rrugën që i tregon Partia, pa marrë parasysh vështirësitë e pengesat që orvaten t'i nxjerrin atij imperialistët dhe revisionistët e ndryshëm. Lavdi popullit tonë heroik!

Duke pasur parasysh se vendi ynë ndodhet në kushtet e rrithimit kapitalist e revisionist, Partia e ka mësuar popullin tonë heroik të mbajë kurdoherë të mprehtë vigjilencën, të ndërtojë socializmin, duke mbaj-

tur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën dhe të mos e lëshojë këtë të fundit nga dora derisa në botë të ekzistojnë imperializmi e veglat e tij. Partia jonë ka mbajtur vazhdimisht parasysh çështjen e mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së vendit tonë. Ajo u ka kushtuar kurdoherë një kujdes të posaçëm forcimit të parashtrur të fuqisë mbrojtëse të vendit, ngritjes së vazhdueshme të aftësisë dhe të gatishmërisë luftarake të Ushtrisë sonë Popullorë, të forcave të Sigurimit të Shtetit dhe të kufirit. Ne me gjëzim mund t'i njoftojmë popullit se forcat tona të lavdishme të armatosura janë në gjendje dhe në gatishmëri luftarake të plotë për të mbrojtur me sukses Republikën Popullore të Shqipërisë dhe për t'i dhënë përgjigjen e merituar çdo armiku që do të guxojë të prekë kufijtë e shenjtë të atdheut tonë të dashur socialist.

Të dashur shokë dhe shoqe,

E tillë është në vija të përgjithshme rruga që ka pëershkuar gjatë 20 vjetëve të ekzistencës së saj Partia jonë e lavdishme, të tillë janë fitoret historike që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e urtë të Partisë.

Këto fitore u detyrohen para së gjithash, luftës dhe përpjekjeve heroike të popullit tonë, patriotizmit të tij të flaktë, vendosmërisë së tij të patundur, aftësive të tij krijuese dhe talentit të tij. Ky ka qenë dhe mbetet faktori vendimtar i çlirimtë të vendit tonë dhe i ndërtimit të shoqërisë socialiste e komuniste te ne.

Këto fitore i detyrohen udhëheqjes së Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, në të gjitha etapat e mo-

mentet, ka pasur një vijë të përgjithshme të drejtë. Vetëjeta, praktika, e tregojnë se kjo është një vijë marksiste-leniniste, që u përgjigjet plotësisht interesave jetike të popullit shqiptar, si dhe interesave të përbashkëta të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të çështjes sonë të madhe të revolucionit e të socializmit, të lirisë së popujve e të paqes.

Partia jonë e ka ruajtur kurdoherë të pastër si kristali vijën e saj marksiste-leniniste, e ka mbrojtur atë në luftë të ashpër me armiqtë e deviatorët e ndryshëm, që nga Anastas Lula e Sadik Premte, Ymer Dishnica e Sejfulla Malëshova deri te Koçi Xoxe, Tuk Jakova e Bedri Spahiu, Liri Gega e Liri Belishova etj., të cilët janë përpjekur ta largojnë Partinë nga rruga e saj e drejtë. Por Partia jonë qëndroi kurdoherë e patundur si shkëmb graniti. Në këtë luftë ajo ruajti dhe forcoi dita-ditës më shumë unitetin ideologjik e organizativ të radhëve të saj, mbi bazën e marksizëm-leninizmit, si një ndër faktorët më të rëndësishëm të fitoreve tona, të forcës e të pathyeshmërisë së Partisë sonë përballë çdo armiku. Këtë unitet ne do ta ruajmë si sytë e ballit dhe do ta forcojmë gjithnjë më shumë.

I bindur nga vetë eksperiencia e tij për drejtësinë e vijës së Partisë sonë, populli ynë e ka mbështetur dhe e ka përkrahur pa rezerva Partinë, në të gjitha momentet e rrethanat, është bashkuar rreth saj në një unitet monolit të pathyeshëm. Në këtë unitet qëndron forca e patundur e Partisë dhe e popullit tonë, garancia e shëndoshë e të gjitha fitoreve të kaluara, të tashme dhe të ardhshme të popullit. Ky unitet është grushti më i rëndë kundër të gjithë armiqve të Partisë e të

popullit tonë, imperialistëve e revizionistëve të çdo kallëpi. Ne, Parti e popull, do ta ruajmë këtë unitet si dritën e syrit dhe do ta forcojmë atë pareshtur nga dita në ditë.

Fitoret e mëdha historike që ka korrur populli ynë në luftën për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e socializmit në një Shqipëri të lirë, të pavarur e sovrane, i detyrohen edhe ndihmës e përkrahjes internasionaliste që i kanë dhënë e i japin vendit tonë Bashkimi Sovjetik, Republika Popullore e Kinës dhe vendet e tjera socialiste. Për këtë ndihmë bujare Partia dhe populli shqiptar do t'u jenë atyre mirënjojës përjetë. Kjo ndihmë është një shprehje e mrekullueshme e miqësisë, që lidh popullin tonë me popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, me popullin e madh kinez dhe me të gjithë popujt e vendeve të tjera socialiste.

Të dashur shokë e shoqe,

20-vjetorin e lavdishëm të themelimit të Partisë sonë ne e festojmë në kushte të reja ndërkombëtare shumë të favorshme për forcat e paqes, të demokracisë e të socializmit. 20 vjet më parë, kur u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë, në botë sundonte sistemi kapitalist, sistemi i shtypjes dhe i shfrytëzimit të egër të popujve. Bashkimi Sovjetik, vendi i parë i socializmit fitimtar, ishte në atë kohë i rrethuar nga të katër anët nga vende kapitaliste. Kontinente të tëra vuanin nën zgjedhën koloniale të imperializmit. Forcat më reaksionare të borgjezisë, shtetet fashiste e militariste, të ndërsyera nga qarqet më agresive të imperializmit

ndërkombëtar, kishin shpërthyer Luftën e Dytë Botërore, kishin hedhur nën zgjedhën e tyre popuj të tërë dhe si bisha të tërbuara ishin vërsulur kundër pjellës së Revolucionit të madh Socialist të Tëtorit, Bashkimit Sovjetik.

Sot, pas 20 vjetësh, ndryshime të mëdha rrënjosore kanë ndodhur në botë. Në saje të Luftës së madhe Patriotike të popujve sovjetikë, në radhë të parë, u arrit fitorja historike mbi fashizmin. Shtete të reja u shkëputën nga sistemi kapitalist dhe u futën në rrugën e socializmit. Në Kinë triumfoi Revolucioni Popullor që është ngjarja më e madhe historike pas Revolucionit Socialist të Tëtorit.

Zhvillimi i pandalshëm i socializmit dhe ngritja në një shkallë më të lartë e luftës nacionalçirimtare të popujve shpunë në mënyrë të pashmangshme në shembjen e sistemit të skllavërisë koloniale të imperializmit. 42 shtete të reja, me një popullsi prej më shumë se një miliard e dyqind milion njerëz, kanë fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Ndërsa pas Luftës së Parë Botërore vendet e skllavëruara dhe të kontrolluara nga imperializmi përfshinin mbi 77 për qind të territorit të botës dhe rreth 70 për qind të popullsisë botërore, tanë të tilla vende zënë vetëm mbi 10 për qind të sipërfaqes dhe rreth 3 për qind të popullsisë botërore. Shthurrja e sistemit kolonial të imperializmit është një ngjarje tjetër me rëndësi të madhe ndërkombëtare.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve është ngushtuar së tepërmë sfera e sundimit të imperializmit, është thelluar edhe më shumë kriza e përgjithshme e tij, janë ashpërsuar të gjitha kontradiktat e brendshme dhe të

jashtme klasore dhe kombëtare të tij. Sot imperializmi nuk është më sunduesi i vetëm dhe i plotfuqishëm në botë. Ai sot nuk mund të shijë më sipas qejfit. Ligjet e tij nuk veprojnë kudo në botë. Përballë sistemit kapitalist, që po shkon drejt greminës së tij të pashmangshme, qëndron i fuqishëm dhe i pamposhtur sistemi socialist, rreth të cilit janë bashkuar dhe po bashkohen gjithnjë e më shumë të gjitha forcat revolucionare antiimperialiste që luftojnë për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Ky është realiteti i ditëve tona dhe ky realitet tregon në mënyrë bindëse se raporti i forcave sot në botë ka ndryshuar në dobi të socializmit dhe në dëm të imperializmit. Forcat e socializmit, forcat e çlirimit kombëtar, të paqes e të demokracisë, kanë epërsi mbi forcat e imperializmit, të kolonializmit, të luftës e të reaksionit. Të gjitha këto kanë krijuar në botë një gjendje të re, kushte shumë të favorshme për të zhvilluar edhe më me sukses luftën kundër imperializmit, për paqen dhe për zhvillimin e revolucioneve sociale, nacionalçlirimtare, demokratike e popullore.

Partia e Punës e Shqipërisë i njeh dhe i kupton ndryshimet e thella që janë bërë në botë, kushtet dhe fenomenet e reja që kanë lindur. Por ne hedhim poshtë çdo orvatje që bëhet nga revisionistët e sotëm, të cilët, nën parullat e «interpretimit në mënyrë krijuese të marksizmit në kushtet e reja», përhapin pikëpamjet e tyre të shtrembra e oportuniste, përpiken t'i shesin ato si «një zhvillim të mëtejshëm të marksizmit» dhe kujtdo që shprehet kundër këtyre pikëpamjeve, ata nxitojnë t'i vënë vulën e dogmatikut, të sekta-

ristit, të aventurierit. Kjo është një taktikë e njojur. Këtu s'ka asgjë të re, asgjë origjinale. Gjithë revizionistët dhe oportunistët, duke filluar nga Bernshtajni e deri te Titoja, nën pretekstin e «ndryshimeve të situatës» e «të fenomeneve të reja» kanë mohuar parimet themelore të marksizmit. Sikurse thoshte V. I. Lenini, ata, duke u maskuar gjithnjë nën parullën e luftës kundër dogmatizmit, duke shfrytëzuar «fjalëzën e përshtatshme: dogmatik», janë ngritur kundër marksizmit.

Nga ndryshimet që janë vërtetuar në botë duhen bërë konkluzione të drejta revolucionare, marksiste-leniniste, duhen bërë konkluzione që të mos krijojnë iluzione reformiste e pacifiste dhe të dobësojnë luftën kundër imperializmit, por ta forcojnë gjithnjë e më shumë këtë luftë të drejtë, duhen bërë konkluzione që të mos e largojnë çështjen e revolucionit, por ta afrojnë atë gjithnjë e më shumë, të mos i largojnë popujt nga lufta për çlirimin e tyre kombëtar, por ta ngrenë këtë luftë në një shkallë gjithnjë e më të lartë.

Të marrim problemin e luftës e të paqes. A do të thotë se ndryshimi i raportit të forcave në dobi të socializmit ka sjellë edhe ndryshimin në natyrën e imperializmit, se imperializmit i janë lidhur këmbë e duar, se ai nuk është në gjendje të bëjë asgjë, të shpërthejë luftëra dhe të ndërmarrë veprime të ndryshme agresive? Një konkluzion i tillë është jo vetëm i gabuar, por edhe shumë i dëmshëm. Nënvleftësimi i forcave të armikut dhe mbivlerësimi i forcave tona sjell dobësimin e vigjilencës dhe të shtyn në aventura të rrezikshme, ashtu sikurse nënvleftësimi i forcave tona dhe mbivlerësimi i forcave të armiqve të shpie në

lëshime të paprincipta, në gabime dhe në qëndrime oportuniste. Duke u nisur nga gjendja reale e raportit të forcave sot në botë, Partia jonë ka theksuar dhe thekson gjithnjë se në çështjen e luftës dhe të paqes duhen parë të dyja mundësitë dhe duhet pregatitur për të dyja mundësitë, si për atë të ndalimit të luftës, ashtu dhe për atë të shpërthimit të saj nga ana e imperialisteve. Bindja jonë e thellë se në kohën e sotme lufta botërore dhe luftërat e tjera agresive që shpërthen imperializmi mund të ndalojen, nuk mbështetet aspak te «qëllimet e mira» të krerëve të imperializmit, por në forcën ekonomike, politike e ushtarake të vendeve socialiste, në unitetin dhe në luftën e klasës punëtore ndërkombëtare, në luftën e vendosur të popujve të mbarë botës kundër luftënxitesve imperialistë, në unitetin dhe në kompaktësinë e të gjitha forcave paqedashëse.

Gjatë gjithë viteve të ekzistencës së pushtetit populor, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka ndjekur me vendosmëri dhe me konsekuençë një politikë të jashtme që u është përgjigjur plotësisht interesave të popullit e të atdheut tonë, interesave të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë kombëtare, si edhe interesave të të gjithë kampit të socializmit e të çështjes së paqes dhe të përparimit të shoqërisë njerëzore. Parimet e politikës së jashtme të Partisë së Punës të Shqipërisë kurdoherë kanë qenë dhe mbeten: forcimi i pandërprerë i marrëdhënieve të miqësisë, të bashkëpunimit vëllazëror, të ndihmës e të përkrahjes reciproke me vendet sëssialiste; përkrahja e luftës nacionalçlirimtare antiimperialiste dhe antikoloniale të popujve dhe të kombeve të shtypura, si dhe e luftës revolucionare

të punonjësve në vendet kapitaliste; përpjekjet për sigurimin e marrëdhënieve të bashkekzistencës paqësore të Republikës Popullore të Shqipërisë me vendet kapitaliste, sidomos me vendet fqinje; përpjekjet për ruajtjen dhe për forcimin e paqes në botë, sidomos në razonin e Ballkanit e të Adriatikut; demaskimi i politikës së luftës dhe të agresionit që ndjekin fuqitë imperialiste, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe partnerët e veglat e tyre rreth vendit tonë, siç janë imperialistët italianë, monarko-fashistët grekë dhe re-visionistët jugosllavë.

Në politikën e jashtme Partia dhe Qeveria jonë kanë ecur kurdoherë krah për krah me vendet e tjera socialiste në përpjekjet për ruajtjen dhe për forcimin e paqes në botë. Ato gjithmonë kanë aprovuar dhe kanë mbështetur fuqimisht vijën e përgjithshme të politikës së jashtme të Bashkimit Sovjetik e të të gjitha vendeve të tjera socialiste për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme ndërkombëtare. Dhe kjo politikë e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë ka gjetur gjithmonë aprovimin e plotë të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera socialiste, të cilat e kanë konsideruar atë pérherë si një politikë të drejtë, në dobi të çështjes sonë të përbashkët.

Por kohët e fundit, N. Hrushovi me shokë e kthyen pllakën dhe na akuzojnë herë si «aventurierë e luftëdashës» herë për «afrim» me imperializmin. Ata që na akuzojnë ne, përveç shpifjeve dhe trillimeve, nuk kanë asnë argument, asnë fakt të vetëm për të provuar se politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë ka ndryshuar. Asgjë nuk ka ndryshuar në

politikën tonë të jashtme. Nuk ka ndryshuar as qëndrimi ynë përsa u përket çështjeve të luftës e të paqes, as përsa i përket luftës kundër imperializmit, as përsa u përket marrëdhënieve me shtetet e tjera e sidomos me shtetet fqinje.

20 vjet jetë dhe luftë revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë hedhin poshtë të gjitha këto shpifje e trillime të ulëta që indinjojnë thellë dhe kanë zemëruar popullin tonë, i cili ka luftuar dhe lufton me heroizëm kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij. Ata që akuzojnë e shpifin kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj nuk janë në gjendje të sjellin qoftë edhe një fakt të vetëm që do të mund të provonte thëniet e tyre, kurse ne jemi në gjendje të sjellim shumë fakte të dokumentuara që tregojnë qartë lëkundjet e tyre nga pozitat e marksizëm-leninizmit dhe të luftës kundër imperializmit. Ne nuk kemi pasur kurrë iluzione për armiqtë tanë, ne nuk jemi përqafuar e nuk jemi puthur me ta, nuk u kemi bërë lajka dhe nuk u kemi fërkuar krahët, s'jemi përkulur kurrë përra para tyre. Partia dhe shteti ynë kanë mbajtur gjithnjë një qëndrim të vendosur e parimor, marksist-leninist, ndaj armiqve të paqes e të socializmit, ata kanë demaskuar ashpër e vazhdimisht imperialistët, qofshin këta amerikanë apo anglezë, francezë apo italianë, politikën e tyre të luftës e të agresionit, ata kanë qenë të papajtueshmëm me armiqtë e klasës. Partia dhe shteti ynë janë trenguar solidarë dhe kanë mbështetur fuqimisht e pa asnje rezervë çështjen e drejtë të popujve që janë ngritur në luftë kundër imperializmit. Ata u kanë dhënë gjithë përkrahjen e tyre popujve vëllezër të Algjerisë, të Ku-

bës, të Kongos, të Laosit etj., në luftën e tyre heroike kundër imperializmit, duke dënuar me vendosmëri të gjitha orvatjet agresive të imperializmit.

Për të gjitha këto «të mira» që Partia jonë i ka bërë imperializmit gjatë kötyre 20 vjetëve është shpërblyer nga ai dhe veglat e tij me një luftë të egër e të pandërprerë që ata kanë zhvilluar kundër Republikës Popullore të Shqipërisë me anë komplotesh e provokacionesh të vazhdueshme, me anë diversionesh, shantzesh e shpifjesh të njëpasnjëshme.

Ne na akuzojnë se kemi frikë nga imperializmi, se kemi frikë të marrim përgjegjësi për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme ndërkombe të. Këtu është fjala përfundimin e traktatit të paqes me Gjermaninë dhe rregullimin e problemit të Berlinit Perëndimor. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë nuk janë trembur dhe nuk i tremben kurrë imperializmit, ato nuk i janë trembur dhe nuk i tremben kurrë përgjegjësisë së tyre si vend socialist e anëtar i Traktatit të Varshavës dhe kanë kryer me nder e përpikëri detyrat e tyre internacionale. Qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për çështjen gjermane njihet nga e gjithë bota, ai përmbarhet në shumë dokumente të njohura publikisht. Pikëpamja e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë dhe mbetet se përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë dhë zgjidhja mbi këtë bazë edhe e problemit të Berlinit Perëndimor janë masa të domosdoshme, të pjekura prej kohësh dhe në interes të Republikës Popullore të Shqipërisë, të Republikës Demokratike Gjermane, të

vendeve të tjera socialiste, në interes të paqes e të sigurimit në Evropë. Ne kemi qenë dhe jemi për zgjidjen sa më parë të këtyre problemeve, sepse çdo zvarritje e tyre është vetëm në dobi të armiqve tanë.

Atëherë vihet pyetja: Kush trembet në të vërtetë, kush ka frikë nga përgjegjësia për zgjidhen e çështjes gjermane, kush e zvarrit atë? Ne që kemi qenë dhe jemi për zgjidhen e saj sa më shpejt, apo akuzuesit tanë, që, në këtë çështje, janë törhequr dhe e kanë zvarritur atë nga viti në vit?

Ose le të marrim problemin e çarmatimit. Dihet botërisht se Qeveria jonë ka mbështetur propozimin e Bashkimit Sovjetik për çarmatin, sepse përderisa ekzistojnë armët dhe zhvillohet gara e armatimeve, përderisa të mos bëhet çarmatimi, nuk ka asnjë sigurim për paqen. Qeveria sovjetike bashkë me Qeverinë tonë kanë bërë propozimin për ta kthyer Ballkanin dhe Adriatikun në një zonë paqeje, pa baza për armë atomike dhe raketa. Por propozimet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve socialiste për çarmatim dhe për krijin e zonave të paqes janë hedhur poshtë nga fuqitë imperialiste. Ne jemi të ndërgjegjshëm se problemi i çarmatimit është një problem i vështirë, për zgjidhen e të cilit duhen bërë përpjekje të mëdha, duhet bërë një luftë e vendosur, pa lëshime, nga vendet socialiste dhe të gjitha forcat paqedashëse, për t'ia imponuar atë imperializmit. Por N. Hrushovi, në vend që të ndjekë një rrugë të tillë të drejtë, kërkon të çarmatosë një vend socialist të rrethuar nga të katër anët me armiq siç është Republika Popullore e Shqipërisë. Duke dobësuar fuqinë mbrojtëse të Republikës Popullore të Shqipërisë, ne po mund të marrim përshtatje të gjallë, që do t'i dhënë një përgjegjësi të gjallë për zgjidjen e çështjes gjermane, që do t'i dhënë një përgjegjësi të gjallë për zgjidjen e saj sa më shpejt, apo akuzuesit tanë, që, në këtë çështje, janë törhequr dhe e kanë zvarritur atë nga viti në vit?

përisë, ai dëmtoi jo vetëm interesat e vendit tonë, por edhe të të gjithë kampit të socializmit. Dhe gjithë kjo bëhet në një kohë kur në Mesdhe vërtitet si kuçedër Flota VI Amerikane, kur në Greqi dhe në Itali janë vendosur bazat amerikane të raketave, kur forcat e NATO-s vazhdojnë me ethe garën e armatimeve, kur imperialistët dhe revanshistët e Gjermanisë Perëndimore po vrangellojnë armët dhe po rrezikojnë seriozisht paqen botërore. Asnjë faj e përgjegjësi nuk kishte për këtë Qeveria Shqiptare. Por sido që të ishte puna, N. Hrushovi në asnjë mënyrë nuk duhej të kishte arritur deri atje sa t'i ndërsejë sheshit imperialistët dhe reaksionarët e ndryshëm kundër një vendi socialist siç është Republika Popullore e Shqipërisë. Megjithëkëtë mbrojtja e kufijve të Shqipërisë është e siguruar plotësisht.

Në kushtet kur në botë ekzistojnë shtete me sisteme të ndryshme shoqërore i vetmi parim i drejtë për të rregulluar marrëdhëni midis tyre, është parimi i bashkekzistencës paqësore, parim i përcaktuar nga Lenini dhe që është zbatuar edhe nga Stalini. Partia jonë e Punës gjithnjë ka menduar dhe mendon se politika e bashkekzistencës paqësore u përgjigjet interesave të të gjithë popujve, si të vendeve socialistë, ashtu edhe të vendeve kapitaliste, i përgjigjet qëllimit të forcimit të mëtejshëm të pozitave të socializmit e të paqes në botë. Prandaj ajo është për marrëdhënie të shtetit tonë socialist me shtete të tjera josocialiste.

Është absurde të akuzosh Partinë dhe shtetin tonë socialist se gjoja ata janë kundër bashkekzistencës paqësore. Kjo shpifje hidhet poshtë nga gjithë veprimta-

ria praktike e shtetit tonë në fushën e politikës së jashtme. Ne nuk kundërshtojmë parimin e bashkekzistencës paqësore, por nuk jemi dakord me disa pikëpamje oportuniste të N. Hrushovit e të pasuesve të tij, që e konsiderojnë bashkekzistencën paqësore si vijën e përgjithshme të politikës së jashtme të vendeve socialiste, si rrugën kryesore të fitores së socializmit në shkallë botërore, që për hir të bashkekzistencës paqësore heqin dorë nga lufta për demaskimin e imperializmit, shuajnë luftën ideologjike e politike kundër revolucionizmit jugosllav, nën pretekstin se Jugoslavia në disa çështje të politikës së jashtme mbështet propozimet sovjetike. Një kuptim i tillë i bashkekzistencës paqësore është i shtrembër dhe antimarksist, sepse çon në mohimin e luftës së klasave. Zbatimi i drejtë i politikës së bashkekzistencës paqësore, duke mënkuptuar edhe demaskimin e imperializmit dhe të politikës së tij të luftës e të agresionit, duhet të ndihmojë zhvillimin e luftës së klasës punëtore në vendet kapitaliste, si edhe të lëvizjes nacionalçlirimtare në vendet koloniale e të varura. Nga ana e tyre sukseset e luftës revolucionare klasore dhe nacionalçlirimtare, duke ngushtuar e duke dobësuar pozitat e imperializmit, forcojnë çështjen e paqes dhe të bashkekzistencës paqësore. Partitë komuniste në vendet kapitaliste, krahas me luftën përtua imponuar politikën e bashkekzistencës qeverive borgjeze të vendeve të tyre, zhvillojnë njëkohësisht luftën e klasave për përbysjen e pushtetit të borgjezisë, për kalimin në socializëm sipas kushteve konkrete të çdo vendi.

Përsa u përket formave të kalimit në socializëm,

N. Hrushovi, në Kongresin XX të PK të BS dhe më vonë, e ngatërroi keq edhe këtë çështje. Ai rrugën paqësore përmarrjen e pushtetit nga ana e klasës punëtore pothuajse e absolutizoi dhe u krijua iluzioni se gjoja vetëm duke siguruar shumicën në parlament klasa punëtore dhe partia e saj komuniste mund të marrin pushtetin në duart e veta. Këto teza u pëlqyen vetëm revisionistëve dhe oportunistëve të ndryshëm, të cilët i përdorën ato përmët të justifikuar pikëpamjet e veta antimarksiste. Ne, komunistët shqiptarë, nuk kemi qenë dhe nuk jemi kurrë apriori kundër rrugës paqësore. Por mësimet e marksizëm-leninizmit, eksperiencia historike dhe realiteti i ditëve të sotme, na mësojnë se, përsigurimin e fitores së çështjes së socializmit, klasa punëtore dhe partia e saj duhet të pregetiten njëherësh përmët dyja mundësitë, si përmët atë të rrugës paqësore, ashtu dhe përmët atë jopaqësore. Të orientohesh vetëm nga rruga paqësore përsigurimin e fitores së socializmit do të thotë të vihesh në rrugë të shtrembër. Vetëm duke u pregetitur mirë përmët rrugën jopaqësore, rriten shanset edhe përmët rrugën paqësore.

Kështu e kuptojmë ne bashkekzistencën paqësore dhe lidhjen e saj me luftën e klasave. Kështu e kuptojmë dhe e zbatojmë politikën e bashkekzistencës paqësore me shtetet e tjera josocialiste dhe në radhë të parë me fqinjët tanë.

E çuditshme është si Nikita Hrushovi dhe pasuesit e tij kërkojnë nga ne që ta zbatojmë bashkekzistencën paqësore me fqinjët tanë grekë. Ata na akuzojnë se nuk ecim në një radhë me ta në propozimet përmët çarmatimin e vendeve ballkanike, na akuzojnë se s'bëjmë përpje-

kje «për mirëkuptim ballkanik»; ata bashkohen me korin e revizionistëve jugosllavë dhe të monarko-fashistëve grekë se gjoja ne jemi «luftënxitësit e Ballkanit», në një kohë kur Greqia, vazhdon ta quajë veten në «gjendje lufte» me Shqipërinë, kur ajo ka rivendikime tokësore ndaj atdheut tonë dhe komploton për të sulmuar Shqipërinë. Akuzat e kritikuesve tanë s'kanë asnjë bazë, se asnjë njeri me mend në kokë nuk mund të mendojë që Shqipëria e vogël dhe e rrrethuar nga ujqi, që 17 vjet me radhë kërkojnë ta përpijnë të gjallë, të mos dojë paqen dhe çarmatimin.

Se sa u çarmatos Greqia monarko-fashiste, se sa u realizuan shpresat e atyre që besonin në një gjë të tillë, këtë e di gjithë bota, këtë e vërtetonjeta, por të linim ne pa kritikuar Nikita Hrushovin (dhe këtë kritikë e bëmë në rrugë shoqërore), kur ai i lë shpresa Sofokli Venizelosit për «autonominë e Shqipërisë së Jugut», kjo do të ishte tradhti nga ana jonë. Nikita Hrushovit s'i pëlqeu kritika jonë e drejtë. Kjo është e keqja më e vogël. Por kritika jonë u kthyte prej tij në kundërakuzë, duke na akuzuar se gjoja ne shpifim kundër Bashkimit Sovjetik që na ka çliruar dhe na mbron. Kjo, natyrisht, është makiavelike. Por më vonë djalli nxori përsëri brirët në shesh. Në kohën kur amerikanët, grekët, turqit, bënë manovrat e mëdha ushtarake rrëth kufijve të Shqipërisë dhe të Bullgarisë, N. Hrushovi, në deklaratën që i bëri gazetarit Sulcberger të «Nju-Jork Tajmsit» në datën 10 shtator 1961, tha tekstualisht: «Ju (amerikanët) keni vendosur baza edhe në Greqi dhe prej andej kërcënoni aleaten tonë Bullgarinë». A mos vallë Greqia monarko-fashiste s'i ka vendosur raketat edhe

kundër Shqipërisë? Që kur Nikita Hrushovi ka vendosur që Shqipëria të mos jetë më aleate e Bashkimit Sovjetik? Kjo është një gjë e përbindshme. A janë këto çështje të vogla? A mund t'i lejohet Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Kryeministrat të Bashkimit Sovjetik, sikur edhe në thikë e në pikë të jetë me Shqipërinë socialiste, që t'i thotë hapur reaksionit grek se Shqipëria socialiste s'është më aleate e Bashkimit Sovjetik dhe t'i dërgojë lajm presidentit Kenedi se «marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë janë të prishura»?

Jemi ne, pra, sipas disave, që i shohim punët si «nacionalistë sektarë», kurse të tjerët, që spekulojnë me interesat e popullit tonë, janë «marksistë». Nesër po këta kritikues mund të na bëjnë përgjegjës edhe për humbjet në votime të partisë përparamtare greke EDA. A mos vallë këta të ashtuquajtura marksistë mendojnë se ne duhet t'u dorëzojmë çelësat e vendit tonë monarko-fashistëve grekë që të fitojë vija e tyre e «bashkekzistencës paqësore» ose marrja e fuqisë në Greqi «me rrugën paqësore dhe parlamentare»? Jo, këtë të mos e presin nga ne. Këta të ashtuquajtura marksistë të mos harrojnë se internacionalismin e madh Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar e kanë treguar duke shpëtuar me dhjetëra mijë heronj të popullit grek dhe të Partisë Komuniste Greke, të cilët, ne jemi të sigurt, nuk e pështyjnë kalin, pasi kanë këpucyer lumin.

Këtë politikë të jashtme kanë ndjekur Partia dhe Qeveria jonë. Këto janë pikëpamjet tona mbi problemet

e zhvillimit të sotëm botëror. Pikërisht për këto qëndrime e për këto pikëpamje na kritikojnë, për këto na sulmoi N. Hrushovi në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në këtë mënyrë ai i pari, në mënyrë të njëanshme nxori në shesh botërisht mosmarrëveshjet tona, duke u dhënë armë armiqve dhe duke marrë kështu mbi vete një përgjegjësi të rëndë historike si përqarës i unititetit të lëvizjes komuniste ndërkombe të tij kampit socialist. Partia jonë e Punës nuk i ka shprehur kurrë botërisht mosmarrëveshjet, ajo ka folur për to vetëm në mbledhje partie, portani që N. Hrushovi i bëri ato të njoitura botërisht, Partia jonë është e detyruar të thotë edhe ajo hapur pikëpamjen e vet.

N. Hrushovi, në fjalimet e tij në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, duke akuzuar Partinë tonë, tha se marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike u prishën përfundimisht shqiptarë. Dihet mirë se 20 vjet të veprimtarisë revolucionare të Partisë sonë janë 20 vjet të një pune kolosale përfundimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popujve sovjetikë, përvendosjen e lidhjeve më të ngushta e vëllazërore midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. 20 vjet të veprimtarisë së Partisë sonë janë 20 vjet besnikërie të sinqertë, dashuri të madhe e vëllazërore të Partisë sonë përfunduar e madhe të Leninit, e cila kurdoherë ka qenë përvendosja e burim frymëzimi dhe eksperience, nga e cila kemi mësuar si të punojmë e të luftojmë përfundimisht mirën e popullit tonë, përvendosja e socializmit e të komunizmit. 20 vjet të veprimtarisë së Partisë sonë kanë qenë përvendosja e

popullin shqiptar vitet e një ndihme vëllazërore internacionliste, të cilën, Partia dhe Qeveria jonë, e kanë shfrytëzuar drejt për zhvillimin ekonomik të atdheut tonë, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, për përmirësimin e nivelit të jetesës të popullit shqiptar.

Në këto kushte është absurde dhe e pabesueshme për cilindo shpifja se gjoja qenkan udhëheqësit shqiptarë që «pa asnje shkak» dhe «me një shpejtësi të mahnitshme» paskan ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik! Është gjithashtu e pabesueshme edhe shpifja e përbindshme se udhëheqësit shqiptarë qenkan lidhur me imperializmin dhe i qenkan shitur atij «për 30 aspra»! «Zbulimeve» të këtilla mund t'u zënë besë vetëm amatorët e përrallave dhe të romaneve policeske, por asnje njeri serioz, sepse çdo njeri i ndershëm, që sado pak njeh historinë 20-vjeçare të Partisë sonë, nuk mund të mos shohë se një shpifje të tillë nuk e justifikon asnje qëndrim i Partisë sonë, asnje veprim i udhëheqësve të saj. Partia e Punës e Shqipërisë, gjatë gjithë rrugës së saj revolucionare, kurdoherë ka luftuar dhe lufton me vendosmëri kundër imperializmit dhe agjentëve të tij, ajo kurrë, as në të kaluarën, as tani, as edhe në të ardhshmen nuk i ka zgjatur, nuk i zgjat dhe nuk do t'i zgjatë dorën për lëmoshë kurrikujt e aq më pak imperializmit dhe aleatëve të tij. Ajo ka marrë e merr nga miqtë e vëllezërit e saj të vendeve socialiste jo lëmosha, por vetëm ndihma internacionliste në kredi dhe do të vazhdojë të marrë edhe në të ardhshmen vetëm nga ato vende socialiste që do të dëshirojnë t'i ofrojnë një ndihmë të tillë. Lëmoshë ne nuk i kërkoj-

më kurkujt. Në qoftë se N. Hrushovi e pasuesit e tij, për një arsy apo për një tjetër nuk duan të na ndihmojnë, më kot presin që ne t'u drejtohemë për «lëmoshë» imperialistëve e aleatëve të tyre. Populli ynë ka miq e shokë në vendet socialiste që nuk e kanë lënë dhe nuk e lënë atë në baltë. Por, pavarësisht nga kjo, ne i themi N. Hrushovit se populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës do të rrojnë edhe me bar po të jetë nevoja, por kurrë nuk do të shiten «për 30 aspra», se ata preferojnë më mirë të vdesin në këmbë e me ndër sesa të rrojnë me turp e të gjunjëzuar.

Atëherë, pse u keqësuan marrëdhëniet sovjeto-shqiptare? Këtë e kanë të qartë dhe e dinë mirë vetë N. Hrushovi dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare. Hrushovi e di shkakun sepse vetë është fajtori. Ne do të themi vetëm këtë se pikënisja është Mbledhja e Bukureshtit e qershorit 1960.

Midis Partisë sonë të Punës dhe udhëheqjes sovjetike edhe përpara qershorit 1960 kanë ekzistuar mos-marrëveshje për disa çështje me karakter ideologjik dhe politik, por megjithëkëtë asnje influencë negative nuk kanë pasur këto në marrëdhëniet midis dy shteteve tona socialiste, midis dy partive tona marksiste-leniniste.

Partia e Punës e Shqipërisë ka deklaruar gjithnjë dhe deklaron edhe tani se eksperienca e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka qenë një ndihmë e madhe në rrugën tonë për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Megjithëkëtë, për shembull, për disa teza parimore të Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partia jonë nuk ka qenë e nuk është e të njëjtit

mendim me udhëheqjen sovjetike, ashtu si nuk është edhe tani me mjaft teza të Kongresit XXII apo të programit të ri të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që aprovoi Kongresi XXII. A nuk e ka këtë të drejtë Partia jonë? A nuk është kjo në përputhje me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe me internacionalizmin proletar? A mund të konsiderohet kjo si qëndrim anti-sovjetik, siç përpilen të na akuzojnë?

Udhëheqësit sovjetikë e quajnë «antimarksiste», «dogmatike», «sektare» e «kundër internacionalizmit proletar» etj. çdo parti që nuk është e një mendjeje me ta për ato teza parimore, që u shtruan në Kongresin XX. Bile nga tribuna e Kongresit XXII, ish-anëtarja e Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, E. Furceva, arriti deri atje sa deklaroi: «Si mund ta quajnë veten komunistë ata njerëz që nuk pranojnë vendimet e Kongresit XX të partisë sonë?». Domethënë sipas disa udhëheqësve sovjetikë kriteri i besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj komunizmit e internacionalizmit proletar qenka qëndrimi ndaj Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. A mund të jetë marksiste një logjikë e tillë? Në qoftë se të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës do të vendosnin kriteret e reja, që shpiku Furceva, atëherë vetëm mosqenia dakord, të themi, me shumë teza revisioniste të Kongresit VIII të Partisë Komuniste të Italisë do të hidhte në fatkeqësi me miliona komunistë në botë dhe do të krijuhen vështirësi për ta, sepse nuk do të dinin se në cilën adresë të dorëzonin teserat e tyre të partisë.

Sipas parimeve leniniste, që rregullojnë marrëdhë-

niet midis partive marksiste, sado i rëndësishëm të jetë kongresi i një partie, sado e madhe dhe me autoritet të jetë partia e një vendi, vendimet e kongresit të saj janë të detyrueshme vetëm për anëtarët e saj. Në lëvizjen komuniste ndërkombejtare të gjitha partitë, theksin Deklarata e Moskës, janë të barabarta dhe të pavarura, ato e përpunojnë politikën e tyre duke u nisur nga kushtet konkrete të vendeve të tyre dhe duke u udhëhequr nga parimet e marksizëm-leninizmit. Orvaja për t'i bërë vendimet e kongresit të një partie si norma ndërkombejtare të detyrueshme për të gjitha partitë, është një shkelje brutale e parimit të barazisë dhe të pavarësisë së partive marksiste-leniniste, është në kundërshtim të hapur me internacionalizmin proletar. Pra, nuk është Partia jonë, por udhëheqja sovjetike, me N. Hrushovin në krye, ajo që ka shkarë nga pozitat e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, duke u orvatur t'u imponojë partive të tjera kursin e vet, duke kërkuar prej tyre të heqin dorë nga pikëpamjet e veta dhe t'u binden e t'u nënshtrohen atyre.

Qëndron apo nuk qëndron në pozitat e marksizëm-leninizmit Partia jonë, kjo nuk përcaktohet aspak nga qëndrimi i saj kritik ndaj disa tezave të shprehura nga udhëheqës të disa partive motra, as nga vlerësimi subjektiv që mund t'i bëjnë vijës dhe veprimtarisë së saj N. Hrushovi dhe ata që i shkojnë pas. Kriteri i së vërtetës ështëjeta, praktika, prandaj për individët dhe për partitë e ndryshme duhet gjykuar nga faktet, nga veprimtaria e tyre praktike. Rruga e përshkuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, vija që ajo ka ndjekur,

qysh nga themelimi i saj, veprimtaria e saj revolucionare 20-vjeçare, janë faktet më bindëse që dëshmojnë për besnikërinë e saj të patundur ndaj marksizëm-le-ninizmit, ndaj interesave jetike të popullit shqiptar, ndaj çështjes së madhe të socializmit e të komunizmit si dhe ndaj çështjes së paqes në botë.

Partia jonë e Punës, vërejtjet e saj të veçanta mbi mjaf teza parimore të Kongresit XX dhe mbi disa qëndrime të udhëheqësve sovjetikë, me të cilat nuk ka qenë dakord, i ka bërë në rrugë të rregullt partie, duke respektuar kështu të gjitha parimet e vendosura bashkërisht e që rregullojnë marrëdhëniet midis partive motra. Përsa u përket vërejtjeve tona lidhur me politikën e jashtme dhe me problemet e zhvillimit të sotëm botëror ne i thamë më lart. Le të shohim më poshtë një problem tjetër të rëndësishëm, për të cilin ne kemi pasur dhe kemi mendim të ndryshëm nga ai i udhëheqësve sovjetikë. Fjala është mbi qëndrimin ndaj J. V. Stalinit dhe veprës së tij. -

Sipas pikëpamjes së Partisë sonë, N. Hrushovit, për të shtruar tezat e tij oportuniste në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe për t'i përhapur ato më vonë, iu desh më parë të shkurorëzonte J. V. Stalinin dhe veprën e tij. Këtë gjë ai e bëri me raportin e posaçëm që mbajti në Kongresin XX «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij». Partia jonë nuk ka qenë dhe nuk është dakord me kritikën kundër Stalinit, ashtu si u bë ajo në Kongresin XX e më vonë.

N. Hrushovi, duke shpifur kundër Partisë sonë në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe duke ndërhyrë brutalisht në punët tona

të brendshme tha se «udhëheqësit shqiptarë janë kundër kritikës së kultit të individit të Stalinit», sepse gjoja në Partinë tonë lulëzokan metodat e kultit të individit, se në Shqipëri mbretërokan terrori dhe padrejtësia. Nuk do të ndalemi këtu për të hedhur poshtë këto shpifje, por fakti që autori i tyre ka rënë kaq poshtë sa, për të mobilizuar opinionin publik kundër Partisë sonë, përdor të tilla «argumente» të huajtura nga armiqtë më të tërbuar të socializmit e të komunizmit, tregon qëllimet e tij të errëta. Duket qartë se në Kongresin XXII duke i lidhur sulmet e pafaktuara kundër Partisë së Punës të Shqipërisë me «luftën kundër kultit të Stalinit e të grupit antiparti», N. Hrushovi kishte për qëllim të tregonte «analogjinë» midis gjoja «stalinizmit shqiptar» dhe «epokës së krimeve staliniane» në Bashkimin Sovjetik, për të krijuar kështu «atmosferën» që i nevojitej në kongres dhe në opinionin publik botëror, për t'i bërë më të besueshme shpifjet e tij.

Partia e Punës e Shqipërisë i ka pasur e i ka kurdoherë parasysh mësimet e marksizëm-leninizmit mbi rolin e masave, të klasave, të partisë dhe të udhëheqësve. Ajo kurdoherë e ka konsideruar dhe e konsideron shfaqjen e kultit të individit si një fenomen të huaj për marksizëm-leninizmin, të dëmshëm për një parti komuniste e punëtore. Partia jonë nuk ka hezituar, kur ka qenë rasti, të kritikojë qysh në embrion shfaqjet e ndryshme të këtij lloji në radhët e saj, siç e bëri në Kongresin III të saj. Gjithashtu Partia jonë, kur ka qenë rasti, ka luftuar me guxim dhe ka zhdukur nga rrënjet çdo shkelje të ligjshmërisë revolucionare, çdo shpërdorim të pushtetit nga cilido qoftë, siç

bëri në Kongresin I të saj. Të gjithë e dinë se ç'pësuan armiku i Partisë dhe i popullit Koçi Xoxe e shokët e tij, të cilët, përpara vitit 1948, nën nxitjen e revisionistëve jugosllavë dhe duke shpërdoruar besimin që u kishte dhënë populli e Partia, shkelën ligjet e shtetit për t'u bëri varrin shumë kuadrove të Partisë dhe të shtetit.

Në Partinë tonë nuk ekziston as sëmundja e kultit të individit, as thyerja e ligjshmërisë socialiste. Por, në të njëjtën kohë, duke u ruajtur nga shfaqjet e kultit të individit, Partia jonë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste ushqen një dashuri e respekt për udhëheqësit e saj; duke respektuar me përpikëri ligjshmërinë socialiste, Partia jonë dhe pushteti popullor janë të rreptë ndaj armiqve të Republikës sonë Popullore, ndaj të gjithë atyre që kërkojnë t'u bëjnë varrin fitoreve historike të popullit tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë, pra, ka qenë dhe është kundër kritikës që iu bë J. V. Stalinit në Kongresin XX dhe që u përsërit edhe në Kongresin XXII të PK të BS për disa arsyet të tjera parimore.

Sipas pikëpamjes së Partisë sonë, J. V. Stalini, në gjithë veprimtarinë e tij teorike e praktike, ka qenë dhe mbetet një nga udhëheqësit dhe personalitetet më të shquara jo vetëm të Bashkimit Sovjetik e të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, një nga mbrojtësit më të zjarrtë dhe teoricienët më të mëdhenj të marksizëm-leninizmit. Merita e tij e madhe historike qëndron në faktin se për shumë vjet me radhë ai ka qenë një nxënës besnik dhe shok armësh i vendosur i V. I. Leninit në luftën përmbysjen e carizmit dhe

për triumfin e Revolucionit të madh Socialist të Tetorit, kurse pas vdekjes së Leninit ai, në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, mbrojti me besnikëri leninizmin nga sulmet e tërbuara të trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve e të armiqve të tjerë dhe i shpartalloi ata ideologjikisht dhe politikisht. J. V. Stalini, si drejtuesi kryesor i partisë, dha një kontribut të madh në udhëheqjen me sukses të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe të Luftës së madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit; zhvilloi më tej marksizëm-leninizmin për një sërë çështjesh të rëndësishme të shoqërisë socialiste sovjetike dhe të ndërtimit të socializmit e të komunizmit; dha një kontribut të çmuar në forcimin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, si dhe në demaskimin e revizionizmit modern në personin e në grupin tradhtar revisionist të Titos. Duke e vlerësuar kështu veprimtarinë e J. V. Stalinit, nuk ka dyshim se disa gabime që ai mund të ketë bërë gjatë viteve të fundit të jetës së tij, ishin të pjesshme dhe nuk mund të shërbejnë si kriter për të dhënë vlerësimin e përgjithshëm të personit të J. V. Stalinit dhe të veprimtarisë së tij. Në vlerësimin e përgjithshëm të veprimtarisë së J. V. Stalinit, në plan të parë, qëndrojnë meritat e tij të mëdha: lufta për mbrojtjen e leninizmit, lufta për ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, lufta për formimin dhe për forcimin e kampit socialist, për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, lufta konsekiente kundër imperializmit, politika e tij për mbrojtjen e paqes e të bashkekzistencës paqësore. Ato përbëjnë karakteristi-

kat themelore të tij si udhëheqës e si komunist. E tillë ka qenë dhe mbetet pozita e patundur e Partisë së Punës të Shqipërisë lidhur me vlerësimin e veprës së J. V. Stalinit.

Pozita e shtrembër e N. Hrushovit në kritikën ndaj J. V. Stalinit qëndron në faktin:

a) Në mënyrë të njëanshme e tendencioze nga ai u ekzagjeruan së tepërmë gabimet e J. V. Stalinit, duke arritur bile deri në shpifje të ulëta ndaj tij. Stalini u paraqit gati si «armik» i Bashkimit Sovjetik dhe i komunizmit, ai u karakterizua si njeri «brutal», «kapriçioz», «despot», «vrasës», «gjakpirës» e «kriminel» ndaj kuadrove të partisë dhe revolucionarëve besnikë e të sprovuar dhe «sylesh» ndaj imperialistëve e fashistëve, si njeri që bënte «marrëzira» të mëdha, si në praktikë ashtu dhe në çështjet teorike, që «nuk kishte haber» se ç'bëhej në Bashkimin Sovjetik, që shfaqte «mungesë respekti ndaj kujtimit të Leninit» e mjaft akuza të tjera të këtij lloji. Deklaratat e shkëputura që u bënë në Kongresin XX dhe pas tij, se Stalini mbetet një mark-sist-leninist i shquar etj., janë krejt formale dhe bëhen-shin për të ulur përshtypjen e keqe dhe zemërimin e ligjshëm, që ngjallën në komunistët e të gjithë botës akuzat kundër Stalinit. Në fakt, as në Kongresin XX dhe as deri sot, nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në propagandën e saj nuk është bërë asnjë vlerësim pozitiv i trashëgimit teorik të J. V. Stalinit, për të treguar se ku qëndrojnë anët e tij pozitive dhe kontributi i tij në mbrojtjen dhe në zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit. Kulmi i këtij qëndrimi çnjerëzor arriti në Kongresin XXII

të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku jo vetëm u përsëriten akuzat e Kongresit XX, kësaj here publikisht, por u muar edhe një vendim i posaçëm për të hequr trupin e balsamosur të J. V. Stalinit nga mauzoleumi. Duke mos qenë në gjendje të hedhë poshtë Stalinin me argumente parimore në fushën e veprimtarisë e të krijimit teorik të tij, Hrushovi, për të luftuar Stalinin, e hedh çështjen në terrenin policor e agjentural dhe merr masa edhe për likuidimin e kufomës së Stalinit. Sa hipokrite tingëllojnë pas gjithë këtyre veprimeve fjalët e N. Hrushovit në janar 1957 se «kur ishte fjalë për çështjen e revolucionit, për mbrojtjen e interesave të klasës së proletariatit, në luftën revolucionare kundër armiqve tanë të klasës, Stalini mbronte me trimëri dhe papajtueshmëri çështjen e marksizëm-leninizmit», se «në gjënë kryesore e themelore — dhe gjëja kryesore e themelore për marksistë-leninistët është mbrojtja e interesave të klasës punëtore, e çështjes së socializmit, lufta kundër armiqve të marksizëm-leninizmit — në këtë gjë kryesore e themelore, sikurse thuhet, dhëntë zoti që çdo komunist të dijë të luftojë ashtu sikurse luftoi Stalini»!

b) Në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në propagandën sovjetike, pas këtij kongresi, N. Hrushovi e trajtoi në mënyrë të njëanëshme çështjen e luftës kundër kultit të individit, duke lënë në harresë doktrinën leniniste mbi marrëdhëniet midis masave, klasave, partive dhe udhëheqësve. I madhi Lenin, sidomos në veprën e tij gjeniale «Sëmundja fashnjore e «majtizmit» në komunizëm», theksonte me forcë domosdoshmërinë e krijimit në çdo parti marksis-

te të një gruپi drejtuesish, pak a shumë të qëndrueshëm, të përbërë nga njerëzit më me autoritet, më me influencë, më me eksperiencë, që quhen udhëheqës. Pa një udhëheqje të tillë të qëndrueshme lufta e klasës punëtore dhe e partisë së saj komuniste nuk mund të kurorëzohet me sukses. Në kundërshtim me këto mësimë të qarta të Leninit, në Kongresin XX, me pretekstin e luftës kundër kultit të individit, rolit të udhëheqësve revolucionarë iu kundërvu e ashtuquajtura «demokraci e masave».

Të ashtuquajturën «kritikë parimore» kundër kultit të individit të Stalinit, N. Hrushovi dhe gruپi i tij, dhe kjo me kalimin e kohës po bëhet gjithnjë e më e qartë, e përdori për qëllimet e tij antimarksiste. Se si e përdori ai këtë dhe për ç'qëllime vepron në planin e brendshëm (në Bashkimin Sovjetik e në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik), kjo nuk është punajonë, për këtë mund të gjykojë vetëm Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Por, megjithëkëtë, ne nuk mund të mos konstatojmë se efektivisht N. Hrushovi, duke folur për «krimet» që janë bërë në epokën e Stalinit, për «vrasjet e të pafajshmëve», për «zhdukjen e mijëra kuadrove» nëpërmjet proceseve «false», për regjimin e «terrorit», i cili piktuohet me entuziazëm të shfrenuar me ngjyrat më të zeza, duke ia bërë të njobura të gjitha këto opinionit publik ndërkombëtar, i bën një shërbim shumë të keq Bashkimit Sovjetik, u bën qejfin vetëm imperialistëve dhe gjithë armiqve të komunizmit.

N. Hrushovi ka akuzuar udhëheqjen e Partisë sonë për kritikat e drejta dhe në mbledhje partie, që ajo

ka bërë për disa veprime të palejueshme kundër vendit tonë, se gjoja udhëheqësit shqiptarë «hedhin baltë kundër Bashkimit Sovjetik». Po këtë zell të shfrenuar të tij për të nxirë një epokë të tërë të lavdishme, epokën e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik, për të diskredituar në sytë e gjithë botës lavdinë e Bashkimit Sovjetik, duke e paraqitur atë si vendin ku pas kan sunduar terrori e vrasjet, pikërisht ashtu siç ka propaganduar e propagandon gjithë shtypi reaksionar borgjez, si ta quajmë? A nuk është pikërisht ai vetë, që me veprimet e tij diskrediton Bashkimin Sovjetik? A nuk fyen rëndë ai heroizmin e popujve sovjetikë që në luftë me armiq të brendshëm e të jashtëm, në luftë me vështirësi e pengesa të panumërtë, nën udhëheqjen e partisë së tyre komuniste që drejtohej nga Stalini, hodhën themelet e shoqërisë socialiste e komuniste në Bashkimin Sovjetik, kur propozon që në Moskë të ngrihet përmendorja e «viktimate» të kultit të individit? Dikush këto veprime i quan «autokritikë e guximshme». Le ta mendojnë më thellë këtë sa të mira dhe sa të këqija u ka sjellë Bashkimit Sovjetik dhe lëvizjes komuniste kjo farë «autokritike e guximshme»!

N. Hrushovi, duke folur për «padrejtësitë» e «viktimat e periudhës së kultit të individit», duke shpallur si të trilluara proceset e ndryshme, pavarësisht në qoftë se në gjithë atë luftë mund të ketë ndodhur edhe ndonjë gabim, tregohet konsekuent në konceptet e tij anti-marksiste mbi imperializmin dhe shërbëtorët e tij. Në fakt ai i bëri një shërbim imperializmit, pse e paraqit atë të parrezikshëm për vendet që ndërtojnë socializmin, ul vigjilencën e popujve në luftën kundër agjen-

turës së imperializmit, që ka vepruar dhe po vepron me egërsi kundër kampit socialist. N. Hrushovi adoptoi taktikën e heshtjes edhe ndaj komplotit të organizuar nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë e Flota VI Amerikane, që u demaskuan te ne disa muaj më parë. Bile, pasi ua rekomandoi këtë taktikë edhe disa partive të tjera motra, përhapi parullën se komploti është i trilluar, se pjesëmarrësit e këtij komploti ishin «patriotë e luftëtarë të ndershëm», të cilët, më vonë, në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në fjalimin e tij të mbylljes, ai i mori hapur nën mbrojtje. Kurse jo shumë kohë më parë, N. Hrushovi, zyrtarisht, ka akuzuar udhëheqësit shqiptarë si njerëz të lidhur me agjenturat imperialiste. Pra, sipas logjikës së tij, del se kush lufton kundër imperializmit, kush lufton kundër agjentëve të tij, kush lufton për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut socialist, ai është «agjent i imperializmit». Dhe në të kundërtën, kush ngrihet kundër pushtetit të popullit dhe kundër partisë, kush vihet në shërbim të armiqve të socializmit, ai është «martir», «patriot i mirë», ai merret nën mbrojtje nga udhëheqësi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për njerëz të tillë do të ngrihen edhe përmendore.

Çështja e luftës kundër kultit të Stalinit u përdor nga N. Hrushovi për të shkurorëzuar leninizmin, për të pregetitur terrenin që të revizionohej marksizëm-leninizmi dhe për të përhapur pikëpamjet e veta oportuniste për çështjet më të rëndësishme të zhvillimit të sotëm botëror e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ky veprim e kjo taktikë e tij nuk është as e re, as

origjinale. Në fakt, edhe Trocki në luftën e tij kundër leninizmit, ka përdorur të njëjtën taktkikë.

«...Trocki në shkrimet e tij, thotë J. V. Stalini, bën edhe një (edhe një!) orvatje për të pregatitur kushtet e zëvendësimit të leninizmit me trockizmin. Trocket i duhet «me çdo kusht» të diskreditojë partinë, kuadrot e saj që bënë kryengritjen, me qëllim që nga diskreditimi i partisë të hidhet në diskreditimin e leninizmit. Kurse diskreditimi i leninizmit i nevojitet për të futur kontrabandë trockizmin, si «të vetmen» ideologji «proletare» (mos e merrni me shaka!). Gjithë kjo bëhet, sigurisht (o, sigurisht!) nën flamurin e leninizmit, me qëllim që procedura e kësaj kontrabande të kryhet «pa kurrfarë dëmi»»¹.

N. Hrushovi e përdori gjithashtu çështjen e Stalinit për të goditur elementët e shëndoshë marksistë-leninistë në udhëheqjet e partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, për të trembur, dhe në rast rezistence, edhe për të likuiduar çdo njeri që do të guxonte ta kundërshtonte, për të vënë në heshtje partitë e tjera dhe udhëheqës të ndryshëm, që nuk do të mbështetnë pikëpamjet revizioniste, kursin e tij. Çështja e kultit të individit, me një fjalë, u përdor si gogol për të bërë presione mbi partitë e tjera dhe për të likuiduar udhëheqësit që nuk i pëlqenin N. Hrushovit. Këto qëllime, që deri dje ai i mbante të fshehta, duke i mbu-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 361.

Iluar me një frazeologji «parimore» e «marksiste», në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i zbuloi sheshit. Po të mbajmë parasysh edhe faktin se, në të njëjtën kohë, Hrushovi merr nën mbrojtje dhe quan «patriotë» elementë antiparti dhe agjentë të imperializmit, pjesëmarrës të komplotit të organizuar nga imperialistët kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, atëherë del e qartë lufta «parimore» e tij kundër kultit të individit në Shqipëri, preokupacioni i tij i madh! Hrushovi kërkon të likuidojë udhëheqësit e sotëm të Partisë sonë dhe në vend të tyre të vendosë elementë antiparti dhe komplotistë, agjentë të imperializmit.

Që N. Hrushovi, nën pretekstin e luftës kundër kultit të individit, kërkon të shkurorëzojë leninizmin, për t'i hapur rrugën revizionizmit, e tregon edhe fakti se atë nuk e preokupon aspak lufta e drejtë e parimore marksiste-leniniste kundër kultit të individit, sepse po të ishte kështu, pavarësisht nga fjalët e tij demagogjike, ai nuk kishte se si të mos vinte re se tani në Bashkimin Sovjetik po duken përditë e më shumë shfaqjet e kultit të individit, bile shpeshherë në forma më të hapura dhe më ekzaltuese për vetë personin e tij. Kështu është vështirë të gjesh numër të revistave të ilustruara sovjetike, ku të mos ketë fotografi të N. Hrushovit, faqet e shtypit sovjetik janë mbushur me citate nga fjalimet e tij, në të katër anët dhe për të gjitha çështjet flet vetëm ai, një film i tërë i kushtohet jetës së tij dhe filma të tjera vizitave të tij në vende të ndryshme të botës; lëvdata të shumta i bëhen në fjalime e shkrime të ndryshme duke i atribuar atij personalisht sukseset më të mëdha të popullit sovjetik në fushën e zhvillimit

të industrisë, të shkencës e të teknikës. Po bëhen përpjekje të mëdha, të ethëshme, për ta paraqitur Hrushovin jo vetëm si «strateg të madh ushtarak», por gati edhe «arkitekt» të fitores mbi fashizmin në Luftën e Dytë Botërore.

Ku qëndron atëherë principialiteti i N. Hrushovit në luftën kundër shfaqjeve të kultit të individit, të cilin ai e reklamon me aq bujë në luftën e tij të paprincipitë kundër partive të tjera motra dhe udhëheqësve të tyre?

Ja, shokë, përsë Partia jonë nuk ka qenë e nuk është dakord me udhëheqjen sovjetike për çështjen e kritikës së saj ndaj Stalinit.

Partia jonë e Punës nuk ka qenë e nuk është dakord me udhëheqjen sovjetike edhe përsa i përkët çështjes së qëndrimit ndaj revizionizmit të sotëm, e veçanërisht ndaj klikës tradhtare të revizionistëve jugosllavë. N. Hrushovi dhe grapi i tij çështjen e Stalinit dhe të kultit të individit e përdorën edhe për të pregatitur terrenin për rehabilitimin e plotë të klikës revizioniste e tradhtare të Titos, për ta paraqitur atë si «viktimi» të gabimeve të Stalinit, duke inkurajuar kështu renegatët revizionistë, nga ishin e nga s'ishin që të fillonin veprimtarinë e tyre kundër marksizëm-leninizmit nën parullat demagogjike të «antistalinizmit» etj.

Dihet se klika revizioniste jugosllave u dënuar botërisht, si në letrat e njohura të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, të firmosura nga J. V. Stalini e V. M. Molotovi, ashtu edhe në Rezolucionin e Byrosë Informativë të disa partive komuniste e punëtore të qershorit 1948 «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste të Jugosllavisë», rezolucion, i

cili më vonë u mbështet nga të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës. Më pas, në nëntor të vitit 1949, doli Rezolucioni i dytë i Byrosë Informative, në të cilin tregohej se klika e Titos kishte degjeneruar përfundimisht në një agjenturë të imperializmit, se ajo likuidoi fitoret e revolucionit në Jugosllavi, se e largoi Jugosllavinë nga rruga e socializmit dhe nga kampi socialist dhe e vuri atë nën vartësinë ekonomike e politike të imperializmit, se klika titiste zhvillonte një veprimtari të gjerë spiunazhi e komplotesh kundër vendeve të ndryshme socialiste, se përkrahte në forma të ndryshme politikën imperialiste të luftës, të agresionit etj.

Pikëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet se konkluzionet e Stalinit dhe të Byrosë Informative, lidhur me klikën renegate revizioniste jugosllave, kanë qenë dhe mbeten të drejta. Këto konkluzione janë vërtetuar dhe vërtetohen si nga realiteti jugosllav në atë kohë, ashtu edhe nga ngjarjet e mëvonshme e ato të ditëve të sotme. Revisionistët jugosllavë u bënë qendra e diversionit dhe e komplateve në shërbim të imperializmit kundër vendeve të kampit socialist. Nën drejtimin e tyre punoi në Shqipëri banda e Koçi Xoxes, e cila synonte të shkatërronte Partinë e Punës dhe të likuidonte pushtetin popullor. Nga Jugosllavia futeshin ilegalisht në vendet socialiste me qindra agjentë e provokatorë, spiunë e diversantë, detyra e të cilëve ishte terrori, sabotimi, pregetitja e komplateve kundër socializmit në këto vende. Klika revizioniste e Titos gjithnjë e më hapur, që nga 1948 e këtej, është vënë në shërbim të imperializmit amerikan, me të cilin e lidhin milionat e miliardat e dolla-

rëve që përbëjnë kreditë ekonomike e ushtarake amerikane për Jugosllavinë, e lidh pjesëmarrja në «Paktin e Ballkanit», që s'është tjetër veçse aneks i Paktit të Atlantikut, e lidh politika e diversionit dhe e komploteve kundër vendeve socialiste dhe kundër lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve të porsaqiruar ose që akoma vuajnë nën kthetrat e kolonializmit.

Deri në vitin 1955 të gjitha partitë komuniste e punëtore ishin unanime në dënimin e udhëheqjcs revolucioniste jugosllave dhe zhvillonin një luftë të vendsur e parimore ideologjike-politike kundër saj. Mirëpo, pikërisht në këtë kohë, N. Hrushovi shpalli se ndaj Jugosllavisë dhe udhëheqësve të saj qenka bërë një padrejtësi e madhe, se «nën influencën e agjentit Beria» kundër tyre janë bërë akuza të pathemelta, se edhe në çështjen jugosllave paska gabuar rëndë J. V. Stalini. Dhe, menjëherë, ai mori iniciativën, vajti në Beograd, ku e quajti Titon «shok të dashur», hodhi në shportë në mënyrë të njëçanshme rezolucionet e Byrossë Informative dhe shpalli me zë të lartë se «Jugosllavia është vend socialist» dhe se «udhëheqësit jugosllavë, megjithëse kanë disa lëkundje, janë në përgjithësi marksistë-leninistë».

C'tregon eksperienca, c'tregonjeta? Eksperienca dhejeta praktike edhe para, edhe pas vitit 1955, tregonjë se në vlerësimin e çështjes jugosllave kishin të drejtë Stalini dhe Byroja Informativë, sepse vlerësimi i tyre mbështetej në faktet objektive, në mësimet e marksizëm-leninizmit. Eksperienca dhejeta praktike nga ana tjetër tregonjë se në qëndrimin ndaj klikës revolucioniste jugosllave nuk ka të drejtë N. Hrushovi dhe

ata që e pasojnë, sepse veprimet e tyre mbështeten në pikëpamjet subjektive dhe janë në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit, në kundërshtim me realitetin objektiv.

Le t'u referohemi fakteve. Ç'rezultate dhanë përpjekjet për rehabilitimin e klikës së Titos? Udhëheqësit revisionistë jugosllavë nuk hoqën dorë as nga pikëpamjet e tyre antimarksiste, as nga veprimitaria e tyre armiqësore kundër kampit socialist dhe partive komuniste e punëtore motra. Rezultati më i dukshëm, që dhanë përpjekjet e N. Hrushovit, ishte fakti se, pas vitit 1955, u krijuan mundësi për revisionistët jugosllavë që të veprojnë më lirisht kundër lëvizjes komuniste botërore e vendeve të kampit socialist, nën maskën e «shokut të persekutuar», duke shfrytëzuar në këtë drejtim edhe patronazhin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Rehabilitimi i revisionistëve jugosllavë solli me vete edhe rehabilitimin e gjithë agjentëve dhe shokëve të tyre në disa parti motra ku filloi, nën maskën e «korrigjimit të gabimeve», një fushatë e vërtetë kundër kuadrove të shëndoshë të partisë dhe një aktivizim i të gjithë elementëve antiparti. Kështu ndodhi në disa parti komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës, si edhe në disa parti të vendeve kapitaliste. Më tipike në këtë drejtim janë ngjarjet e Hungarisë, ku aktivizimi i elementëve revisionistë, me Imre Nagin në krye, që kishin përkrahjen dhe nxitjen aktive të revisionistëve jugosllavë, çoi deri në shpërthimin e kundërrevolucionit, i cili vuri në rrezik vetë ekzistençën e Hungarisë si shtet i demokracisë populllore.

Megjithëkëtë, N. Hrushovi vazhdimisht, me besim të madh te Titoja dhe shokët e tij, ndoqi me këmbëngulje politikën e afritit, të lajkave dhe të përkëdheljeve me revisionistët jugosllavë. Ngjarjet e Hungarisë e tregojnë edhe më qartë këtë qëndrim. Kur filloi kundërrevolucioni në Hungari, për çdo njeri ishte e qartë se në këto ngjarje një rol të poshtër po luanin edhe revisionistët jugosllavë. Kjo u duk në influencën e tyre në diskutimet kundërrevolucionare të klubit «Petëf», kjo u duk gjatë kryengritjes kundërrevolucionare dhe entuziazmit që shprehnin revisionistët jugosllavë në atë kohë, por akoma më qartë u pa edhe në faktin se tradhtari Imre Nagi, pas shpartallimit të kundërrevolucionit, gjeti strehë në ambasadën jugosllave në Budapest. Në vend që të demaskoheshin pa mëshirë renegatët e Beogradit, si ndër frysuesit kryesorë të grushtit kundërrevolucionar në Hungari, N. Hrushovi, me çdo mënyrë, u përpoq ta zbuste përgjegjësinë e tyre, ta minimizonte dhe më në fund ta eleminonte plotësisht. Ish-ambasadori i Bashkimit Sovjetik në atë kohë në Shqipëri, L. I. Krillov, i komunikoi Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë letrën që N. Hrushovi në datën 9 nëntor 1956 i kishte dërguar J. B. Titos. Në letër Hrushovi, ndër të tjera, i shkruante Titos sa më poshtë:

«Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e shqyrtoi letrën tuaj të fundit. Ne e quajmë të mundshme të biem dakord me pikëpamjet tuaja që tani të mos i jepet një rëndësi e veçantë çështjes nëse ambasada jugosllave në Budapest veproi drejt ose jo duke strehuar Imre Nagin me shokë. Ne vëmë re me

kënaqësi se, qysh në bisedimet e Brionit, ju keni qenë plotësisht dakord me qëndrimin tonë ndaj shokut Janosh Kadar, si një personalitet i shquar e me autoritet revolucionar në Hungari, i aftë në këto momente e kondita të vështira për të kryesuar qeverinë e re revolucionare... Ju ishit plotësisht të kënaqur me faktin që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, qysh në verën e këtij viti, në lidhje me largimin e Rakoshit, përpiquej që shoku Kadar të bëhej sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Puno-njësve në Hungari».

Çdo koment lidhur me këtë letër është i tepërt. Kjo letër tregon fare qartë se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, duke marrë nëpër këmbë çdo rregull që përcakton marrëdhëniet midis partive motra, ka shkuar aq larg, sa të ndërhyjë edhe në një çështje kaq të rëndësishme dhe me karakter të theksuar të brendshëm partie, siç është caktimi në vendin e sekretarit të parë të një partie motër të këtij apo të atij personi. Ajo tregon gjithashtu fare qartë se N. Hrushovi ka qenë prej kohësh plotësisht dakord me J. B. Titon, se ai e ka parë të arsyeshme që për çdo gjë, bile edhe për «emërimin» e sekretarit të parë të një partie tjeter të këshillohej me J. B. Titon, tamam me atë që ishte në krye të organizatorëve, që kurdisën kundërrevolucionin në Hungari.

Nga kjo kuptohet qartë dhe është fare logjike pse N. Hrushovi u përpoq që të mbyllej çështja e ndërhyrjes jugosllave në ngjarjet e Hungarisë: sepse nuk mund të bëhen dy gjëra në të njëjtën kohë, edhe të këshillohesh me Titon, edhe ta demaskosh atë.

Pas fjalimit famëkeq të Titos në Pula, në nëntor të vitit 1956, u gjallërua lufta e partive komuniste e punëtore kundër revizionizmit jugosllav dhe u kritikuan udhëheqësit jugosllavë për qëndrimin e tyre. Por grupi tradhtar i Titos jo vetëm nuk bëri asnjë autokritikë apo hap pozitiv ndaj lëvizjes komuniste, por në vitin 1958 e gjykoi bile të volitshme të formulonte e të përmblidhte idetë e veta revizioniste në programin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, i cili u botua si kunderpeshë e Deklaratës së Moskës të partive komuniste e punëtore të nëntorit 1957. Dukej sikur ta-shmë nuk kishte më vend as për iluzionin më të vogël, sepse Titoja dhe grupi i tij, atë çka fshihnin prej vitesh, nën parulla demagogjike pseudomarksiste e pseudosocialiste, në program e shkruan hapur. Po ç'ndodhi? Në fillim N. Hrushovi, i cili e ndieu veten ngushtë para opinionit publik dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, me gjithëse me gjysmë zemre, mbajti qëndrim ndaj revizionistëve jugosllavë. Por kjo nuk zgjati shumë. Me një shkathtësi të habitshme dhe në kundërshtim me logjikën më elementare, ai, në Kongresin V të Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, në korrik të vitit 1958, dha orientimin që të mos flitet për revisionistët jugosllavë, duke thënë: «Në luftën tonë për çështjet e përbashkëta nuk duhet t'u kushtojmë revisionistëve jugosllavë më shumë vëmendje sesa e meritojnë. Ata duan që t'u ngrihet vlera, që njerëzit të mendojnë se ata janë qendra e botës... Ne nuk do të ndihmojmë në ndezjen e pasioneve, në ashpërsimin e marrëdhënieve. Edhe në gjendjen e krijuar në marrëdhëni tona me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë

do të jetë e dobishme të ruhet një shkëndijë shprese, të kërkohen forma të pranueshme për disa çështje».

Këtë gjë ai e theksoi edhe gjatë vizitës së tij në Shqipëri, në maj të vitit 1959. Në të njëjtën kohë, gjithnjë e më shpesh filloi të qarkullojë përsëri fjala mbi «shokun Tito», filloi sërish të propagandohet se «Jugosllavia është shtet socialist», se midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë «ekziston mirëkuptimi reciprok për shumë probleme të politikës së jashtme».

Është me vend të kujtojmë se V. I. Lenini në kohën e tij ka zhvilluar një luftë të papajtueshme jo vetëm kundër oportinizmit, por edhe kundër atyre që pre-dikonin «unitetin» me oportunistët.

Grupi revisionist i udhëheqësve jugosllavë, duke u lënë i qetë në punën e tij tradhtare, antisocialiste e komplotiste, vazhdoi më me intensitet veprimtarinë e tij, si për përcarjen e lëvizjes komuniste, ashtu edhe për minimin e lëvizjes nacionalçirimitare dhe antiimperialiste të popujve, që luftojnë për liri ose që sapo kanë fituar lirinë kombëtare. Revisionistët jugosllavë përditë e më shumë e tregojnë veten si armiq të komunizmit e të lirisë së popujve. Pikërisht pse është e tillë klika revizioniste e Beogradit, përfaqësuesit e 81 partive komuniste e punëtore motra, në Deklaratën e Moskës të vitit 1960, dënuan me vendosmëri udhëheqësit revisionistë jugosllavë. Në Deklaratë, siç dihet, theksohet se udhëheqësit jugosllavë, mbasi tradhtuan mark-sizëm-leninizmin, e shkëputën vendin e tyre nga kampi socialist, e vunë atë nën vartësinë e të ashtuquajturës «ndihmë» të imperialistëve amerikanë dhe të imperialistëve të tjerë dhe në këtë mënyrë krijuan rrezikun e

humbjes së fitoreve revolucionare të arritura me luftën heroike të popullit jugosllav, se revizionistët jugosllavë bëjnë një punë minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se nën pretekstin e politikës jashtë bloqeve ata zhvillojnë një veprimitari që i sjell dëm çështjes së unititetit të të gjitha forcave dhe shteteve paqedashëse. Më në fund në Deklaratë theksohet nevoja e një lufte të vazhdueshme për demaskimin e plotë të grupit të udhëheqësve jugosllavë.

Megjithékëtë, mbas nëntorit të vitit 1960, në të shumtën e rasteve, këto teza të drejta të Deklaratës u lanë në harresë nga udhëheqja sovjetike. Bile, për të inkurajuar klikën revizioniste të Titos, «për të zbutur» zemërimin e saj, u pa e arsyeshme që nga udhëheqësit sovjetikë të bëhen deklarata zyrtare të ngrohta në adresë të «shokëve» jugosllavë. Kështu, vetëm pak ditë pas daljes së Deklaratës të 81 partive motra, anëtarë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe ministri i Jashtëm i Bashkimit Sovjetik, A. Gromiko, në Sovjetin Suprem të Bashkimit Sovjetik, në datën 23 dhjetor 1960, deklaroi se në disa gjëra themelore politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik përputhet plotësisht me politikën e jashtme të Jugosllavisë. Kurse vetë N. Hrušovi në intervistën e dhënë vëzhguesit të gazetës «Nju-Jork Tajms», Sulcberger, botuar në «Pravda» më 10 shtator 1961, deklaroi: «Ne, natyrisht, e konsiderojmë Jugosllavinë një vend socialist». A nuk është një deklaratë e tillë në kundërshtim me Deklaratën e 81 partive komuniste e punëtore të botës? A nuk duhet menduar se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me këtë dek-

laratë ka synuar «të zbutë» zemërimin e udhëheqësve revizionistë jugosllavë dhe t'u bëjë atyre të ditur publikisht se çka shkruhet në Deklaratën e Moskës apo edhe në ndonjë dokument tjetër të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik është formale, kurse pikëpamjet e tij janë të tjera?

Përse vallë ndodh një gjë e tillë? Përse me kaq këmbëngulje mbahet një qëndrim i tillë dashamirës ndaj një grapi renegatësh të marksizëm-leninizmit, të zhytur kokë e këmbë në llumin e revizionizmit e të tradhtisë, dhe, në të njëjtën kohë, sulmohen me tërbim partitë komuniste e punëtore që u kanë qëndruar kurdoherë besnike doktrinës revolucionare të marksizëm-leninizmit dhe çështjes së socializmit?

Partia e Punës e Shqipërisë nuk mund të ishte dhe as që mund të jetë dakord me një qëndrim të tillë oportunist ndaj një klike renegatësh. Në luftën kundër revizionizmit të sotëm, sidomos kundër klikës revizioniste të Beogradit, Partia jonë e Punës ka mbajtur dhe mban kurdoherë parasysh mësimet e çmuershme të të madhit Lenin, i cili theksonte me forcë se oportunitzmi përbën një rrezik serioz për vetë ekzistencën e rendit socialist.

Këto mësime të rëndësishme të Leninit ishin aq më tepër të kuptueshme për Partinë tonë, sepse ajo e kishte provuar në kurrizin e saj se ç'do të thotë revizionizëm jugosllav jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, sepse, në fakt, klika e Beogradit kurrë ndonjëherë, as përpara vitit 1948 dhe as pas vitit 1955, jo vetëm nuk kishte hequr dorë nga komploti e diversioni kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së

Punës të Shqipërisë, por bila i ka shtuar ato. Pra, lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit jugosllav ishte një detyrë e rëndësishme internacionale e Partisë sonë, si parti marksiste-leniniste, por edhe një detyrë e lavdishme, për të mbrojtur atdheun tonë socialist nga synimet dhe nga komplotet e revolucionistëve jugosllavë. Disa udhëheqësve sovjetikë nuk u pëlqente ky qëndrim i Partisë së Punës të Shqipërisë, sepse ishte në kundërshtim dhe përbënte një pengesë për planet e tyre të afrit e të përqafimit me klikën titiste. Filluan të qarkullojnë parulla se «shqiptarët janë gjaknxehtë», «shohin ngushtë dhe e bëjnë luftën kundër udhëheqësve jugosllavë nga pozitat e nacionalizmit», se «shqiptarët duan të rrëmbejnë flamurin e antirevizionizmit» dhe se «po i rritin vlerën klikës së Titos» etj., etj. Por Partia jonë nuk u lëkund nga pozitat e saj parimore dhe vazhdoi me konsekuençë e pa kompromis luftën kundër revolucionistëve jugosllavë. Ky veprim i Partisë sonë asnjëherë nuk i ka pëlqyer N. Hrushovit dhe është një nga arsyet që shpjegon qëndrimin kaq të egër të tij kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj.

Qëndrimi i grupit të N. Hrushovit ndaj revizionizmit jugosllav në fakt, nuk është qëndrim i ndryshëm vetëm nga ai i Partisë së Punës të Shqipërisë, por nga ai i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, që është shprehur në deklaratat e Moskës të viteve 1957 e 1960, kur revizionizmi cilësohet si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe revizionizmi jugosllav si minues i kampit socialist dhe i forcave të paqes. Pra, është e qartë se udhëheqja

sovjetike përpinqet ta zbutë luftën kundër oportunizmit dhe revizionizmit në lëvizjen komuniste. Këtu e kanë burimin edhe orvatjet për të shtrembëruar me gjithfarë lloj manipulimesh tezën e qartë të dy deklaratave të Moskës mbi revizionizmin si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore dhe për të nxjerrë në plan të parë luftën kundër dogmatizmit. Për Partinë tonë ka ardhur duke u bërë çdo ditë e më e qartë se, duke e pranuar me fjalë nevojën e luftës kundër revizionizmit dhe duke mos e bërë atë në fakt, N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë, nën pretekstin e luftës kundër dogmatizmit luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, bëjnë përpjekje për të hedhur poshtë tezat themelore të doktrinës revolucionare të proletariatit, pikërisht ashtu siç janë orvatur të bënin në të kaluarën oportunistët e revisionistët e kallëpeve të ndryshme dhe siç u orvat të bënte edhe Titoja.

Cilat qenë pasojat e përhapjes së pikëpamjeve të ndryshme oportuniste, të luftës së paprincipitë kundër J. V. Stalinit dhe të politikës së pajtimit me klikën tradhtare revizioniste titiste që kanë ndjekur me këmbëngulje N. Hrushovi dhe grapi i tij? Megjithëse ata ngrenë në qiel, me bujë të madhe, «*pasojat e mrekullueshme*» që dhanë gjoja «*kritika e kultit* të individit të J. V. Stalinit» dhe «*normalizimi i marrëdhënieve* me Jugosllavinë», megjithëse e paraqitin çështjen sikur me Kongresin XX filloi një epokë e re në zhvillimin dhe në forcimin e mëtejshëm të lëvizjes komuniste botërore, faktet flasin krejt të kundërtën. Këto pikëpamje e veprime të shtrembra u bënë flamur në duart e elementëve oportunistë e revisionistë në shumë vende,

për të shpërthyer sulmin revizionist kundër partive marksiste-leniniste. Kështu ndodhi në Partinë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Danimarkës, të Holandës, të Italisë, të Francës, të Anglisë etj. Nën influencën e pikëpamjeve oportuniste, të paraqitura nga N. Hrushovi në Kongresin XX, revizionizmi u gjallërua dhe mori një përhapje të gjerë në mjaft parti komuniste e punëtore, duke u bërë një rrezik shumë serioz për tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Pikërisht, nën parullat e luftës kundër «despotizmit stalinist», të huajtura nga raporti «sekret»: «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij», i cili «për çudi» u ra në dorë qarqeve reaksionare në Perëndim dhe u ribotua prej tyre me tonelata, reaksiuni imperialist dhe revisionistët modernë, sidomos renegatët revizionistë të Beogradit, armiq të socializmit, organizuan veprimet kundërrevolucionare kundër rendit socialist në Poloni dhe grushtin kundërrevolucionar në Hungari. Pikërisht nën mbrojtjen e këtyre tezave oportuniste, të sulmeve kundër Stalinit dhe të qëndrimeve pajtuese të N. Hrushovit me revisionistët jugosllavë, u gjallërua më tepër grupi renegat i Titos, iu la dorë e lirë atij për të zhvilluar gjerësisht veprimitari minues kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Për ne është krejt e qartë se një konkluzion i tillë nuk është i pranueshëm as për N. Hrushovin, as për pasuesit e tij. Por është logjike të shtrojmë pyetjen: Përse pikërisht pas Kongresit XX u gjallëruan menjëherë renegatët dhe revisionistët në radhët e partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, ngriti

përsëri krye klika revizioniste jugosllave dhe të gjithë së bashku shpërthyen sulmin frontal kundër marksizëm-leninizmit? Përse flamur i tyre nuk u bënë, të themi, tezat e Kongresit XIX apo XVIII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik? Këtu ka vetëm një shpjegim: se mjaft teza që u shtruan në Kongresin XX kishin karakter oportunist, prandaj përbënин ushqim ideo-ologjik për renegatët e për revizionistët në luftën e tyre kundër marksizëm-leninizmit, se qëndrimet ndaj Stalinit ishin antimarksiste, prandaj u përdorën me aq sukses nga armiqtë e marksizmit e të socializmit përqëllimet e tyre.

Këto konsekuenca të hidhura u ndienë edhe në Shqipëri. Në vendin tonë elementët oportunistë të tipit Tuk Jakova e Bedri Spahiu, si dhe mjaft elementë të tjerë të përjashtuar nga Partia për veprimtari antiparti, u aktivizuan dhe, me nxitjen direkte të revizionistëve jugosllavë, organizuan komplotin në Konferencën e Partisë për qytetin e Tiranës në prill të vitit 1956. Dihet se një rol kryesor në këtë komplot luajti tradhtari Panajot Plaku, agjent i vjetër i spiunazhit jugosllav, të cilin mbasi u arratis nga Shqipëria në Jugosllavi, N. Hrušovi, qysh më 1957, propozoi t'i jepej edhe strehim politik në Bashkimin Sovjetik. Parullat e këtyre tradhtarëve ishin parulla demagogjike «të liberalizimit e të demokratizimit të diktaturës së proletariatit», «të normalizimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë», «të rehabilitimit të Koçi Xoxes dhe të elementëve antiparti të dënuar më parë» etj. Është kuptimplotë fakti që, pikërisht në atë kohë, në prill-maj 1956, udhëheqja sovjetike me anë të M. Susllovit dhe të P. Pospjellovit

u përpoq të bindte Partinë tonë për të rehabilituar tradhtarin Koçi Xoxe, armik i Partisë e i popullit shqiptar, agjent i klikës revizioniste të Beogradit, i pushkatur për veprimtarinë e tij armiqësozë, që synonte likuidimin e Partisë e të pushtetit popullor dhe shndërrimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë titiste.

Qëndrimet antimarksiste të N. Hrushovit për çësh-tjet e mësipërme i sollën, pra, një dëm të madh çësh-tjes sonë të përbashkët të socializmit e të komunizmit, me gjithëkëtë lëvizja komuniste e punëtore ndërkombëtare mundi t'i bëjë ballë me sukses sulmit të renegatëve revizionistë. Marksizëm-leninizmi është flamuri i fitores, prandaj armiqjtë e tij, revizionistët dhe oportunistët, kanë dështuar e do të dështojnë kurdoherë me turp.

Nga sa u tha më sipër del qartë se karakteri i mos-marrëveshjeve tona ka qenë krejtësisht ideologjik e politik, se Partia jonë nuk është pajtuar me pikëpamjet e me veprimet oportuniste të N. Hrushovit për disa çështje jetike të zhvillimit të sotëm botëror e të lë-vizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, pikëpamje të cilat janë në kundërshtim me parimet themelore të marksizëm-leninizmit dhe përbëjnë një shkelje të rëndë të deklaratave të partive komuniste e punëtore të viteve 1957 e 1960. Por ekzistenca e këtyre pikëpamjeve të shtrembra te udhëheqësit sovjetikë është vetëm gjysma e së keqes. E keqja më e madhe është se konceptet e tyre oportuniste ata përpiken t'ua imponojnë me çdo kusht të gjitha partive komuniste e punëtore, pa u ndalur për këtë qëllim as përpara presioneve,

shantazheve e sulmeve më brutale kundër atyre partive dhe udhëheqësve të tyre që nuk janë dakord me tezat revizioniste të N. Hrushovit, që i kundërshtojnë ato dhe mbrojnë me vendosmëri marksizëm-leninizmin. Këtu është e keqja më e madhe, këtu qëndron edhe shkaku që marrëdhëniet midis vendit tonë dhe udhëheqjes sovjetike janë acaruar. Duke e parë se orvatjet e tij të shumëllojshme për të gjunjëzuar Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për t'i imponuar asaj pikëpamjet e veta antimarksiste dështuan para qëndrimit të patundur marksist-leninist të Partisë sonë dhe duke dashur të justifikojë përpara partisë së tij dhe përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare veprimtarinë e vet të palejueshme, armiqësore, kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, N. Hrushovi është hedhur në shpifje të egra e publike si ato që bënë ai dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Fakti që ai zgjodhi tribunën e Kongresit XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për të bërë «gjyqin» kundër Partisë sonë, fakti që ai gënjeu përfaqësuesit e disa partive komuniste, që të shpreheshin jo shoqërisht kundër Partisë sonë në përvëndetjet e tyre drejtar kongresit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, hedh dritë mbi metodat puçiste dhe mbi taktikën e tij të besasisë, të imponimit të njëanëshëm të dëshirës së tij lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, mbi mosrespektimin e parimeve themelore, që rregullojnë marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtore të botës, që janë vendosur

bashkërisht dhe që janë përcaktuar në deklaratat e Moskës.

Për të shqyrtuar veprimtarinë e një partie komuniste e punëtore, për të thënë pikëpamjen nëse është apo nuk është ajo në pozita të drejta, mund të gjykojë vetëm një forum ndërkombëtar, një mbledhje ndërkombëtare e partive komuniste e punëtore, mbasi të jenë dëgjuar me hollësi argumentet e asaj partie. Mirëpo N. Hrushovi pati frikë të kërkonte thirrjen e një mbledhjeje të tillë, sepse ai është i bindur se nuk do t'ia arrinte dot qëllimit të tij për të dënuar Partinë tonë të Punës. Për këtë arsyе ai nuk ftoi në Kongresin XXII edhe Partinë tonë, sepse fjala e saj do të nxirrte edhe një herë në shesh të vërtetën mbi marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, do të demaskonte përsëri pikëpamjet dhe veprimet e tij antimarksiste, do të hidhte poshtë të gjitha shpifjet e akuzat e tij krejt të pathemelta.

Metoda, që përdori Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për të sulmuar në mënyrë të njëanshme Partinë tonë është e njojur përlëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Këtë taktkë ai përdori edhe në Bukuresht, ku, me akuza false e të njëanshme, u përpoq të gjunjëzonte parti marksiste-leniniste dhe të komprometonte, me anë të prononcimit të shpejtë, të papeshuar e të pastudjuar mirë, përfaqësuesit e tyre, por, me gjithë përpjekjet e tij, nuk ia arriti qëllimit. N. Hrushovi përkundrazi u detyrua të pranonte zhvillimin e Mbledhjes së Moskës të nëntorit 1960, ku u bënë debate të drejta, ku u pa qartë se pikëpamjet e tij nuk gjetën mbështetjen entuziaste të pjesëmarrësve, gjë që shprehet edhe në

vetë dokumentet e aprovuara nga përfaqësuesit e 81 partive dhe që N. Hrushovi po i shkel brutalisht në të gjithë veprimtarinë e tij. Prandaj ai, për të sulmuar Partinë tonë, u kthyte në metodat e tij puçiste, duke përdorur për këtë qëllim Kongresin XXII.

Në këtë mënyrë N. Hrushovi sabotoi efektivisht edhe çdo mbledhje të ardhshme ndërkombejtare, sepse duke sulmuar në mënyrë të njëanshme dhe publikisht Partinë tonë, ai e vuri Partinë e Punës të Shqipërisë në kushte të pabarabarta.

Në Kongresin XXII, N. Hrushovi dhe pasuesit e tij akuzuan Partinë tonë se gjoja ajo me veprimet e saj po «prish unitetin, po përcan kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombejtare». Duhet të kesh humbur çdo ndjenjë përgjegjësie dhe serioziteti që të thuash një gjë të tillë. Kush në të vërtetë po i vë minat unitetit tonë: Partia e Punës e Shqipërisë apo udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me N. Hrushovin në krye? Partia jonë, e cila kurdoherë u është përmbajtur parimeve që mosmarrëveshjet tona të zgjidhen në rrugë partie, apo udhëheqja sovjetike që i ka marrë nëpër këmbë këto parime dhe që ka hyrë në rrugën antimarksiste të presioneve, shantazheve dhe derisa bën thirrje të hapur për kundërrrevolucion në Shqipërinë socialiste? Partia e Punës e Shqipërisë asnjëherë nuk ka folur publikisht për mosmarrëveshjet tona, ajo vetëm në rrugë partie dhe në mbledhje partie ka kritikuar hapur e me kurajë pikëpamjet dhe veprimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë, kurse N. Hrushovi i pari foli publikisht nga tribuna e Kongresit XXII jo vetëm për ekzistencën e mosmarrëveshjeve tona, por

volli vrer, shpifi në mes të ditës, kundër Partisë dhe pushtetit tonë popullor, duke e paraqitur atë si një «regjim terrori ku majtas e djathjas ka burgje e skuadra ekzekutimi», duke përdorur gjuhën e Rankoviçit, që ka thënë se «në Shqipëri mbretëron teli me gjemba dhe çizmja e kufitarit». Partia jonë është për unitetin, për forcimin e tij të mëtejshëm, por për një unitet të shëndoshë, të çeliktë, jo për një unitet anemik e të sëmurë. Pikërisht pse është për unitetin e çeliktë të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare e të kampit socialist, ajo me kurajë e në rrugë partie ka kritikuar shfaqjet dhe veprimet antimarksiste të N. Hrushovit, që e dobësojnë këtë unitet.

Neve na vjen shumë keq që disa udhëheqës të partive komuniste u bashkuan me pikëpamjet e gabura të N. Hrushovit. Ne nuk duam të kërkojmë shkaqet, që i detyruan ata të mbanin këtë qëndrim (bile ne e kuptojmë fare mirë pozitën e vështirë në të cilën janë gjendur ata), por a mund të quhet e drejtë pozita e tyre e njëanshme, apriori, kur shumica e përfaqësuesve të këtyre partive nuk janë në dijeni të zhvillimit të marrëdhënieve midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike? A është e drejtë që të mbash këtë anë apo tjetren, kur dëgjon vetëm argumentet e njërsës palë, kurse palës tjetër i është mohuar e drejta të thotë pikëpamjen e saj? Apo në lëvizjen komuniste duhen vendosur parime të reja, sipas të cilave i madhi duhet të dëgjohet, i vogli jo, i madhi ka të drejtë, kurse i vogli kurdoherë ka gabim? Sipas mendimit tonë një arsyetim i tillë nuk është aspak i drejtë dhe nuk përputhet me normat leniniste të marrëdhënieve midis

partive. Një qëndrim i tillë nuk e ndihmon forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombejtare, forcimin e kampit socialist, por e dobëson atë dhe do të krijojë më vonë telashe të mëdha.

Megjithëkëtë, në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovin nuk e përkrahën të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore. Nga 80 delegacionet e huaja, që morën pjesë në punimet e këtij kongresi dhe që folën ose dërguan me shkrim përshëndetjet e tyre, 34 përfaqësues të partive motra nuk u bashkuan me shpifjet e me akuzat e N. Hrushovit kundër Partisë sonë, ata nuk folën për mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes sovjetike. Sigurisht mjaft prej tyre mund të kenë vërejtjet e veta për punën e Partisë së Punës të Shqipërisë, por në Kongresin XXII, që ishte kongresi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të një partie të caktuar, ata nuk e gjykuau me vend të flisnin për një çështje që i përket gjithë lëvizjes komuniste ndërkombejtare, duke mbajtur në këtë mënyrë një qëndrim korrekt marksist-leninist. Duhet të themi gjithash tu se edhe masa e delegatëve të brendshëm të Kongresit XXII nuk u shprehën për mosmarrëveshjet sovjeto-shqiptare, ata nuk folën kundër Partisë sonë, ata nuk e mbështetën N. Hrushovin në sulmet e në shpifjet e tij kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Nga 88 delegatë, që diskutuan në kongres, vetëm 14 folën kundër Partisë sonë. Dhe të gjithë këta ishin pjesëtarë të udhëheqjes sovjetike.

Partia jonë e Punës falënderon për qëndrimin e tyre parimor e korrekt, si përfaqësuesit e partive ko-

muniste e punëtore që nuk përkrahën N. Hrushovin në sulmet e tij të njëanshme ndaj Partisë sonë, ashtu edhe delegatët e Partisë Komuniste të lavdishme të Leninit, të cilët, duke ruajtur traditat bolshevike dhe parimet leniniste të gjykimit objektiv të çdo çështjeje, nuk e mbështetën N. Hrushovin në këtë akt antimarksist.

Nga tribuna e Kongresit XXII, midis akuzave të shumta shpifëse, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik foli edhe për gjoja mungesën e demokracisë në Partinë tonë, për gjoja shkeljet e normave leniniste në jetën e brendshme të saj. Kjo, natyrisht, është një ndërhyrje e hapët në punët e brendshme të Partisë sonë, por, megjithëkëtë, këtyre «mbrojtësve» të demokracisë mund t'u themi: Shihni më mirë punët tuaja, sepse jo në Partinë e Punës të Shqipërisë, por në partitë tuaja ka shumë shembuj skandalozë të thyerjes së rregullave më elementare të demokracisë. Dimitër Poljanski, kur sulmoi grupin «antiparti», sigurisht u rezervua të tregonte me hollësi gjithë prapaskenën që ai dhe shokët e tij kishin organizuar në kohën e plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në verën e vitit 1957. Poljanski ia fshehu kongresit, por ai këtë ia ka thënë një «miku» të tyre, që atëherë na e përshkroi me hollësi.

Le të marrim një shembull tjetër. Kur gjyqi në Tiranë u dha dënimin e merituar agjentëve të imperializmit amerikan, të Jugosllavisë e të Greqisë, Teme Sejkos me shokë, nga gjithë shtypi i vendeve të demokracisë popullore të Evropës vetëm gazeta «Trud», organ i klasës punëtore bullgare, e njoftoi drejt këtë

gjyq. Por menjëherë, brenda ditës, me metodat më «demokratike» u shpall se presidenti dhe sekretarët përgjegjës të Këshillit Qendror të Bashkimeve Professionalë të Bullgarisë u shkarkuan nga detyra. Dhe kjo, sepse qeveria jugosllave, po atë ditë, paraqiti një protestë serioze pranë qeverisë bullgare lidhur me njoftimin e dhënë mbi gjyqin e Tiranës nga kjo gazetë.

Më në fund, ata që flasin për demokracinë e brendshme dhe për respektimin e normave të partisë, këtu fjalën e kemi veçanërisht për Palmiro Toliatin, si e quan ai veprimin e tij në Kongresin XXII, kur foli e dënoi Partinë tonë, të rregullt, demokratik? Ai nuk dinte më parë se çfarë ka ndodhur e si janë zhvilluar marrëdhëniet midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike. Të paktën Partia jonë nuk i ka dhënë Partisë Komuniste të Italisë asnje material. Komiteti i saj Qendror nuk kishte marrë më parë ndonjë vendim me të cilin të denonconte Partinë tonë dhe, pra, të autorizonte përfaqësuesit e saj për ta dënuar atë. Të paktën ne nuk dimë asnje fakt të tillë. Atëherë për çfarë demokracie bëjnë fjalë këta udhëheqës, që skandalizohen pa shkak për fatin e një personi, kurse, kur është fjala për fatin e një partie, të 50 000 komunistëve dhe të një populli të tërë, bëjnë deklarata fyeze pa kurrfarë përgjegjësie dhe në kundërshtim flagrant me rregullat elementare jo vetëm të demokracisë së partisë, por edhe të logjikës së thjeshtë e ndërgjegjes njerëzore? Palmiro Toliati na lëshoi neve «anatemën»¹ romane,

¹ Anatema (nga greqishtja) — çshenjtërim, çkishërim, mallkim. Përdorej për heretikët, çifutët, që i përzinte kisha.

duke na akuzuar ne se përcajmë unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombejtare. Ku bazohet Toliati, kur s'ka shumë vjet që sulmoi publikisht sistemin socialist sovjetik e predikoi policentrizmin dhe zonat e influencës në lëvizjen komuniste ndërkombejtare? Ai s'ka dhe nuk do të ketë asnje fakt kundër nesh, por me tezat e veta antimarksiste ai u shërbeu shumë revisionistëve jugosllavë. Por për çudi kundër pikëpamjeve revisioniste të Toliatit nuk u ngrit kush.

N. Hrushovi, që aq shunië flet për metoda demokratike, për durim dhe për internacionalizëm, ka përdorur kundër Partisë sonë metodat më antimarksiste dhe krejt të huaja për marrëdhëniet midis vendeve socialiste. Me qëllim që të nënshtrojë Partinë e Punës të Shqipërisë, që ta ndalojë atë të ketë pikëpamjen e saj, që t'i imponojë asaj pikëpamjet e veta antimarksiste, ai dhe pasuesit e tij nuk janë ndalur përparaasnje mase, jo vetëm në marrëdhëniet midis partive tona, por edhe në marrëdhëniet midis shteteve tona socialiste. Sot nuk duam të futemi në hollësi dhe të ndalemi shumë në këto çështje, sepse ka dhe shumë fakte e dokumente të panumërt, që i ilustrojnë në mënyrë objektive këto, por do të përmendim se, si rezultat i përdorimit të metodave antimarksiste nga udhëheqja sovjetike përzgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese, si rezultat i presioneve të njëpasnjëshme si në lëmin ekonomik, ashtu edhe në atë politik e ushtarak, marrëdhëniet midis vendit tonë dhe Bashkimit Sovjetik janë acaruar shumë. Ky proces ka filluar qysh nga gjysma e dytë e vitit të kaluar, domethënë pas Mbledhjes së Bukuresh-

tit. Qysh atëherë N. Hrushovi mosmarrëveshjet ideo-logjike e politike që ekzistonin midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike në vend që të pranonte t'i zgjidh-nim me durim, i bëri publike dhe i shtriu edhe në marrëdhëniet shtetërore.

Kështu në fushën ekonomike u ndërprenë të gjitha kreditë që Bashkimi Sovjetik i kishte akorduar vendit tonë për pesëvjeçarin e tretë dhe kjo me qëllim që të sabotohet plani ekonomik i vendit tonë; u tërhoqën pa asnjë arsyе dhe në mënyrë të njëanshme gjithë specialistët sovjetikë që punonin në Shqipëri, për të cilët ekonomia jonë kishte shumë nevojë dhe që ne kishim kërkuar zyrtarisht të qëndronin; pala sovjetike pothuajse ka ndërprerë fare edhe marrëdhëniet tregtare mbi bazën e kleringut, nën pretekstin e paraqitur si ultimatum, që të fillojmë qysh nga ky vit nga shlyerja e kredive të vjetra (megjithëse sipas dokumenteve ekzistuese kjo gjë do të fillonte pas vitit 1970); gjithashtu iu prenë bursat të gjithë studentëve shqiptarë civilë e ushtarakë që studjonin në Bashkimin Sovjetik etj., etj. Presionet ekonomike u shoqëruan me presione e masa restiktive edhe në fushën ushtarake.

Nga ana tjetër dihet mirë prej të gjithëve se shtypi i Republikës Popullore të Shqipërisë shkruan vazhdimi-sht mbi jetën dhe sukseset e Bashkimit Sovjetik në ndërtimin e komunizmit, përkrah hapat dhe propozimet e ndryshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të qeverisë sovjetike lidhur me çështjet e ndryshme ndërkombëtare. Kurse shtypi sovjetik, në të kundërtën, prej afro një viti e gjysmë ka shpallur një bllokadë të rreptë heshtjeje kundër Shqipërisë, ndërsa nuk lë që

t'i shpëtojë as rasti më i vogël për të shkruar qoftë edhe për ndonjë fjalë pozitive që i ka shpëtuar rastësisht ndonjë lordi anglez. Shtypi sovjetik nuk shkruan asnjë radhë jo më për Partinë e Punës të Shqipërisë, por as për Shqipërinë, sikur mbi tokë të mos ekzistonin fare as Republika Popullore e Shqipërisë dhe as populli shqiptar, që ndërton socializmin e lufton për paqen në gojën e ujkut, i rrethuar nga të katër anët nga imperialistët dhe nga veglat e tyre. Akulli i heshtjes u thye vetëm në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nga Nikita Hrushovi, dhe u thye vetëm e vetëm për të shpifur e për të vjellur vler kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në këto veprime antimarksiste e armiqësore ndaj popullit shqiptar, Nikita Hrushovin e kanë ndjekur dhe disa udhëheqës të vendeve socialiste të Evropës. Të gjithë së bashku, ata po bëjnë çmos që ta izolojnë Shqipërinë ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht, duke krijuar rreth saj «kordonin sanitar». N. Hrushovi harron se në shekullin e triumfit të leninizmit nuk mund të ketë «kordon» që të izolojë një popull dhe një parti që luftojnë me vendosmëri për triumfin e socializmit e të komunizmit, nuk mund të ketë «kordon», sado i organizuar dhe i fortë të jetë ai, që t'i rezistojë së drejtës marksiste-leniniste. Çdo «kordon» do të shpartallohet dhe organizatorët e tij do të dështojnë me turp.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik nuk u mjaftua me kaq. Duke e

parë se të gjitha presionet, blokadat e shantazhet e tij nuk dhanë rezultatin që dëshironte, nuk i gjunjëzuan dot Partinë dhe popullin tonë, nga tribuna e Kongresit XXII bëri thirrje haptazi për të rrëzuar me grusht kundërrevolucionar udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, për të likuiduar Partinë tonë, gjë të cilën ai rezervohet ta bëjë edhe kur është puna për qeveritë e vendeve kapitaliste, sepse e konsideron një ndërhyrje në punët e tyre të brendshme. Ai tha: «T'i japësh fund kultit të individit do të thotë për Shehun, Hoxhën e të tjerë të heqësh dorë në esencë prej posteve komanduese në parti e në shtet. Por këtë gjë ata nuk duan ta bëjnë. Ne jemi të bindur se do të vijë koha kur komunistët shqiptarë, kur populli shqiptar do të thonë fjalën e tyre dhe atëherë udhëheqësit shqiptarë do të duhet të jalin përgjigje për atë dëm që ata u shkaktuan vendit të tyre, popullit të tyre, çështjes së ndërlimit të socializmit në Shqipëri». Populli e komunistët shqiptarë ia dhanë përgjigjen N. Hrushovit nëpërmjet qindra e mijëra telegrameve e letrave, një pjesë e të cilave u botuan në shtypin tonë.

Partia dhe populli ynë kanë dëgjuar, vazhdimisht, për 17 vjet me radhë, thirrje për të përbysur pushtetin tonë popullor, për të likuiduar Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj. I kanë dëgjuar e i dëgjojnë ato çdo vit nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga imperialistët amerikanë, anglezë dhe të tjerë, nga radio «Spanja nacionaliste» e Frankos, nga tradhtarët revisionistë të Beogradit, nga monarko-fashistët grekë etj. Këta bile kanë organizuar dhe komplete për t'ia arritur qëllimit të tyre. Tani thirrje të

tilla i dëgjuam edhe nga Nikita Hrushovi, i cili në fakt po bashkohet me ta në veprimtarinë armiqësore kundër popullit shqiptar dhe Partisë së tij të Punës. Ku janë mbështetur imperialistët dhe veglat e tyre në veprimtarinë kundër pushtetit popullor dhe Partisë në vendin tonë? Forcat e tyre kanë qenë llumi i shoqërisë sonë, elementët e degjeneruar e antiparti, njerëzit e shitur te zbulimet e huaja, të cilët populli ynë i përmend vetëm me një ndjenjë urrejtjeje, përbuzjeje e ne-veritjeje të thellë. Këta do të jenë edhe rezervat e Nikita Hrushovit. Dhe s'mund të jetë ndryshe. Tërë populli ynë, i madh e i vogël, të gjithë njerëzit e ndershëm e patriotë të atdheut tonë, me parti ose pa parti, janë të bashkuar sot më fort se kurrë rreth Partisë sonë të lavdishme dhe vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, që shpreh interesat jetike të popullit tonë dhe u përgjigjet interesave të përbashkëta të çështjes sonë të madhe, të socializmit e të komunizmit. Përparrë unititetit të çeliktë të Partisë dhe të popullit tonë, përparrë kësaj force të pathyeshme, do të dështojnë me turp të gjitha veprimet armiqësore dhe ndërhyrjet brutale të Nikita Hrushovit, ashtu siç kanë dështuar më parë dhe do të dështojnë kurdoherë gjithë veprimtaria armiqësore dhe të gjitha komplotet e imperialisteve, të revisionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë e të armiqve të tjerë kundër popullit shqiptar, Partisë së tij të Punës dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovi e akuzoi Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj për antisovjetizëm, duke e quajtur

çdo vërejtje e kritikë ndaj pikëpamjeve e veprimeve antimarksiste të tij, të bërë në mbledhje partie e sipas rregullave leniniste, sulm kundër Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë. Kjo është një shpifje e shtrembërim monstruoz.

Kush në të vërtetë e mbron Bashkimin Sovjetik dhe prestigjin e tij: Nikita Hrushovi, që me sulmet e veta të paprincipta dhe shpifjet kundër J. V. Stalinit ka diskredituar Bashkimin Sovjetik, duke e paraqitur atë si një vend ku ka sunduar terrori më i egër, njëloj si në Gjermaninë e Hitlerit, apo Partia e Punës e Shqipërisë, që ka mbrojtur dhe mbron Bashkimin Sovjetik nga sulmet e egra të propagandës imperialiste e revizioniste, së cilës i dha armë Nikita Hrushovi? Kush e mbron Bashkimin Sovjetik dhe prestigjin e tij: Nikita Hrushovi, që me veprimet antimarksiste, sulmet, presionet e bllokadat kundër Republikës Popullore të Shqipërisë u jep armë imperialistëve për të njollosur para opinionit publik botëror Bashkimin Sovjetik dhe Partinë e tij Komuniste, apo Partia e Punës e Shqipërisë, që ka treguar dhe tregon se veprimet antimarksiste të tij nuk kanë asgjë të përbashkët me parimet dhe me traditat internacionaliste të Bashkimit Sovjetik e të Partisë së madhe të Leninit?

Partia jonë dëgjoi me durim çfarë u tha në Kongresin XXII në adresë të saj. Edhe ne po e themi pikëpamjen tonë lidhur me këto çështje. Partia e Punës e Shqipërisë, me ndërgjegje të qetë e të pastër, i bën thirrje Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i bën thirrje Komitetit Qendror të ri që zgjodhi Kongresi XXII që, me drejtësinë leniniste, me objektivitet e

gjakftohtësi, jo në mënyrë të njëanshme, të gjykojnë mbi gjendjen e kriuar në marrëdhëniet midis dy partive e dy vendeve tona. Partia jonë ka qenë kurdoherë e gatshme, për hir të unitetit të lëvizjes komuniste e të kampit socialist, të interesave të vendeve tona, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese. Por ajo gjithnjë ka qenë dhe çشتë e mendimit që këto çështje të zgjidhen drejt dhc vetëm në rrugë marksiste-leniniste, në kushtet e barazisë dhe jo të presioneve e të diktatit.

Partia dhe populli ynë, pavarësisht nga sulmet, shpifjet dhe veprimet armiqësore që janë drejtuar kundër tyre, ruajnë të paprekur në zemrat e tyre ndjenjat e pastra të miqësisë me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë na ka mësuar ta duam Bashkimin Sovjetik, atdheun e madh të Leninit e të Stalinit, si në kohë të mira, ashtu edhe në kohë të vështira.

Shokë dhe shoqe,

Gjithëjeta e veprimitaria 20-vjeçare e Partisë sonë, si dhe faktet e realiteti i sotëm tregojnë qartë se Partia jonë ka pasur gjithnjë një vijë të përgjithshme të drejtë, se edhe lidhur me çështjet e sotme të rëndësishme, që preokupojnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, veçanërisht lidhur me çështjen e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike, ajo qëndron në pozita të drejta, marksiste-leniniste dhe internacionliste.

Të bindur thellësisht se janë me të vërtetën, populli dhe Partia jonë, të bashkuar si një trup i vetëm, me ndërgjegje të qetë e të pastër dhe me vendosmëri të papërkulur, do të 'ndjekin edhe në të ardhshmen pa

lëkundje rrugën e tyre të drejtë. Dhe në këtë rrugë ata do të fitojnë.

Garanci për këtë është populli ynë heroik e i pa-përkulur, është Partia jonë e lavdishme, Partia e revolucionit popullor, Partia që gjatë këtyre 20 vjetëve fitoi mbi fashizmin dhe u dha lirinë popullit e atdheut tonë, Partia që triumfoi mbi prapambetjen, urinë dhe paditurinë dhe e futi vendin në rrugën e socializmit, të përparimit e të kulturës, Partia që, si pjellë besnikë e popullit tonë heroik, ka bërë të dështojë çdo provokacion apo komplot që ka pasur për qëllim të kthcjë robërinë dhe varférinë në shtëpitë tona. Rëndësi për fitoret tona ka përkrahja e miqësia jonë me popujt sovjetikë, me popullin kinez, me gjithë popujt miq të vendeve socialiste e të vendeve të tjera, me të cilët Partia jonë, si një Parti besnikë e parimeve të internacionalistët proletar, e ka lidhur në miqësi të singertë e të pathyeshme popullin tonë të vogël, por heroik.

Ne kalojmë disa vështirësi të përkohshme përfaktin se duhet t'u bëjmë ballë jo vetëm sulmeve dhe intrigave të armiqve tanë të betuar, imperialistëve amerikanë dhe të tjerë, aleatëve e shërbëtorëve të tyre revizionistëve jugosllavë, por sepse duhet të zembrapsim edhe shpifjet e sulmet e reja që po na bëhen. Por vështirësitë kurrë nuk i kanë trembur e nuk i kanë përkulur as Partinë tonë, as popullin tonë. Duke shtrënguar radhët tona rreth Partisë, duke forcuar vigjilencën, duke shumëfishuar përpjekjet tona për të realizuar me sukses, më mirë se çdo herë tjetër, detyrat për realizimin e planit të shtetit në të gjitha fushat, ne do të dalim

faqebardhë. Ne jemi të bindur se në këtë luftë e në këto përpjekje do të kemi përkrahjen e gjithë miqve tanë, të gjithë popujve të vendeve socialiste, duke përfshirë edhe popullin sovjetik, të gjithë komunistëve të botës, duke përfshirë edhe komunistët sovjetikë, të cilët shpejt a vonë do të shohin se grushti që është drejtuar kundër Partisë dhe popullit tonë është i padrejtë, është i rrezikshëm për të gjithë komunistët e botës.

Me këtë besim ne festojmë 44-vjetorin e Revolucionit të madh Socialist të Totorit dhe festën e madhe të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme. Me këtë besim, me flamurin revolucionar të leninizmit fitimtar, me flamurin e shpalosur të Partisë sonë heroike, ne, komunistët shqiptarë, së bashku me gjithë popullin tonë patriot e luftëtar, do të marshojmë me hapa të sigurt drejt fitoresh të reja, për lavdinë e marksizëm-leninizmit, për lavdinë e komunizmit, për lavdinë e atdheut tonë socialist!

Lavdi marksizëm-leninizmit fitimtar, flamurit të fitoreve të Partisë e të popullit tonë!

Rroftë 44-vjetori i Revolucionit të madh Socialist të Totorit!

Rroftë 20-vjetori i themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë!

Rroftë populli ynë heroik e i papërkulur!

Lavdi Partisë së Punës të Shqipërisë!

**NAFTËTARËT KANË QENE DHE JANE NË RADHËT
E PARA TE LUFTËS E TE PERPJEKJEVE
TE POPULLIT TONE PËR NDERTIMIN
E SOCIALIZMIT**

*Nga fjala në mitingun me naftëtarët
e Qytetit «Stalin»*

9 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe naftëtarë,

Eshtë me të vërtetë një gëzim shumë i madh për ne, kur vijmë në qytetin e naftës, sepse këtu Partia ka pasur dhe ka një nga qendrat më të rëndësishme të klasës punëtore. Klasa jonë punëtore, në ditët më të vështira që kalonte populli ynë, formoi Partinë tonë të lavdishme, e cila dje mbushi 20 vjet plot me luftëra dhe me suksese të mëdha për të mirën e popullit shqiptar.

8 Nëntorin, këtë ditë të madhe historike, e festoi dje e tërë Shqipëria, tërë populli. Njëkohësisht i gjithë populli ynë ishte në këmbë, i gatshëm, i gëzuar dhe optimist për të realizuar detyrat e mëdha që vuri Kongresi IV i Partisë. Që nga ditët e Kongresit e gjer më sot në vendin tonë është vënë re një mobilizim i shum-

anshëm i të gjithë punonjësve në kantiere e fabrika, në fusha e malësi për ndër të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të dashur. Të gjithë u mobilizuan me të tëra forcat për realizimin e planit në çdo sektor.

Gjithë ky entuziazëm dhe besim i madh për Partinë është njëkohësisht edhe për ju, shokë punëtorë, sepse ju, si e gjithë klasa jonë punëtore, qysh në fillim keni qenë, jeni dhe do të jeni në shekuj kolona vertebrale e Partisë sonë. Ju, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, u trenguat në lartësinë e duhur në luftën për çlirimin e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit. Në ditët më të vështira, nëpërmjet Partisë, ju realizuat unitetin e popullit shqiptar për t'u bërë ballë pushtuesve fashistë italianë dhe gjermanë. Ju u çelikosët në një alcancë të përjetshme me fshatarësinë punonjëse dhe me intligjencën patriote. Në shembullin e sakrificave tuaja, i gjithë populli ynë shkoi në luftë. Nën udhëheqjen e klasës sonë punëtore, e denjë dhe e aftë si proletariati i lavdishëm i Komunës së Parisit dhe i Revolucionit të madh Socialist të Totorit, dërrmuat pushtuesit dhe shkatërruat pushtetin e borgjezisë dhe të feudalëve. Kështu në krye dhe së bashku me popullin, të lidhur me të si mishi me thoin, ju ngritët pushtetin popullor. Prandaj më 8 Nëntor, kur zemrat e popullit rrahin për Partinë, ato rrahin njëkohësisht edhe për ju, shokë punëtorë, sepse ju, gjatë këtyre 20 vjetëve, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste, keni korrujt suksese të mëdha, të cilat, në të kaluarën nuk mund të arriheshin kurrë. Populli dhe klasa jonë

punëtore janë bërë shembuj guximi, heroizmi, durimi e pjekurie edhe për popuj të tjerë.

Në një kohë kaq të shkurtër Partia jonë, në krye të popullit, e ndryshoi krejtësisht faqen e atdheut. Pothuajse nga hiçi, ne tani kemi një atdhe që lulëzon, me një industri e bujqësi të përparuar. Në vendin tonë janë zhvilluar shumë arsimi dhe kultura, nuk ka më padituri, vuajtje, varfëri dhe sëmundje si në të kaluarën; populli rron i lirë e i gjëzuar, se ai luftoi për këtë ditë, derdhi gjak dhe me zotësinë, pjekurinë e mençurinë e tij ndërtoi socializmin, krijoi mirëqenien për veten e tij. Kjo u arrit në radhë të parë sepse populli është vetë në fuqi dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste. Për të arritur këto ditë të lumtura u deshën me të vërtetë shumë sakrifica, u derdh gjaku i mijëra dëshmorëve, që bëri të rilindë populli shqiptar. Ata që ranë në këtë luftë të madhe çlirimtare nuk do të vdesin kurrë, po do të kujtohen me respekt brez pas brezi, sepse gjaku i tyre është në themelin e Shqipërisë së re. Të gjitha këto populli i bëri për veten e tij dhe jo për të tjerët. Këtë ai e sheh, prandaj punon e dërsitet dhe kurrë nuk lodhet, përkundrazi sa më shumë punon, aq më tepër merr forca për të ndërtuar e për të prodhuar.

Kjo forcë e madhe që e shtyn popullin shqiptar kurdoherë përpara qëndron në besimin e patundur që ai ka te Partia e tij e lavdishme, që e udhëheq kurdoherë drejt. Partia nuk i tha popullit se të mirat do të krijohen pa djersë dhe pa mundime, se në punën tonë për ndërtimin e socializmit nuk do të kemi të bëjmë me armiq të egër, të panumërt, të jashtëm e të brendshëm.

Përkundrazi, Partia i tregoi popullit realitetin dhe me parullat realiste të saj dhe në unitet të çeliktë me të, ai u mobilizua i téri dhe ecën përpara në ndërtimin e Shqipërisë së re, duke dërrmuar armiqëtë e komplotistët e jashtëm e të brendshëm.

Një popull i vogël si ky yni, me punën e qëndrimet e tij heroike, ka fituar admirimin dhe respektin e popujve në botë. Ju, naftëtarët, keni qenë në radhët e para të luftës për çlirim dhe të përpjekjeve për ndërtimin e socializmit. Ata që janë më të kaluar në moshë dhe kanë punuar këtu para dhe pas Çlirimt, e dinë fare mirë se ç'përpjekje janë dashur për ndërtimin e qytetit tuaj të naftës, të kantiereve, uzinave e distilerive, me sa armiq të jashtëm e të brendshëm është dashur të luftohet, për shkak se ata kërkonin t'i sabotonin këto ndërtime. Por të gjitha orvatjet dhe komplotet e tyre ne i kemi thyer.

Sa e vlefshme ka qenë dhc është nafta për vendin tonë të gjithë ne e kemi të qartë. Pa të ne do të kishim mbetur si peshku pa ujë. Ju, naftëtarët, të udhëhequr nga direktivat e Partisë, ngritet këto kantiere dhe bëtë që atdheut jo vetëm të mos i mungojë për asnje ditë nafta, por prodhimi i saj të shtohet nga viti në vit. Tani nxjerrja e naftës nuk është më një privilegji i Qytetit «Stalin». Sot janë krijuar edhe qendra të tjera të naftës. Ju, punëtorë, inxhinierë dhe gjeologë të naftës, me vrullin e madh, mençurinë dhe zotësinë tuaj, i dhatë atdheut fusha e burime të reja nafte, që do të rritin prodhimin e saj dhe begatinë e popullit tonë. Kjo është një vepër për t'u lavdëruar dhe për të cilën Partia e populli ju janë mirënjosës. Prandaj në emër të KQ

të Partisë dhe të Qeverisë ju përshëndes nga zemra dhe ju uroj që, si kurdoherë, edhe gjatë vitit të parë të pesëvjeçarit të tretë ju të plotësoni e të tejkaloni detyrat!

Partia i ka kushtuar një kujdes të veçantë nxjerrjes së naftës. Tani këtu punon një numër i madh kuadrosh, midis të cilëve disa anëtarë të Plenomit të Komitetit Qendror, këtu ka nga inxhinierët më të mirë të vendit tonë për të qenë afër jush në çdo moment, për t'ju ndihmuar më shumë në çdo sektor, me qëllim që edhe plani të realizohet, por edhejeta juaj e përditshmë të bëhet më e mirë e më e bukur. Ja, unë shoh tani se ky shesh, ku jemi mbledhur, është zgjeruar e është zbuluar, por edhe me popull është mbushur plot e përplot. Kjo është një gjë shumë e mirë. Nga ana tjetër edhe këtu, në qytetin tuaj, janë ngritur shumë shtëpi e pallate të bukura dhe s'ka dyshim që në të ardhshmen qytetet e naftës do të bëhen akoma më të bukura.

Partia ka vënë dhe do të vërë në duart tuaja mjete e makineri moderne, si për të shtuar prodhimin, ashtu edhe për të lehtësuar punën, që të keni kohë për të mësuar dhe për t'u çlodhur. Ligji kryesor i Partisë është që çdo gjë të bëhet për të mirën e popullit, për përmirësimin e jetës së tij. Por Partia na mëson gjithashtu që këto mundësi që na janë krijuar, këto makineri e pajisje që kemi, t'i shfrytëzojmë në maksimum. Ju duhet t'i ruani e t'i zhvilloni edhe më tej cilësitë e larta të klasës punëtore, disiplinën e hekurt në punë, ndershmërinë dhe ruajtjen e pasurisë socialiste, vullnetin për të mësuar. Në këto drejtime, ju, naftëtarët,

ashtu siç keni qenë deri më sot, të bëheni shembull e flamur për të gjithë punonjësit e Shqipërisë. Por si kudo, edhe këtu nuk përjashtohet që të mos ketë një rëz pa të meta.

Detyra e Partisë është që të ndihmojë se cilin nga ne, që, kur gabon, ta shohë drejt në sy gabimin, të marrë masa të korrigojhet dhe të ecë përpara. Kështu kanë vepruar Partia dhe klasa jonë punëtore dhe kështu do të veprojnë ato edhe në të ardhshmen. Ky është një nga faktorët e rëndësishëm të përparimit tonë. Partia jonë nuk i lë të kalojnë punët në rrugë tjetër, ndryshe e merr lumi popullin. Pse Partia punon drejt, në rrugën marksiste-leniniste, prandaj jeta e popullit tonë çdo vit përmirësohet, dyqanet janë plot, çmimet ulen vazhdimisht. Kjo ndodh se klasa punëtore në miniera, në uzina, në fabrika e kantiere dhe fshatarësia në kooperativat bujqësore, e kanë kuptuar drejt vijën e Partisë, e kanë zbatuar dhe e zbatojnë drejt atë, prandaj planet tona jo vetëm realizohen, por edhe tejkalojen në sasi dhe në cilësi.

Ne nuk do të zgjerojmë vetëm prodhimin e naftës, për të cilën po punojnë punëtorët dhe inxhinierët tanë që na premtojnë se do të zbulojnë fusha të reja nafte, por rëndësi ka edhe çështja e zhvillimit të miëtejshëm të gjithë industrisë sonë të rëndë.

Gjer tani të gjitha degët e minierave tona kanë ecur përpara dhe po zhvillohen. Ky është një sektor me rëndësi të madhe për gjithë ekonominë tonë edhe për të ardhshmen, sepse zhvillimi i minierave të qymyrit, naftës, bakrit, kromit, jo vetëm që i kanë sjellë shumë të mira popullit tonë, por ato janë një bazë e madhe

mbështetëse që pesëvjeçarin e ardhshëm të bëhen hapa më të mëdhenj përpëra.

Ju keni dijeni për zbulimin e përv zhvillimin e minierave tona të hekur-nikelit. Nga hekuri ne do të nxjerrim edhe çelik. Gjithashtu po bëhen zbulime edhe për minerale të tjera. Në të ardhshmen këto minerale do të përpunohen në vendin tonë, ashtu siç përpunojmë tanë naftën. Jashtë detyrave të pesëvjeçarit, në Gjegjan të Kukësit, janë zbuluar shtresa të rëndësishme të mineralit të bakrit. Atje mendojmë që, me mundësitet dhe me mjetet tona, të ngremë një fabrikë përpërunimin e bakrit.

Shokët drejtues të naftës më thanë se edhe ju, duke zbatuar direktivat e Partisë, materialet që ndodhen në vend i keni grumbulluar dhe me to keni bërë të shtohet kapaciteti i uzinës, i distilerisë etj. Kjo është një punë për t'u lavdëruar, por te ju ka rezerva të tjera, me të cilat mund të bëni edhe më shumë.

Pra, duke rikuperuar të tilla materiale në vend, do të bëhet edhe fabrika e përpunimit të bakrit në Gjegjan pa ardhur asnje material nga jashtë. Në të ardhshmen do të zgjerohen uzinat tona të përpunimit, por objekti më i rëndësishëm është ndërtimi i metalurgjisë së hekurit. Natyrisht, për ngritjen e këtij objekti në Elbasan do të na ndihmojë RP e Kinës..

Nuk dua të numëroj të gjitha veprat që do të ndërtohen në këtë pesëvjeçar se do të zgjatesha, po dua t'ju them se këtu afér do të ndërtohet një kombinat i ri tekstilesh, ku do të punojnë rrëth 6 000 veta, ndër të cilët shumica gra. Shumë nga gratë tuaja pas ca kohe do të futen në këtë kombinat. Kjo është një

gjë shumë e mirë se puna është nder, lavdi, mirëqenie, shëndet dhe grave tona trimëresha nuk u është trembur kurrë syri nga puna.

Midis objekteve të shumta që parashikon ky pesëvjeçar do të ndërtohen edhe uzinat për prodhimin e plehrave kimike, që do të ndihmojnë shumë për përparimin e bujqësisë. Rëndësi të madhe ka çështja që t'i jepen popullit më shumë prodhime bujqësore e blegtorale si bukë, mish, gjalpë, qumësht etj.

Duhet thënë se edhe bujqësia jonë ka bërë përparime të mëdha. Në saje të vijës së drejtë të Partisë, asgjë nuk i ka munguar popullit, ndërsa ka vende të demokracisë popullore të Evropës që, me gjithëse janë më të përparuara se ne, por nga politika jo e drejtë ekonomike që ndjekin, në tregjet e tyre ka mungesa në mish e vaj. Në këto vende plehra kimike ka shumë më tepër se te ne, por është fakt se mungesa të tillë janë vërtetuar. Prandaj të gjitha këto përparime që ne kemi arritur në bujqësinë tonë e në sektorët e tjerë janë rezultat i politikës së drejtë ekonomike të Partisë, e cila po ia ndryshon faqen dita-ditës Shqipërisë. Kur t'i sigurojmë bujqësisë edhe plehra kimike, atëherë prodhimet bujqësore do të janë më të shumta,jeta e popullit do të bëhet më e begatshme. Këtë begati do ta krijojnë me duart e tyre të arta klasa jonë punëtore dhe fshatarësia punonjëse.

Të gjitha ato që ka parashikuar në planet e saj Partia do të bëhen medoemos, për këtë nuk ka asnje dyshim, por puna është që ato të realizohen sa më shpejt dhe që të plotësohet kjo, kërkohet që të gjithë të punojmë e të prodrojmë sa më mirë, të mësojmë sa

më shumë, se vendi ynë ka nevojë të madhe për një-rëz të mësuar, për inteligjencën e vet të dalë nga radhët e klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse. Prandaj kudo duhet të bëhen përpjekje për të mësuar, për të përvetësuar shkencën, teknikën, agroteknikën, se pa dituri nuk mund të ecet përpara.

Ja, për shembull, nafta pa gjeologë nuk mund të zbulohet. Ne kemi preqatitur tani mjaft gjeologë, me gjithëkëtë ata janë akoma të paktë. Partia ka menduar me kohë për preqatitjen e kuadrove. Këtij qëllimi i shërbejnë hapja e universitetit dhe e instituteve të larta në vendin tonë, që tani i ndjekin me mijëra studentë.

Unë jam shumë i gjëzuar që edhe midis jush ka një shumicë të madhe punëtorësh që ndjekin me kujdes shkollat dhe kurset e ditës e të mbrëmjes. Kjo është një gjë shumë e mirë për atdheun, për Partinë dhe për vetë ju. Sa më i mësuar të jesh, aq më pak do të lodhesh në punë, aq më shumë do të prodhosh, aq më tepër do të nderohesh, aq më i lumtur do të jetosh. Të gjitha këto shkojnë zinxhir. Prandaj të gjithë të mësojnë, kudo të ndiqen shkollat dhe kurset që ka hapur Partia. Në të vërtetë të punosh e njëkohësisht të ndjekësh shkollën është mjaft e vështirë, por kjo është një detyrë që duhet kryer. Kurdoherë do të punojmë dhe do të mësojmë se tërëjeta është punë dhe mësim, këto na nxjerrin në dritë, na shtojnë begatinë dhe forcën e Partisë e të popullit tonë.

Pastaj, pasi foli për zhvillimin e disa ngjarjeve politike ndërkombëtare, shoku Enver Hoxha tha:

Ne nuk kemi qenë dakord me N. Hrushovin edhe për çështjen e Stalinit, emrin e të cilit e mban qyteti

juaj. Vërejtjet, kritikat dhe pikëpamjet tona ia thamë hapur, ashtu si na kanë mësuar Lenini dhe Partia Bolshevike. Megjithatë trupin e J. V. Stalinit, që luftoi me aq rreptësi e konsekuencë kundër imperializmit dhe armiqve të marksizëm-leninizmit, revisionisti Hrushov e hoqi nga Mauzoleumi i Sheshit të Kuq, e dogji dhe e futi në baltë, por vepra e Stalinit kurrë nuk do të vdesë, sepse i gjithë njerëzimi nuk do ta harrojë atë në shekuj, për sa ka bërë ai për çlirimin e popujve. J. V. Stalini ndoqi me besnikëri të madhe mësimet e Leninit si nxënës besnik i tij. Le të flasë sa të dojë Nikita Hrushovi që kërkon të mohojë meritat e mëdha të J. V. Stalinit. Faktet historike nuk mund të errësohen.

Nikita Hrushovi, duke sulmuar botërisht në Kongresin XXII Partinë tonë, komplotoi përsëri hapur kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër unititetit të saj. Në vend që mosmarrëveshjet midis dy partive tona të zgjidheshin në mbledhje të rregullta të përfaqësuesve të të gjitha partive, ai i bëri të njohura botërisht. Ai përdori tribunën e Kongresit XXII të PK të BS dhe i vuri të gjitha partitë e tjera në një gjendje të vështirë, por nuk i bëri mirë llogaritë, sepse 34 parti nuk e sulmuan Partinë tonë.

Pushkën kundër nesh e shkruhu i pari Hrushovi, prandaj ai le të presë tanë topat e Partisë sonë, por në rrugën marksiste-leniniste, për probleme parimore, që kanë një rëndësi të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare. N. Hrushovi doli i pari botërisht, pra ai është shkaktari i këtij debati të hapur, ai është shkaktari i çarjes së unititetit të kampit socialist, ai shkeli Deklarat-

tën e Moskës. Është e natyrshme që në këto kushte Partia jonë do të mbrohej, prandaj e tha fjalën e vet dhe fjala e Partisë së Punës të Shqipërisë do të shkojë kudo dhe do të bëjë efektin e duhur në mos menjëherë, më vonë. Koha do të punojë për ne, se e drejta është me ne. Këtë e shohim edhe në popullin tonë, i cili u solidarizua plotësisht me vijën e drejtë të Partisë sonë.

Tani ne jemi të rrethuar nga të katër anët nga imperialistë e revisionistë, por jemi të fortë. Në shekullin e triumfit të marksizëm-leninizmit nuk mund të ketë izolim ideologjik. Në radhë të parë, Shqipëria ka një Parti dhe një popull si çeliku, ne mbajmë në njëren dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, populli shqiptar është i armatosur mirë si politikisht ashtu edhe ushtarakisht. Ushtria jonë e lavdishme është edukuar nga Partia me një frymë të lartë patriotizmi, me traditat e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, me idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit, me gatishmëri të plotë për sakrificën e fundit, për të mbrojtur lirinë dhe paravësinë e atdheut, të fituar me gjakun e gjyshërve e të stërgjyshërve tanë, që luftuan në shekuj për këtë ditë të lumtura që gëzojmë sot. Ne kemi Armën e fuqishme dhe besnikë të Sigurimit të Shtetit që qëndron vigjilente dhe zbulon çdo komplot që kurdisin armiqtë kundër atdheut tonë. Organet e Sigurimit të Shtetit të lidhura ngushtë me popullin kanë bërë të dështojë çdo orvatje e armiqve dhe kështu do të ndodhë kurdoherë.

Nga ana tjetër, çdo qytetar i Republikës që ka pushkë, ta fshijë e ta ruajë të pastër. Të rritni vazhdimisht vigjilencën revolucionare, se kjo është një pu-

shkë më e madhe dhe më e mprehtë kundër armiqve. Prandaj hapni sytë kundër të gjithë atyre që kërkojnë të dëmtojnë atdheun, popullin, Partinë.

Ne nuk jemi vetëm, revolucionarët dhe popujt në botë janë me ne. Këto situata janë të rënda, por ato nuk e trembin popullin tonë. Pastaj kjo është një vështirësi e përkohshme që ne do ta kapërcejmë me sukses si kurdoherë.

Të punojmë pa u lodhur që të realizojmë e të tejkalojmë planet tona ekonomike. Pra të punojmë më me vrull e besim për të ardhshmen e lumtur të popullit. Vështirësi ekonomike kemi pasur dhe do të kemi se janë vështirësi të rritjes, të cilat ne do t'i kapërcejmë e çdo vit ekonomia jonë do të ecë përpara. Garanci për këtë janë Partia dhe populli ynë heroik.

Duhet kuptuar se Partia ka mbajtur qëndrim të drejtë ndaj njerëzve që kanë gabuar dhe kështu do të vazhdojë edhe në të ardhshmen. Ajo ka qenë e pamëshirshme kundër atyre armiqve, që kanë tradhtuar interesat e popullit dhe të atdheut. Partia këtyre njerëzve u ka dalë borxhit. Në rast se disa njerëzve u ngrihet mendja dhe, nga këto që po bën Hrushovi me pasuesit e tij, presin të bëhet katrahurë në Shqipëri e të vijnë miqtë e tyre të përtejkufijve, u themi le të mendohen mirë. Atyre që në këto situata ngrenë veshët, dome-thënë reaksionarëve, u themi: «Mos u eksitoni zotërinj, por ulni kokën dhe shkoni në punë, mos vini veten në rrrezik». Këtë këshillë ua bëjmë për të mirën e tyre, sepse ne nuk mund të lejojmë që ca reaksionarë të dëmtojnë interesat e popullit, kjo nuk do të ndodhë kurrë dhe davaja e tyre është e humbur. Prandaj le të

ecin ndershmërisht. Ju e dini se ka nga këta njerëz që u gabuan gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e më vonë, po pastaj janë ndrequr. Kjo është një gjë shumë e mirë për ta dhe këtë e bëri vija e drejtë e Partisë. Partia do ta kryejë detyrën e vet ndaj tyre si gjithnjë, ajo është e drejtë edhe me ata që bëjnë kthesën, sepse drejtësia që mbron Partia e ka bërë atë të fitojë kurdoherë.

Të dashur shokë naftëtarë, unë e ndiej veten të lumtur dhe shumë të gjuar që ndodhem midis jush, sepse, kur vjen midis punëtorëve, midis popullit, merr forca të reja. Ju uroj nga zemra shëndet të mirë dhe punë të mbarë për lumturinë e popullit, për lulëzimin e atdheut, për lavdinë e Partisë sonë! Të jeni të bindur se sukseset tona në të ardhshmen do të jenë akoma më të mëdha se gjer më sot. Me besim të patundur, pra, në çështjen tonë të madhe, me besim të patundur te Partia jonë e shtrenjtë, ju, shokë naftëtarë, të jeni kurdoherë në ballë dhe shembull për realizimin e detyrave që ju ka vënë përpara Partia!

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë!

Rrofshin naftëtarët tanë!

Rrofshin punonjësit, rinia dhe pionierët e qytetit që mban emrin e të pavdekshmit J. V. Stalin!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

ASHTU SI ËSHTË POPULLI I DREJTË, I FORTË DHE I PAPERKULUR, ASIITU ËSHTË EDHE PARTIA

*Nga fjala në mitingun spontan me popullin
e qytetit të Beratit*

10 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ju falënderoj nga zemra për entuziazmin dhe për dashurinë e madhe që ju po manifestoni për Partinë tonë heroike të Punës, e cila qëndron e fortë dhe e çeliktë si mali i Tomorit. Populli heroik shqiptar, i papërkulur në shekuj, u ka bërë ballë rrebesheve të shumta dhe më së fundi, nën udhëheqjen e Partisë fitoi lirinë dhe tani po ndërton me sukses socializmin. Forca e Partisë sonë qëndron te ju, shokë e shoqe, qëndron te populli ynë. Ashtu si është populli i drejtë, i fortë dhe i papërkulur, ashtu është edhe Partia e drejtë, e fortë dhe e papërkulur. Këto virtute të larta të popullit tonë janë bërë edhe virtytet e Partisë. Prandaj Shqipëria, dikur vend i robëruar, me një popull të varfër e të mjeruar, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë, doli në dritë.

Partia jonë, pararoja e klasës punëtore, këto ditë mbushi 20 vjet jetë. Ajo, në krye të popullit dhe bashkë me të, brenda këtyre viteve, bëri që në Shqipëri të arrihen fitore, të cilat nuk ishin arritur gjatë shekujve.

Partia e Punës e Shqipërisë është partia e komunistëve shqiptarë, është një parti marksiste-leniniste, që udhëhiqet nga ideologjia e klasës punëtore, që vuri në programin e vet dhe luftoi qysh në ditët e para të krijimit të saj për çlirimin e popullit nga pushtuesit e nga tradhtarët dhe për ndërtimin e jetës së lumtur për popullin. Partia jonë i zbaton me besnikëri parimet marksiste-leniniste që përfaqësojnë dëshirat dhe aspiratat më të mira të popullit. Prandaj ne korrëm këto suksese dhe në të ardhshmen fitoret tona do të jenë akoma më të mëdha.

Guximi dhe trimëria e popullit tonë kanë ekzistuar në shekuj, populli shqiptar kurdoherë ka luftuar me heroizëm për liri, tokë dhe dritë, ai ka derdhur rrëke gjaku kundër pushtuesve të ndryshëm, po asnjeherë s'ka fituar lirinë e vërtetë, sepse nuk kishte një udhëheqje të tillë të shëndoshë, me një moral e ideo- logji të pastër dhe me qëllime fisnike, siç është tanë Partia e Punës. Që kur u themelua Partia shpërthyen, me një forcë më të madhe, guximi dhe trimëria e popullit tonë. Partia është trashëgimtarja e denjë e tradi- tave më të mira të popullit tonë. Ajo eci në traditat e mëdha të stërgjyshërve tanë, të cilat i pasuroi me eksperiencën e madhe të luftës së proletariatit botëror, ndoqi shembullin e komunarëve heroikë të Parisit e të Revolucionit të madh të bolshevikëve, prandaj fitoi.

Gjatë Luftës Nacionallirimtare në programin e

Partisë sonë ishte shkruar lufta për çlirimin e atdheut, për t'i dhënë lirinë popullit, për ta sjellë këtë në fuqi me kryengritje të armatosur, për vendosjen e pushtetit popullor me anën e të cilit ai do të kryente reforma të mëdha politike, shoqërore dhe ekonomike, që do t'i jepnin mundësi vendit të përparonte, të ngrihej mirëqenia e popullit dhe niveli i tij arsimor e kulturor. Këtë program Partia jonë e zbatoi me vendosmëri. Për atë, i gjithë populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, luftoi në gërxhe e në male, për atë edhe këtu në Beratin tuaj e në Skraparin heroik filluan përpjekjet e para kundër pushtuesve dhe bandave tradhtare. Ju e mbani mend mirë se si vërsuleshin partizanët tanë mbi ushtarët e Italisë fashiste dhe të Gjermanisë naziste, si luftonte në ballë Zylystar Veleshnja dhe si binin heroikisht partizanët për çlirimin e atdheut dhe të popullit tonë.

Sakrificat e mëdha të Luftës Nacionalçlirimtare nuk shkuan dëm. Me gjakun e heronjve të kësaj lufte u ngrit Shqipëria e re. Armiqtë që nuk ia duan të mirën vendit tonë, do të thyejnë kurdoherë kokën, se pse Shqipëria e re rron në shekullin e leninizmit dhe gjithmonë do të triumfojë, pavarësisht se imperialistët amerikanë e partnerët e tyre, revisionistët e Beogradit dhe Nikita Hrushovi që kanë tradhtuar rrugën e lavdishme të Leninit, tani janë ngritur të tërë kundër një partie dhe një populli të vogël. Por populli dhe Partia jonë nuk janë as të vegjël, as të vetëm. Me ne janë popujt e Bashkimit Sovjetik dhe komunistët e vërtetë sovjetikë, populli dhe komunistët e Kinës, popujt dhe komunistët revolucionarë të të gjithë botës. Armiqtë tanë janë vëtëm disa grupe, ashtu siç ishin në kohën e

Luftës Nacionalçlirimtare në vendin tonë organizatat tradhtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», të cilat nuk kishin asnjë bazë në popull, sepse ky ishte i lidhur shumë ngushtë vetëm me Partinë Komuniste.

Revisionistët si Titoja, Hrushovi dhe ata që i pasojnë, janë vetëm një sëmundje e përkohshme në trupin e shëndoshë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Këtë sëmundje do ta mposhtë me siguri vala e furishme e marksizëm-leninizmit, ashtu siç ka mposhtur edhe në të kaluarën të gjithë armiqtë dhe tradhtarët. Karl Marks kur filloi luftën e tij për çlirimin e proletariatit ishte fare i vetëm kundër kuçedrës kapitaliste që sundonte atëherë në të gjithë botën. Manjatët e imperializmit dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit qeshnin në atë kohë me idetë e Karl Marksit, por ato qysh atëherë fituan, vazhdimisht po fitojnë, dhe sot kanë triumfuar edhe në Shqipërinë tonë të vogël, populli i së cilës tanë është bërë zot i fateve të veta.

Pas 17 vjet çlirimi, atdheu ynë, Shqipëria, sot ka ndryshuar aq shumë saqë s'njihet fare, është mbushur me fabrika e uzina, me hidrocentrale e kombinate, janë ndërtuar e po ndërtohen hekurudha të reja, fshati ynë po ndryshon dita-ditës pamjen, është bërë në përgjithësi kolektivizimi i bujqësisë, vendi po përparon në çdo drejtim, janë hapur në çdo fshat shkolla fillore, me qindra shkolla 7-vjeçare e të mesme, sot kemi universitetin tonë dhe disa institute të larta. Brenda këtyre 17 vjetëve anembanë vendit është përhapur shkëndija e diturisë, për të cilën kanë luftuar e kanë dhënë jetën patriotët tanë më të shquar, ndër të cilët edhe poeti i madh i Rilindjes, Naim Frashëri. Populli ynë, me men-

çurinë dhe me zotësinë e tij, nën udhëheqjen e Partisë, e përtëriti në shkallë më të lartë atdheun e vet, e lulëzoi Shqipërinë.

Në saje të politikës së drejtë të Partisë, populli ynë u dha fund mjerimit dhe varfërisë, papunësisë, shtypjes dhe paditurisë, padrejtësive politike dhe shoqërore, privilegjeve që gjëzonin një grusht bejlerësh dhe agallarësh. Shikoni tani si është vendi ynë. Kudo dyqanet janë plot me mish, gjalpjë, vaj, oriz, sheqer, me fruta e zarzavate, ndërsa një gjë e tillë nuk ndodh në vendet socialiste të Evropës. Në vendin tonë është krijuar kjo situatë se vija e Partisë dhe e Qeverisë sonë është e drejtë. Partia i ka treguar popullit kurdoherë rrugën e drejtë dhe ai ka parë se të gjitha ato që i ka thënë Partia janë bërë.

Plani ynë i tretë pesëvjeçar është një plan madhështor, i cili do të realizohet patjetër. Më kot mundohet Nikita Hrushovi të na bëjë bllokadë, më kot ai na preu kreditë dhe tërhoqi specialistët, plani ynë është i siguruar, objektet dhe zërat që janë parashikuar do të realizohen me siguri.

Ju jeni në dijeni të atyre që ne do të ngremë gjatë pesëvjeçarit të tretë. Edhe në qytetin tuaj do të ngrihen mjaft objekte me rëndësi e mbi të gjitha kombinatë i ri i tekstileve. Kështu do të ndërtohen vepra të mëdha edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Gjatë këtij pesëvjeçari edhe kooperativave bujqësore të rrëthit tuaj do t'u jepet një ndihmë e madhe nga ana e shtetit, sepse do të ngrihen dy uzina të mëdha për prodhimin e plehrave kimike, të cilat do të bëjnë që të rriten mjaft prodhimet bujqësore e blegtoreale.

Për realizimin me sukses të planit tonë të tretë pesëvjeçar ne do të kemi edhe ndihmën e madhe inter-nacionaliste të Republikës Popullore të Kinës. Tani s'mbetet gjë tjetër veçse të punojmë pa u lодhur për realizimin e planit. Popullin tonë as lufta, as puna nuk e kanë trembur. Puna në vendin tonë çdo ditë e më shumë është bërë një çështje nderi, sepse gjithsecili e di se punon për veten e tij, për mirëqenien e popullit, për lulëzimin e atdheut, për sigurimin dhe lumturinë e brezave të ardhshëm.

Por që të realizohet plani, vëllezër dhe motra, është e domosdoshme të mësojmë, të fitojmë dituri, të përvetësojmë shkencën, sepse kështu do të mundim të vëmë në lëvizje dhe të shfrytëzojmë për të mirën tonë fabrikat dhe kombinatet e reja që do të ndërtojmë, uzinat dhe hidrocentralet, bujqësinë tonë moderne. Dhe kushtet për të mësuar çdo ditë e më shumë Partia i ka krijuar për të gjithë.

Prandaj me besim të madh e të patundur të ecim përpara se koha punon për ne, për socializmin. Partia jonë marksiste-leniniste do ta mbrojë gjer në fund ideologjinë tonë fitimtare, sepse kështu ajo ka mbrojtur jetën e popullit dhe pavarësinë e atdheut të vet. Në rast se ajo nuk do të vepronë kështu, atëherë të gjitha fitoret tona do të vihesin në rrrezik.

Pastaj shoku Enver Hoxha u ndal në veprimtarinë revizioniste të N. Hrushovit dhe të grüpit të tij. Ai theksoi pikëpamjet dhe qëndrimet antimarksiste të kë-tij gruji ndaj imperializmit, hodhi poshtë tezat revi-zioniste mbi luftën dhe paqen, mbi rrugët e kalimit për në socializëm; vuri në dukje drejtësinë e vijës së Par-

tisë sonë, qëndrimet e saj marksiste në Mbledhjen e Bukureshit të në atë të Moskës etj. Në vazhdim të fjalës së vet, shoku Enver Hoxha tha:

Vellezër dhe motra, kur Partia jonë ndërmori këtë luftë të lavdishme kundër grupit të N. Hrushovit, vuri në plan të parë interesat e larta të popullit tonë, lirinë dhe pavarësinë e atdheut, interesat e larta të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Për këtë qëndrim që mban Partia jonë, Komiteti Qendror ka menduar thellë, i ka peshuar vështirësitë që do të hasim nga ky qëndrim dhe zgjodhi rrugën e drejtë në të cilën duhet të ecim ne dhe gjithë komunistët e botës, rrugë e cila do të na çojë kurdoherë në fitoren mbi armiqtë e marksizëm-lenismit. Udhëheqja jonë asgjë nuk u ka fshehur as Partisë, as popullit. Çdo problem, çdo situatë, ashtu si i shpjegohet Partisë, i shpjegohet edhe popullit. Situatat që i krijoj N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë lëvizjes komuniste ndërkombëtare janë nga më të vështirat. Sa situata të vështira i janë krijuar gjatë jetës së saj Partisë sonë, por ajo i ka kapërcyer të gjitha me sukses dhe kurdoherë ka korrur fitore mbi çdo armik.

Bashkë me punën e palodhur e të organizuar mirë për realizimin e planit, i madh e i vogël të vëmë të gjitha forcat dhe dituritë tona për t'i dhënë popullit më shumë. Populli duhet ta dijë se sot vendi ynë ka një ushtri të fortë e të lavdishme për t'i bërë ballë çdo vështirësie, pastaj në vendin tonë edhe vetë populli është i armatosur për të ruajtur fitoret e tij. Si ndodh që në Shqipëri t'i jepen armë popullit? Kjo ndodh se populli është i lidhur ngushtë me Partinë, pran-

daj ai është i armatosur dhe qëndron vigjilent e i gatshëm.

Partia na mëson ta kritikojmë cilindo që bën gabim, sepse kështu evitohen të metat dhe dobësitë. Atyre që përsëritin gabimet duhet t'u hiqet mirë veshi, kurse ata që i përsëritin vazhdimisht e me qëllim gabimet, pasi të merren masa ndëshkimore, në rast se nuk e pushojnë veprimtarinë keqbërëse, atëherë t'i jepen gjyqit. Njerëzit e ligj që dëmtojnë interesat e popullit të mos kenë shpresë se tani u erdhi koha, të mos mendojnë se mbaroi Partia. Jo, Partia kurrë nuk do të mbarojë, por do të rrojë në shekuj. Partia, i këshillon këta njerëz të mos prekin interesat e popullit, ndryshe do ta kenë keq me të.

Partia jonë ka mbajtur një qëndrim të drejtë ndaj njerëzve që kanë gabuar dhe nuk ka bërë keq. Ajo u ka sinjalizuar këtyre njerëzve të heqin dorë nga rruga e gabuar se kështu është e mira e tyre. Por, nëse disa nuk kanë hequr dorë nga rruga e tyre armiqësore, ne u themi se e kanë kot që mbajnë veshët ngritur. Më mirë për ta do të ishte të shikojnë punën, të punojnë ndershmërisht. Këtë këshillë le ta futin në xhep, se kushdo që të prekë interesat e popullit do të marrë dënimin e merituar, do të japë llogari përfajet që do të bëjë. Çdo njeri që nuk mendon drejt duhet ta dijë se forca e Partisë dhe e popullit është e pamposhtur.

Shokë dhe vëllezër, nëna dhe motra të Beratit, me besim të patundur dhe me dashuri të madhe për Partinë, me besim në forcat tuaja, t'i përvisheni punës kudo për të realizuar planet, t'u jepni ekonomisë dhe popu-

llit edhe më shumë nga sa është parashikuar. Kjo është vija e Partisë dhe kjo vijë do të realizohet me sukses.

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i rrethit të Beratit dhe i Skraparit heroik!

Rrofshin rinia dhe pionierët tanë!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PARTIA JONË KA LUFTUAR ME VENDOSMËRI DIIE KURDOHERË KA FITUAR

*Nga fjala me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe
të ekonomisë të rrëthit të Beratit*

10 nëntor 1961

Në këto momente që po kalojmë është e natyrshme që populli dhe Partia jonë janë të interesuar t'u flasësh si po zhvillohen ngjarjet në botë. Por përpëra se t'ju flas, dëshiroj t'ju uroj juve dhe nëpërmjet jush gjithë komunistët dhe popullin e rrëthit të Beratit, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë së tij, të lavdishme, si edhe për punën dhe luftën që ata bëjnë për mbrojtjen dhe zbatimin e vijës së Partisë!

Qenia anëtar i Partisë është kurdoherë nderi më i madh për çdo punonjës të vendit tonë, por çdo vit që kalon bëhet edhe më e qartë se të jesh anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë është një gjë e lavdishme, se për 20 vjet me radhë Partia jonë, domethënë komunistët shqiptarë, kanë luftuar me heroizëm, kanë bërë sakrificat më të mëdha. Ata nuk kanë marrë parasysh as vdekjen për të udhëhequr popullin në fitoren e ma-

dhe të çlirimit dhe të ndërtimit të socializmit. Prandaj komunistët, me luftën dhe me punën e tyre, kanë ngri-tur lart e kurdoherë më lart emrin e Partisë së tyre, kanë krijuar në popull një besim të pakufishëm për të. Fjala e Partisë për popullin tonë është ligj, ajo nuk bëhet dy. Kjo është një nga fitoret më të mëdha që i kanë sjellë atdheut tonë përpjekjet dhe lufta e drejtë e komunistëve. Populli ynë e do Partinë e vet, e ruan, e mbron atë, ndjek me besim të madh çdo porosi të saj, ecën me besnikëri në rrugën e drejtë të saj, duke kaluar nga fitorja në fitore në luftë me vështirësitë dhe me pengesat e shumta që i kanë dalë ose që i kanë krijuar armiqtë e tij të egër.

Rruga e përshkuar nga Partia jonë gjatë këtyre 20 vjetëve është plot suksese, të cilat janë arritur me luftëra dhe me përpjekje të mëdha. Të kujtojmë të kaluarën, shokë, duke filluar që nga Lufta Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit, më vonë kundër imperialistëve anglezë, amerikanë, kundër komplotistëve revisionistë jugosllavë, e tani së fundi kundër revisionistit Nikita Hrushov dhe pasuesve të tij dhe do të shohim se Partia jonë për asnjë moment nuk ka lëvizur dhe nuk është larguar nga rruga e saj e drejtë marksiste-leniniste, por ka luf-tuar me vendosmëri dhe ka fituar kurdoherë. Lufta e drejtë e Partisë sonë është çmuar dhe çmohet lart jo vetëm nga populli shqiptar, por edhe jashtë vendit tonë, nga lëvizja komuniste ndërkombëtare dhe nga gjithë njerëzit përparimtarë e liridashës. Edhe veprat e lartë e Partisë sonë, ndërtimi i Shqipërisë së re socialistë, çmohet shumë nga popujt e botës, sepse ata e

shohin se si një vend dhe një popull i vogël u bëjnë ballë me heroizëm vështirësive e pengesave të shumta të armiqve të ndryshëm.

Fitoret e mëdha historike, që kemi korrur gjatë këtyre 20 vjetëve, duhet të na nxitin, për të hedhur hapa më të mëdhenj përpara. Këta hapa do të jenë akoma më të sigurt, sepse Partia jonë, ashtu si gjermani, do të vazhdojë të zbatojë me besnikëri në shekuj doktrinën tonë fitimtare të marksizëm-leninizmit, do të luftojë për mbrojtjen dhe për pastërtinë e saj kundër të gjitha valëve dhe furtunave. Partinë tonë, asgjë nuk do ta tundë nga rruga e vet, nga vija e drejtë mark-siste-leniniste.

Unë dua t'ju uroj gjithashtu edhe për përpjekjet dhe për sukseset tuaja në realizimin e planit. Punonjësit e rrethit të Beratit i kanë kryer me nder detyrat që u janë vënë përpara nga Kongresi IV i Partisë. Ju e keni realizuar planin si dhjetëmuajor dhe unë kam bindjen e plotë se planin vjetor jo vetëm do ta realizoni, por edhe do ta tejkaloni në shumë sektorë. Suksese të mëdha keni korrur edhe në bujqësi. Marrja e flamurit, si meritë për realizimin e planeve, jo vetëm ju nderon, por tregon edhe punën e mirë që kanë bërë organizata e Partisë dhe punonjësit e rrethit tuaj si në bujqësi, ashtu edhe në sektorët e tjera të ekonomisë. Në qoftë se ju në bujqësi nuk keni arritur të realizoni dot rendimentet e parashikuara për disa kultura, kjo ka ndodhur nga kushtet atmosferike dhe jo sepse nuk keni punuar. Komiteti Qendror është në dijeni se kudo në rrethin tuaj janë bërë të gjitha përpjekjet, se ashtu si kudo në vendin tonë, edhe në rrethin e Beratit, është

pnuar më mirë se çdo vit tjetër, vetëm se thatësira e madhe na ka dëmtuar mjaft edhe këtu në Berat, sidomos në drithëra dhe në duhan. Unë vizitova edhe ekspozitën bujqësore të këtij rrëthi, e cila është organizuar mjaft mirë dhe paraqit qartë sukseset tuaja të mëdha në bujqësi. Atje pashë me kënaqësi të madhe sukseset e një radhë kooperativash bujqësore që, me gjithë kushtet atmosferike jo të favorshme, kanë arritur rezultate shumë të mira në punën e tyre. Duhet vënë në dukje se ato kanë pnuar më mirë nga disa kooperativa të tjera.

Pra, bashkë me urimet dhe lëvdatat për të gjithë ata që kanë pnuar mirë dhe kanë kryer detyrën, mund të bëhet edhe ndonjë kritikë ndaj atyre që detyrën nuk e kanë realizuar plotësisht. Sidoqoftë ne shikojmë se rrëthi i Beratit do ta realizojë me sukses planin e prodhimit dhe të grumbullimit të pambukut, bile shumë më mirë se çdo vit tjetër, si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Pambuku ka një rëndësi të madhe për vendin tonë jo vetëm se me prodhimin e tij kooperativistët tanë sigurojnë të ardhura të mira, por edhe për të ardhshmen e vendit tonë. Ja, këtu në rrëthim e Beratit do të ndërtohet një kombinat i ri tekstilesh, që do të jetë një vepër e madhe e pesëvjeçarit të tretë, ku do të punojnë me mijëra punëtorë që në shumicë do të jenë gra dhe vajza. Ne mund të themi pa frikë se tanë në kooperativat bujqësore të rrëthit të Beratit është krijuar tradita e pambukut, kooperativistët e njohin mirë këtë bimë me leverdi të madhe dhe e duan. Kështu, kur të ngrihet kombinati i ri i tekstileve, kooperativat bujqësore të rrëthit tuaj nuk do të kënaqen me 8 ose

me 10 kv për hektar, po do të luftojnë të marrin 20 dhe 25 kv.

Në rrithin e Beratit ne shikojmë edhe një zhvillim të mirë të frutikulturës, si të siqve, të vreshtave, të ullinjve e të zarzavateve, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin e popullit tonë dhe për eksport.

Midis sukseseve të tjera në rrithin tuaj është edhe realizimi i planit për hapjen e tokave të reja, për pyllëzimet dhe ujitjen. Kjo është një shenjë e mirë që tregon se fshatarët, kooperativat tuaja bujqësore e kanë kuptuar rëndësinë që ka realizimi i këtyre detyrave. Kooperativistët e kanë të qartë rëndësinë që ka zgjerimi i sipërfaqeve të ujitshme, për shtimin e prodhimeve bujqësore, megjithatë ata duhet të bëjnë akoma përpjekje sidomos për ndërtimin e hauzeve, dhe të mos presin që këto të bëhen vetëm me ndihmën materiale dhe financiare të shtetit, por të ndërtohen edhe me vetë forcat e kooperativës.

Po ta marrim çështjen në përgjithësi duhet thënë se edhe blektoria ka pasur rritje. Vetëm tani duhet luftuar për shtimin e rendimenteve, për shtimin e prodhimit të qumshtit. Në rrithin e Beratit ka kooperativa që kanë arritur suksese të mira. Ato tani le të bëhen shembull edhe për të tjerat. Ja në ekspozitë pashë që një lopë jepte 5 000 litra qumësht në vit, prandaj në këtë drejtim duhet të bëhen akoma përpjekje si në fusha, ashtu edhe në zonat malore. Për këtë, orientimi që ka dhënë Partia për zhvillimin e bujqësisë e të blektorisë edhe në kushtet e zonave malore duhet të zbatohet me përpikëri.

Mbi të gjitha kini parasysh çështjen e drithërave.

Të luftohet nga të gjithë që të prodhojmë më shumë drithëra, të zbatojmë mirë agroteknikën e këtyre kulturnave që nga zgjedhja e farës, plugimet e thella, mbjelljet në kohë, shërbimet kulturore, korrjet në kushte të mira e pa firo e gjer te depozitimi dhe te ruajtja e tyre me kujdes e pa humbje. Ne duhet të kemi parasysh të prodhojmë sa më shumë drithëra në vend, sepse gjer tani kemi sjellë shumë drithëra nga jashtë.

Tani ne kemi krijuar edhe rezerva drithi, që nuk i kishim ëndërruar kurrë. Megjithatë, duke pasur parasysh situatën, të luftojmë, që të prodhojmë sa më shumë drithëra buke dhe t'i administrojmë mirë fondet që kemi.

Partia dhe Qeveria, në çdo situatë nuk e kanë lënë popullin asnjëherë pa bukë dhe nuk kanë lejuar që te ne të krijohet panik si në Bullgari, Çekoslovakia ose në ndonjë vend tjetër të demokracisë popullore të Evropës. Këtë e themi jo se i kemi inat ata, ne kurrë nuk ua duam të keqen popujve vëllezër të vendeve socialistë, se jemi internacionalistë, por në vendet e demokracisë popullore të Evropës ka filluar një farë paniku dhe njerëzit sulen që të blejnë çdo gjë që ka në treg. Në Çekoslovakia, për shembull, bukën kanë filluar ta japid me kupona, kurse në treg nuk gjen as artikuj të domosdoshëm ushqimorë, sepse i kanë ngritur njerëzit, të cilët kanë frikë nga lufta. Kjo gjendje atje është krijuar se udhëheqja nuk i ka preqatitur realisht popullin dhe partinë me zhvillimin e situatave, por vazhdimit u ka thënë se do të kemi paqe.

N. Hrushovi ndjek taktika të gabuara, ai hidhte në

popull bomba fjalësh, u thoshte njerëzve të flinin «të qetë», ndërsa tani e ktheu menjëherë pllakën, thotë se «lufta është në prag të derës». Natyrisht, kjo taktikë shkakton deziluzione në popull dhe është pasojë e asaj që Hrushovi dhe njerëzit e grupit të tij nuk e mësojnë popullin të kuptojë se imperializmi është armiku kryesor që pregetitet të hedhë botën në luftë, prandaj ne duhet t'i qëndrojmë përballë dhe t'ia imponojmë paqen. Po paqja nuk arrihet me rrugët dhe me metodat e N. Hrushovit, i cili me politikën që ndjek i lë kohë imperializmit amerikan të armatoset vetë e të armatosë edhe miqtë e tij, e në radhë të parë, imperialistët gjermanë dhe, kur të gjejë kohën e përshtatshme, të shpërthejë luftën.

Prandaj populli duhet të pregetitet realisht, të sqarohet drejt ashtu siç janë situatat. Këtë thotë Partia jonë dhe kështu ka vepruar. Si rrjedhim në vendin tonë ka një qartësi të tillë politike sa populli punon i qetë pa u trubulluar aspak, pa panik e me besim të patundur në forcat e tij.

Ashtu si në rrethin tuaj, në të gjithë Shqipërinë situata paraqitet e mirë. Ne shikojmë me gëzim se si realizohen dhe tejkalohen planet tona në fushën e industrisë dhe të gjitha shenjat tregojnë se plani industrial këtë vit, që është viti i parë i këtij pesëvjeçari, do të tejkalohet. Në bujqësi viti ka qenë në përgjithësi prodhues, me përjashtim të drithërave dhe të duhanit ku jemi dëmtuar ca. Prandaj, na vihet detyrë që tani të kryhen sa më mirë të gjitha punimet bujqësore të stinës dhe në të gjitha kooperativat bujqësore kjo detyrë të merret mirë në dorë nga Partia dhe punët të

kryhen si duhet në bazë të kërkesave agroteknike. Të bëhen përpjekje, gjithashtu, që brenda këtyre dy muajve që mbeten, plani në të gjithë sektorët të tejkaloherë. Realizimi e sidomos tejkalimi i planit të këtij viti ka rëndësi shumë të madhe, sepse do të hyjmë në vitin e dytë të pesëvjeçarit të tretë me suksese më të mëdha. Plani i vitit të dytë të këtij pesëvjeçari është akoma më i ngjeshur dhe kështu ndodh nga viti në vit. Ne kemi besim të plotë se pesëvjeçari i tretë do të realizohet, objektet e parashikuara në të do të ndërtohen, sepse janë siguruar nga të gjitha drejtimet, si nga ana financiare, me punëtorë e specialistë, ashtu edhe nga ana materiale. Përveç këtyre, në planin tonë janë futur edhe objekte të reja, shumë të rëndësishme, lidhur me ndryshimet që u shkaktuan nga prerja e kredive.

Sa ditë që kalojnë aq të mira sjellin për popullin tonë sidomos në zbulimin e mineraleve. Partia dhe Qeveria jonë mendojnë se do t'ia arrijnë qëllimit që brenda vitit të ardhshëm të disponojmë të dhëna konkrete për rezervat e mineraleve të reja. Pas kësaj do të mendohet për ngritjen e disa veprave që kanë të bëjnë me këto minerale, për zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Antimarksisti Hrushov mendoi se, duke hequr specialistët sovjetikë, Shqipëria do të mbetej si peshku pa ujë. Po Shqipëria nuk mbeti ashtu si dëshironte ai, përkundrazi gjeologët tanë kanë mundur të zbulojnë disa minerale që, duhet ta themi hapur, gjeologët sovjetikë na i kanë fshehur. N. Hrushovi me njerëzit e tij, kanë menduar edhe këtë: në rast se shqiptarët nuk gjunjëzohen, atëherë e rrëzojmë këtë udhëheqje dhe

vendosim një udhëheqje tonën, domethënë revizioniste, pastaj brenda vitit ia japim këto të dhëna udhëheqjes së re shqiptare dhe trumbetojmë «mrekullirat» që do të bëjë ajo me këto zbulime. Taktikat e revizionistëve ne i njohim. Po planet dhe taktikat e tyre nuk pijnë ujë.

Plani i tretë pesëvjeçar, pra, do të ketë shumë sihariqe, prandaj të mobilizojmë forcat, të organizojmë mirë punën dhe të krijojmë mundësi për t'i shfrytëzuar këto sihariqe dhe pastaj të hedhim hapa më të mëdhenj përpara, për t'i dhënë popullit më shumë të mira materiale dhe ne jemi të sigurt se, nën udhëheqjen e Partisë dhe në saje të vijës së saj të drejtë, populli ynë do të arrijë suksese më të mëdha në të ardhshmen në të gjitha drejtimet.

Ja, edhe në këtë vit plot me vështirësi, ç'entuziazëm e mobilizim të madh ka në të gjithë punonjësit. Asnjeri nuk pret nga importi si dy vjet më parë. Tani i gjithë populli është ngritur kudo në këmbë dhe, për çdo aksion e punë që ndërmerrët, secili përpinqet ia kryejë sa më mirë detyrën e ngarkuar me mjetet që ka. Të gjitha këto përpjekje të punonjësve bëhen me qëllim që të prodrojmë sa më shumë gjëra në vend e të sjellim sa më pak nga jashtë. Kështu secili mendon, vret mendjen se si të ekonomizojë sa më shumë dhe të forcojë ekonominë e vendit.

Por, në këtë drejtim, ne kemi akoma shumë punë për të bërë, prandaj të punojmë me këtë vrull të madh që vlon te ne. Të mos harrojmë asnjëherë se armiku kryesor për ne vazhdon të jetë imperializmi, në radhë të parë imperializmi amerikan dhe aleatët e tij. Por nga armiqjtë tanë të rrezikshëm është edhe revizionizmi

modern, revizionizmi jugosllav dhe N. Hrushovi me grupin e tij.

Pasi foli për disa çështje parimore të lëvizjes komuniste e punëtore revolucionare, për disa ngjarje të situatës ndërkontaktare dhe për veprimtarinë antimarksiste të grüpuit të Hrushovit, shoku Enver Hoxha tha:

Jemi duke kaluar momente shumë të vështira, jo vetëm ne, por e gjithë lëvizja komuniste ndërkontaktare e në radhë të parë Bashkimi Sovjetik. Prandaj në këto momente të kryejmë detyrën tonë të madhe në drejtim të ruajtjes së kufijve të shenjtë të atdheut tonë. Po të kryejmë këtë detyrë, atëherë ne kemi kryer edhe detyrën tonë internacionliste për mbrojtjen e lëvizjes komuniste ndërkontaktare. Kur ne vëmë në dukje rrugën antimarksiste që ndjek N. Hrushovi dhe krimet që bën ai kundër popullit shqiptar, t'i bëjmë të qartë popullit tonë se këto veprime e qëndrime të ulëta ndaj nesh i bën udhëheqja e tanishme e partisë dhe e shtetit të Bashkimit Sovjetik. Po ka ndonjë që mund të thotë: Përse nuk ngrihet populli sovjetik, pse nuk ngrihen komunistët sovjetikë? Kjo s'është e lehtë. Dihet se sëmundja vjen menjëherë, por me një ditë ajo nuk shërohet.

Të kemi gjithashtu parasysh edhe çështjen e vigjilencës. Aktualisht kundër vendit tonë ekziston rrethimi i dysfishtë imperialisto-revisionist, të cilat ne i rezistojmë dhe shikoni ç'entuziazëm i zjarrtë është ngjallur në masat e Partisë dhe të popullit tonë. Kjo gjendje tregon sa drejt i kanë kuptuar ato situatat, si iu përgjigjen atyre, si janë lidhur si mishi me koskën midis tyre dhe si janë mobilizuar plotësisht për realizimin e

planeve. Kjo tregon pjekurinë politike dhe ideologjike të Partisë dhe të popullit tonë, kjo tregon gjithashtu edhe ngritjen e aftësive të punonjësve të vendit tonë. Prandaj të shumëfishojmë forcat që ta mbyllim me rezultate të mira planin e këtij viti në të gjithë sektorët e ekonomisë. Realizimi i planit luan një rol vendimtar në forcimin dhe në lulëzimin e atdheut tonë socialist, por bashkë me këtë të jemi gjithashtu edhe vigjilentë e të gatshëm për ruajtjen gjer në fund të fitoreve të arritura dhe për garantimin e së ardhshmes së lumtur të popullit tonë.

Në këto situata të vështira, armiqtë e paqes, imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revisionistët, mund të shkaktojnë incidente në kufi me qëllim që të na shqetësojnë e të na mbajnë në ethe. Por ata i bëjnë gabim llogaritë, nervat ne i kemi të fortë, prandaj edhe jemi të qetë, sepse kufijtë e atdheut tonë janë të siguruar, ushtria jonë vigjëlon e ruan, ajo është e pajisur dhe në gatishmëri të plotë për mbrojtjen e atdheut. Po ashtu vigjilente është edhe Arma e Sigurimit të Shtetit, e cila kurdoherë ka korru suksese në shpartallimin e planeve të armiqve, sepse ka qenë gjithnjë afër popullit, të cilin e mbajmë të armatosur. I tillë është besimi që ka Partia te populli ynë, i tillë është uniteti midis tyre, ai është i pathyeshëm. Prandaj e kanë kot armiqtë tanë që orvaten të na shqetësojnë, të na përçajnë. Ata përpiken dhe futin në vendin tonë diversantë e provokatorë, por tashmë ne kemi një eksperiencë të gjatë 20-vjeçare në luftën kundër armiqve dhe dimë t'i zbulojmë, t'i kapim dhe t'u presim kokën.

Prandaj situata e vendit tonë çdo muaj e çdo vit do të zhvillohet vazhdimesht në favorin tonë.

Situatat që ka krijuar Hrushovi me grupin e tij nuk mund të themi se janë të lehta. Këto situata janë të vështira për gjithë botën, por veçanërisht për vendin tonë. Prandaj, duke pasur mirë parasysh këtë gjë, ne duhet të mobilizojmë forcat, për t'i përballuar me sukses dhe për të dalë fitimtarë. Në ballë të vështirësive të jenë komunistët, në mënyrë që populli të shohë që ata, si kurdoherë, edhe në kohët e këqija, janë në ballë të situatës, për të kapërcyer çdo vështirësi. Komunistët duhet të jenë kurdoherë në luftë me rehatinë. Komunistët të jenë gjithashtu në ballë të luftës edhe për realizimin e planit. Ata duhet të jenë më vigjilente nga të gjithë në luftën kundër armiqve dhe, në rast se i kërcënohenet atdheut rreziku më i vogël, të jcnë ata të parët për t'i dalë zot.

Pra, të vështira janë situatat shokë, por ne asnjëherë nuk u jemi trembur këtyre situatave, sepse jemi në rrugë të drejtë, prandaj kemi besim se do t'i përballojmë ato dhe do të fitojmë, sigurisht ashtu si thamë edhe më lart që Partia të jetë kurdoherë vigjilente, të mbajë lart fryshtë revolucionare në radhët e veta dhe me këtë fryshtë të marrë çdo vendim e të zgjidhë çdo detyrë. Në këtë fryshtë të bëhen kritika dhe autokritika brenda në Parti për të luftuar të metat dhe gabimet. Edhe sikur e ashpër të jetë një kritikë e drejtë, ai që kritikohet, po të gjykojë drejt, do të shikojë se ajo i bën mirë. Kështu mendon ai që është marksist i vërtetë dhe mendon me baza revolucionare. Kur shkoi një herë në Çekoslovaki N. Hrushovi dhe po shëtiste me Zap-

tockin, e kritikoi këtë, përse kishin bërë në Pragë një monument aq të madh për Stalinin. Kur Zapotocki iu përgjigj se PK e Çekoslovakisë do t'i bëjë Stalinit një monument tjetër, akoma më të madh, atëherë Hrushovi i tha se Stalini e kishte kritikuar rëndë Zapotockin. Ky iu përgjigj se është e vërtetë që Stalini e kishte kritikuar rëndë, po me këtë ai e kishte ndrequr, e kishte korrigjuar dhe theksoi se Hrushovi kishte harruar edhe anën tjetër që Stalini më pas edhe e kishte lavdëruar. Prandaj, përfundoi Zapotocki, «kritika e drejtë e Stalinit mua më ka bërë mirë».

Prandaj, shokë dhe shoqe, ta mbajmë kurdoherë lart fryshtësi revolucionare në Parti dhe do të shohim se akoma më shumë do të kalitet Partia jonë. Gjërat e vogla, si grindjet, mosmarrëveshjet etj., kur në një organizatë-bazë partie nuk mbahet lart fryshtësi revolucionare, zënë rrënje dhe pastaj hapin plagë, por, kur fryshtësi revolucionare qëndron në një nivel të lartë, atëherë këto rrënje zbulohen dhe thahen. Në rast se komunistët bëhen të qartë, ata do të shohin interesat e mëdha të popullit dhe të atdheut, realizimin e planit, rritjen e vigjilencës, mbrojtjen e atdheut dhe të popullit nga armiqjtë, mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga armiqjtë e tërbuar të socializmit, nga imperialistët dhe revisionistët modernë. Me një fryshtësi tillë revolucionare do të kalitet Partia dhe do të zhduken shfaqjet e huaja, nuk do të ketë më thashetheme, që janë pasoja të situatave të apatisë, kur lulëzojnë mbeturinat mikroborgjeze. Një fryshtësi tillë, pra, duhet zhvilluar në Parti dhe kjo do të bëhet, sepse ne kemi një Parti revolucionare me vijën e drejtë dhe me hovin revolu-

cionar të së cilës do të realizojmë me sukses të gjitha detyrat që na përkasin, në lëmin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të rrojë dhe të forcohet Partia jonë e Punës!

Botohet për herë të parë me shkurt time, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE ECIM PERPARA PA E HEQUR PUSHKEN NGA KRAHU

*Fjala në mitingun me popullin e lokalitetit të Tërpanit
të rrëthit të Beratit*

11 nëntor 1961

Të dashur shokë të lokalitetit të Tërpanit,

Ju falënderoj nga zemra që jeni mbledhur këtu për të dëgjuar fjalët, që, sipas porosisë së Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë, do t'ju transmetoj juve, popullit heroik të kësaj krahine, që keni qenë dhe do të jeni kurdoherë një bazë e fortë mbështetjeje e Partisë, juve që keni qëndruar dhe keni luftuar me heroizëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Të gjithë ju, burra e gra, të rinj e të reja, në ato kohë të vështira rrokët armët dhe u hodhët në radhët e luftës për çlirimin e atdheut dhe të popullit. Prandaj në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë ju sjell me këtë rast pëershëndetjet më të nxehta!

Populli shqiptar mburret me popullin patriot të krahinës suaj, që ka qenë në radhët e para të Luftës Nacionalçlirimtare. Ju e kuptuat sa të rënda ishin ato kohëra, kur luhej fati i atdheut, kur populli ose duhej

të rronte i skllavëruar nën zgjedhën e fashistëve italianni, gjermanë, si dhe të bejlerëve, të agallarëve dhe të gjithë shfrytëzuesve të vendit, ose duhej të ngrihej për t'i shporrur qafe këto shushunja dhe të merrte vetë në dorë fatet e tij. Populli ynë e kuptoi drejt vijën e Partisë se vetëm me luftë të vendosur do të siguronte përveç lirisë dhe pavarësisë së vendit, edhe një jetë më të mirë. Edhe ju, populli i kësaj krahine, e kuptuat dhe e zbatuat mirë vijën e Partisë, se në zemrën tuaj vlonët etja për liri, ishit trima e të zgjuar dhe shikonit qartë e larg, gjë që bëri të shpartalloheshin italianët dhe gjermanët, ballistët, zogistët dhe të gjithë reaksionarët.

Atëherë ne nuk kishim as armë, po ato ua morëm armiqve. Partizanët tanë, siç e mbani mend, ishin të zhveshur e të zbatohur, herë hanin dhe herë vuanin nga uria, por kur vinin në shtëpitë tuaja dyert i gjenin kurdoherë të hapura dhe ua jepnit me gjithë zemër ato që kishit. Por tani ato çeta partizane, pa ushqime e pa veshmbathje, ata luftëtarë me nga një fishek në trastë, janë bërë një ushtri moderne, e disiplinuar, e stërvitur dhe e pajisur me mjetet më të reja të luftës. Kjo ushtri nuk fle në dafinat e fitoreve të së kaluarës, po qëndron vigjilente dhe ruan të mos preken nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm fitoret historike të popullit tonë dhe i jep kështu mundësi popullit të punojë dhe të jetojë i qetë e i lumtur që bijtë, nipërit e stërnipërit tanë të rrojnë brez pas brezi në bollëk dhe në lumturi. Ushtria jonë komandohet nga oficerë të zotë, bijtë tuaj, bij të këtij populli, dikur të varfër e të pamësuar, të cilët më vonë i mësoi Partia.

Dëshira jonë është që të mos ketë luftë, vuajtje

e mjerime, megjithatë Partia dhe populli mbajnë në këmbë një ushtri të fortë si çeliku dhe i tërë populli është ushtar. Kjo e bën vendin tonë të pamposhtur. Pastaj Shqipëria nuk është vetëm, ajo ka miq si Kinën e madhe 700 milionëshe, popujt e vendeve socialiste e shumë miq të tjerë kudo në botë dhe kush prek Shqipërinë ai ka prekur edhe miqtë tanë. Prandaj armiqtë e vendit tonë, imperialistët, revisionistët jugosllavë ose monarko-fashistët grekë, duhet të mendohen mirë para se ta prekin Shqipërinë, sepse, po ta bëjnë këtë, do të gjejnë vdekjen, jo vetëm nga ushtria jonë, jo vetëm nga populli ynë heroik, por edhe nga të gjithë miqtë tanë.

Prandaj, motra dhe vëllezër, situata zhvillohet në favorin tonë, sepse ne jemi më të fortë nga armiqtë tanë. Para luftës ne kemi qenë të varfër e të mjeruar, sepse mbi kurrizin tonë rronin bejlerët, agallarët, kurse tani vendi ynë është zhvilluar ekonomikisht, është pasuruar dhe është bërë më i bukur. Tani ne kemi plot fabrika e kombinate që prodhojnë për popullin. Dihet se përpara Çlirimit çdo gjë sillej nga jashtë, natyrisht ato i paguanim shtrenjtë. Ju, fshatarët, me vështirësi të madhe mund të blenit një metër basme ose pak sheqer. Kurse tani shumë artikuj të nevojshëm i bëjmë në vend, në fabrikat tona, ku prodhohet me makineri të reja moderne, ku punojnë djemtë dhe vajzat tuaja, që dikur nuk dinin as të lexonin e as të shkruanin, kurse tani janë bërë njerëz të mësuar, që drejtojnë me zotësi fabrika dhe makina shumë të komplikuara.

Bejlerët dhe agallarët thoshin për djemtë dhe për

vajzat tuaja se ata dinë vetëm të ruajnë lopët. Por ata vëtë, megjithëse hiqeshin të ditur e të zotë, në të vërtetë nuk kishin asnë farë zotësie e mençuria. Zotësia dhe mençuria janë te populli. Partia e ngriti popullin në luftën për dije dhe djemtë e vajzat e tij shkuan me dhjetëra mijëra në shkolla e me punën, me mendjen dhe me duart e tyre të arta po lulëzojnë atdheun. Populli është i zoti i mendjes, i krahut dhe i «gishtit» po ta dojë nevoja, kurse pasanikët dinin vetëm si të pasuroheshin, duke rrjepur e duke vjedhur popullin.

Brenda 17 vjetëve, populli iu përvesh punës për të ndërtuar jetën e tij të lumtur dhe i udhëhequr nga Partia ngriti vepra të mëdha, uzina, fabrika, hidrocentralë, hekurudha, thau këneta e ndërtoi kanale, prodhon më shumë misër, grurë, pambuk, duhan, panxhar, fruta, ka hapur miniera nga të katër anët dhe është duke hapur të tjera. Kudo në fshat e qytet po ndërtohen shkolla, spitale, pallate dhe shtëpi të reja banimi për popullin punonjës. E pse të mos punonte populli me këtë vrull? Mos vallë ai do të jetonte gjithmonë në kasolle e shtëpi të vogla?

Krahina juaj është malore, nuk është e pasur si në fusha, ku fshatarësia siguron më shumë prodhime. Po tani Shqipëria, është një familje e madhe socialiste ku një punon për të gjithë dhe të gjithë punojnë për një. Prandaj kur prodhon fusha e Myzeqesë, ajo e Beratit apo e Lushnjës, kanë edhe malësitë. Po edhe malësitë kanë detyrat e tyre për zhvillimin e ekonomisë, sidomos për zhvillimin e blektorisë, të frutikulturës, për zhvillimin e bletëve etj. Dhe në fakt edhe në krahanat malore, ashtu si edhe në tuajën ka përparime, po

duhet punuar akoma që përparimet të janë edhe më të mëdha. Shteti ka ndihmuar me kredi fshatarësinë e zonave malore dhe në të ardhshmen ai do ta ndihmojë edhe më tepër për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe të frutikulturës, sepse në këto drejtime mundësitet janë më të shumta.

Partia në periudhën që vjen do t'i kushtojë rëndësi të madhe zhvillimit të bujqësisë. Tani te ne janë krijuar kooperativa bujqësore gjer në malësitë dhe po jepin rezultate shumë të mira. Sidomos në zonat fushore janë hapur toka të reja, janë prishur gjerdhe dhe kudo punojnë traktorë. Bujqësia nuk është më ajo e vjetra. Po të ecnim si përpara, nuk do të prodhonim dot shumë, kurse tani ka metoda të reja pune edhe në bujqësi. Që t'i marrësh më shumë tokës, atë duhet ta punosh sipas mënyrave të reja, që pemët të jepin më shumë duhet t'i krasitësh, t'i punosh, t'i ujitësh e t'i plehërosh. Tani i kemi mundësitë që nga vreshtat dhe pemët çdo vit të marrim më shumë. Po, që të shtojmë prodhimet, ne duhet të mësojmë. Kështu duhet vepruar edhe për drithërat, pambukun etj. Brenda 4-5 vjetëve do të ndërtohen dy fabrika të mëdha për plehra kimike, sepse plehu organik është i pamjaftueshëm. Kështu prodhimet tona do të shtohen, pra buka, sheperi, orizi, pambuku do të bëhen më të lira, populli do të ketë më bollëk dhe këtë bollëk do ta krijojë me duart e tij, nën udhëheqjen e Partisë. Parti e popull të bashkuar janë të zotë të bëjnë mrekulli.

Në vendin tonë do të rritet vazhdimesht industria, e cila do të japë prodhime të reja për popullin, do të përmirësojë cilësinë e tyre dhe do të bëjë që të ulen

çmimet, të cilat te ne zbresin çdo vit, ndërsa në vendet kapitaliste ato ngrihen vazhdimisht. Në vendin tonë çmimi i bukës, i sheqerit, i këpucëve, i basmave dhe i trikotazheve çdo vit do të bëhet më i lirë. Kjo do të thotë se vlera e prodhimeve tuaja në të holla si e leshit, e qumshtit, e bagëtive, e frutave etj., do të rritet, domethënë ju të keni më shumë të ardhura, të bleni më shumë sende të nevojës së parë dhe vazhdimisht më të lira. Në këtë drejtim do të punojnë Partia dhe populli gjatë këtij pesëvjeçari.

Por që të ndërtojmë një të ardhshme më të lumtur duhet të mobilizohemi të gjithë në punë. Ju puna kurrë nuk ju ka trembur, po tani ne punojmë në kushte të tjera, punojmë për veten tonë, të lirë dhe të gjuar. Puna tani është nder, se pa të asgjë nuk krijohet. Prandaj i gjithë populli duhet të organizojë mirë punën kudo, në fushë e në malësi. Puna tani kërkon që të lodhim jo vetëm krahët, po edhe mendjen.

Prandaj bashkë me punën ne duhet edhe të mësojmë dhe jo vetëm të rintjtë e të rejat, po edhe ne më të moshuarit, të mësojmë ato mënyra të reja pune që na japid më shumë prodhime. Për këtë qëllim Partia dhe pushteti kanë hapur kudo shkolla të kulturës së përgjithshme dhe profesionale, si edhe kurse të shumta të çfarëdo lloji si për blektorinë, për bujqësinë, për frutikulturën etj. Prandaj rregullojeni kohën e punës dhe i ndiqni këto shkolla dhe kurse, që kështu të shkullet nga ndërgjegjja edhe ajo ndjenjë fanatizmi që ekziston te ndonjëri, sepse ka shfaqje të tillë që na pengojnë në punë, që na frenojnë të punojmë me hovin e duhur për zhvillimin e ekonomisë.

Partia jonë është një parti marksiste, parti e së resë që nuk plaket kurrë se radhët e saj mbushen me djemtë dhe vajzat e reja, prandaj ajo mbetet kurdoherë e re dhe punon e lufton që t'ia bëjë popullit jetën vazhdimisht më të mirë. Për këtë arsyе populli e do Partinë e tij me gjithë shpirt, sepse ajo e çlroi nga zgjedha e huaj dhe nga tradhtarët, të cilët në kohën e sundimit të tyre thoshin: «C'janë këta rrjepacakë që thonë se do të çlrojnë Shqipërinë, se do të mundin fuqitë e mëdha siç janë Italia dhe Gjermania?». Po fjalët e tyre i mori era dhe në Shqipëri ndodhi siç kishët thënë V. I. Lenini, se do të vijë koha që të varfërit do të fitojnë mbi të pasurit. Dhe kjo u realizua në vendin tonë, populli erdhi në fuqi dhe pasanikët i hodhëm në gropë nga ku nuk do t'i lëmë të ngrihen më kurrë, u shkatërrua forca e tyre politike dhe ekonomike, asnjeri s'ka besim te ata se e dinë ç'njerëz ishin, kurse çdo gjë që ka thënë Partia është bërë dhe do të bëhet me siguri.

Ne, komunistët dhe populli shqiptar, jemi të fortë. Të fortë janë gjithashtu popujt e vendeve socialiste në krahasim me armiqjtë imperialistë e revizionistë. Ne jemi luftëtarë të vendosur për paqe, kundër luftës. Luftën e duan vetëm kapitalistët dhe shërbëtorët e tyre. Njerëzit e pasur, siç ishte Ali bej Këlcyra, e duan luftën, sepse vetëm te lufta ata kanë shpresë të rimarrin fuqinë. Kapitalistët në të gjitha vendet e sidomos në SHBA e gjetkë preqatiten për një luftë të re. Por popujt luftojnë për paqen dhe nuk mbyllin sytë përpara gjendjes së krijuar. I gjithë populli ynë qëndron në gatishmëri për ta mbrojtur vendin nga çdo rrezik. Sikur

ndokush të shpallë luftën ne jemi të vendosur jo vetëm të mbrohem, por edhe t'i japim një mësim të mirë, ta mundim.

Prandaj ne, të luftojmë për paqen, por njëkohësisht të jemi edhe vigjilentë, domethënë të hapim sytë përpara armiqve, të cilët presin një ditë të trubullt, për të hedhur ndonjë parullë ose për të thënë ndonjë fjalë të keqe kundër pushtetit dhe Partisë. Populli duhet të jetë kurdoherë në këmbë për të mbrojtur Partinë, lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Por në këtë drejtim neve na dalin disa pengesa jo vetëm nga armiqtë, që i njohim mirë, imperialistët, monarko-fashistët grekë dhe revizionistët jugosllavë, po edhe nga ata që gjer dje i kishim miq.

Pastaj, pasi foli për veprimtarinë antimarksiste e revizioniste të N. Hrushovit dhe të grupit të tij, si dhe për qëndrimin e drejtë parimor, marksist-leninist, revolucionar të Partisë sonë në të gjitha çështjet, shoku Enver Hoxha tha:

Prandaj, me besim të patundur te marksizëm-leninizmi, të ecim përpara pa frikë dhe druajtje, pa e hequr pushkën nga krahu, të punojmë me të gjitha forcat që të prodhojmë sa më shumë të mira materiale për popullin se kështu do të triumfojë çështja e madhe e socializmit dhe e konunizmit.

Të dashur vëllezër dhe motra,

Punoni të qetë dhe mobilizohuni për realizimin e planeve për të mirën tuaj, për të mirën e atdheut tonë të dashur. Partia, të gjitha forcat, të gjithë zotësinë

dhe diturinë e saj i ka vënë e do t'i vërë në shërbim të popullit. Gjithçka, që ka vendosur Partia për t'u bërë, do të realizohet me sukses për të mirën tuaj, për të mirën e gjithë popullit tonë. Njëkohësisht ju duhet të qëndroni kurdoherë vigjilentë, domethënë të hapni sytë në çdo gjë, barutin ta mbani të thatë dhe pushkën të pastër. Duke vepruar kështu, medoemos çdo gjë do të shkojë mirë dhe drejt, ashtu si e do populli dhe Partia.

Partia është në çdo moment me ju, në zemrën tuaj, në shtëpitë, në fushat dhe arat. Shkonit te Partia për të zgjidhur çdo gjë që keni, me zemër të hapur, për gëzime dhe për halle. Vështirësitë dhe gëzimet tuaja janë vështirësi e gëzime edhe për Partinë. Partia e siguron popullin se për të do të ketë vetëm ditë të lumbur e të gëzuara. Çdo ditë, çdo muaj, çdo vit më shumë po ngrihet niveli i jetesës, po krijohet mirëqenia. Kështu ne kemi besim të plotë se socializmi do të fitojë dhe ne do të ecim edhe më përpara, drejt komunizmit, ashtu si e do populli ynë trim dhe heroik.

Të rrojë Partia e Punës e Shqipërisë që e udhëheq popullin në rrugën e socializmit, në rrugën e begatisë dhe të jetës së lumtur!

Të rrojë populli heroik shqiptar!

Të rrojë populli i lokalitetit të Tërpanit dhe i gjithë rrethit të Beratit!

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TE JEMI KURDOHERE ORGANIZATORE TE MIRE NE PUNEN E PARTISE DHE TE EKONOMISE

*Nga biseda në mbledhjen e byrosë së Komitetit
të Partisë të Rrethit të Përmetit*

11 nëntor 1961

Edhe në rrethin tuaj, si në të gjitha rrethet e tjera të vendit tonë është punuar mjaft mirë, gjë që ka sjellë rezultate të kënaqshme në zhvillimin e ekonomisë, sidomos në frutikulturë e në vitikulturë. Përmeti është një rreth i përshtatshëm për këto kultura, prandaj vazhdoni t'i zhvilloni, duke pasur kurdoherë parasysh të kultivoni llojet më të mira si të rrushit, ashtu edhe të pemëve të tjera. Pra mos luftoni vetëm për sasinë, por edhe për cilësinë.

Natyrisht problemi i drithërave duhet t'ju preoku pojë më shumë se çdo gjë tjetër. Këtyre t'u vini rëndësi, që të sigurojmë sa më shumë bukë. Sa të jetë e mundur i vini kujdes problemit të ujitjes. Planin për këtë çështje ju e keni realizuar, por ka rrethe që e kanë tejkaluar shumë, qoftë me hauze të mëdha apo të vogla, qoftë me ndërtim kanalesh. Prandaj mos u kënaqni me rezultatet që keni arritur gjer tanë, se thatësira në ven-

din tonë është një pengesë serioze, për të cilën duhen marrë masa. Prandaj, që ta luftojmë këtë të keqe, duhet të shfrytëzojmë çdo mjet e mundësi për ndërtim kanalesh, hauzesh, vijash etj. Në këtë drejtim duhet të mobilizoni mirë të gjitha forcat në fshat.

Me rëndësi, për shtimin e prodhimit të drithërave është edhe problemi i farërave. Kësaj çështjeje të madhe Maqo Çomoja nuk i vinte rëndësi. Ai ishte një megaloman, që në gojë kishte vetëm shifra dhe mburrje, megjithëse për këto çështje vazhdimisht i kishim hequr vërejtjen. Vetë rrethi juaj të punojë për sigurimin e farërave, për të cilat ju duhet të kujdeseni që nga mbjellja e parcelave e gjersa drithi të futet në hambar. Sa të jetë e mundur luftoni, për të siguruar sa më shumë farë të mirë dhe për këtë qëllim të organizoni një kontroll për grumbullimin, për ruajtjen dhe shpërndarjen e saj, sepse ashtu si të jetë fara, ashtu do të dalë edhe gruri ose misri. Prandaj, në këtë drejtim, të keni shumë kujdes.

Kujdes duhet të tregoni gjithashtu edhe për forcimin organizativ të kooperativave bujqësore. Të përpinqeni që të shtohen krerët e lopëve sidomos në kooperativat fushore. Në lugina ka mundësi t'u sigurohen atyre më shumë ushqime dhe silazh. Duhet t'ua bëni të ditur të gjithë kooperativistëve rëndësinë e tij, prandaj të bëhet ç'është e mundur që kudo të mbillen nga ato bimë që shërbejnë për silazh.

Mbani Partinë të pastër nga elementët kontrabandë. Njerëz jo të sigurt është më mirë të qëndrojnë jashtë sesa të futen në Parti dhe ta dobësojnë atë nga brenda. Në Parti të futen njerëz që kanë dhënë prova besnikë-

rie. Prandaj ka rëndësi të madhe pastrimi i Partisë nga elementët e dyshimit. Ata që tregohen të pakujdes- shëm në punë, Partia ka për detyrë t'i edukojë, kurse atyre që vihen në shërbim të të huajve t'u tregohet vendi. Po ta mbajmë Partinë të pastër ashtu si e kemi, do të jemi në gjendje të përballojmë çdo situatë, jo vetëm ato që na krijojnë armiqëtë e jashtëm, por të përballojmë edhe detyrat tona për ndërtimin e socializmit.

Partia jonë është e fortë. Forca e madhe e saj qëndron në lidhjet e ngushta me masat, në mobilizimin e përgjithshëm dhe në luftën për kapërcimin e vështirësive. Këtë Partia jonë e ka provuar gjatë gjithë jetës së saj, këtë e ka provuar edhe kohët e fundit kur marrëdhëniet tona u acaruan me grupin revisionist të N. Hrushovit dhe të miqve të tij në vendet e demokratisë populllore. Kjo është një fitore e madhe për Partinë se kemi të bëjmë me një grup revisionist, që ka arritur gjer në krye të shtetit e të partisë në BS. Partia dhe vendi ynë i vogël lidhjet kryesore dhe për të gjithë sektorët i kishte kryesisht me Bashkimin Sovjetik, për të cilin ka ushqyer një dashuri të madhe. Po të mos ishte e fortë dhe e kalitur Partia, brenda radhëve të saj, me situatën e krijuar, mund të ndodhnin edhe lëkundje. Por, me gjithë vështirësitë, asnjë lëkundje nuk u vërtetua në Partinë tonë. Ne mund të themi pa hezitim se vetëm një Liri Belishovë dhe një Koço Tashko tradhtuan, kurse në udhëheqje dhe në gjithë Partinë nuk ka dalë njeri që të shfaqë as dyshimin më të vogël.

Mund të thotë ndokush se si ndodhi kjo? Kjo ndodhi se udhëheqja e vuri vazhdimisht në dijeni Partinë

dhe e sqaroi për të gjitha çështjet, gjë që luajti një rol vendimtar. Asgjë nuk duhet mbajtur pa ua thënë organizatave-bazë të Partisë dhe masave të popullit. Shihni ç'konfuzion politik dhe ideologjik ka në partitë e tjera si në PK të BS, ashtu edhe në ato të vendeve të demokracisë popullore të Evropës. Sado të fshehta të mbahen mosmarrëvçeshjet tona në këto parti dhe t'u thuhet komunistëve vetëm me fjalë se «Partia e Punës e Shqipërisë ka devijuar dhe i ka hedhur baltë Bashkimit Sovjetik», ata do të bëjnë patjetër pyetje dhe do të thonë: «Pa na tregoni se në ç'drejtime ka shkarë kjo parti dhe ç'thotë ajo kundër BRSS?». Për shembull, në pozita të vështira u gjend Susllovi në aktivin e partisë në Leningrad, ku iu bënë me dhjetëra pyetje saqë nuk dinte si të dilte nga situata. Edhe udhëheqës të PK të Bullgarisë e patën shumë vështirë në aktivitet e partisë, saqë u detyruan të mbyllnin mbledhjet se nuk dinin ç'të bënин. Një situatë e tillë ndodh se ata nuk e informojnë drejt partinë dhe thonë gjëra që nuk i hanë anëtarët e partisë. Prandaj qëndrimi i udhëheqjes ndaj komunistëve duhet të jetë i drejtë, bile edhe popullit duhet t'i thuhet qartë çdo gjë, ashtu si ka vepruar kurdoherë Partia jonë.

Në këtë situatë të vështirë, që është krijuar për shkak të qëndrimit armiqësor të udhëheqjes sovjetike, Partia jonë u kalit edhe më shumë, populli u mobilizua totalisht për realizimin e planit të vitit të parë të pesë-vjeçarit të tretë në të gjithë sektorët, gjë që nuk është parë kurrë. Në industri plani do të realizohet dhe do të tejkalohet. Edhe në bujqësi është punuar më mirë se çdo herë tjetër. Në qoftë se në drithëra nuk kemi

realizuar rendimentet e parashikuara, sepse ka pasur edhe mungesa e gabime, në përgjithësi punonjësit e këtij sektori kanë punuar mirë. Viti bujqësor nuk ka qenë i mbarë për drithërat edhe për shkak të thatësirës, e cila na dëmtoi edhe duhanin. Në kulturat e tjera si në atë të pambukut, të panxharit etj., planin do ta realizojmë. Ullinjtë gjithashtu i kemi mirë. Ky vit ka qenë i mirë edhe për frutikulturën, kurse për blegtorenë ka qenë një vit mesatar. Pra në bujqësi mund të themi se ky vit ka qenë në përgjithësi një vit mesatar, më i mirë nga viti i kaluar.

Eshtë fakt se mobilizimi i punonjësve ndihmoi shumë në mbajtjen e nivelit të jetesës sipas parashikimeve të planit. Populli u furnizua në rregull, bile më me bollëk, pa qenë nevoja të nxirrnim nga rezervat shtetërore. Kudo ka pasur në sasitë e nevojshme bukë, mish, qumësht, gjalpjë, vaj e prodhime të tjera bujqësore e industriale. Ndërsa në disa vende të tjera socialiste janë krijuar trubullira të mëdha nga konfuzioni ideo-logjik dhe nga vështirësitet ekonomike. Në BS ka pasur vështirësi në realizimin e planeve, sidomos në sektorin e bujqësisë, ku Hrushovi trumbetonte me të madhe se do të bënte «mrekullira». Po është fakt se parashikimet e tij nuk u realizuan për arsyet e vijës së tij të gabuar ekonomike. Ne dimë se furnizimi i qyteteve të BS ka qenë shumë i paktë, prandaj në masë ka pasur pëshpëritje haptazi nëpër rrugë. Këtë na e thonë shokët tanë që janë atje dhe që e njohin mirë jetën e vendit. Këtë situatë e kemi parë me sytë tanë, kur kemi vizituar BS. Në një qytet, prej 45 mijë banorësh në Ukrainë, kishte dyqane bosh, pa fruta, pa zarzavate dhe pa

mish, bile edhe artikuj industrialë atje kishte shumë pak. N. Hrushovi e ngriti në plenum këtë çështje, kritikoi dhe shkarkoi nga puna shumë kuadro, por faji qëndron te vetë Hrushovi, i cili ka thënë fjalë të mëdha për bujqësinë dhe asgjë s'është realizuar.

Kështu ka ndodhur edhe në Bullgari, që është një vend i përparuar në bujqësi, ku gjatë një viti e gjysmë ka mungesë mishi për shkak të vijës së gabuar të Zhivkovit. Tani kanë filluar t'u japid punonjësve dhe bukë me kupona. Edhe gjalpi mungon në treg. Ne mendojmë se vendet socialiste të Evropës nuk janë aq ngushtë për bukë, por kjo situatë është shkaktuar si pasojë e rrugës së gabuar politike që ndjekin. Në këto vende është krijuar një gjendje paniku.

Vija e përpunuar nga N. Hrushovi me parullat pacifiste: «Nuk ka luftë», «imperializmit i kanë rënë dhëmbët», «do të bëhet gjithçka që them unë» etj., e vinte popullin në qetësi. Për të realizuar qëllimet e tij Hrushovi përdor taktika nga më të ndryshmet.

Te ne situata është krejtësisht ndryshe, sepse vija e Partisë sonë është e drejtë, ajo duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, e njeh konkretisht dhe realisht gjendjen dhe jo si na akuzojnë revizionistët se gjoja i kuptojmë situatat në mënyrë dogmatike. Hrushovi me shokë na këshillojnë t'i kuptojmë situatat si ata, në mënyrë revizioniste. Ai thotë: «Ne jemi më të fortë, prandaj s'ka ç'na bën imperializmi». Që ne jemi më të fortë këtë e dimë, por ne kemi parasysh edhe faktin se imperializmi nuk i ka hedhur armët, siç llomotit Hrushovi.

Le të marrim Kongresin XXII. Ky kongres do të shqyrtonte dhe do të aprovonte projektprogramin e

PK të BS sipas të cilit përcaktohej rruga për në komunizëm. Atëherë përse ky kongres merret me luftën kundër kultit të individit, kundër grupit «antiparti» dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë? Përse Hrushovi dhe pasuesit e tij e kalojnë në plan të dytë problemin themelor për të cilin u mblohd Kongresi XXII dhe tërheqin vërejtjen e gjithë komunistëve të botës në këto probleme që sipas deklaratave të bëra më parë gjoja janë zgjidhur, kur këto «vështirësi» na paskeshin qenë kapërcyer, dhe nuk qenkeshin më «probleme përtat»? Kjo tregon të kundërtën. Hrushovi i nxori përsëri në shesh këto çështje se janë problem i madh për të. Nuk është aspak e vërtetë, si deklaruan Hrushovi me shokë, se u kapërcye çështja e Stalinit. Çështja e Stalinit dhe vepra e tij nuk mund të kapërceheshin lehtë. Stalini ishte në krye të KQ të PK të BS për 30 vjet dhe gjatë kësaj kohe nën drejtimin e tij u ndërtua socializmi në BRSS, u ngrit industria socialiste, u bë kolektivizimi, revolucioni kulturor, u korr fitorja mbi fashizmin. Prandaj çështja e Stalinit rron dhe do të rrojë. Por N. Hrushovi e ngriti përsëri këtë problem në plan të brendshëm, për t'u thënë kundërshtarëve të tij të shumtë që kush vazhdon në rrugën «sektare» dhe «dogmatike» të shqiptarëve do ta pësojë më keq se ata. Kjo do të thotë se për Hrushovin situata brenda nuk është e qetë.

Megjithëse N. Hrushovi prej kaq vitesh po bërtet si tellalli se «jemi të fortë», se «imperialistëve u kanë rënë dhëmbët», asgjë konkrete nuk duket, imperialistët asnjë propozim të Bashkimit Sovjetik nuk kanë pranuar. Politika e jashtme e BRSS për shkak të vijës oportuniste

revisioniste të Hrushovit nuk ka pasur asnjë sukses, imperializmi vazhdon të armatoset, të pregetitet për luftë, kurse ai thotë se «do të kemi paqe». Dhe në fakt me gjithë llomotitjet për paqe të Hrushovit, nga të katër anët, kudo ku sundon imperializmi ka zjarre lufte. Në Algjeri po derdhet gjak, po kështu në Kongo, Angola, Laos, Oman etj. Këto vatra zjarri mund të çojnë botën në një luftë tjetër botërore.

Edhe politika e brendshme, sidomos politika ekonomike e grupit të N. Hrushovit ka bërë prapa, saqë ka vështirësi në furnizimin e popullsisë. Edhe në këtë drejtim politika e tij dështoi. Veç kësaj shihet se po ngrihen në poste të rëndësishme elementë të dobët. Një vijë e tillë e ndjekur nga Hrushovi ka tendencë të zbutë frymën revolucionare të kuadrove sovjetikë, të degjenerojë njerëzit.

Po Hrushovi nuk ndalet këtu. Ai ka një plan të tërë për përhapjen e ideologjisë borgjeze dhe të mënyrës së jetesës të vendeve kapitaliste në BS; tani me mijëra turistë e delegacione dalin nga Bashkimi Sovjetik jashtë. Vetëm në Itali vjet shkuan shumë grupe turistësh. Hrushovi ka arritur gjer aty që, për t'u thënë shteteve perëndimore se po afrohet me ta, në ekspositën sovjetike në Paris gjatë kësaj vere, gratë që shërbnin atje i kishin bërë si karnavale, të veshura me modën më ekstravagante të Parisit. Po pse qytetërim është ky? Ai e bën këtë për t'i treguar botës kapitaliste se është liberal dhe «ecën me kohën»!

Për të tërhequr vëmendjen e popullit dhe të komunistëve sovjetikë nga rruga e rrezikshme ku po i çon, ai pregetiti Kongresin XXII, në të cilin u orvat t'i japë

goditje Partisë sonë sikur ajo me «dogmatizmin» e saj përbën një rrezik të madh për botën, por që në të vërtetë via e saj e drejtë është një rrezik i madh për vijën e tij revizioniste. Por nuk jemi ne i vetmi rrezik për vijën revizioniste të N. Hrushovit dhe të grupit të tij. Nga pikëpamja e potencialit një rrezik të madh për të përbën PK e Kinçs, me në krye Mao Ce Dunin, që ndjek dhe zbaton një vijë të drejtë marksiste-leniniste.

Më poshtë, pasi vuri në dukje kundërshtimet e PPSH me grupin e N. Hrushovit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në këtë situatë ne duhet të mbajmë lart fryshtën revolucionare të Partisë sonë, të cilën e kemi të çeliktë dhe të pastër, kemi një popull që e do shumë Partinë dhe e kuption shumë mirë situatën. Këtë nuk e themi vetëm ne që jemi bijtë e tij dhe që me të drejtë mburrremi me popullin tonë. Në vendin tonë që nga njeriu më i zhvilluar e deri te ai më i thjeshti e kuptojnë si duhet situatën. Kjo është pasojë e punës së madhe të komunistëve shqiptarë dhe e vijës së drejtë të Partisë. Prandaj të mbajmë kurdoherë lart e më lart këtë fryshtë revolucionare, të jemi ne vetë shembull vendosmërie e sakrifice, të organizojmë si duhet ne, drejtuesit, punën e Partisë dhe të ekonomisë.

Problemet ekonomike për ne kanë një rëndësi të madhe. Prandaj, detyrat që na cakton Partia, duhet t'i zbatojmë me përpikëri dhe me siguri do të fitojmë.

Uroj me këtë rast shokët e Partisë dhe të pushtetit të rrethit të Përmetit për punën e mirë që kanë bërë! Në të ardhshmen përpinquni të bëni sa më pak gabime në punë dhe të përmirësoni treguesit e planit. Realizimi

mi i planit të këtij viti të bëhet një mbështetje e mirë për vitet e ardhshme që do ta kenë planin akoma më të ngjeshur. Natyrisht çdo gjë do të realizohet në luftë me vështirësitë e reja që do të na dalin. Ne kemi parasysh se edhe armiqjtë tanë që kemi në kufi nuk do të na lënë rehat. Nuk është puna se do të na shpallin luftë, po diversantë e spiunë do të na dërgojnë me qëllim presioni dhe që të na shqetësojnë. Po ne nuk shqetësohem lehtë, kemi 20 vjet që luftojmë, jemi mësuar me luftë e vështirësi dhe jemi regjur. Ne nuk do të biem në pozitat që duan të na futin atë, për të na larguar nga puna jonë për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë dhe të bujqësisë. Tani eksperiençë kemi, popullin e kemi të mirë, ushtrinë dhe armën e sigurimit i kemi të forta, të armatosura si duhet dhe të gatshme për të realizuar çdo detyrë të Partisë, ashtu sikurse është i gatshëm populli i rrëthit tuaj. Momentet janë revolucionare dhe shumë të përshtatshme për të përballuar çdo vështirësi e pengesë që mund të na dalin përpëra, sado të mëdha që të jenë ato.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

FITORET SIGUROHËN ME LUFTË, ME PUNË, ME VIGJILENCE

*Nga biseda me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe
të ekonomisë të rrethit të Përmetit*

12 nëntor 1961

Shokë të dashur,

Mua më ka dërguar këtu Komiteti Qendror i Partisë për t'u takuar me ju dhe me popullin e rrethit të Përmetit, prandaj ju transmetoj në radhë të parë juve, komunistëve dhe popullit të rrethit tuaj, përshëndetjet dhe urimet më të përzemërtat të udhëheqjes përfestën e madhe të 20-vjetorit të themelimit të PPSH!

Kanë kaluar 20 vjet që kur u krijua Partia jonë. Gjithë këtë kohë Partia e ka kaluar bashkë me popullin. Kjo ka qenë një periudhë e pasur luftërash dhe përpjekjesh për Partinë dhe popullin tonë, për çlirimin e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit. Partia jonë marksiste-leniniste ka qëndruar kurdoherë në ballë të kësaj lufte dhe ka kryer me nder detyrat ndaj popullit të vet dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo, gjatë je-

tës së saj, në asnjë moment nuk është përkulur përparrë vështirësive të shumta që i kanë dalë, por i ka kapërcyer ato me sukses, ka realizuar detyrat që i ka vënë vetes si dhe planet ekonomike, ka përpunuar kurdoherë një vijë të drejtë politike, ekonomike e kulturore. Pikërisht për të gjitha këto Partia është bërë krijesa më e shtrenjtë për çdo komunist dhe për popullin tonë. Në popullin tonë është rrënjosur një dashuri aq e thellë, e pastër dhe e sinqertë për Partinë, sa nuk ka pasur asnjë forcë dhe intrigë të armiqve që ta dëmtojë sado pak atë. Gjithë kjo dashuri e madhe për Partinë nuk është diçka e rastit, as e sipërfaqshme. Të duash dikë do të thotë t'i njohësh dhe t'i vlerësosh cilësitë e mira që ka, si drejtësinë, ndershmërinë, guximin. Po të mos i ketë këto cilësi, s'ke përsë ta duash. Partia jonë ia fitoi zemrën popullit jo me fjalë, por me vepra, me hovin e saj revolucionar, me drejtësinë e saj në çdo vendim, me përpjekjet, gjakun dhe djersën e komunisteve, të cilat bënë të çlirohet atdheu, të vendoset push-teti popullor, dhe Shqipëria, nga një vend i varfër të bëhet sot një Republikë e lulëzuar, ku populli gëzon ditë të mira e të lumtura. Pra dashuria e popullit për Partinë i ka rrënjet të thella.

Rezultatet, që ka arritur vendi ynë brenda këtyre 17 vjetëve çlirim, nën udhëheqjen e Partisë, u arritën se viaja e Partisë kurdoherë ka qenë dhe është e drejtë marksiste-leniniste, e palëkundshme dhe besnikë e teorisë sonë ngadhnjmëtare, ndryshe, po të kishte rrëshqitur nga pozitat e drejta në ndonjë moment, kjo vijë do të ishte komprometuar, ndërtimi i socializmit do të ishte rrezikuar. Ritmet vazhdimisht të larta të zhvilli-

mit ekonomik e kulturor të vendit tonë i detyrohen, pra, vijës së drejtë të përgjithshme të Partisë sonë, të cilën, duke e zbatuar me kujdes, në teori dhe në praktikë, miqtë e saj, partitë komuniste e punëtore të botës, e kanë aprovuar dhe e kanë duartrokitur. Kundërshtarët tanë e shohin fare mirë se vija 20-vjeçare e drejtë dhe e palëkundur e Partisë sonë, pa kompromise dhe pa shkarje nga binarët e marksizëm-leninizmit, nuk mund të ndryshojë kaq lehtë. Partia jonë, duke ndjekur me urtësi vijën e saj të drejtë, ka shkuar vazhdimisht duke u forcuar. Pra, vija e drejtë e Partisë, përpjekjet dhe puna e suksesshme e komunistëve, e popullit tonë, ndihma internacionale e BS dhe e vendeve të tjera socialiste kanë bërë që ne të kemi sot gjithë këto rezultate.

Rezultatet e shkëlqyera që janë arritur gjatë 17 vjetëve është e tepërt t'i numërojmë, sepse i dimë jo vetëm ne, kuadrot e Partisë, por i gjithë populli ynë, gjer në malësitë tona më të largëta. Brenda kësaj kohe të shkurtër në vendin tonë janë bërë mrekulli të mëdha, duke i krahasuar veprat që janë ndërtuar dhe punët që janë bërë, jo vetëm me të kaluarën tonë, po edhe me zhvillimin e vendeve të demokracisë popullore, të cilat nuk e kanë filluar punën për ndërtimin e socialistët nga ajo bazë që jemi misur ne. Në shumë prej vendeve të tjera socialiste, para Çlirimit kapitalizmi ka qenë në lulëzim, borgjezia vendëse që kishte interes të nxirrte përfitime sa më të mëdha me shfrytëzimin e masave, kishte ngritur një ekonomi të përparuar, një farë industrie pak a shumë të mirë, kishte zhvilluar bujqësinë, kishte çuar më përpara edhe shkencën e tek-

nikën, sigurisht të gjitha këto në kuadrin e sistemit kapitalist.

Ndërsa këtu në Shqipëri popullit dhe Partisë, pasi çliruan vendin dhe përmbyssën pushtetin feudoborgjez, iu deshën ta fillonin punën nga e para, sepse në vendin tonë nuk kishte as uzina, as hekurudha etj. dhe tani, pas 17 vjetëve ne mund të themi se kemi ndërtuar një bazë shumë të fuqishme ekonomike, duke ngritur një industri moderne socialiste, kemi shtuar minierat. Tani industria jonë punon me rendiment të lartë, ajo vihet në lëvizje nga punëtorët dhe nga inxhinierët tanë, që i pregetiti Partia në punë dhe në shkolla, brenda dhe jashtë shtetit.

Kolektivizimi i bujqësisë, që është një nga faktorët vendimtarë për ndërtimin e socializmit në fshat, thuajse ka përfunduar. Tani kemi shumë kooperativa bujqësore, të cilat mund të themi se kanë bërë një kthesë të madhe në rritjen e prodhimit. Përfundimet pozitive të kësaj kthese duken qartë. Fshatarësia ka bërë përparime të mëdha në këtë rrugë dhe, duke pasur besim të madh te Partia, bashkimi i saj në kooperativë është bërë jetë. Tani të gjithë i janë përveshur me gjëzim punës kolektive. Po krijohet figura e fshatarit të ri me kërkesa dhe me pikëpamje të reja socialiste, gjë që ka rëndësi të madhe për të ardhshmen e lumtur të fshatit tonë. Kjo shihet qysh tani me zhdukjen e gjerdheve, me punën që bëjnë kudo traktorët dhe makinat e shumta bujqësore, me futjen e metodave të reja të përparuara në fshat etj.

Gjatë këtyre 17 vjetëve ne kemi realizuar dy pësëvjeçarë dhe jemi në pesëvjeçarin e tretë, që ka një

rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit tonë. Viti i parë i këtij pesëvjeçari po realizohet me sukses dhe në industri ai parashikohet të tejkalohet. Edhe në bujqësi planet u realizuan më mirë nga viti i kaluar me gjithë thatësirën e madhe. Kjo i detyrohet punës së mirë që ka bërë fshatarësia nën udhëheqjen e Partisë. Po të ishte koha e përshtatshme, rezultatet do të ishin edhe më të mira në bujqësi, planet do të ishin realizuar në të gjithë zërat, sepse drithërat na janë dëmtuar, po kështu edhe duhani. Përsa u takon frutave dhe perimeve, ky vit ka qenë një vit i mbarë. Edhe në blegtori janë bërë përparime të dukshme në realizimin e planit. Kështu, duke realizuar shtesat në krerë e në qumësht, në treg ka pasur mish e bulmet dhe populli është i kënaqur, sepse detyrimet janë realizuar, bile në disa rrethe edhe tepricat. Po prodhimet blegtorale nuk kanë arritur akoma treguesit e planeve. Kjo dëshmon se trajtimi i blegtorisë nuk po bëhet si duhet në rrugën e modernizimit.

Realizimi i mirë i detyrave ekonomike të vtit të parë të këtij pesëvjeçari vërteton jo vetëm vijën e drejtë të Partisë, po edhe forcën e madhe dhe mobili-zuese të saj, vendosmërinë e popullit përpara vështirësive që na krijoi këtë vit grapi i N. Hrushovit. Qysh në fillim të këtij viti N. Hrushovi u përpoq që plani ynë pesëvjeçar të sabotohej, por nuk arriti dot t'i pengonte e t'i demoralizonte Partinë dhe popullin tonë. Përkundrazi, këtë vit u manifestua një mobilizim i jashtëzakonshëm i Partisë dhe i popullit që nuk është parë asnjëherë në vendin tonë. Kjo ka bërë që planet të realizohen, edhe pse ka pasur mungesa importi, për

arsye se njerëzit u mobilizuan në mënyrë të tillë që të kapërcehen vështirësitet pa u bërë fare kërkesa organeve qendrore të shtetit, po duke u bazuar në forcat e veta. Kjo gatishmëri e përgjithshme e punonjësve i detyrohet vijës së drejtë të Partisë. Partia dhe populli ynë i treguan gjithë botës se, me gjithë bllokadën politike, ekonomike dhe ushtarake, që i bënë N. Hrushovi dhe pasuesit e tij Shqipërisë, kjo ecën përpara dhe lulëzon.

Ne kemi miq kudo në botë. Një nga miqtë tanë më besnikë është PK e Kinës, e cila ndjek një vijë të drejtë marksiste-leniniste.

Gjatë realizimit të planit, Partisë dhe Qeverisë sonë mund t'u dalin edhe probleme të paparashikuara, për shembull, ndërtim minierash të reja në vende të pasura me minerale që na ishin fshehur nga «miqtë», por që tani po i zbulojnë gjeologët tanë, të cilët u janë qepur maleve dhe po nxjerrin minerale shumë të çmuershme, përveç atyre që kemi parashikuar. Në vitet e ardhshme ne do të dimë me siguri ç'vende të tjera përbajnjë minerale, çfarë mineralesh kanë, çfarë do të bëjmë me to dhe ç'industri tjetër do të ngremë. E tillë është perspektiva e vendit tonë përsa i përket zhvillimit të minierave dhe të industrisë së rëndë. Në bazë të kësaj perspektive Shqipëria e Veriut do të kthehet në një zonë të pasur industriale. Prandaj të gjithë të mobilizohemi për realizimin e planit pesëvjeçar që ka një rëndësi të madhe veçanërisht përmbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut.

Edhe në rrëthin tuaj, në Përmet, siç na vunë në dijeni shokët e byrosë së komitetit të Partisë të rrëthit, vëmë re se janë arritur rezultate të mira në zhvillimin

e ekonomisë dhe të kulturës. Kolektivizimi edhe këtu po jep rezultate të mira, sidomos në drejtim të fruti-kulturës. Frutat në rrëthim tuaj, sidomos këtë vit, kanë qenë të bollshme. Edhe me grurin ju nuk dolët keq, kurse plani i misrit nuk është realizuar plotësisht, kryesisht për shkak të thatësirës. Këto rezultate të mira në sektorin e bujqësisë e kanë burimin te mobilizimi i fshatarësisë së rrëthit tuaj, e cila ka punuar për sistemimin e tokave, ka hapur toka të reja, ka punuar për realimin e planit të ujitjes dhe po tregon mjaft kujdes për sektorin e blegtorisë, sidomos për bagëtitë e imta. Shokët më raportuan se fshatarësia kooperativiste e rrëthit tuaj, sidomos ajo e lokalitetit të Dëshnicës ka pasur rezultate shumë të mira dhe për këtë ne e urojmë nga zemra.

Sidoqoftë gjithë fshatarësia e rrëthit tuaj duhet t'i vërë kujdes të madh shtimit të prodhimit të drithërave se ky është dhe mbetet për ne një problem shumë i rëndësishëm. Ne importojmë akoma shumë drithë dhe kryesisht e sjellim nga RP e Kinës, e cila është treguar e gatshme për të na i plotësuar nevojat. Në të ardhshmen ne duhet të prodhojmë sa më shumë drithëra, në mënyrë që të importojmë sa më pak.

Për të kryer këtë detyrë duhet të punohen mirë fushat, t'u bëhet shërbimi drithërave që nga kullimi, prashitja e gjer te shërbimet e tjera kulturore. Gjithashtu t'i bëhet luftë thatësirës që përbën një rrezik të madh për kulturat e arave. Prandaj të mos qëndrojmë vetëm me ato pak motopompa që keni këtu, po të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme, gjer te ndërtimi i hauzeve të vog-

la, fundi s'humbasim gjë të bëhen të tilla sa për të ujitur edhe një kopësht, pa le pastaj për të ujitur 2-3 ose 5 hektarë. Kështu të arrijmë të shtojmë prodhimin e drithërave dhe të pakësojmë importimin e tyre. Në këtë drejtim ju jeni në rrugë të mirë dhe ju urojmë suksese të mëtejshme.

Partia dhe Qeveria do t'ju ndihmojnë më shumë për zhvillimin e bujqësisë. Kështu nga 12 traktorë që ka rrethi juaj së shpejti do të bëhen 15 dhe numri i tyre do të rritet në të ardhshmen. Gjithë makineria bujqësore, që është parashikuar në plan, do të na vijë në kohën e caktuar nga Republika Popullore e Kinës. Çdo gjë që është parashikuar në plan për bujqësinë do t'ë sigurohet dhe do të na vijë. Vetëm organizatat-bazë të Partisë të kooperativave bujqësore duhet të jenë në gjendje që të punojnë sa më mirë, të vazhdohet të bëhen sa më shumë toka qilizmë për të shtuar prodhimet. Ju e keni parë në jetë ç'rezultate të mira jep kjo punë, prandaj vazhdoni të bëni sa më shumë toka qilizmë.

Pastaj kini kujdes për zgjedhjen dhe për sigurimin e farërave se dhe ky është një faktor shumë i rëndësishëm për shtimin e prodhimit. Këtë problem duhet ta ndiqni në mënyrë shkencore, nga mbjellja e gjer te vjelja e prodhimit, t'i bëni mirë llogaritë dhe të nxirri konkluzione, se cila farë bën dhe cila nuk bën, të përdorni ato farëra që japos rezultate, këto duhet të seleksionohen, të dezinfektohen dhe të ruhen si duhet për t'u përdorur në kohën e mbjelljeve. Sidomos shokët e malësisë të kenë kujdes në këtë çështje se atje fshatarët nuk hedhin sasinë e caktuar të farës për hektar. Për çdo dynym duhet të hidhet të paktën 20-22 kg

farë gruri se aty del, dhe kështu do të merret më shumë prodhim. Në këto drejtime, pra, duhet të bëni shumë përpjekje jo vetëm me këshilla, po edhe me mjete se edhe ndihma e Partisë dhe e shtetit nuk do t'ju mungojë si kurdoherë edhe në të ardhshmen.

Por të gjitha këto punë të mëdha nuk mund të kryhen si duhet pa mësuar, pa përvetësuar shkencat. Edhe në këtë drejtim, ne kemi përparime të mëdha. N. Hrushovi mendoi se, duke na hequr specialistët, në vendin tonë do të paralizohejjeta ekonomike e kulturore, në miniera, në uzina e fabrika, në shkolla, në institucionet etj., por ai u gabua rëndë, sepse Partia jonë me ndihmën e PK të BS kur ishte në krye J. V. Stalini, kishte punuar drejt e me kohë që djemtë dhe vajzat e vendit tonë të mësonin në shkollat sovjetike. Kjo ishte një ndihmë shumë e madhe. Njerëzit tanë mësuan në BS e pastaj u kthyen në atdhe dhe si bij të popullit u mobilizuan në punë me të gjitha forcat pas largimit të specialistëve sovjetikë për të zëvendësuar punën e tyre, treguan iniciativa të shkëlqyera në punë, kështu që nuk u ndie pothuajse fare largimi i specialistëve të huaj nga vendi ynë. Kjo ndodhi se ata vunë mbi çdo gjë interesin e popullit dhe të atdheut, punuan me vetëmohim pa marrë parasysh asnijë vështirësi. Sido-qoftë të përpinqemi të përfitojmë nga eksperienca e mirë e nga puna e dijetarëve të vendeve të tjera të botës. Por këtë eksperiencë ta shohim me sy kritik dhe t'uа përshtatim kushteve tona.

Partia jonë tani ka krijuar mundësi që punonjësit e çdo sektori mundet dhe duhet të mësojnë e të përfitojnë duke filluar që nga kurset mujore, shkollat

professionale e gjer te universiteti dhe institutet e lar-
ta. Të gjitha këto Partia dhe Qeveria jonë i kanë hapur
për të pajisur me dituri njerëzit tanë. Prandaj të gjithë
duhet të bëjnë përpjekje të mësojnë, për të realizuar
detyrat në sektorët ku punojnë, të përballojnë me suk-
ses vështirësitet e përkohshme e të ecin përpara. Në
këtë drejtim ne duhet t'i përqendrojmë mirë forcat
tona.

Në vazhdim të fjalës së vet, shoku Enver Hoxha foli përmosmarrëveshjet politike dhe ideologjike që ekzistojnë në gjirin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, përt shkak të pikëpamjeve revizioniste e antimarksiste të grupit tradhtar të N. Hrushovit. Në përfundim shoku Enver Hoxha tha:

Vija e Partisë sonë është e drejtë dhe gjëzon përkrahjen dhe aprovimin e plotë të komunistëve dhe të masave të popullit. Ne bëmë shumë mirë që e vumë popullin në dijeni dhe kurdoherë kështu kemi bërë e do të bëjmë, çdo gjë ia kemi thënë e do t'ia themi atij, të mirat dhe të këqijat i kemi ndarë e do t'i ndajmë me të. Situatat janë revolucionare, ato janë edhe shumë të vështira, se kemi të bëjmë me një luftë me të ashtuquajturit miq, por që në të vërtetë janë njerëz të maskuar dhe të vendosur të na dëmtojnë, po të gjej-
në të çara në radhët tonë.

Duhet të jemi realistë. Ndryshe nga qëndrimi i drejtë, që kemi mbajtur, ne nuk mund të vepronim. Ky vendim është marrë nga udhëheqja e Partisë sonë pasi jemi menduar shumë, se kemi të bëjmë me një çështje jashtëzakonisht serioze, që është çështje vije. Kjo vijë e drejtë që ka zbatuar Partia bëri që populli të fitonte

gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e më vonë gjatë periu-dhës për ndërtimin e socializmit. Në qoftë se ne në këtë rast me Hrushovin do të bënim edhe lëshimin më të vogël, çdo fitore jona do të rrezikohej. Marksisti është marksist, vija është vijë, prandaj asaj i duhet qëndruar besnikë. Çështjet duhen gjuuar kurdoherë me gjakftohtësi, pa u trembur se përpara kemi Hrushovin apo ndonjë tjetër «me autoritet të madh».

Fitorja nuk vjen menjëherë. Edhe lufta kundër grupit të Hrushovit nuk do të marrë fund brenda një ose dy vjetëve se grapi i tij është në krye të partisë e të shtetit, ai nuk e lë lehtë pushtetin. Veç për një gjë jemi të sigurt, që çdo ditë pozitat e tij do të dobësohen, sepse edhe puna jonë do ta demaskojë, por ai do të demaskojë veten edhe me veprimet e qëndrimet e tij.

Partia jonë, ashtu si ka ecur kurdoherë me kujdes, edhe në këto situata duhet të ecë me kujdes. Çdo gjë, çdo veprim ta bëjmë ashtu si duhet dhe në kohën e duhur. Partia jonë ka pjekuri të madhe, le të bërtasin armiqtë se ajo është e re, vetëm 20-vjeçare. Por këta 20 vjet kanë qenë për të vite eksperience të madhe në luftë me armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Shumica e komunistëve shqiptarë si të thuash, i kishin akoma buzët me qumësht, ishin 16-vjeçarë kur u ngritën me pushkë në dorë në luftë për çlirimin e vendit nga push-tuesit e huaj dhe kundër mjerimit. Pas Çlirimit anëtarët e Partisë sonë e vazhduan luftën në frontin e ndërtimit të jetës së lirë, në luftë kundër vështirësive e pengesave të panumërtë, kundër armiqve të egër të jashtëm e të brendshëm.

Natyrisht në vijën tonë ne ecim dhe do të ecim pa asnjë lëkundje, po me kujdes. Veç do të jemi të pamëshirshëm kundër revizionistëve, ose kujtdo që ecën në rrugën antimarksiste. Dhe në luftën tonë s'jemi vetëm. Bashkë me ne, armiqtë e marksizmit i lufton gjithë komunizmi ndërkombetar, miliona komunistë në botë janë me ne. PK e Kinës qëndron në pozita të patundura marksiste-leniniste. Në pozita të drejtë qëndrojnë edhe mjaft parti të tjera të botës.

Nuk ka dyshim se kursi marksist-leninist do të fitojë, po, për të arritur në fitore, duhet durim, punë dhe luftë e pandërprerë e vigjilencë. Prandaj Partia, komunistët të jenë në ballë të punës dhe të luftës, të mobilizojnë popullin për realizimin e planeve ekonomike e kulturore. Të jemi vigjilentë për mbrojtjen e Partisë, të punojmë për çelikosjen e mëtejshme të unitetit të Partisë me popullin, për mbajtjen gjallë të hovit revolucionar të masave. Të luftojmë çdo mosmarrëveshje midis njerëzve për gjërat e vogla, t'i zhdukim këto në fryshtë revolucionare, të pastrohet çdo gjë që na pengon se momentet janë të rëndësishme. Në këtë drejtim të mobilizojmë të gjitha forcat, sepse armiku do të përpinqet të godasë Partinë, me një mijë e një mënyra, jo vetëm në krye po edhe në bazë. Prandaj, kur ndonjëri thotë diçka jo të mirë, pa qëllim të keq ose pa dashje, të mos merret shtrembër, por duhet vënë në vend me zgjuarsi, të sqarohet ai një herë, dy herë dhe kur duket se nuk e ka mirë t'i thuhet se po shkon larg dhe të bëhen të gjitha përpjekjet që të mos i lihet armikut. Po ata që kërkojnë të çajnë unitetin e Partisë, të goditen pa mëshirë, uniteti i Partisë të mbrohet nga

kushdo qoftë, në mënyrë që asnje orvatje e Hrushovit me shokë të mos gjejë të çara te ne. Uniteti i udhëheqjes me Partinë dhe i organizatave-bazë me popullin tonë është i çeliktë.

Tani, na mbetet të kryejmë me ndër detyrat që na ngarkon Partia, si edhe atë detyrë të madhe inter-nacionaliste që na e imponuan rrëthanat. Ne krenohemi se do ta mbajmë lart e të pastër flamurin e Partisë sonë dhe do të luftojmë pa u përkulur për fitoren e plotë të marksizëm-leninizmit kundër imperialistëve, revizionistëve dhe çdo armiku tjetër, që do të cenojë interesat e popullit tonë, kufijtë e atdheut dhe marksizëm-leninizmin.

Të rrojë në shekuj Partia jonë!

Botohet për herë të parë me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KUSH PREK POPULLIN KA PREKUR PARTINË DHE KUSH PREK PARTINË KA PREKUR POPULLIN

*Fjala në mitingun me popullin e rrethit
të Përmetit në Këlcyrë*

13 nentor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të rrethit të Përmetit dhe të lokalitetit të Këlcyrës,

Ju falënderoj nga zemra që morët mundimin dhe erdhët sot këtu në këtë miting. Të gjithë ne së bashku jemi punonjës dhe luftëtarë të një çështjeje të madhe, për të cilën na ka edukuar Partia, përvjetorin e lavdëshëm të së cilës e festuam këto ditë.

Gjithçka shkon mirë në vendin tonë. Këtë ne ua detyrojmë në radhë të parë popullit shqiptar dhe udhëheqjes së tij të lavdishme, Partisë së Punës të Shqipërisë. Partinë e lindi populli, se vetëm populli mund ta lindte atë, ai e krijoi Partinë për të pasur një udhëheqje besnike deri në fund për mbrojtjen e të drejtave dhe të çështjes së tij. Populli në shekuj kishte vuajtur nga robëria e rëndë e sunduesve të huaj, e bejlerëve,

e feudalëve dhe e agallarëve, prandaj në shekuj ai kishte luftuar për lirinë dhe për tokën që ta kishte të veten, ta punonte për vete, të ishte i lirë të thoshte atë që mendonte dhe të bënte atë që donte. Megjithëse populli shqiptar ka luftuar e ka derdhur gjak në shekuj, nuk i ka fituar dot ato të mira që gjëzon sot. Por gjatë shekujve, në luftëra, vuajtje e mjerime, ai grumbulloi një eksperiencë të madhe. Në çastet më të vështira për atdheun tonë, në një kohë kur ai ishte i pushtuar nga fashistët italianë, që u ndihmuani nga tradhtaret, bejlerët dhe agallarët, më 8 Nëntor 1941 populli krijoi Partinë Komuniste të Shqipërisë, sot Partia e Punës. Midis këtyre armiqve kanë qenë edhe shtypësit e egër të krahinës suaj, bejlerët e urryer të Këlcyrës.

Gjyshërit e stërgjyshërit e Ali bej Këlcyrës e kanë shitur kurdoherë Shqipërinë te turqit e te pushtuesit e tjerë të huaj. Për këto tradhti dhe për shtypjen e tyre të egër, populli ynë i ka dënuar ata me plumb. Xhelal bej Këlcyrën, të atin e Ali bej Këlcyrës, hakmarrja e drejtë e fshatarëve të krahinës suaj e shtriu përdhe në fillim të këtij shekulli. Edhe Ali bej Këlcyra me shokë erdhën në Shqipëri nga mërgimi me tanksat e Musolinit dhe me aeroplanët e Konti Çianos për të përjetësuar sundimin e huaj në Shqipëri, për të forcuar pozitat e tyre në kurriz të popullit e të fshatarësisë. Ata dhe bandat e tyre u armatosën nën urdhrat e fashistëve, për të shuar luftën e popullit tonë, për të shkatërruar Partinë tonë dhe për ta kthyer vendin në një koloni italiane.

E gjithë eksperienca e madhe shekullore e popullit

tonë, sidomos në vitet e këtij shekulli, e frysmezuar nga ideologjia e madhe e marksizëm-leninizmit, u kristalizua më 8 Nëntor 1941 me krijimin e Partisë heroike Komuniste të Shqipërisë. Partia, pra, ishte pjellë e popullit shqiptar, lindi nga populli dhe u lidh me popullin si mishi me thoin. Shikoni ku i kanë ngritur bejlerët ish-sarajet e tyre, në majë të shkrepave, për të, sunduar mbi fshatin, larg atij populli, që ata e quanin rajá e që kishin frikë të madhe prej tij. Kur ndonjë rajá hynte atje brenda, ata e hidhnin në gropë dhe kufoma e tij dilte në Vjosë.

Partia lindi nga populli, u lidh me të dhe e ngriti në këmbë popullin, i cili nën udhëheqjen e saj shkroi faqet më të shkëlqyera të historisë së tij. Edhe në kohën e Skënderbeut populli ynë ka bërë luftëra legjendare. Luftërat heroike të popullit shqiptar, i udhëhequr nga Skënderbeu, kanë pasur një rëndësi të madhe për Evropën, e cila dridhej në atë kohë nga fuqia e madhe e Turqisë. Këto luftëra e shpëtuan Evropën nga pushtimi turk, prandaj fama e Skënderbeut nuk mbeti vetëm në Shqipëri, emri i Skënderbeut mori dhenë. Dokumente dhe libra të shumtë kanë shkruar shkrimitarë, historianë dhe filozofë të ndryshëm të Evropës për Skënderbeun dhe për luftërat e popullit tonë, në të cilët vënë në dukje burrërinë, trimërinë, drejtësinë dhe virtutet e larta të popullit tonë.

Populli ynë luftoi për liri e për pavarësi edhe më vonë, por nuk fitoi. Ato, për të cilat kishte ëndërruar gjatë shekujve, ai i fitoi vetëm pasi u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë, e dalë nga gjiri i tij dhe e ndriçuar nga marksizëm-leninizmi, teoria që udhëhoqi

në fitore klasën punëtore, e cila si një grusht i çeliktë i dha goditjen e parë dërrmuese kapitalizmit francez në kohën e Komunës së Parosit, që i rezistoi borgjezisë franceze dhe Gjermanisë së Kaizerit e të Bismarkut. I madhi Karl Marks në atë kohë thoshte se komunarët e Parosit po sulmojnë qiejt. E tillë ishte lufta heroike e proletariatit francez që u udhëhoq direkt nga Karl Marks i dëshvitet e tij.

Idetë e proletariatit triumfuan në BS me Revolucionin e madh Socialist të Tetorit, 44-vjetorin e të cilit e festuam javën e kaluar.

Populli ynë, me Partinë në krye, me Partinë në zemër u hodh në luftë me besim të patundur se do t'i mundte pushtuesit fashistë italo-gjermanë, tradhtarët e vendit, ballistë e zogistë dhe të gjithë ata që do ta pengonin në luftën e tij çlirimtare. Partia kishte besim të patundur në këtë gjë se njihet ligjet e zhvillimit të historisë, që nuk mund të ndryshohen nga kushdo qoftë. Ecjen e shoqërisë përpara nuk mund ta pengojnë as imperializmi amerikan, as bombat atomike. Rrugën e klasës punëtore drejt socializmit nuk mund ta ndalojnë as tradhtarët dhe as agjentët e imperializmit. Kush përpinqet t'i thyejë këto ligje ai bie në greminë, kurse vala e revolucionit ecën përpara.

Me fitoren e luftës së popullit tonë, në Shqipëri ungri për herë të parë flamuri i vegjëlisë, i klasës punëtore dhe i fshatarësisë sonë të vuajtur por heroike, flamuri i kuq i Skënderbeut. Tani Shqipëria u bë e lirë në shekuj e përgjithnjë. Sot nuk mund të ketë armik, qoftë edhe i fortë e i madh, që ta kthejë Shqipërinë nga rruga që ka marrë, pavarësisht se rreth e rrötull

kemi armiq. Rrojmë në shekullin e leninizmit dhe me ne janë popujt e gjithë botës.

Këto ditë ne festuam 20-vjetorin e themelimit të Partisë me entuziazëm të papershkruar. Partia është në zemrën e çdo shqiptari, të madh ose të vogël, sepse ajo jo vetëm i dha lirinë popullit, siguroi pavarësinë e Shqipërisë, po bëri edhe gjithë ato ndryshime saqë brenda një kohe kaq të shkurtër u ndërtuan hidrocentrale, fabrika e kombinate, që punojnë dhe prodhojnë për popullin gjëra të mira, të bucura dhe të lira. Industria që ne kemi ndërtuar, brenda këtij pesëvjeçari do të zgjerohet e do të forcohet akoma më shumë me fabrika e me kombinate të reja, për t'u dhënë popullit dhe ekonomisë popullore më shumë tekstile të leshta e të pambukta për t'u veshur bukur e ngrohtë, më shumë artikuj ushqimorë, më të shijshëm e më të lirë, më shumë çimento e të një cilësie më të mirë për të ndërtuar me një vrull e shpejtësi më të madhe objekte të reja, pallate e shtëpi banimi, vatra e shtëpi kulture.

Tani fshatrat tona thuajse nuk njihen fare nga ndërtimet e shumta që janë bërë e po bëhen, nga shkolat, dyqanet, qendrat shëndetësore, depot, furrat, ndërtesat bujqësore etj. Në çdo fshat tani kemi shkollë fillore, ashtu siç e kishin ëndërruar Samiu dhe Naimi, të cilët e donin popullin me gjithë shpirt dhe për të mirën e tij luftuan deri në ditët e fundit të jetës së tyre. Për këtë popull, për bukuritë e rralla të këtij trualli, për bagëtinë dhe për bujqësinë tonë këndoi aq bukur Naimi i madh e i pavdekshëm. Por ëndrrat e Naimit me shokë, lufta dhe puna e palodhur e tyre, u realizuan në

Shqipëri nën udhëheqjen e Partisë, i realizoi populli, te i cili Naimi kishte besim të madh. Vargjet e Naimit: «Lum kush të rrojë, ta shohë zonjë» tani tingëllojnë bukur në realitetin shqiptar, sepse Shqipëria u bë me të vërtetë «zonjë».

Vëllai i Naimit, Sami Frashëri, ideologu i Rilindjes sonë Kombëtare, ky filozof i njohur jo vetëm në Shqipërinë e tij të dashur, si dhe në Turqi, ku jetoi e punoi për një kohë të gjatë, por në gjithë Orientin dhe Evropën, luftoi tërë jetën e vet edhe për përhapjen e arsimt dhe të shkollave shqipe. Ai ëndërronte e thoshte se do të vijë shpejt koha që edhe ne në vendin tonë të kemi universitetin ose «gjithëmësonjëtoren», siç e quante ai. Këtë universitet sot e ngriti Partia dhe tani atje mësojnë mbi 2 000 studentë. Por veprimtaria kulturnore e shkencore e Sami Frashërit, sidomos në fushën e gjuhësisë është aq e gjerë dhe krijuese, sa e ngratë atë në nivelin e një shkencëtarit ndërkombëtar.

Në vendin tonë këtë pesëvjeçar do të ngrihen fabrika e uzina të reja, shkolla 7 e 11-vjeçare. Edhe këtu në Këlcyrë do të fillojë vitin e ardhshëm ndërtimi i një shkolle 11-vjeçare, kështu djemtë dhe vajzat tuaja nuk do të largohen që këtej për të ndjekur shkollën e mesme. Të tillë shkolla dhe fabrika, do të ngrihen jo vetëm në një qendër të tillë si Këlcyra juaj, që do të rritet dhe brenda disa vjetëve nuk do të njihet ç'ka qenë, por edhe në qendra të tjera më të vogla. Politika e Partisë është e tillë që ekonomia dhe kultura të zhvillohen kudo, që industria të mos grumbullohet vetëm në disa qendra, por të shpërndahet proporcionalisht në tërë vendin, që burrat dhe gratë të afta për punë të

mos «emigrojnë», fjala vjen, në Tiranë ose në Durrës, në Vlorë apo në Shkodër. Zhvillimi i bujqësisë dhe ngritja kudo e fabrikave të reja të janë të tillë që prodhimi të përfshijë gjithë ato forca pune, sidomos gra që janë pa punë për t'u sjellë kënaqësi vetë atyre dhe familjeve të tyre. E tillë është politika e Partisë.

Partia ka në program të zhvillojë, në radhë të parë, industrinë e minierave, sepse ajo do t'i sjellë ekonomisë popullore të ardhura të mëdha. Një pjesë e këtyre të ardhurave do t'i jepet bujqësisë, e cila bashkë me industrinë të ecë paralelisht. Pasuritë e nëntokës sonë i kemi zbuluar dhe po i zbulojmë vazhdimisht. Përveç vendburimeve të naftës dhe minierave të baktit, të qymyrgurit, të kromit, po hapen edhe të tjera, që brenda 2-3 vjetëve do të shfrytëzohen. Disa prej këtyre as që ishin planifikuar, sepse u zbuluan më vonë nga gjeologët tanë të rinx, nga ata që 10-15 vjet më parë ju, prindërit, me vështirësi i dërgonit në shkollë duke menduar se duhen për të ruajtur bagëtitë. Por Partia ju këshilloi dhe ju e dëgjuat fjalën e saj, duke gjykuar se ajo nuk thoshte për të keqen tuaj. Tani e shikoni vetë se iku koha e djemve, e vajzave të bejlerëve dhe të agallarëve; bijtë e bijat e popullit drejtожnë tani fabrikat e uzinat, zbulojnë pasuritë e nëntokës, thajnë këneta, drejtожnë anije e ndërtожnë hekurudhat. Të gjitha këto pasuri të mëdha tani janë në duart e sigurta të popullit dhe jo të Ali beut e të qehajallarëve të tij. Prandaj punët tonë ecin mirë dhe do të shkojnë kurdoherë përpresa.

Përparime të mëdha ka bërë dhe po bën edhe bujqësia te ne. Kush nga ju ka shkuar më përpresa në Vlorë,

Fier, Lushnjë, Korçë, Durrës ose Tiranë, tani ato s'ka për t'i njojur se fushat në të gjitha anët e Shqipërisë janë zbukuruar, janë pastruar e janë sistemuar. Kudo tani punojnë traktorë. Të mos vemë larg, edhe në qytetin dhe në rrëthin heroik të Përmetit, që u bë shkrumb e hi gjatë luftës dhe ku më parë sundonin bejlerët, agallarët e teqetë, që i mbanin njerëzit në errësirë, janë bërë ndryshime të mëdha. Kudo të zë syri ara të bukura dhe blloqe me pemë. Në gjithë luginën e Përmetit tani shikon ara të sistemuara nga duart e kooperativistëve.

Ky vit, në përgjithësi, për bujqësinë ka qenë mesatar. Po të mos bënte thatësirë, do të kishim prodhime të bollshme, si në grurë, në misër, edhe në duhan, që na u dëmtua, sidomos në Shkodër, në Elbasan etj. Tani Qeveria ka marrë masa për t'i ndihmuar prodhuesit e duhanit. Mund të themi se në pambuk patëm prodhime të mira. Edhe panxhari nuk shkoi keq.

Unë jam shumë i gjëzuar që vizitoj Këlcyrën, e cila, siç më njoftuan shokët e Partisë, qëndron në radhët e para të lokaliteteve të rrëthit tuaj në zhvillimin e frutikulturës, rrushit dhe blegtorisë. Ne e dimë se fshatarët e këtij lokaliteti kanë qenë dhe janë patriotë. Në qoftë se disa prej tyre u gënjen nga bejlerët e Këlcyrës ose nga Baba Kamberi, Partia kishte besim të plotë se me zemër nuk ishin me ata, sepse ishin njërej të vuajtur, të varfër e të mjeruar. Disave prej këtyre fshatarëve tani mund t'u vijë keq për ato që kanë ndodhur dhe ndonjëri i penduar mund të thotë: «Përse unë e thashë atëherë një fjalë të keqe për këtë Parti, që do të na çlironë dhe na çliroi?», bile ka ndonjë që

ka hedhur edhe ndonjë pushkë dhe tani e vret ndër-gjegjja. Por, vëllezër, Partia e dinte se këta ishin të gënjer. Sot shohim se Kajca, që quhej «Moskë e vogël» në kohën e luftës nga qëndrimi i saj i vendosur, edhe tani lufton për vijën e Partisë, por ka edhe fshatra të tjera, si Zhepova, që luftojnë me heroizëm për ndërtimin e socializmit, qëndrojnë në ballë për realizimin e detyrate të Partisë, sepse e duan atdheun, e duan Partinë me gjithë shpirt. Kështu punon edhe Ballabani. Nuk ka armik që të kalojë kufirin këtu dhe të mos e kapni për zverku ashtu si ka ndodhur, për shembull, në Zhepovë.

Shokë dhe vëllezër, Partia ka theksuar se Lufta Nacionalçlirimtare ishte një luftë e lavdishme, por e vështirë. Ndërtimi i socializmit është një luftë po aq e lavdishme, po aq e vështirë, në mos më tepër se Lufta Nacionalçlirimtare. Prandaj nuk ka pse të thotë njeri: «Si nuk hodha edhe unë një pushkë atëherë kundër armiqve!». Kush punon dhe kryen mirë detyrat e ndërtimit të socializmit, ai ka hedhur shumë pushkë kundër armiqve për lavdinë e popullit tonë. Dhe ju këtë detyrë jeni duke e kryer, pra Partia është e kënaqur dhe mburret me punën tuaj.

Sivjet ju keni marrë prodhime të shumta, kështu që të ardhurat i keni pasur më të mëdha. I hëngshi me shëndet e i gjëzofshi ato, se janë mundi i punës suaj! Ndërtoni me to shtëpi të reja, vishuni dhe jetoni më mirë. Gjithashtu punoni edhe më mirë tokat, shtonit dhe administroni më mirë bagëtinë. E ardhshmja është jona. Çdo ditë që vjen më e lumtur do të jetë për popullin, më mirë do të rrojmë, se më shumë do të prodrojmë.

Ju keni pasur suksese në hapjen e tokave të reja dhe në ujitje, por mos u kënaqni me to. Partia ju kë-shillon që çdo kooperativë bujqësore të hapë hauze në vendet më të përshtatshme, qofshin ato edhe të vogla qofshin edhe sa për të ujitur një kopsht. Përmeti ka pasur tradita për këto punë, prandaj i zhvilloni këto tradita, për të shtuar prodhimin. Luftë thatësirës së verës, që na dëmton prodhimin. Po të mos ju kishte dëmtuar thatësira këtë vit, ju do të kishit marrë rendimente më të larta si në grurë, ashtu edhe në misër. Megjithëkëtë, sipas kohës, përsëri nuk dolët keq.

Rrethit të Përmetit, që ka kushte shumë të mira për zhvillimin e frutikulturës e të vitikulturës dhe për blegtorinë, Partia i ka dhënë e do t'i japë kredi. Në planin e tretë pesëvjeçar investimet e kreditë për rrethin tuaj do të shtohen, që krahina juaj të bëhet më e bukur, më e begatshme dhe shembull për të gjitha rrethet e tjera në zhvillimin e frutikulturës e të vitikulturës. Por mos harroni blegtorinë e imtë, se edhe kjo na sjell shumë të mira. Atje ku ka mundësi, të mbani edhe lopë, jo nga ato që jepin 200 litra qumësht në vit, po racë të mirë që jepin 1 000 litra e lart, mundësitë i keni, prandaj i shfrytëzoni si duhet ato.

Frutikultura, vitikultura dhe blegtoria u realizuan mirë. Për këto arsyе furnizimi i popullit sivjet është bërë më mirë nga vitet e kaluara. Por edhe vjet, që kishim një thatësirë më të madhe, mund të themi pa ngurruar, se popullit nuk i mungoi asgjë, sepse Partia dhe Qeveria morën masa me kohë dhe krijuan rezerva.

Këtë vit ishim më mirë se vjet. S'ka dyshim se vitin që vjen do të jemi akoma më mirë, pavarësisht

nga disa vështirësi që na janë krijuar, se popullin tonë kurrë nuk e kanë trembur vështirësitë dhe kurrë nuk do ta trembin. Vështirësi ne kemi pasur vazhdimi. Ne kemi qenë dhe jemi të rrethuar nga armiq: nga revisionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë dhe nga imperializmi amerikan, që i drejton të gjithë këta armiq. Ata kanë vënë kundër nesh të gjitha mjetet, që nga radiot e shtypi i tyre që flasin e shkruajnë kundër nesh e deri te organizimi i komplateve njëri pas tjetrit gjatë këtyre 20 vjetëve që i kemi zbuluar, i kemi shtypur dhe kemi ecur përpara. Partia dhe pushteti i kanë hedhur armiqtë në hendek dhe populli ka çarë me sukses përpara në rrugën e tij të drejtë.

Gjendja në vendin tonë, pra, zhvillohet si dëshiron populli në saje të drejtësisë së vijës së Partisë dhe sepse Partia dhe populli janë një e të pandarë. Kush prek popullin ka prekur Partinë dhe kush prek Partinë ka prekur popullin. Rruga e Partisë ka qenë dhe është kurdoherë e drejtë. Kjo ka bërë që edhe mjaft nga armiqtë tanë të dikurshëm t'i vënë gishtin kokës dhe të thonë se «me këta nuk matesh kollaj». Pastaj ata i kanë vënë gishtin kokës edhe për një gjë tjetër: «Ne, thonë ata, ishim në fuqi për shumë vjet, po asgjë nuk kemi bërë, kurse komunistët, duke e udhëhequr mirë popullin, ia kanë ndryshuar faqen Shqipërisë». Ka nga këta njerëz që thonë se «duhet t'u heqim kapelen komunistëve». Neve na vjen mirë se Partia do që edhe ata që kanë qenë në rrugë të gabuar të ndreqen, asnjë njeri të mos ia lëmë armikut, të pastrohen zemrat, të futen njerëzit në punë, edhe ata që kanë gabuar,

sepse puna i edukon njerëzit. Jeta e përbashkët dhe puna e ndershme i bëjnë njerëzit të zotë dhe patriotë.

Shokë, ka edhe nga ata që, të gënjer, për një kohë shkuan me «Ballin», por Partia ka qenë bujare dhe u ka dhënë dorën. Disa prej tyre janë bërë luftëtarë të vendo-sur për jetën e re në Shqipëri, se e panë me sytë e tyre realitetin e vendit tonë pas Çlirimt, kujtuan vuajtjet e popullit në të kaluarën, luftërat e tij. Ata që u menduan më mirë thanë: «Ku po shkojmë dhe çfarë po bëjmë kështu, ne këtu kemi lindur, prandaj këtu duhet të rrojmö dhe të vdesim. Ne, që për ca kohë nuk kemi jetuar si njerëz të ndershëm, le ta ndryshojmë rrugën tonë të gabuar». Njerëz të tillë, që e kanë braktisur rrugën e mëparshme, ka njaft dhe këtë e bëri politika e drejtë e Partisë.

Ju e dini sa e kemi dashur ne Bashkimin Sovjetik se ai na ndihmoi të çlirohemi, na ndihmoi për ndërtimin e Shqipërisë së re. Por për fat të keq atje ka ardhur në krye të shtetit dhe të Partisë një grup revizionist, me Hrushovin në krye, që nuk ecën në rrugën e caktuar nga Lenini dhe Stalini.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli me argumete mbi punën armiqësore që zhvillon grupi i N. Hrushovit për të përcarë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare, theksoi veprimtarinë e tij antimarksiste në Mbledhjen e Bukureshtit dhe në atë të Moskës, duke vënë në dukje qëndrimin parimor e revolucionar të Partisë sonë. Në fund shoku Enver Hoxha tha:

Prandaj, shokë dhe shoqe, këtë luftë të drejtë e të madhe që zhvillon Partia jonë e bën vetëm në interes të popullit dhe të komunizmit. Partisë sonë i takoi

nderi që të luftojë krah për krah me Partinë e madhe Komuniste të Kinës për mbrojtjen e socializmit dhe të komunizmit nga ky grup renegatësh që ka në krye N. Hrushovin, i cili është i lidhur ngushtë me revolucionistët jugosllavë dhe punon nën rrogot për dobësimin e kampit socialist e në radhë të parë kundër vetë Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë e gjykoj mirë qëndrimin që mban; ajo për këtë nuk mori vendim të shpejtuar, por plotësisht të drejtë dhe jemi të bindur se fitorja do të jetë me ne. As qëndrimet antishqiptare të revisionistëve, as vepritmet komplotiste të monarko-fashistëve grekë, apo të imperialistëve amerikanë nuk kanë ç'u bëjnë vendit dhe Partisë sonë, as ekonomikisht, as politikisht e ideologjikisht, as ushtarakisht.

Populli ynë është i téri ushtar. I tërë populli është me pushkë në krah dhe me një entuziazëm të lartë punon e vigjelon për të mbrojtur atdheun, socializmin. Vetëm një Qeveri si jona mund t'i japë popullit armët në dorë. Kjo ndodh se te ne popull e Parti janë një e të pandarë. Veç kësaj ne kemi një ushtri të lavdishme, të çeliktë dhe të inkuadruar si duhet, që është farkëtuar në shkollën e madhe të Luftës Nacionalçirimi, që udhëhiqet nga vija e drejtë e Partisë, e përbërë nga bij besnikë deri në fund të popullit dhe të Partisë. Ushtria jonë është trime, për kauzën e Partisë ajo të merr gjak në vetull dhe për këtë ka dhënë prova. Me këto ideale të mëdha, që e udhëheqin ushtrinë tonë, me këtë shpirt të lartë sakrifice e prekje që ka ajo, asnjë nuk guxon ta prekë Shqipërinë. Partia e ka në gatishmëri të plotë ushtrinë si nga pikëpamja morale, ashtu edhe nga

pikëpamja materiale. Ne kemi edhe Armën e lavdishme të Sigurimit të Shtetit, roje vigjilente, heroike dhe e zgjuar e atdheut, që bashkëpunon ngushtë me popullin kundër çdo armiku të Republikës.

Shikoni ç'siguri, ç'qetësi e ç'gjakftohtësi ka në vendin tonë! Shikoni ç'krenari të ligjshme për Partinë dhe pushtetin e tyre ka te njerëzit tanë! Asnjë trubullirë, asnjë alarm, asnjë shqetësim në popullin tonë. Të tillë janë populli, Partia, ushtria, sigurimi, të fortë, sypatembur, me besim të patundur në të ardhshmen. Kjo u detyrohet vijës së pastër si kristali të Partisë, ngritjes politike të popullit, ndërgjegjes së tij të lartë revolucionare.

Prandaj, shokë të dashur, me besim të patundur te Partia, në forcat e pashterura të popullit tonë, në drejtësinë e vijës së Partisë dhe të shtetit tonë, si kur doherë së bashku me Partinë, të hidhemi në punë për të realizuar planet tona. Kjo ka një rëndësi të veçantë në këto situata për t'u treguar Hrushovit dhe shokëve të tij se ne luftojmë dhe punojmë të papërkulur dhe korrim suksese. N. Hrushovi kujtoi se, duke prerë kreditë, duke tërhequr specialistët, Shqipëria do t'i binte në gjunjë. Po Shqipëria s'e bëri këtë dhe jo vetëm nuk u mposht, jo vetëm nuk vdiq për bukë, po emri i saj u ngrit edhe më lart, ajo pati edhe më shumë suksese. Edhe me kredi, që na u prenë nga Hrushovi, na ndihmoi Republika Popullore e Kinës. Prandaj t'i përvishe mi punës me besim për realizimin e planit të ri pesëvjeçar, sepsejeta po tregon se, me gjithë këto vështirësi e pengesa që na kanë sjellë revisionistët, viti i parë i pesëvjeçarit të tretë po realizohet me sukses.

Atëherë të mobilizohemi për realizimin e planit tonë madhështor, ta bëjmë këtë plan një mbështetje të fuqishme për planet e ardhshme për të mirën e popullit tonë! Me këtë besim të patundur t'i përvishemi punës për rezultate edhe më të mëdha!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli patriot e punëtor i rrethit të Përmetit!

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**VIGJILENCEN TA KEMI NË RENDIN E DITES,
ARMIËT T'I MBAJMË GATI DIIE BARUTIN
TË THATE**

Fjala në mitingun me popullin e rrëthit të Gjirokastrës

14 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër, të rinj e të reja, pionierë të shkollave,

Ju falënderoj nga zemra që u mblohdhët sot këtu në Sheshin e Çerçizit që të takohemi së bashku. Njëko-hësisht, i ngarkuar nga KQ i Partisë dhe Qeveria, dua të përshëndes popullin heroik të Gjirokastrës dhe t'i sjell atij urimet më të mira për festën e madhe të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme të Punës!

Kjo dashuri e madhe që tregoni ju për Partinë e Punës të Shqipërisë është e natyrshme, e ligjshme dhe e sinqertë, sepse, po të mos ishte krijuar Partia 20 vjet më parë, populli ynë, edhe sot e kësaj dite do të rronte në robëri, i skllavëruar dhe në mjerim, atdheu ynë nuk do të ishte i lirë e i pavarur. Ju e dini mirë se brez pas

brezi ka rrjedhur si lumë gjaku i gjyshërve e i stërgjyshërve tanë në këto vende, për të mbrojtur jetën dhe nderin e tyre, për të jetuar të lirë dhe të pavarur, për tokën dhe për bukën e gojës. Legjendare kanë qenë luftërat e popullit tonë, që janë dëgjuar në të gjithë botën. Këto luftëra nuk kishin për qëllim vetëm lirinë dhe pavarësinë e atdheut e të popullit tonë, por kanë luajtur një rol të madh edhe për mbrojtjen e qytetërimit evropian nga hordhitë barbare të Turqisë.

Luftërat e popullit shqiptar me Skënderbeun në krye, që për 25 vjet me radhë mundi turqit osmanlinj, u admiruan dhe u përshkruan nga historianë, filozofë e shkrimtarë të mëdhenj të Evropës, të cilët, në atë kohë dhe më vonë, në librat e tyre, vunë në dukje virtytet e larta të popullit tonë dhe veçanërisht të udhëheqësit të këtyre luftërave, Skënderbeut.

Po edhe pas vdekjes së Skënderbeut përpjekjet e popullit tonë për liri e për jetë të pavarur nuk pushuan. Njëra pas tjetrës dërgoheshin ushtritë e fuqishme të sultani të turq kundër popullit tonë të vogël, për të shtypur luftërat e tij çlirimtare, por ai asnjëherë nuk u tremb e nuk u përkul. Populli ynë qëndronte vazhdimisht me pushkë në krahë, dilte maleve dhe atje i organizuar në çeta vazhdonte luftën për liri, godiste armiqëtë. Duke luftuar kështu gjatë shekujve, ai mundi të mbante gjallë traditat e tij të lavdishme, gujhën, nderin, doket dhe zakonet e tij të bukura.

Në Luften heroike Nacionalçirimitare, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë, u shfaqën me një forcë më të madhe cilësitetë e larta morale që populli ynë trashëgoi nga të parët, guximi, trimëria, vendos-

mëria dhe nderi kombëtar; në dejt e brezave të rinj lëvrinte gjaku i stërgjyshërve që dhanë jetën pér tokën, pér bukën, pér lirinë e dëshiruar.

Njëzet vjet më parë, 200 nga bijtë e bijat më besnikë të këtij populli, të paktë në numër, por me besim të patundur në çështjen e madhe të popullit, në heroizmin e tij, të udhëhequr e të ndriçuar nga mësimet ngadhnjimtare të marksizëm-leninizmit, krijuan më 8 Nëntor 1941 Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe filuan luftën pér çlirimin e atdheut. Partia i bëri thirrje popullit të ngrihej kundër pushtuesit fashist, kundër bejlerëve e agallarëve pér lirinë dhe pér një jetë të re, sepse rronim në shekullin e leninizmit, sepse kishët ardhur koha pér t'u dhënë fund vuajtjeve e mjerimeve. Thirrjes së Partisë iu përgjigj i gjithë populli shqiptar.

Në këto ditë, që festuam 20-vjetorin e themelimit të Partisë, i madh e i vogël kujtonte me mallëngjim dhe me krenari të gjithë dëshmorët e popullit, burra e gra, të rinj e të reja, martirë të çështjes së madhe, që nuk kursyen as jetën e tyre pér t'i sjellë popullit lumburinë, pér t'i dhënë atij në dorë pushtetin, pér ta bërë zot të tokës dhe të vetes së tij. Prandaj gjatë këtyre ditëve të 20-vjetorit të themelimit të Partisë, nga të katër anët e Shqipërisë shpërtheu një entuziazëm i madh dhe një manifestim i zjarrtë i dashurisë pér Partinë, që është gjendur dhe gjendet kurdoherë atje kurreziku është më i madh. Populli ka pasur dhe ka besim të plotë te Partia, sepse ajo i ka treguar atij kurdoherë rrugën e drejtë.

Liria fitohet me gjak. Po me gjak ndërtohet edhe

socializmi. Kështu u ndërtua mbi gërmadhat e së vjetrës Shqipëria e re. Një pushtet i vendosur me luftë e me përpjekje është i fortë e i pathyeshëm. I tillë është pushteti ynë popullor, që ka lindur nga gryka e pushkës dhe mbrohet po me pushkë.

Partia, pra, vazhdoi me besnikëri vijën e saj të drejtë pa u përkulur dhe populli e ndoqi atë me besim të madh. Dhe kishte të drejtë populli të kishte besim te Partia, sepse komunistët nuk ishin as bij bejlerësh, as bij agallarësh, të cilët e kishin shitur Shqipërinë në çdo kohë te të huajt. Anëtarët e Partisë Komuniste të Shqipërisë ishin bijtë e klasës heroike punëtore, të fshatarësisë sonë të vuajtur patriote, të njerëzve të ndershëm. Prandaj shumica dërrmuese e shqiptarëve braktisi rrugën e tradhtisë, që ndiqte «Balli Kombëtar» e «Legaliteti», ata u kthyen pushkën këtyre organizatave antipopullore, që kërkonin me demagogji e me mashtrim ta devijonin Luftën Nacionalçlirimtare dhe ta lidhnin popullin pas qerres së pushtuesve italianë e gjermanë. Me lindjen e Partisë, koha e tradhtarëve mbaroi dhe populli, që kishte një eksperiencë të madhe të paguar me gjak, lot e djersë, tani që gjeti një udhëheqje të drejtë të dalë nga gjiri i tij, u bashkua si një trup i vetëm rreth Partisë dhe u hodh i téri në luftë. Ne atëherë armë nuk kishim, por armë pér ne kishin armiqtë tanë, pushtuesit italianë dhe gjermanë. Ne kishim zemër prej çeliku, dhe e kishim të qartë se luftonim pér një çështje të drejtë, prandaj luftuam me armët, që ua rrëmbenim armiqve në luftë dhe i mundëm ata.

Shumë njerëz thoshin: «More, ç'po bëjnë këta ko-

unistët, këta janë të krisur». Po ne nuk mund të ishim të tillë, nuk mund të jetë i krisur populli. Partia e kishte të qartë perspektivën, ishte e ndërgjegjshme për të përballuar luftën e vështirë.

Gjatë këtyre 17 vjetëve te ne është bërë një transformim rrënjosor, duke filluar që nga njerëzit e deri te natyra e vendit tonë në skajet më të largëta. Këto transformime, motra dhe vëllezër, i keni bërë ju me duart tuaja, me forcën, me vullnetin dhe zotësinë tuaj. Kësaj pune të madhe, që është kryer te ne, i duhet shtuar edhe ndihma internacionaliste e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të tjera socialiste, por pa popullin, pa mobilizimin, pa krahun dhe pa mendjen e tij, sado e madhe që të jetë ndihma nga jashtë, nuk mund të arrihen këto rezultate. Pa Partinë, pa vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, pa udhëheqjen e saj të urtë, asnje ndihmë nuk mund të sillte përparimin e madh të vendit tonë.

Politika ekonomike ka luajtur dhe luan një rol vendimtar në jetën e popullit, në forcimin e pushtetit popullor. Prandaj në vijën e Partisë, ndërtimi i Shqipërisë së re, ngritja e një ekonomie moderne zinte vendin kryesor. Por, që të bëhej kjo, që t'i silleshin popullit të mira, duheshin rrëzuar medoemos të gjitha pikëpamjet dhe strukturat e vjetra të klasës feudale, në radhë të parë, duhej t'i jepcë toka fshatarësisë, se asaj i përkiste. Mbi këtë tokë kishte derdhur gjakun e djersën e saj fshatarësia dhe jo bejlerët e agallarët, që rrinin nëpër kulla dhe si shushunjat thithnin nga djersa e fshatarëve prodhimet që këta i krijonin me

aq mundime. Pas Çlirimtit duhej ndërtuar menjëherë çdo gjë që ishte shkatërruar nga lufta.

Regjimi i Zogut nuk vuri asnijëherë një gur mbi një tjetër. Vetë populli i Gjirokastrës vdiste për një pikë ujë. Sa herë u mblodhën të holla për të sjellë ujë në qytet, po i hanin ata që ishin në krye dhe që «do të sillnin ujin». Atëherë nuk u ndërtua asnijë punishte e vogël; ngriheshin njerëzit në mëngjes dhe nuk dinin ç'të bënin, si do të kalonin ditën, ç'do t'u sillte e nesërmja, si do të jetonin.

Pas Çlirimtit populli dhe Partia iu përveshën punës me vendosmëri të madhe, për të kapërcyer ato vështirësi të jashtëzakonshme. Kujtoni ato kohë fill pas Çlirimtit, kur s'kishim asnijë ndihmë, i madh e i vogël, pa bukë e pa këpucë, punuam atje ku thoshte Partia dhe brenda një kohe të shkurtër u ndërtua çdo gjë që ishte shkatërruar, urat, rrugët, shtëpitë në fshatra e qytete, shkollat etj. Pastaj u hartuan plane më të mëdha. Në radhë të parë Partia u kujdesua që fshatarësia e varfér të bëhej me tokë dhe gradualisht të vihej në rrugën e kolektivizimit. Njëkohësisht filloi ndërtimi i objekteve industriale, duke ngritur ato lloj fabrikash, që do t'i jepnin popullit mallrat, për të cilat kishte më shumë nevojë, si ushqime e veshmbathje. U vunë në shfrytëzim minierat ekzistuese dhe u hapën të tjera të reja.

Planet e Partisë po realizoheshin me sukses. U ngriten oxhaqe të reja, fshati filloi të gjallërohet, vendin e par mendës së drurit filloi ta zinte traktori, u shpërndanë farëra të zgjedhura e plehra kimike. Fshatari punonte me gëzim, se e dinte që tanë punonte përveten e tij, por njëkohësisht ai duhej edhe të mësonte

dhe e dëgjoi fjalën e Partisë. Qindra shkolla të reja u hapën kudo në Shqipëri.

Tani pas 17 vjetësh ne kemi krijuar industrinë tonë moderne, kemi zgjeruar shumë sektorin e minierave, realizuam në përgjithësi kolektivizimin e bujqësisë dhe konstatojmë me kënaqësi se çdo vit që kalon jeta e popullit tonë bëhet më e begatshme, më e lumbtuar. Dyqanet tona kudo janë plot, shohim se edhe në këto vitet e fundit, megjithëse të vështira prej thatësirës së madhe, popullit nuk i ka munguar as buka, as mishi, as vaji, as djathi e as qumshti. Vështirësitë kurdoherë janë kapërcyer, si rezultat i vijës së drejtë ekonomike dhe politike që përpunoit dhe ndjek Partia jonë dhe i ekzistencës së pushtetit popullor.

Në vendin tonë është krijuar edhe një inteligjencë e re e dalë nga gjiri i popullit. Pas Çlirimt, kur morëm pushtetin në dorë, skeptikët na «qanin hallin», si do t'ia bënim, duke thënë: «Ata që janë tani në krye, janë njerëz të pamësuar, si do të punojnë në këto fabrika pa mjeshtra, pa specialistë që të njohin teknikën e re» etj., etj. Por Partia hapi nga të gjitha anët shkolla, se e dinte që pa arsim nuk ndërtohet socializmi. Me qindra e me mijëra janë ata që në Shqipëri kanë kryer shkolla të larta e të mesme. Tani në çdo 5 veta, njëri mëson dhe ky numër çdo vit do të vijë duke u shtuar. Sot ne shohim me kënaqësi që kemi kuadro të zotë në çdo sektor, besnikë të Partisë e të popullit.

Të dashur shokë, plani ynë i tretë pesëvjeçar, që aprovoi Partia në Kongresin IV, do ta bëjë Shqipërinë më të bukur, popullin akoma më të lumtur. Ne ndiejmë

kënaqësi dhe zemra na mbushet me kurajë të madhe kur shohim, se në këto momente, sidomos sivjet që kemi hasur në mjaft vështirësi, një entuziazëm i papërshkruar ka shpërthyer në popull, një mobilizim që s'është parë kurrë gjatë këtyre 17 vjetëve. Plani i vitit të parë të pesëvjeçarit jo vetëm po realizohet, por edhe do të tejkalohet. Këtë mrekulli e kanë bërë populli ynë, klasa jonë punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia dhe gruaja heroike shqiptare, specialistët tanë të mrekullueshëm. N. Hrushovi, duke tërhequr padrejtësisht specialistët sovjetikë nga Shqipëria, kujtonte se ne do të mbeteshim me gisht në gojë, se fabrikat nuk do të punonin, minierat do të mbylleshin, do të paralizohej jeta ekonomike e vendit dhe Partia e Punës e Shqipërisë do t'i gjunjëzohej atij. Por kjo nuk ndodhi dhe N. Hrushovi mori përgjigjen e merituar bashkë me të gjithë armiqtë e brendshëm, që kishin ngritur veshët.

Vija e Partisë është të ecim kurdoherë përpara, të punojmë për popullin dhe ta bëjmë jetën e tij gjithnjë e më të gjëzuar. Dhe ne jemi të sigurt se plani i tretë pesëvjeçar do të realizohet e do të tejkalohet me sukses. Për këtë qëllim është siguruar çdo gjë, pavarësisht se Hrushovi dhe miqtë e tij i prenë kreditë vendit tonë. Por Shqipëria ka miq besnikë të mëdhenj dhe jo vetëm Kinën e madhe, që na u ndodh shumë. afér në këto kohë të vështira. Ne jemi të bindur se do të vijë dita që Hrushovi dhe grupi i tij do t'i japin llogari popullit sovjetik për të gjitha këto që bëjnë.

Në vedin tonë gjatë këtij pesëvjeçari industria do të zgjerohet me fabrika e me kombinate të reja. Në

Berat do të ndërtohet një kombinat i ri i madh tekstilesh dhe vajzat tona janë të gëzuara se do të shkojnë të punojnë atje dhe do të prodhojnë stofa për veshje më të bukura dhe më të lira. Populli do të ketë edhe triko, këpucë e çdo gjë tjetër, më të bukura e më shumë. Edhe këtu në Gjirokastër do të ngrihet një fabrikë për këpucë. Gjithashtu në vendin tonë do të ngrihen fabrika çimentoje, nga të cilat njëra e madhe, të tjerat, më të voglat, do t'i ndërtojë klasa jonë punëtore me mundësitë tona të brendshme, për të pasur më shumë çimento për ndërtim fabrikash, shkollash, hauzesh, kanalesh dhe shtëpish banimi në fshatra e në qytete. Këto male e këto gërxhe që ishin dhe janë kështjella për mbrojtjen e lirisë sonë, janë bërë sot edhe një burim i madh pasurimi. Ju e dini se kemi zbuluar dhe kemi hapur minierat e hekur-nikelit me një përmbajtje shumë të lartë industriale, të cilat na hapin perspektiva të shkëlqyera në përpunimin e hekurit në vend. Tani ne kemi një potencial të mirë ndërtimi, prandaj, veç objekteve ekonomike, do të ndërtojmë më shumë edhe shtëpi banimi për popullin, mirëpo mungesat në hekur dhe në çimento na pengojnë, por edhe këto do t'i sigurojmë. Kush ka çimento e sidomos industri të përpunimit të hekurit, ai ka një bazë të fuqishme ekonomike dhe mbrojtëse. Kjo nuk do të thotë se tani nuk bëjmë ndërtime. Ja edhe në këtë shesh, po ndërtohet një hotel, më poshtë godina e komitetit të Partisë, nga ana tjetër e qytetit një lagje e tërë është ndërtuar. Mendoni ç'bëhet në gjithë Shqipërinë, qytete të reja ndërtohen, të vjetrat zbukurohen!

Mjaft fabrika të reja do të ndërtohen gjatë pesë-

vjeçarit. Edhe gjilpërat përpara i sillnim nga jashtë. Tani shumë mallra që i duhen popullit do t'i bëjmë në vend. Plani parashikon që edhe këtu në Gjirokastër të ndërtohet një uzinë metalike, që do të prodhojë thika, lugë, pirunë, çadra etj., për gjithë Shqipërinë. Bashkë me industrinë do të zhvillohet në një shkallë të gjerë artizanati, sidomos për eksport. Ato qendra pune, që deri tani kanë formën e punishteve të thjeshta, brenda disa vjetëve do të bëhen ndërmarrje të rëndësishme me prodhim më të madh e më të përparuar.

Në këtë pesëvjeçar do të hidhet baza e industrisë kimike për prodhimin e plehrave, të cilat do të ndihmojnë për shtimin e prodhimeve bujqësore. Shikoni ç'�ov të madh i ka dhënë tani kolektivizimi prodhimit bujqësor e blegtoral! Fushat janë pastruar nga ferrat, shkurret, gjerdhet, në to punojnë qindra e qindra traktorë, mijëra të tjerë do të importohen gjatë pesëvjeçarit. Kjo punë ka ndihmuar që të shtohen prodhimet. Tani fshatarësia e ka kuptuar rëndësinë e jetës dhe të punës së përbashkët, kjo është vendimtare, dhe ajo rron si një familje e madhe, të gjithë për një e një për të gjithë, punon e organizuar dhe me vullnet të madh. Ajo, gjithashtu, e ka kuptuar se një bujqësi e përparuar intensive lyp mësim dhe edukim. Prandaj kooperativistët mësojnë me etje të madhe eksperiencën e përparuar dhe metodat e reja agroteknike. Iku ajo kohë kur metodat e reja në prodhim futeshin me vështirësi, tani mjafton që njerëzit të sqarohen dhe menjëherë e rrëmbejnë metodën e re dhe e vënë në jetë. Prandaj në këto kushte që janë krijuar, rendimentet në bujqësi do të dyfishohen dhe do të trefishohen, sidomos me ngritjen e

uzinave për prodhimin e plehrave kimike. Kjo do të thotë që populli të ketë prodhime më të shumta dhe më të lira. Atë që porosit Partia populli e vë në jetë dhe e zbaton me ndërgjegje se çdo gjë bëhet për të mirën e tij. Ai ka besim se planet e Partisë do të zbatohen me sukses.

Minierat tona, që tani janë vënë në shfrytëzim të plotë, këtë pesëvjeçar do të zgjerohen, do të mekanizohen e do të prödhojnë më shumë. Parashikimet edhe në këtë sektor jo vetëm realizohen, por edhe tejkalojen. Kjo ndodh se kuadrot tanë u janë qepur maleve dhe gërxheve dhe kanë dhënë rezultate të shkëlqyera në punë. Minierat janë një pasuri e madhe për popullin tonë. Ju e dini Minierën e Bakrit në Rubik, por tani gjeologët tanë kanë zbuluar një minierë të pasur bakri në Gjegjan të Kukësit, me perspektivë të shkëlqyer në prodhimin e këtij minerali. Miniera e Gjegjanit është me rëndësi të madhe dhe do të numërohet si një nga minierat më të rëndësishme të vendit për nxjerrjen e bakrit. Kështu në Gjegjan do të ngrihet një industri e re për përpunimin e bakrit me materiale të brendshme, me zotësinë e punëtorëve, të teknikëve dhe të inxhinierëve tanë.

Kur shkon në Tropojë, para se të arrish në vend, të del përpara madhështor mali i Shkëlzenit mbuluar me borë. Ai të kujton luftërat heroike të të parëve tanë kundër turqve ose kralëve të Serbisë; atje është derdhur gjaku i vëllezërve tanë kosovarë që kanë luttuar kundër Turqisë, kundër lordit anglez Bikonsfild, kundër Bismarkut, që donin ta copëtonin Shqipërinë. Atje te Shpella e Dragobisë, ka luftuar heroikisht patrioti i madh, Bajram Curri. E tani në faqet e atij mali

gjeologët tanë me kilometra të tërë kanë zbuluar mineral alumini me përbajtje të lartë për të mirën e popullit tonë.

Nuk do të bënim gabim, në qoftë se do të thoshim se situata jonë e brendshme është e mirë jo vetëm nga ana politike, por edhe nga ana ekonomike. Ky vit është një vit mesatar për bujqësinë, kurse në industri plani po tejkalohet. Drithërat dolën më mirë se vjet, por nuk i realizuam dot sipas planit për arsyet e tjetër, prandaj pambuku dhe kulturat e tjera do të realizohen, ndërsa plani i frutave e i perimeve është tejkluar. Në të katër anët e Shqipërisë prodhimi i rrushit ka qenë i bollshëm, po, nga sa kam mësuar, vetëm ju këtu në Gjirokastër keni ngrënë pak rrush. Prandaj hiqjuni veshin atyre të tregtisë se rrush ka kudo. Po mua më duket se këtu dardha, fiq, shalqij etj., ka pasur.

Rëndësi të madhe ka fakti që populli është furnizuar mirë me ushqime dhe do të vazhdojë të furnizohet rregullisht edhe gjatë dimrit. Krejt ndryshe ndodh jo vetëm në vendet kapitaliste, ku një pjesë e klasës punëtore vuau nga papunësia, por edhe në disa vende socialiste të Evropës, ku ka filluar të ndahet buka me racion, të mungojë mishi, megjithëse janë më të përpunuara nga ne në bujqësi. Kurse te ne nuk mungojnë prodhimet blegtoriale, frutat e perimet dhe çdo gjë tjetër. Njerëzit e Partisë dhe të pushtetit tonë luftojnë që ta rregullojnë mirë ekonominë. Neve, gjirokastritëve, na thonë se «lidhim macen kur hamë bukë» (*të qeshura*). Por çështja e të shpenzuarit me ekonomi e me llogari është

sot në rendin e ditës si për tërë vendin tonë ashtu edhe për çdo familje. Pra le të bëjnë si gjirokastritët edhe banorët e krahinave të tjera, kjo është një gjë e mirë. Pra popullit as i ka munguar, as ka për t'i munguar gjë. Vetëm se duhen bërë të gjitha përpjekjet për realizimin e planit sidomos në bujqësi, prandaj të synohet që të kryhen mirë punimet e stinës, t'u bëhen shërbimet e duhura të gjitha kulturave, të punohet për kullimin e tokës dhe në kohën e shirave, në pranverë, këto punë t'i kemi të kryera. Tokat të punohen thellë, të bëhen sa të jetë e mundur më shumë toka qilizmë dhe të luftohet për të shtuar sipërfaqet e ujitshme. Ju e keni realizuar planin e ujitjes sivjet, por keni rezerva shumë më të mëdha, të cilat t'i shfrytëzoni. Bëni prita dhe hauze për të luftuar me sukses thatësirën, motra e vëllezër të Dropullit, derisa Partia dhe Qeveria të vendosin për sistemimin e fushës suaj të bukur.

Të keni parasysh që në radhë të parë të shtojmë sasitë e drithërave të bukës. Buka është para së gjithash. Pa bukë nuk kemi mbetur dhe kurrë nuk do të mbetemi. Rezervat e shtetit me drithëra nuk kanë qenë kurrë kaq të mëdha sa tani, prandaj asnjeri të mos ketë frikë për bukë. Për këtë qëllim ne kemi pasur dhe kemi ndihmën internacionaliste vëllazërore të Kinës së madhe të Mao Ce Dunit.

Disa pëshpëritin vesh më vesh e thonë: «E, sa larg është Kina!». Po kohët kanë ndryshuar, nuk janë më kohët e para. Le të jetë larg deri në fund të botës. Tani largësitë gjeografike as që llogariten; Kina është afër Shqipërisë, këtë le ta kenë parasysh ata që mbaj-

në shpresa të kota. Në shekullin e leninizmit në Tokën tonë nuk ka largësi gjeografike. Gjithashtu ne kemi miq edhe shumë vende, popuj e parti të tjera. Sidoqoftë gjendja ekonomike e vendit tonë është e mirë, dhe në këto baza ta forcojmë edhe më shumë atë.

Por, që të jetë kurdoherë e shëndoshë situata në popull, duhet të ekzistojë një fryshtë revolucionare, të ketë bashkim dhe kompaktësi, singjeritet dhe dashuri të thellë në mes të njëri-tjetrit, në mes të popullit dhe Partisë. Kjo kompaktësi në vendin tonë sot është më e fortë se kurrë. Partia dhe populli janë një, të lidhur si mishi me koskën dhe nuk ka as forcë, as intrigë që ta çajë unitetin e tyre. Mbaruan historitë e vjetra toskë e gegë, myslimanë e të krishterë. Të gjithë jemi një e të pandarë rrreth Partisë sonë të dashur, të gjithë jemi një e të pandarë për mbrojtjen e interesave të atdheut dhe për mbarëvajtjen e tij, për të ndërtuar një jetë të lumtur, për ruajtjen e lirisë dhe të pavarësisë së popullit. Kurrë nuk është parë në vendin tonë një kompaktësi kaq e madhe, në një situatë të vështirë si tani. Kjo është garanci për fitoret tona të sotme dhe të nesërme, është garanci se këtë vend dhe këtë popull nuk ka forcë që t'i mposhtë.

Faktor tjetër që situata jonë është e mirë dhe e shëndoshë është dashuria e popullit për atdheun e tij, mbrojtja e kufijve të Republikës. Ne kemi një ushtri të fortë si çeliku, të disiplinuar dhe besnikë deri në fund për ruajtjen e interesave të popullit, e përbërë nga bijtë e këtij populli, e udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme. Ushtria jonë ka një eksperiencë të pasur

dhe një besim të madh për vijën e drejtë të Partisë. Ishte Partia ajo e cila, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, rrënijoste në zemrat e partizanëve idealet dhe interesat e larta të popullit, u bënte të qartë rrugën e vësh-tirë që duhej ndjekur, por që do të na çonte në fitore. Pas Çlirimit Partia i edukoi e i mësoi kuadrot e ushtrisë në shkolla dhe në akademi, i bëri njerëz të zotë, u dha dituri dhe tani ata janë të gatshëm dhe të aftë ta drej-tojnë si duhet ushtrinë dhe të mundin çdo armik, janë të mësuar e janë të stërvitur për të përdorur çdo armë, edhe nga ato më modernet. Oficerët tanë janë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, njerëz të dashur me ushtarët dhe me popullin, njerëz të dashur të Partisë. Në çdo kënd të atdheut ushtria jonë qëndron në gatishmëri të plotë, roje vigjilente e atdheut tonë të dashur.

Ne kemi armën e sigurimit, rojet e kufirit, armë besnike e të lavdishme dhe shumë të dashura të popullit, që vigjëlojnë ditën dhe natën për ruajtjen e kufive të atdheut nga çdo armik, për mbrojtjen e interesave të popullit nga armiqtë e brendshëm, të hapurose të fshehtë. Përveç kësaj populli ynë është ushtar e i preqatitur për mbrojtje. Në vendet e tjera nuk ia jepin në dorë armët popullit, kurse te ne Partia ia jep, sepse populli është një me Partinë. Situata te ne është e fortë, e shëndoshë, ajo na jep mundësi të ecim përpara pa frikë e pa druatje, për të korru r suksese akoma më të mëdha. Dhe këtë situatë të favorshme ne ia detyrojmë unititetit në mes popullit e Partisë.

Shqipëria është dhe do të mbetet një vend socialist. Le të lehin sa të duan armiqtë dhe kun-

dërshtarët tanë, ky është dhe do të mbetet realitet e nuk mund të ndryshohet për hatrin apo për qejfin e N. Hrushovit, T. Zhivkovit ose V. Ulbrihit. Këtë realitet e ka vendosur marksizëm-leninizmi, të cilin e zbaton me bcsnikëri PPSH. Marksizëm-leninizmi nuk njeh pengesa. Karl Marks luftonte i vetëm kundër borgjezisë së Tierit, kundër ushtrisë së Bismarkut, kurse klasa punëtore franceze po me idetë e Marksit u ngrit dhe vendosi me luftë Komunën e Parisit. Në Bashkimin Sovjetik, populli, nën udhëheqjen e Leninit, mundi carin, borgjeczinë, intervacionistët dhe bëri të triumfonte Revolucioni i madh i Totorit. Më vonë nën udhëheqjen e Stalinit populli mundi trockistët, buharinistët, zinovievistët etj. dhe forcoi pushtetin sovjetik. Pastaj në Luftën e madhe Patriotike, shpartalloi hitlerianët dhe ndihmoi në çlirim e popujve të Evropës nga zgjedha nazi-fashiste. Kështu idetë e marksizëm-leninizmit kanë pushtuar vazhdimisht mendjet dhe zemrat e popujve. Kjo ka ndodhur edhe në Shqipëri, të cilën nuk ka forcë në botë që ta tundë, sepse në krye është Partia, që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi. Vend i ynë ka plot shokë dhe miq që e duan shumë dhe jo më kot, por për këtë popull heroik, luftëtar e të pamposhtur që nuk njeh disfata, për këtë Parti heroike e sypatrembur, që ka nxjerrë nga gjiri i vet ky popull.

Ne jemi më të fortë, shumë më të fortë nga imperialistët. Ky është fakt i padiskutueshmë. Çdo vit që kalon imperialistët dobësohen, kurse ne forcohem. Sa më shumë dobësohet imperializmi, aq më tepër përpinqet për të zgjatur jetën. Për këtë qëllim ai vazhdi-

misht armatoset, me qëllim që të shpërthejë një luftë të re botërore. Imperializmi është për luftën, kurse ne jemi për ta ndaluar atë, jemi për paqen.

Imperializmi, për arritjen e planeve që kurdis, përdor edhe vegla. Vegla e tij kryesore është revizionizmi modern, i cili është agjenturë e imperializmit dhe nën maskën e komunizmit përpinqet ta dobësojë ose ta shkatërrojë këtë. Të shkatërrosh komunizmin do të thotë të shkatërrosh partitë komuniste, do të thotë të futësh popujt nën robërinë e kapitalit. Një punë të tillë bën revizionizmi, prandaj paguhet mirë nga kapitali.

Në politikën e jashtme Partia jonë ka ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Përsa i përket çështjes se si duhet t'i imponohet paqja imperializmit dhe si të evitohet lufta, Partia jonë, PK e Kinës dhe mjaft parti të tjera nuk janë dakord me vijën që ndjek N. Hrushovi. Ai ka pikëpamje oportuniste, revizioniste dhe mendon se me bisedimet që mund të bëjë me krerët e imperializmit, me Ajzenhauerin, me Kenedin, me Makmilanin e të tjerë, me lajka ndaj atyre, këta mund të gënjen e të çarmatosen. Sipas tij paqja mund të arrihet duke fjetur mendjen se imperializmi amerikan nuk është më ai i mëparshmi, domethënë nuk është agresiv, pra ka ndryshuar e nuk mund të shpërthejë më luftëra.

Partia jonë nuk është e këtij mendimi. Imperialistët vërtet janë dobësuar, por në themel të sistemit të tyre është lufta, grabitja, ata janë luftënxitës dhe të gatshëm të sulmojnë çdo popull, që do ta gjejnë në gjumë ose të dobët. Prandaj ne themi që të jemi vigjilëtë dhe të gatshëm për mbrojtje, pse imperializmit

nuk i zihet besë. Partia jonë thotë që imperialistëve t'u nxjerrim pengesa të panumërtë, që të mos jenë në gjendje të shpërthejnë luftën, të ngrihen punëtorët dhe të gjithë punonjësit në vendet kapitaliste, me anë grevash e demonstratash, për të kundërshtuar armatosjen e imperialistëve amerikanë.

Por N. Hrushovi, që hiqet si komunist, nuk është në një mendje me ne. Në të vërtetë ai nuk është marksist. Ai ka bërë të gjitha përpjekjet të afrohet me imperialistët dhe me revizionistët në dëm të komunizmit. Ai ka bërë çdo përpjekje që të na futë në rrugën e tij antimarksiste, por Partia jonë ka qenë dhe do të jetë deri në fund në kundërshtim me pikëpamjet e tij revizioniste. Ne themi se forcimi i vendeve sociale dhe i unitetit të tyre, mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, kërkon një luftë të pamëshirshme kundër revizionizmit duke u mbështetur në doktrinën leniniste. Kush nuk ecën në rrugën e Leninit, ai rrëshqet nga binarët e marksizëm-leninizmit. Dhe jeta i ka dhënë të drejtë Partisë sonë. 20 vjet me radhë po lufton Partia jonë kundër revizionistëve të Beogradit, të cilët janë munduar ta robëronin atdheun tonë, ta shkattërronin Partinë tonë dhe ta bënин Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Por Partia u ka trenguar gjithmonë vendin. Për këto qëndrime të drejta, që mban Partia jonë, N. Hrushovi na qenka zemëruar.

Edhe një gjë tjetër. Ne nuk ishim dakord dhe nuk jemi dakord me trajtimin që ai dhe shokët e tij i bëjnë çështjes së Stalinit. Duke qenë revisionist, Hrushovi ndërmori njërin pas tjetrit shumë veprime antimarksiste, për të shkurorëzuar leninizmin. Ai filloi së pari me aku-

za dhe me shpifje ndaj Stalinit dhe pastaj ndaj shokëve të tij, që ndiqnin me besnikëri rrugën marksiste-leniniste. Nën udhëheqjen e Stalinit u dërrmua kundërrevolucioni në Bashkimin Sovjetik, u forcua Ushtria e Kuqe, u ndërtua industria e fuqishme socialiste dhe rendi kolkozian, ndryshoi jeta e Rusisë cariste dhe e popujve që përbëjnë sot Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike, u shpartallua Gjermania hitleriane, u çiruan vetë popujt e BRSS dhe vendet e pushtuara të Evropës e të Azisë. N. Hrushovi, që deri përpara se të vdiste Stalini i thurte lëvdata, pas vdekjes së tij filloi nga veprimtaria antimarksiste, me qëllim që të përhapte me lehtësi pikëpamjet e tij revisioniste. Prandaj ai ngriti çështjen e kultit të individit të Stalinit, dhe sikur gjoja në kohën e këtij në BRSS janë bërë vrasje e gjithfarë krimesh. Kjo është njëloj sikur të ngrihen tradhtarët e popullit, të marrin pushtetin dhe të thonë se Partia ka vrarë e ka prerë miqtë e tyre. E vërteta për Stalinin nuk është si thotë Hrushovi. Prandaj Partia janë dhe shumë parti të tjera nuk janë dakord me të.

Edhe gjatë këtyre 7-8 vjetëve që N. Hrushovi ka ardhur në fuqi, jeta ka vërtetuar se vija e Partisë sonë është e drejtë. Ne kemi konstatuar, se fjalët e Hrushovit për Ajzenhauerin si «një burrë shteti që e do paqen dhe gjëzon besimin e plotë të popullit amerikan» etj. jeta i ka hedhur poshtë. Me ardhjen e Kenedit në fuqi Hrushovi filloi të përhapë iluzionin se «në Shtëpinë e Bardhë kanë ardhur njerëz të rinj, me të cilët mund të bisedohet dhe të arrihet në rezultate për paqen». Po vallë a mund të besohet që imperializmi agresor dhe

luftënxitës amerikan t'i japë kolltukun presidencial një njeriu që do me të vërtetë paqen e popujve? Këtë prof-kë mund ta fabrikojnë e ta besojnë vetëm tradhtarët e tipit të Hrushovit, vetëm ata që oportunizmi në politikë i bën me domosdo edhe sharlatanë në gjykimin dhe në vlerësimin e fenomeneve reale. Kush është në realitet presidenti Kenedi? Gjithë bota e di se është pikërisht ai që e zhvilloi si kurrë më parë luftën në Vietnam, është ai që dërgoi e dërgon atje me mijëra e mijëra ushtarë janki për të shfarosur popullin e vuajtur e liridashës vietnamez. Me emrin e Kenedit janë lidhur krimet më të ulëta në Angola, në Kongo e gjekë, duart e tij janë të lyera me gjakun e njerëzve të pafajshëm dhe liridashës, ashtu siç janë lyer dhe duart e Ajzenhauerit, bile Kenedi është më i poshtër se paraardhësi i tij dhe s'mund të jetë ndryshe. Pra, në politikën e jashtme, vija e N. Hrushovit nuk dha asgjë,jeta po vërteton tezat e Partisë sonë.

Neve na vjen shumë keq për Bashkimin Sovjetik, por është fakt që ka dështuar si politika e jashtme ash-tu edhe politika e brendshme e N. Hrushovit, sidomos në bujqësi. Ai bëri shumë plane për bujqësinë, por asgjë nuk mundi të realizonte, me gjithë potencialin e madh ekonomik dhe teknik që disponon shteti sovjetik. Ai bëri ndryshime të shumta në organizimin e ekonomisë dhe të administrimit të saj, që nuk dhanë rezul-tate dhe tani na del sikur fajin na e paskan disa sekre-tarë të parë krahinash ose rajonesh, të cilëve u vuri fshesën.

Punët, pra, N. Hrushovit nuk i shkonin mirë as brenda as jashtë, prandaj ai duhet të përdorte grush-

tin antimarksist, për të nënshtuar ata që s'i bindeshin në lëvizjen komuniste botërore. Për këtë qëllim organizoi një komplot të madh në Bukuresht, ku në mënyrë të befasishme donte të hidhte RP të Kinës jashtë kampit socialist, duke akuzuar PK të Kinës si një parti antimarksiste.

Si rezultat i qëndrimit të drejtë e të vendosur marksist-leninist të Partisë sonë dhe të PK të Kinës Hrushovi nuk ua arriti dot qëllimeve të tij antimarksiste në Bukuresht. Por, sidoqoftë ai nuk hoqi dorë nga qëllimet e tij, prandaj në Mbledhjen e Moskës të nëntorit 1960 bëri të gjitha përpjekjet dhe përdori të gjitha intrigat për të gënjer ose për të gjunjëzuar Partinë tonë, e cila nuk i nënshtrohej diktatit të tij tradhtar.

Por Partia jonë nuk gënjehet lehtë se për 20 vjet me radhë ka qenë në luftë me armiqtë e Partisë dhe të popullit tonë, imperialistët, revisionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë dhe ishte në gjendje të kuptonte ku ishte e drejta dhe ku ishte e padrejta. Partia jonë në Mbledhjen e Moskës e tha haptazi përpara të gjitha partive atë që mendonte dhe kjo ishte një gjë normale. Por Hrushovi me shokë u tërbuan nga qëndrimi i Partisë sonë. Duhet thënë drejt se në Mbledhjen e 81 partive në nëntor 1960 në Moskë pati diskutime të shumta, sidomos në komisionin pregatitor. Pikëpamjet e Partisë sonë, të PK të Kinës dhe të disa partive të tjera, sidomos të vendeve të Azisë me gjithëse këto parti përbënë pakicën, triumfuan dhe u vunë në Deklaratën që aprovoi kjo mbledhje, ndërsa projektdeklarata e paraqitur nga grupi i Hrushovit u ndryshua rrënjosht.

N. Hrushovi mendoi të na nënshtonte ekonomikisht, dhe kujtoi se, po të priste kreditë, Shqipëria do të vdiste për bukë dhe do t'i përulej. Ne i kishim firmosur marrëveshjet për pesëvjeçarin e tretë në nivelin më të lartë, por udhëheqësit sovjetikë na ftuan të shkonim prapë në Moskë për t'i parë dhe një herë. Qëllimi ishte që ne të shkonim t'u përuleshim.

Si e panë se ne as ekonomikisht nuk u përulëm, atëherë u përpoqën të na frikësonin ushtarakisht. Me BRSS ne kishim një marrëveshje për bazën ushtarako-detare të Vlorës. Një pjesë e anijeve luftarake ishin në duart e djemve tanë, që i manovronin ato me zotësi të madhe. Në bazë të marrëveshjes midis dy shteteve, të gjitha anijet në bazën e Vlorës na përkisnin neve, prandaj ne duhej t'i merrnim në dorëzim. Për këtë qëllim Partia kishte preqatitur edhe kuadrot. Duke parë rezistencën e Partisë sonë kundër kursit të tij anti-marksist, Hrushovi me grupin e tij u përpoqën të shtinin në dorën e tyre bazën e Vlorës. Po Vlora ka zot, dhe ky zot është populli shqiptar. Ushtarët dhe oficerët tanë, në çdo rast, kanë treguar shembuj të lartë heroizmi dhe zotësie luftarake për mbrojtjen e atdheut dhë të socializmit nga çdo armik, prandaj në bazë të këtij vlerësimi dhe të marrëveshjes midis dy shteteve, baza e Vlorës do të mbetej shqiptare. Iku ajo kohë kur Ibrahim Pasha i Beratit, të cilin Ali Pashë Tepelena e kishte vënë përpara, i propozonte një gjenerali të Napoleon Bonapartit t'i shiste Vlorën «për 40 aspra», për të shpëtuar kokën. Iku ajo kohë kur bejlerët dhe Zogu shisnin Vlorën dhe Sazanin, Vermoshin dhe Shën Nau-min, iku ajo kohë kur revisionistët jugosllavë u për-

poqën me dinakëri të dërgonin divizionet e tyre në Shqipëri që të mbështetnin Koçi Xoxen me shokët e tij dhe ta kthenin Shqipërinë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Edhe Hrushovit Partia i tha: Vlora ka qenë, është dhe do të mbetet shqiptare e nën drejtimin e Partisë sonë dhe baza e saj ushtarake është e Shqipërisë socialiste.

N. Hrushovi, si e pa që nuk ia doli dot Shqipërisë, mendoi t'i jepte «grushtin e fundit», prandaj organizoi në Kongresin XXII të PK të BS një sulm të ri antimarksist kundër Partisë dhe vendit tonë. Ai pati frikë të bënte një mbledhje të re të partive, prandaj në këtë kongres revizionist nuk e ftoi Partinë e Punës të Shqipërisë, me qëllim që ta sulmonte në mungesë. Por edhe në këtë ndërmarrje Hrushovi dështoi. Ai kujtoi se do t'i kishte me vete të gjitha partitë kundër Partisë sonë, po nuk i doli ashtu si mendonte.

N. Hrushovi bëri një krim shumë të madh duke shpallur botërisht mosmarrëveshjet që ekzistonin në kampin socialist, në vend që të përpinqej me durim për t'i zgjidhur ato. Duke qenë se Partia jonë është e vogël, ai mendonte se mund të bënte si të donte me të, por për marksizëm-leninizmin të gjitha partitë e klasës punëtore janë njëlloj. Për krimin shumë të rëndë, që bëri Hrushovi, i cili i vuri zjarrin kampit socialist, natyrisht, asnje marksist nuk pret që ai të bëjë autokritikë, po jemi të bindur se do të dështojë.

As dy javë s'kanë kaluar pas mbarimit të Kongresit XXII të PK të BS dhe miqtë e Hrushovit, që

folën ndonjë fjalë në favor të tij në kongres, i drejtøjnë Komitetit Qendror të Partisë sonë fjalë të mira dhe i kërkojnë falje, duke thënë se s'kishin si të bënин ndryshe, por rruga e Partisë së Punës të Shqipërisë është e drejtë, prandaj na drejtohen me fjalët: «Qëndroni se edhe te ne keni me qindra mijëra miq, ne jemi plotësisht të bindur për rrugën tuaj të drejtë!».

E tillë është situata, shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër. Ne jemi duke kaluar disa vështirësi në fushën ndërkombëtare, në lidhje me marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, por jemi të bindur se këto do të kapërcehen. Ne kemi kapërcyer vështirësi të tilla të mëdha edhe herë të tjera dhe jemi mësuar. Prandaj i themi dhe ia kemi përsëritur N. Hrushovit se me Shqipërinë dhe me popullin shqiptar nuk lejojmë të luhet. Ne e ndjekim me besnikëri vijën e bashkekzistencës paqësore, por atë bashkekzistencë, që na kanë mësuar Lenini dhe Stalini, jo atë të revizionistik Hrushov. Ne duam të kemi marrëdhënie të mira me qeverinë jugosllave, por kurrë nuk do të pushojmë së demaskuari politikën proamerikane dhe qëndrimet antimarksiste të klikës titiste. Ne bëjmë tregti dhe duam ta vazhdojmë tregtinë me Jugosllavinë. Gjithashtu ne duam të kemi marrëdhënie të mira edhe me Greqinë, pavarësisht se çfarë regjimi ekziston në këtë vend.

Po N. Hrushovi i kuption ndryshe këto çështje. Ai e kuption ndryshe bashkekzistencën tonë me Greqinë dhe me Jugosllavinë. Ai do që ne të pushojmë menjëherë luftën politike dhe ideologjike kundër revizionistëve jugosllavë. Bashkekzistencën tonë me Greqinë

N. Hrushovi e kupton që ne t'i japim asaj të drejtën për të gllabëruar Korçën dhe Gjirokastrën, për të cilat borgjezia greke ka pretenduar prej kohësh. Kjo është një ëndërr e vjetër. Sidomos pas Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë të vitit 1912, nën bajonetat e ushtrisë shoviniste greke, qeveria reaksionare e E. Venizellosit shpalli në pranverën e 1914-s të ashtuquajturën «autonomi e Vorio Epirit» si hap të parë për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Por shovinistët grekë, Hrushovi dhe armiqtë e tjerë le ta dinë mirë se kanë perënduar një herë e përgjithmonë ato kohë, kur tokat e Shqipërisë bëheshin monedhë tregu, se Korça dhe Gjirokastra kanë qenë, janë e do të jenë toka shqiptare, se, për të mbrojtur tërësinë e vendit të tij, populli shqiptar në të kaluarën ka derdhur gjak dhe, po të jetë nevoja, do të derdhë edhe në të ardhshmen.

Ju të gjithë e dini se ç'ishte «autonomia e Vorio Epirit». Si shumë nga ju edhe unë isha i vogël në kohën e kësaj «autonomie», po baballarët dhe gjyshërit tanë e dinin më mirë ç'fshihej prapa saj. «Autonomia» e Shqipërisë së Jugut, e predikuar prej kohësh dhe e vënë në zbatim nga Elefter Venizelosi dhe Zografoja, synonte copëtimin e Shqipërisë. Në kohën e «autonomisë» u dogjën e u rrafshuan fshatra shqiptare, nga njerëzit e Zografos u therën pleq, gra e fëmijë. Tani i biri i Elefterit, Sofokli Venizelosi shkoi në Moskë dhe i tha N. Hrushovit se «me Shqipërinë ne do të merremi vesh po të bisedojmë edhe për çështjen e «Epirit të Veriut», çështja e të cilit duhet të zgjidhet në formën e autonomisë». Ai e bisedoi këtë çështje të vdekur me Hrushovin se e di mirë në ç'ujëra jeton ky.

Hrushovi, që hiqet si marksist dhe aleat i Shqipërisë, me gjithëse është dhe Sekretar i Parë i KQ të PK të BS, i thotë Sofokliut se «këto çështje ju duhet t'i zgjidhni në mënyrë paqësore, por unë këtë pikëpamje do t'ua them shokëve shqiptarë» dhe me paturpësinë më të madhe na njofton këtë bisedim. Komiteti Qendror i Partisë sonë i ktheu përgjigje të rreptë Hrushovit, duke i thënë se ajo që kishte biseduar me Venizellosin nuk ishte aspak marksiste, se kufijtë e Shqipërisë janë të paprekshëm dhe se në Shqipëri nuk ka asnje pëllëmbë tokë të huaj, përkundrazi rreth kufijve aktualë të vendit tonë ka toka shqiptare. Pra ia hodhëm poshtë bisedimin që bëri me Venizellosin, i thamë se, kur ky reaksionar ngriti pretendimet e tij ndaj Shqipërisë së Jugut, ju në vend që të bisedonit me të duhej t'i kishit treguar vendin.

N. Hrushovit nuk i pëlqen qëndrimi ynë, po nuk prish punë. Vija e Partisë sonë i pëlqen në radhë të parë popullit tonë që mbron atdheun, kufijtë e tij të shenjtë, lirinë dhe pavarësinë e tij. Kjo është marksiste dhe aspak nacionaliste e shoviniste. Kurrë Partia jonë nuk ka shfaqur ndjenja shovinizmi. Një popullsi gati sa Shqipëria jeton në Kosovë, në Metohi, në Maqedoni e Mal të Zi. Kjo popullsi u masakrua, hoqi të zitë e ullirit nga kralët e Serbisë. Kështu po heq dhe në ditët e sotme nga kralët e rinj jugosllavë. Të mbrosh atdheun dhe popullin tënd është plotësisht marksiste. Prandaj Partia jonë, herë pas here ka ngritur zërin për mbrojtjen e të drejtave të vëllezërve tanë në Jugosllavi, po kurrë s'ka ushqyer ndjenja shoviniste.

Revisionistët na akuzojnë sikur ne nuk dëshiroj-

më të bashkëjetojmë me popujt fqinjë ballkanas. Kjo është një shpifje. Si është e mundur që ne, një vend i vogël, të mos dëshirojmë të jetojmë të qetë dhe në marrëdhënie të mira me fqinjët? Po me kë të bashkëjetojmë? Qeveria greke vazhdon të deklarojë se është në gjendje lufte me Shqipërinë, se ajo kërkon Korçën e Gjirokastrën dhe bën provokacione të njëpasnjëshme në kufijtë tanë. Atëherë kush nuk dëshiron të bashkëjetojë?!

Për ne flitet se nuk jemi për çarmatimin, sepse nuk përkrahim propozimin për çarmatimin e Ballkanit. Ne jemi për çarmatimin e Ballkanit dhe të zonës së Adriatikut, por ne nuk mund të pranojmë të çarmatoset Ballkani pa Italinë, e cila brenda më pak se 20 vjetëve ka sulmuar dy herë vendin tonë. Me N. Hrushovin ne kishim rënë dakord për çështjen e çarmatimit të Ballkanit dhe të Italisë, po ai me shokë e kthyen pllakën. Kështu ato që ka deklaruar më parë për çarmatimin e Ballkanit dhe të Italisë duket se kanë qenë profka. Dhe vëmë re që si Greqia, ashtu edhe Jugosllavia jo vetëm që nuk janë çarmatosur, po përkundrazi ato janë armatosur deri në dhëmbë. Për këto arsyë Hrushovi dhe ata që e pasojnë na akuzojnë se jemi kundër bashkekzistencës paqësore, sepse dështoi politika e bashkekzistencës, sigurisht, në kuqtimin e tyre. Por ne nuk jemi në gabim, sepse, në qoftë se veprojmë ndryshe, merren nëpër këmbë interesat e popullit. Populli shqiptar i ka dhënë Partisë së tij besim të plotë, se e di që ajo do ta mbrojë si kurdoherë, pa u përkulur. Ne jemi në rrugë të drejtë dhe e drejta fiton kurdoherë.

Prandaj, me besim të patundur të ecim përpara në rrugën tonë, të vazhdojmë të qëndrojmë kështu të bashkuar, në një unitet të pathyeshëm popull dhe Parti dhe të punojmë me të gjitha forcat për realizimin e planeve tona, për ta bërë popullin gjithnjë më të lumenjtur. Të luftojmë që planet tona të realizohen sa më shpejt për të mirën dhe gjëzimin e popullit tonë.

Sa më vigjilentë të jemi aq më pak rreziqe do të kalojmë. Nga ana tjetër të forcohet vigjilencia revolucionare ndaj atyre që pëshpëritin dhe që mendojnë se taní, që ne kemi kundër edhe Hrushovin, u erdhi dita, por, ne u themi të mos i harrojnë këshillat e Partisë, të shikojnë punën dhe të mos u ngrihet mendja. Ata duhet të mos e kërkojnë tö keqen, se populli dhe Partia janë të fortë e të lidhur si çeliku. Prandaj në qoftë se duan të jetojnë ndershmërisht të kenë parasysh këshillat e Partisë dhe të jenë të sigurt se, po të punojnë me nder, Partia do t'i ndihmojë. Por në qoftë se ndonjërit i merr koka erë dhe ngre dorën, të jetë i sigurt se do ta paguajë mirë, sepse interesat e popullit dhe të atdheut janë mbi të gjitha. Pra vigjilencën ta kemi në rendin e ditës. Armët t'i mbajmë gati dhe barutin të thatë.

Anëtarët e Partisë e kanë për detyrë që popullit t'i flasin hapur, sepse Partia gjithnjë kështu i ka folur popullit. Për këtë arsyen populli e do shumë Partinë. Njerëzit që duan të sqarohen t'i dëgjojnë me vëmendje anëtarët e Partisë. Çdo njeri ka të drejtë të pyesë, dhe ne e kemi për detyrë t'i përgjigjemi. Por të kihet kujdes që pyetjet të mos merren për të keq, të dëgjohen me vëmendje dhe njerëzit të sqarohen me urtësi dhe

me gjakftohtësi. Njëri mund të thotë edhe ndonjë fjalë që s'është në rregull, Partia të ketë durim ta dëgjojë e ta sqarojë. Ajo të luftojë për çdo njeri, bile të përpinqet ta shpëtojë edhe atë që politikisht është i së-murë rëndë. Po çfarë t'i bënte Partia Bedri Spahiut, i cili që kur u themelua Partia e vazhdimisht ka bërrë gabime të rënda? Është lodhur me të Partia duke e ndihmuar. Më së fundi Bedriu e mbushi kupën, ai u bë agjent i revizionistëve jugosllavë, por Partia nuk flinte dhe i tregoi vendin. Pra një njeri që e quan veten revolucionar duhet të jetë konsekuent në jetë. Partia përgjithësisht me njerëzit duhet të jetë dhe është shumë e duruar por, kur ndokush e mbushi kupën, atëherë Partia mbi të gjitha.

Me bcsim të patundur te Partia, me ideologjinë tonë fitimtare, marksizëm-leninizmin, të bashkuar si një trup i vetëm, të ecim gjithnjë përpara për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi dhe për të korrur kurdoherë fitore të reja!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli heroik i rrëthit të Gjirokastrës!

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

RINIA ËSHTË THESAR I MADH I POPULLIT DHE I PARTISË

*Fjala me nxënësit dhe me pedagogët e gjimnazit
të Gjirokastrës*

15 nëntor 1961

Të dashur pedagogë,
Të dashur shokë dhe shoqe shkollarë,

Ju flas «shkollarë» siç na ka quajtur mësuesi juaj i nderuar, xha Thomai¹, që ka qenë dikur edhe mësuesi im.

Jam shumë i gëzuar që po vizitoj shkollën, ku kam pasur nderin të mësoj edhe unë. Në këtë shkollë ne na kanë mësuar mësues të vjetër, si xha Thomai, Hysni Babametoja e shumë të tjerë, për të cilët ruajmë dashurinë dhe respektin më të thellë, sepse ata kanë punuar pa u lodhur, kanë vënë të gjitha forcat e tyre për të mësuar bijtë dhe bijat e popullit dhe sot,

¹ Thoma Papapano (1884-1970) — patriot dhe Mësues i Popullit.

megjithëse të kaluar në moshë, vazhdojnë të punojnë, për t'u mësuar djemve dhe vajzave të popullit gjuhën e bukur amtare, historinë e lavdishme të popullit tonë dhe shkencën. Ne, dhe i gjithë populli, u jemi mirënjohës mësuesve tanë për punën fisnike që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë.

Mësuesit na kanë mbrujtur në shpirt dashurinë e madhe për popull e atdhe dhe ne, tashmë të rritur, sa kemi mundur nuk kemi kursyer dhe nuk do të kursejmë asgjë, vazhdimisht do të vëmë të gjitha forcat, do të shkrijmë gjithë jetën tonë në shërbim të atdheut, që populli ynë të rrojë çdo vit më mirë, më i lumtur e më i gëzuar dhe ju e brezat e ardhshëm të mos shihni kurrë vuajtje e mjerime.

Si çdo njeri që dikur ka qenë nxënës, edhe unë kam kujtimet më të mira e më të embla të rinisë sime për kohën e shkollës. Prandaj, sa herë vij në Gjirokastërën e dashur, ku kam lindur, nuk më rrihet pa kaluar përmes këtyre rrugëve të ngushta me kalldrëm, që i kam shkelur çdo ditë, vetëm ose me shokë, për të ardhur në këtë shkollë ose pér të luajtur këtu afér, në kohën e lirë. Kur shoh rrugët dhe shtëpitë e qytetit tim, më kujtohen ato kohë sa të hidhura aq edhe të vështira, si pér gjithë popullin shqiptar, ashtu edhe pér qytetarët e Gjirokastrës; më kujtohen hallet e shumta të popullit dhe përpjekjet që bënte pér t'i dhënë fund jetës së vështirë, më kujtohen puna e palodhur e mësuesve tanë me ndjenja përparimtare,jeta plot brenga që bënte brezi ynë. Të gjitha këto kujtime kanë bërë që këto rrugë të ngushta plot gurë, këto shtëpi të mbuluara me

dërrasa¹, kjo shkollë, ku unë me shokët e mi mësuam për kaq vjet me radhë, të më jenë shumë të dashura, të shtrenjta dhe të dhembshura.

Kanë kaluar disa dhjetëra vjet që atëherë, por tani kohët kanë ndryshuar shumë, gjendja e popullit tonë është përmirësuar. Kryesorja është që atdheu ynë, Shqipëria jonë e dashur, tani është e lirë dhe e pavarur dhe populli, nën udhëheqjen e Partisë, ndërton jetën e re, socializmin. Këtë ndryshim rrënjosor, shokë pedagogë dhe nxënës, e solli Partia, prandaj ta doni atë me gjithë shpirt, sepse, po të mos ishte ajo, edhe sot e kësaj dite populli do të vuante në robëri, në varfëri e në mjerim. Shqipëria nuk do të ishte e lirë dhe për popullin nuk do të ishin krijuar këto të mira, që sot i gjëzojnë të gjithë.

Pa Partinë në krye do të ishte e pamundur të ngriheshin në të katër anët e Shqipërisë një numër kaq i madh shkollash fillore e 7-vjeçare, nuk do të ishin ngritur me dhjetëra shkolla të mesme, institutet e larta dhe universiteti, populli shqiptar do të rronte në errësirë të madhe, do të vuante edhe për bukën e gojës, pa lëre pastaj të kishte kohë të mendonte për arsimin dhe për kulturën, për një të ardhshme akoma më të bukur. Tani që populli ka në udhëheqje Partinë, është i sigurt se ka përpëra një perspektivë akoma më të lumtur e më të begatshme.

Por të gjithë e dinë sejeta e begatshme, e bukur dhe e kulturuar nuk mund të ndërtohet menjëherë dhe sidomos pa punuar e pa mësuar. Pa punë dhe pa arsim

¹ Në Gjirokastër «dërrasa» quhen plakat e gurit.

nuk ndërtohet socializmi. Prandaj Partia u ka vënë rëndësi jashtëzakonisht të madhe arsimit, shkollës. Ju, nxënëse dhe nxënës të dashur, duhet të bëni përpjekje më të mëdha, për të mësuar sa më shumë dhe po të jetë e mundur të gjitha notat t'i merrni pesa¹. Por kini parasysh që të mos mësoni vetëm për notë. Mësimet që ju japid mësuesit tuaj të dashur e të nderuar, t'i tretni mirë që, kur të shkonit në klasat ose në shkollat më të larta, ato t'ju shërbejnë si një bazë e shëndoshë për të dalë me sukses nga shkolla dhe pastaj, kur të dilni në jetë, ato t'ju shërbejnë për t'i dhënë sa më shumë çështjes së ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë, në çdo sektor të aktivitetit ekonomik, shoqëror, kulturor e artistik ku do të puttoni. Ju kurdoherë duhet të niseni nga qëllimi i lartë i Partisë, që populli në radhë të parë të rrojë i lirë, që Shqipëria jonë e dashur të bëhet çdo vit e më shumë një vend me kulturë të lartë, me një nivel të zhvilluar ekonomik dhe punonjësit të kenë me bollëk të ushqehen, të vishen bukur, të kenë ndërtesa banimi më të shumta, më të bollshme e komode, të kemi akoma më shumë shkolla dhe institucione kulturore. S'ka asnje dyshim se këto objektive do të arrihen në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë dhe me punën e me përpjekjet tona, sidomos duke mësuar sa më shumë.

Të kaluarit në moshë, si i nderuari Thoma Papapano me shokë, si dhe partizanët e të tjera, që morën pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, kanë

¹ Sipas sistemit të atëhershëm të notave, pesa ishte nota më e mirë.

bërë sa kanë mundur për këtë vend, aq sa kanë pasur forca e dituri, por jemi të sigurt se brezat e ardhshëm do t'i kujtojnë për luftën që kanë bërë në emër të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut dhe për punën që po bëjnë për lumturinë e popullit. Por e ardhshmja, akoma më e mirë e këtij vendi është në duart tuaja, të rinisë. Prindërit tuaj hodhën bazat e ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste, ndërsa ju do të ecni me hapa më të shpejtë se ne, të vjetrit, në ndërtimin socialist e komunist të vendit. Brezi ynë krenohet që po i krijon gjithë këto mundësi brezit të ri, për ta bërë atdheun më të bukur e më të fuqishëm, për ta bërë popullin më të lumtur.

Ta doni me gjithë shpirt popullin. Çdo veprim, çdo punë që bëni, ta shihni nën prizmin e interesave të tij dhe të atdheut. Në qoftë se një punë ose veprim që bën njeriu nuk shihet nën prizmin e interesit të përgjithshëm të popullit dhe të atdheut, atëherë bëhet pengesë për zhvillimin e përparimin e vendit. Interesat personale kurdoherë duhet të gërshetohen me interesat e përgjithshme. Kështu na mëson Partia. Sillni ndër mend dëshmorët, heronjtë e Luftës Nacionalçirimitare, mbi gjakun dhe sakrificat e të cilëve janë hedhur themelët e Shqipërisë së re. Kur ata u vunë në shërbim të Luftës Nacionalçirimitare nuk patën parasysh interesat e tyre të ngushta personale, ata sulmuan me guxim armikun, pa menduar rrezikun, që do t'u kushtonte edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën, sepse u udhëhoqën vetëm nga ideali i çlirimtë të atdheut dhe të popullit. Po të niseshin nga pozita të ngushta personale, atdheu nuk do të ishte çliruar dhe si pasojë edhejeta e tyre, ashtu

si e gjithë popullit, do të ngrysej me vuajtje e me mjerime si dhe më parë. Prandaj jetën ata e dhanë me ndërgjegje të plotë për lirinë e atdheut, për lumturinë e popullit, për lumturinë e familjeve të tyre, për brezat e ardhshëm. Partia na mëson që edhe ne, nën shembullin e tyre, të kemi kurdoherë parasysh që çdo veprim dhe çdo punë që bëjmë, të jetë kurdoherë në interes të popullit. Kush vepron ndryshe gabon. Po në jetë mund të ketë dhe ka njerëz që s'janë të qartë, që nuk arrijnë ta kuptojnë kështu çështjen. Partia ka për detyrë t'i sqarojë këta njerëz, t'i ndihmojë dhe t'i sjellë në rrugë të drejtë që edhe ata të bëhen patriotë të mirë, bij dhe bija të denja të këtij populli heroik e të papërkulur.

Sigurisht, me këtë frysme ju edukon ju, shoqë dhe shokë të rinj, organizata e Bashkimit të Rinise në shkollë. Ju duhet të jeni të lumtur që keni një organizatë rinnie të fortë, që ecën sipas mësimeve dhe shembullit të organizatës së Partisë. Forcojeni dhe zgjerojeni pareshtur organizatën tuaj, punoni që të mos mbetet asnjë djalë apo vajzë e shkollës suaj jashtë radhëve të saj. Gjallërojeni organizatën e rinise, kalitni në radhët e saj të reja dhe të rinj të fortë, të çeliktë e të gëzuar, i edukoni ata me të gjitha cilësitë, për t'i bërë të denjë për në Parti, për t'i sjellë asaj gjak të ri, pa të cilin ajo nuk mund as të jetojë, as të forcohet. Partia është juaja, e rinise, ajo është gjithnjë e re. Ligjet e natyrës, pavarësisht nga dëshira jonë, veprojnë objektivisht, ne me kalimin e viteve plakemi, por në Parti vijnë dhe do të vijnë kurdoherë të rinj, prandaj ajo do të mbetet kurdoherë e re, e fuqishme dhe do të mbrojë pa u përkulur marksizëm-leninizmin.

Rinia është thesar i madh i popullit dhe i Partisë. Të rejat dhe të rinjtë punëtorë, fshatarë, nxënës ose studentë, janë të bashkuar si një trup i vetëm rrëth Partisë, e cila tregon një kujdes shumë të madh për rrininë. Ky kujdes do të jetë i vazhdueshëm për ju, si edhe për mësuesit që ju mësojnë dhe ju edukojnë. T'i respektoni dhe t'i dëgjoni me kujdes mësuesit tuaj, sepse ata jetën e tyre e kanë lidhur me ju. S'ka gjëzim më të madh për mësuesin, kur shikon që ju mësoni dhe përparoni. Nuk ka kënaqësi më të madhe për të kur ngre një nxënës në dërrasë të zezë dhe vë re se ai i përgjigjet mirë; për mësuesin ato janë çaste të lumtura. Kënaqësi e veçantë është për mësuesin, kur dëgjon se nxënësit, të cilët dikur ai i ka mësuar dhe i ka edukuar, janë bërë luftëtarë dhe patriotë të zjarrtë për popullin dhe atdheun, sepse e di që në këta njerëz pasqyrohet edhe puna që ka bërë ai në shkollë. Prandaj t'i doni e t'i nderoni mësuesit, edukatorët tuaj, që lodhen e punojnë për ju, të vini tërë forcat që të përvetësoni sa më mirë mësimet që ata ju jasin.

Të dashur pedagogë, nxënës e nxënëse, pionierë dhe fatosa, ju përshëndes dhe ju uroj jetë të lumtur dhe të gjuar! Natyrisht ju, nxënësit, të keni parasysh në radhë të parë mësimet, por edhe sportin të mos e harroni, bile as *arabadaulen*¹. Dua t'ju kujtoj se kur ishim në moshën tuaj s'kishim topa kështu si keni ju sot. Për të luajtur nënrat na preqatitnin atëherë topa

¹ Lojë popullore nëpërmjet së cilës të rinjtë qëndrojnë të përkulur dhe, sipas radhës, me hedhje, kapërcejnë njëri-tjetrin.

prej lecke dhe këmbët na bëheshin plagë, se shumë nga ne luanim zbathur, s'kishim as këpucë. Pastaj për ne të rinjtë në atë kohë s'kishte asgjë me se mund të mërreshim, askush nuk kujdesej për edukimin dhe për dëfrimin tonë jashtë shkollës në mënyrë të organizuar dhe të udhëhequr nga më të mëdhenjtë. Vetëm xha Thomai, me përpjekjet e tij arriti të krijojë një klub, ku shkonim edhe ne të rinjtë. Atje u ngrit edhe një orkestër. Kjo ishte një iniciativë shumë përparimtare për atë kohë të zyrtë. Në klub krijuam edhe grupin teatral, ku vinim në skenë ndonjë pjesë të vogël. Kaq ishte e mundur të bëhej atëherë. Mirëpo edhe këto iniciativa kaq të vogla nuk i pëlqenin regjimit prapanik të Zogut. Sidoqoftë dua të them se edhe në ato kohë të vështira, me punën e palodhur të mësuesve dhe të rinasë, punohej për të mbajtur lart traditat e mëdha patriotike të popullit tonë.

Sot punët janë krejt ndryshe për ju dhe për të gjithë rininë e vendit tonë. Partia ka krijuar mundësi shumë më të mëdha për t'ju aktivizuar në çdo drejtim. Për arsimin, për edukimin dhe për dëfrimin e rinasë tani kujdeset shumë Partia, kujdeset i gjithë populli. Prandaj, ju në radhë të parë, duhet të kujdeseni për mësimet, por mos lini pas dore edhe aktivitetet jashtë shkollorë, edhe lodrat e kulturën fizike, se edhe ato shërbejnë shumë për edukimin dhe për forcimin e shëndetit tuaj, për kalitjen tuaj në mbrojtje të vendit si dhe për edukimin dhe dëfrimin e kolektivit të shkollës. Unë jam i bindur se ju do të bëni të gjitha përpjekjet për t'i kryer me ndërgjegje të lartë detyrat që ju ngarkon Partia, do të mësoni sa më shumë

dhe do t'i ngrini edhe më lart traditat e mira të shkollës suaj.

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë!

Rroftë rinia e lavdishme e vendit tonë!

Rrofshin të rintjtë dhe të rejat e gjimnazit të Gjirokastërës!

Rrofshin mësuesit që ju mësojnë dhe ju edukojnë!

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DIKTATURA E PROLETARIATIT NË SHQIPERI RRON, VIGJELON DHE VEPRON

Fjala me kuadrot e rrethit të Gjirokastrës

15 nëntor 1961

Në mitingun që u zhvillua dje me popullin, unë fola gati dy orë, prandaj në këtë mbledhje me kuadrot e këtij rrethi, nuk kam shumë gjëra për të thënë. Sido-qoftë, shokët e komitetit të Partisë ishin të mendimit që kjo mbledhje të bëhej dhe unë s'pata ndonjë kundërshtim.

Nuk është keq të theksoj edhe një herë momentet kryesore të situatës së tanishme që zhvillohet në vendin tonë dhe në botë. Siç e dini, në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve ndërkontaktare ka vështirësi, veçanërisht përsa u përket marrëdhënieve politike e ideologjike në mes partive komuniste e punëtore, të cilat influencojnë në gjendjen e përgjithshme ndërkontaktare dhe të kampit socialist. Mosmarrëveshjet që kanë lindur e po zhvillohen në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore, janë rezultat i veprimtarisë armiqësore revisioniste të N. Hrushovit dhe grupit të tij, që ka ardhur në krye të PK të BS. Ky grup po i sjell një dëm shumë

të madh çështjes së revolucionit e të socializmit jo vetëm në BS, por në të gjithë botën. Prandaj duhen bërë të gjitha përpjekjet që kjo sëmundje e rrezikshme në trupin e shëndoshë të lëvizjes komuniste e punëtore, të shërohet e të zhduket.

Grupi i N. Hrushovit, qysh kur erdhi në fuqi, dha shenja se po godiste marksizëm-leninizmin. Këto shenja në fillim nuk ishin aq të dukshme. Hrushovi me shokët e tij kanë ditur të maskoheshin mirë sa ishte gjallë Stalini. Mirëpo pas vdekjes së tij e deri në Kongresin XX të PK të BS këto shenja filluan të bëhen më të dukshme, natyrisht jo për të gjitha partitë komuniste dhe punëtore.

Dyshimet e Partisë sonë për grupin revisionist të udhëhequr nga N. Hrushovi filluan me kohë, qysh përra para Kongresit XX. Po mos vallë Partia jonë ishte më e vjetër se partitë e tjera komuniste e punëtore në luftë kundër rrymave antimarksiste? Jo. Partia jonë nuk është më e vjetër se të tjerat, bile ajo është më e re, po kishte një eksperiencë të madhe në lidhje me luftën kundër revisionistëve jugosllavë. Kjo luftë e pandërprerë nuk përbën një eksperiencë të vogël, ajo e ka kalitur Partinë tonë për të kuptuar më shpejt dhe më lehtë deviacionet e kësaj natyre, që po zhvilloheshin dalngadalë dhe po shfaqeshin në udhëheqjen e PK të BS sa arriti momenti që ato të bëhen të dukshme.

Duhet thënë se, pas vdekjes së J. V. Stalinit, nga të dhënat që kishim ne dhe nga ato që shikonim, udhëheqja sovjetike bënte gabime të rënda në vijë, shkelte në mënyrë flagrante parimet e marksizëm-leninizmit.

U krijua një situatë e tillë që elementët oportunistë e revizionistë, me anë intrigash, mundën të merrnin pozitat kyç në udhëheqje të partisë dhe të shtetit sovjetik. Grupi i N. Hrushovit diti të manovrojë dhe të shtjerë në dorë udhëheqjen e partisë dhe të shtetit sovjetik. Ne nuk dimë konkretisht se si janë zhvilluar ngjarjet, po mund të arrihet fare lehtë në konkluzionin se Hrushovi shfrytëzoi situatën e krijuar, vuri udhëheqësit njërin kundër tjeterit për të dobësuar unitetin, në radhë të parë në Presidiumin e KQ të PK të BS. Është fakt, që e dimë edhe ne, se pas vdekjes së J. V. Stalinit, kur shkonomi në BS, nga goja e Hrushovit kemi dëgjuar të na thoshte përpara shokëve të tjerë të Presidiumit se «në mes nesh ka edhe nuanca, ka edhe mosmarrëveshje për probleme të ndryshme, por s'ka gjë, pse një situatë e tillë mund të ndodhë». Kur ai fliste kështu, të tjerët tundnin kokën. Kjo tregon se fërkime në udhëheqjen sovjetike ka pasur qysh përpara Kongresit XX, por prapa tyre fshiheshin intrigat e Hrushovit, i cili arriti që me forma gjoja demokratike, të likuidojë kundërshtarët e tij dhe të vazhdonte më tej për të realizuar qëllimet e veta antimarksiste.

N. Hrushovi erdhi në fuqi jo vetëm duke shkelur çdo normë leniniste organizative, por duke vepruar me mënyra brutale, ashtu sikundër veprohej në kohën e puçeve cariste. Një herë Poljanski ka treguar se «në një mbledhje të rregullt të Presidiumit të KQ, shumica i mundi pikëpamjet dhe qëndrimin e N. Hrushovit, që nuk dinte ç'të thoshte përpara shokëve, të cilët i kërkonin llogari, u demoralizua përpara fakteve dhe argumenteve të tyre dhe u dorëzua. Presidiumi mori vendim

që N. Hrushovi të shkarkohej nga funksioni i Sekretarit të Parë të KQ të PK dhe i Kryetarit të Qeverisë Sovjetike dhe të bëhej ministër i bujqësisë, se për këtë punë ishte, «specialist i kukuruzit¹». Por nga brenda na lajmëruan për çka ndodhët në Presidium me Hrushovin, prandaj unë dhe disa shokë të tjerë, që ndodheshim në Moskë, rrrethuam Kremlinin me tanksa dhe ushtarë dhe dhamë urdhër që as miza të mos lëvizte nga Kremlini. Nga ana tjetër dërguam nga të katër anët avione për të mbledhur anëtarët e plenumit të KQ të PK të BS. Pastaj u futëm në Kremlin dhe kërkuam të hynim në mbledhje. Na doli Voroshilovi i cili na pyeti se ç'kërkonim. Kur i thamë se duam të futemi në mbledhje, ai na e preu. Kur ne i treguam forcën, ai tha se ç'janë këto gjëra që bëhen, por ne e paralajmëruam: të pakta fjalët, ndryshe të arrestojmë. Kështu hymë në mbledhje dhe bëmë që situata të ndryshohet». Mjaftojnë edhe këto fjalë të këtij puçisti për të mësuar se si u organizua komploti i uzurpimit të udhëheqjes së Partisë nga N. Hrushovi. Le të flasë sa të dojë N. Hrushovi për «respektimin» e normave leniniste, ai i ka shkelur vetë ato, jo vetëm kur erdhi në fuqi, po vazhdimisht.

Kongresi XX është fillimi i një pune të hapur armiqësore brenda në PK të BS dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Veprimtarinë e tij Hrushovi duhej ta mbulonte me fraza marksiste, siç e kanë zakon revolucionistët. Nën këtë maskë ai ndërmori luftën kundër leninizmit. Bari i egër nuk mund të dalë në një tokë të pastruar për të cilën tregohet kujdes vazhdimisht.

¹ Specialist i misrit.

Së pari Hrushovit i duhej të shkurorëzonte leninizmin dhe veprën e J. V. Stalinit.

Në Kongresin XX të PK të BS, N. Hrushovi paraqiti një sërë tezash «të reja», që ishin gjoja «një zhvillim krijues i teorisë marksiste-leniniste». Këto teza, me gjithëse të veshura me petkun e marksizëm-leninizmit, për Partinë tonë qysh atëherë binin erë revizionizëm. Me qëllim që të arrihej në pranimin e këtyre tezave jo vetëm nga PK e BS, por nga e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, Hrushovi mbajti edhe një raport «sekret»: «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij», që drejtohej kundër Stalinit dhe veprës së tij. Ky raport «sekret» iu dha për lexim nga mbarimi i punimeve të kongresit edhe sekretarëve të parë të partive që kishin shkuar në Moskë për të përshëndetur Kongresin XX dhe u rekomandua që të lexohej shpejt e shpcjt me ndihmën e përkthyesve të tyre. Por fakti është që ky raport «sekret» ra edhe në dorën e agjenturave të fshehta të imperializmit, u shtyp me shumicë dhe u shpërnda në të gjithë botën. Një gjë e tillë i leverdiste N. Hrushovit dhe shokëve të tij. Kështu çështja e «kultit të individit të Stalinit» u bë një çështje ndërkombëtare.

Partia jonë nuk ka qenë dhe nuk është dakord me trajtimin që iu bë Stalinit dhe veprës së tij në këtë kongres. Gjithashtu ne nuk ishim dakord edhe me disa shfaqje e qëndrime të Hrushovit në politikën ndërkombëtare. Shumë nga këto shfaqje e qëndrime, atëherë ne nuk i shihnim akoma aq thellë sa sot, por qysh në Kongresin XX ne shihnim një farë tendence të theksuar të Hrushovit për pajtim me elementët oportunistë.

N. Hrushovi filloi të merrte disa masa arbitrale,

siç ishte rishikimi i vendimit të Kominternit për Partinë Polake dhe Hungareze, për rehabilitimin e Bela Kunit etj., që na i servirte. Nga një anë, pra, ai doli me një raport kundër Stalinit, nga ana tjetër doli edhe kundër Kominternit. Të gjitha këto veprime të tij bëhen në mënyrë të shpejtuar, brenda disa ditëve, duke bërë një mbledhje këtej, një mbledhje andej, për të dënuar PK Greke, për të rehabilituar PK Polake etj.

Raporti «sekret» kundër Stalinit Partinë tonë jo vetëm e shqetësoi, po ne filluam të dyshonim për të gjitha çështjet që shtronte Hrushovi, të cilat iu deshën që të errësonë gjithë veprimtarinë revolucionare të Stalinit. Por faktet flasin se vetë Stalin ka qenë kundër kultit të individit dhe shpesh e ka kritikuar atë, duke vlerësuar drejt rolin e masave në histori dhe të Partisë së proletariatit.

Ngritura e çështjes së kultit të Stalinit nga ana e Hrushovit, kishte dy qëllime, të brendshme dhe të jashtme, por objektivi ishte i njëjtë: të errësohej e gjithë vepra që krijoi, forcoi dhe mbrojti PK e BS, me Stalinin në krye, ndërtimi i socializmit. Duke ngritur çështjen e kultit të individit, nga njëra anë N. Hrushovi u përpoq t'i hidhte një vello të zezë Bashkimit Sovjetik dhe ta errësonë periudhën e ndërtimit të socializmit atje, nga ana tjetër, nën pretekstin e «kultit të individit», të likuidonte udhëheqësit e shëndoshë të partive të tjera komuniste e punëtore. Kështu, pas Kongresit XX të PK të BS, me përjashtim të partive komuniste e punëtore të Azisë dhe të Partisë sonë, në të gjitha partitë e tjera, si-demos në ato të vendeve të demokracisë populllore të Evropës, u likuiduan të gjitha udhëheqjet e mëparshme

dhe në krye të tyre u vunë njerëz gjoja të painfektuar nga sëmundja e kultit të individit. Nga udhëheqësit e mëparshëm dikush vdiq, dikush u eleminua. Mjaft udhëheqës të lëvizjes komuniste ndërkombejtare, si Gotvaldi, Bjeruti, Kolarovi, Zapotocki vdiqën. Në Poloni u vunë në krye njerëz, që kishin qenë në burg, por që ishin dënuar gjoja pa faj; në Çekosllovaki u vunë në krye njerëz të bazës që gjoja ishin të painfektuar nga kulti i individit, kurse ata që ishin në udhëheqje vazhdojnë t'i çojnë poshtë e më poshtë. Në Hungari, pas gjithë këtyre trazirave u vunë në udhëheqje njerëz që kishin qenë në burgje gjoja padrejtësisht, ndërsa në Bullgari u eleminua udhëheqja e vjetër dhe vendin e saj e zunë elementë të rinj, që «garantonin zbatimin e kursit të ri marksist-leninist» dhe ishin «të pastruar nga çdo mbeturinë e dogmatizmit» etj. Kursi që filloi të ndiqte N. Hrushovi pati reperkusione të mëdha për të gjitha partitë, shumë prej të cilave pësuan tronditje të forta. Vetëm në Shqipëri nuk pati sukses Hrushovi, prandaj i vuri detyrë vetes të ketë durim me Shqipërinë dhe të preqatiste dalngadalë minat, për të hedhur në erë udhëheqjen e saj.

Partia jonë e kupton se sa i dëmshëm është kulti i individit, prandaj ajo nuk i ka lejuar shfaqjet e tij. Por Partia dhe populli ynë dinë gjithashtu të kenë respekt për udhëheqësit e tyre besnikë. Pikërisht për këtë s'u vjen mirë Hrushovit dhe Titos, të cilët, respektin e Partisë sonë për udhëheqësit e saj duan ta paraqitin si «kult të individit» me qëllim që në udhëheqje të vijnë njerëz të përshtatshëm për punën e tyre armiqësore, antimarksiste e antishqiptare. Në këto mo-

mente, kur Partia jonë lufton me vendosmëri kundër revizionizmit, për të mbrojtur marksizëm-lininizmin, manifestimet e popullit janë shprehje e dashurisë së zjarrtë për Partinë tonë të lavdishme, që e mbrojmë me të gjitha forcat nga rreziku që i kanoset jo vetëm asaj, por gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Orientimet revizioniste të N. Hrushovit për çësh-tjen e Stalinit nuk patën ndonjë sukses. Megjithëse qëllimet e tij nuk i kuptionin të gjithë, sulmin antimarksist kundër Stalinit nën maskën e kultit të individit nuk e pranuan. Por pati edhe parti që u tronditën nga ky sulm. Kështu për shembull, PK e Francës nuk i pranoi tezat e Hrushovit për «kultin e Stalinit», bile në atë kohë Moris Torezi dërgoi një delegacion partie në Moskë dhe i deklaroi Hrushovit se «PK e Francës nuk është dakord me trajtimin që i bëhej Stalinit». Edhe vitin e kaluar, kur erdhi te ne, të njëjtin qëndrim mbante Torezi, që Stalini është një nga marksistët më të mëdhenj. Kurse tani Moris Torezi ka ndërruar kë-mishë, ka marrë rrugën revizioniste.

Një nga aktet kryesore të N. Hrushovit, porsa erdhi në fuqi, ishte të shfajësonte revizionistët jugosllavë. Sipas tij, J. V. Stalini, ashtu si në të gjitha punët e tjera, na paskësh bërë edhe një gabim të rëndë, na paskej persekuuar dhe dënuar gjoja pa të drejtë udhë-heqësit jugosllavë. Ky hap që ndërmori N. Hrushovi, politikisht ia forcoi dyshimet dhe bindjen Partisë sonë se ai dhe grapi i tij po ecin drejt greminës, se ata janë një grup oportunist revizionist. Prandaj i vumë detyrë vetes të ishim vigjilentë dhe nuk u gabuam. Për t'ua arritur qëllimeve të tij antimarksiste, N. Hrushovi përdorte

disa forma, një nga të cilat ishte i ashtuquajturi konsultim me të tjerët. Ai bënte sikur pyeste, por kjo që sa për formë. Kështu, para se të vente në Jugosllavi në vitin 1955, na pyeti ç'mendonim ne për hapat që duheshin marrë për të afruar «shokun» Tito. Ne iu përgjigjëm se nuk jemi dakord të shkonte te Titoja, se për këtë çështje kishte rezolutë të Byrosë Informative të partive komuniste e punëtore, ishin letrat e njohura të Stalinit, të cilat kanë dënuar grupin revizionist të Titos. Prandaj që të thuhet ka pasur apo nuk ka pasur të drejtë Stalini për çështjen jugosllave, duhej mbledhur Byroja Informative për ta shqyrtuar çështjen e jo të veprohej në mënyrë të njëanshme. Mirëpo në kohën kur Hrushovi do të shkonte në Jugosllavi, Byroja Informative ishte shkrirë, prandaj në këto kushte duhej të thirrej një mbledhje e atyre partive që ishin anëtare të saj ku të ftohej edhe një delegacion i Partisë sonë e pastaj të vendosej se ç'duhej bërë me udhëheqjen jugosllave. Por N. Hrushovi nuk e mori fare parasysh pikëpamjen e Partisë sonë, ai shkoi në Beograd dhe të gjithë e dini se ç'u bë atje. Titoja dhe shokët e tij dolën të pafajshëm dhe na ishin persekutuar gjoja padrejtësisht. Kështu ata filluan veprimtarinë e tyre legalisht. Ky ishte një grusht tjetër që Hrushovi me shokë i jepnin marksizëm-leninizmit.

Sic shihet, për N. Hrushovin çështja jugosllave kishte rëndësi të madhe. Hrushovi ka deklaruar se «Beria është përpjekur të merrej vesh me Rankoviçin». Ne nuk e dimë këtë, pse është punë e brendshme e tyre, por dimë një gjë që vetë Hrushovi është takuar me Titon e me Rankoviçin dhe duhet të jenë marrë

vesh edhe për çështjet që u shtruan në Kongresin XX të PK të BS. Hrushovin dhe Titon ne i dimë se cilët janë, por edhe Rankoviçin e njohim mirë se kush është, njeriu i komploteve, i intrigave. Synimi i Hrushovit është që të mos paraqitet klika e Titos si tradhtare e socializmit, përkundrazi ai do që Titoja me shokë të quhen marksistë-leninistë, pavarësisht se e kritikoi rëndë Bulganinin kur ishte kryeministër, që deklaroi në një darkë se «Titoja është një leninist i madh». Këtë Bulganini e ka bërë edhe për shkak se ka dëgjuar shumë fjalë të mira për Titon nga goja e Hrushovit. Mirëpo që të maskohej Hrushovi, na tha se Bulganini ka bërë një gabim të madh që i vuri epitetin «leninist» Titos dhe sa për sy e faqe e dënoi Bulganinin, i cili u detyrua të bënte autokritikë.

Sipas N. Hrushovit, pra, duhej rehabilituar Titoja, ky përçarës i vendeve socialiste dhe i partive komuniste e punëtore, që qysh nga vitit 1948 po ushqehet me dollarët amerikanë. Përpjekjet e Hrushovit për të rehabilituar Titon, fjalët e tij të mira në adresë të revolucionistëve të Beogradit, i bëjnë këta të fundit që të fryhen si gjel dhe të kryejnë veprime aq të hapëta antimarksiste që shpeshherë kanë vënë në pozita të vëshiira edhe Hrushovin e pasuesit e tij, sidomos me organizimin e kundërrevolucionit në Hungari dhe me deklaratat e Titos se duhej ecur përpëra në rrugën e tij për të vendosur një kurs të ri në vendet e demokracisë populllore. Mirëpo kundërrevolucioni në Hungari e demaskoi klikën revolucioniste jugosllave, Titon, gjithashtu edhe N. Hrushovin, sepse ky kishte rënë në ujdi me të për ndryshimin e gjendjes dhe të udhëheqjes së mëparshme

në Hungari. Dhe në qoftë se N. Hrushovi dha urdhër që Ushtria Sovjetike, e cila la mijëra të vrarë në Budapest, të ndihmonte popullin hungarez, ai ishte i detyruar ta bënte këtë nga rrëthanat që u krijuan. N. Hrushovi do ta kishte lënë kundërrevolucionin në Hungari nën patronazhin e revisionistëve jugosllavë dhe atje do të mbetej në fuqi Imre Nagi dhe agjentë të tjerë jugosllavë, por u iku situata nga duart.

Pas Konferencës së Partisë të Tiranës dhe në pragun e kundërrevolucionit hungarez, një delegacion i Partisë sonë, që do të shkonte në Kongresin VIII të PK të Kinës, kaloi nëpër Budapest e Moskë. Në këtë delegacion isha edhe unë. Shokët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punonjësve të Hungarisë, na ftuan në një drekë dhe me këtë rast midis nesh u zhvillua një bisedim. Ata na treguan për trubullirat që po ndodhnin në klubin «Petëf». Pyetjes sonë: «Pse nuk merrni masa kundër elementeve që trubullojnë situatën?», ata iu përgjigjën se «këto janë forma që i lejon demokraci» dhe na u drejtuam me pyetjen: «Po ju, çfarë do të bënit, po të ndodhnin në Shqipëri gjëra të tilla?». Atëherë ne u treguam si vepruam me elementët antiparti e tradhtarë të Konferencës së Tiranës dhe u sugjeruam që «në qoftë se doni të shpëtoni situatën, mendojmë se kështu duhet të veproni edhe ju». «Po ne nuk veprojmë dot kështu, thanë ata, se te ne ka edhe anëtarë të KQ që kanë shkuar për darkë te Imre Nagi për t'i uruar ditëlindjen». Me një qëndrim të tillë ne u shfaqëm kundër dhe me këtë rast, u dhamë një këshillë shoqërore: «Mblidhni plenumin dhe merrni masa partie. Kështu do të forconi situatën. Në këtë

mënyrë kemi vepruar edhe ne kundër armiqve dhe kështu na mëson marksizmi revolucionar. Ju bëni si të doni në shtëpinë tuaj, u thamë ne, por, meqenëse na pyetët, ne shfaqëm pikëpamjen tonë».

Në këto bisedime, një anëtar i Byrosë Politike, si për të kapërcyer fjalën, na pyeti nëse donim të venim në stadium për të parë një ndeshje futbolli, por ne u përgjigjëm se «delegacioni ynë do të nisjet për nën Moskë». Në fund na thanë se këto kohët e fundit Hungarinë ishin duke e vizituat rreth 20 mijë turistë, bile me makinat e tyre. Ne u thamë: «Kini kujdes, se midis tyre ka edhe spionë». «Po nga ata fitojmë devizë të madhe», na thanë. Dhe siç doli, imperialistët, të maskuar me makina «turistike», nëpërmjet Austrisë, futnin pushkë e mitraloza për kundërrevolucionin dhe udhëheqësit hungarezë flinin.

Gjithë zhvillimi i ngjarjeve vërteton se Hrushovi ishte në ujdi me klikën titiste. Kur shkuam në Moskë i thamë Susllovit se ç'po ndodhët në Hungari, se gjendja atje nuk ishte e mirë, se Imre Nagi po lëvizte etj. «E keni gabim, na u përgjigj Susllovi, Nagi nuk është njeri i keq». Aty për aty ne kundërshtuan dhe i thamë Susllovit që «s'jemi dakord me vlerësimin që i bëni ju Nagit». Dhe shtuan se kur Nagi u bë kryeministër ishte për integrimin e kulakëve në kooperativat bujqësore. «E keni gabim, e keni gabim», përsëriti Susllovi dhe nxori nga sirtari «autokritikën e freskët» të Nagit. Megjithatë i thamë Susllovit se Imre Nagi është tradhtar. Koha tregoi se ne kishim të drejtë. Më vonë doli se ç'ishte me të vërtetë Nagi.

Kundërrevolucioni në Hungari ishte kryesisht vepër

e revisionistëve jugosllavë, të cilët synonin që Hungaria të shkëputej nga kampi socialist. Argumentet tona ne i përmendëm në Mbledhjen e Moskës, por Hrushovi skuqej nga inati dhe mbante kokën me dorë. Po kështu, ne përmendëm dokumente edhe në Fjalimin e mbajtur me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PPSH. Nganjëherë situata e detyronte Hrushovin të thoshte ndonjë fjalë kundër Titos, me qëllim që të mos demaskohej vetë. Kur zbutej «lufta» kundër Titos nga ana e Hrushovit, atëherë na këshillonte të pajtoheshim edhe ne me Titon. Pasuesit e Hrushovit bënин si thoshte ai, dhe i qëndronin sus. Në këto raste Titoja sulmonte përsëri dhe Hrushovi detyrohej prapë të mbante qëndrim, siç bëri në Kongresin VII të PK të Bullgarisë, ku Titon e cilësoi «kalë i Trojës». Në pushim, pas fjalës që mbajti, Hrushovi u tha shokëve: «Ja, me gjithë këto që thashë kundër jugosllavëve shoku Enver akoma nuk është i kënaqur». Natyrisht, ne çuditeshim kur Hrushovi fliste kështu, por bësim nuk kishim dhe ai vetë e dinte fare mirë këtë gjë.

Kur jam takuar një herë me Vishinskin dhe bisendonim për çështjen jugosllave, ai më tha: «Ti shoku Enver je akoma i ri, por ka rëndësi të demaskohet i ligu, me durim dhe në kohën e duhur dhe të arrihet që ai të zhvishet lakuriq. Ky është dënim i madh që mund t'i jepet të ligut. Po e kuptoi populli ç'është i ligu, po deshe pushkatoje, po deshe lëre, ai i pushkatur është».

Siç dihet, titistët në Kongresin VII të LKJ shpallën programin e tyre revisionist. Hrushovi me shokë nga zemërimi i shkaktuar në tërë lëvizjen komuniste ndër-

kombëtare, u detyruan të mbanin qëndrim. Mirëpo pak kohë pas shpalljes së programit, Hrushovi filloi të na thoshte të pushonim, të heshtnim për ta se paskej akoma një shkëndijë shprese për të ndrequr «shokët», «vëllezërit» jugosllavë etj., etj. Lufta kundër revizionizmit nga ana jonë sa vinte ashpërsohej. Kjo luftë kundër revizionizmit jugosllav po bëhej një rrezik i madh për Hrushovin, sepse nuk arriti asnjë sukses për të na futur në rrugën e pajtimit me të. Çështja e revisionizmit jugosllav po bëhej një problem shumë i mprehtë edhe për gjithë lëvizjen komuniste botërore. Kishte parti komuniste e punëtore që lëkundeshin sa djathtas, majtas. PK e Francës e pushoi luftën kundër klikës së Beogradit sa u diskreditua përpara punonjësve francezë. Ajo e kishte mirë një kohë. Kur u shpall programi i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, PK e Francës e intensifikoj përsëri luftën kundër klikës së Titos, kurse tani ra në qetësi, mbajti vesh Hrushovin dhe e ndërpren luftën kundër revisionistëve të Beogradit. Ne i thamë Hrushovit, se në këtë çështje duhet të ecim drejt, pa u lëkundur, në rrugën marksiste-leniniste, por ai vazhdoi punën e tij, ai nuk ndreget.

Politika e N. Hrushovit është armiqësore jo vetëm se ai synon të kthejë kursin e PK të BS, por sepse ka një plan të madh ndërkombëtar. Ai hodhi parullat e «mbrojtjes së paqes» dhe të «çarmatimit të plotë e të përgjithshëm», parullën e «bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, si vijë e përgjithshme e politikës së jashtme të shteteve socialiste», parullën se «BRSS do të shkojë në komunizëm në të njëjtën kohë së bashku me të gjitha vendet

e tjera të kampit socialist». Hrushovi, duke u fshehur pas këtyre parullave pompoze është përpjekur të mbulojë veprimtarinë e tij shkatërruese ndaj Bashkimit Sovjetik, kampit socialist dhe lëvizjes komuniste botërore.

Dihet se Partia jonë, përderisa ndjek një politikë që synon ndërtimin e socializmit e të komunizmit në Shqipëri, është për mbrojtjen e paqes në botë, kundër luftës, prandaj të gjitha forcat tona drejtohen për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e paqes, për unitetin e kampit socialist etj., etj., por vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Kështu, N. Hrushovi nuk ka ku të kapet për ta goditur Partinë tonë.

Gjatë zbatimit në praktikë dhe në jetë të këtyre problemeve vazhdimisht dukeshin kundërshtimet e Partisë sonë, të PK të Kinës etj. me vijën oportuniste e revizioniste të Hrushovit. Këto kundërshtime vinin duke u shtuar. Hrushovi nën maskën e parullave gjoja marksiste bënte punë në dobi të imperializmit. Imperialistët i kanë shfrytëzuar shumë pikat e dobëta të politikës revizioniste të Hrushovit dhe kanë vazhduar të armatosen. Kjo nuk do të thotë që ne të ndalonim armatosjen e tyre me anën e luftës, siç thotë Hrushovi për ne. Kjo është një shpifje. Partia jonë ose PK e Kinës as kanë pasur dhe as që kanë të tilla pikëpamje, por ne themi se orvatjet e imperializmit për t'u armatosur dhe për të shpërthyer luftën do të pengohen duke ngritur popujt në këmbë, pse paqja ruhet dhe forcohet në qoftë se e marrin në dorë popujt dhe e çojnë atë deri në fund.

Pas Kongresit XX të PK të BS shumë parti komu-

niste dhe punëtore të botës, duke u gënjer nga vija oportuniste revizioniste e Hrushovit ranë në gjumë dhe në rehati. Pikëpamja e përhapur ishte se meqë ne jemi të fortë, imperialistët s'kanë ç'na bëjnë, prandaj u propagandua me të madhe se «nuk ka më luftë», kështu forca e imperializmit u nënvleftësua. Me formulat e tij të maskuara mirë dhe për të bërë efekt në masat e popullit Hrushovi thoshte se «ne tani mund ta bëjmë zap imperializmin», se «natyra e tij sot ka ndryshuar», se «ai nuk është aq agresiv, jo se nuk do, por se ne jemi aq të fortë sa ai nuk ka mundësi të na bëjë dot gjë dhe do të bëjë atë që i themi ne» e të tjera profka të tilla.

Pehlivani llëqet e Hrushovit arrijnë deri atje sa ai të thotë edhe gjëra të tilla si «unë nuk e njoh verën si Stalini, por politikën e loz në gishta». Ju e mbani mend ç'lëvizje të fuqishme botërore kishte në kohën e Stalinit, si lëvizja e partizanëve të paqes, lëvizja e madhe e klasës punëtore ndërkombëtare, ç'heroizëm të njerëzve kishte në vendet kapitaliste, që shtriheshin përpara trenave të mbushur me armatime, të cilët dërgoheshin nga imperialistët për të shtypur popujt kolonialë, si në Vietnam e gjatkë, gjë që dobësonte luftën e kolonialistëve. Ju kujtohen aksionet masive të partive dhe të popujve kundër kapitalit, grevat e mëdha, manifestimet e fuqishme etj. për demaskimin e imperialistëve, për ndalimin e armëve bërthamore etj. Të gjitha këto aksione që bëheshin në kohën e Stalinit, tani u shuan, sepse «politikani» Hrushov, nxori në plan të parë «zgjidhjen e problemeve nëpërmjet bisedimeve». Prandaj Hrushovi bridhte si turist, sa andej-këtej, për të përha-

pur idetë e tij gjoja për paqen, por që në fakt ishin helm për popujt.

Hrushovi filloi të flasë për «rrugën paqësore të kalimit në socializëm», për marrjen e pushtetit nga ana e klasës punëtore «në rrugën parlamentare». Sipas tij, proletariati, në këtë ose në atë vend, nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme, do të sigurojë një shumicë të qëndrueshme në parlament, me të cilin do të realizojë reforma shoqërore rrënjosore dhe do të hyjë gjoja në rrugën e socializmit. Këto pikëpamje të revisionistëve modernë janë vazhdim i predikimeve të paraardhësve të tyre Bernshtajn, Kautsk etj., të cilët gjithashtu, duke mohuar revolucionin me dhunë, shpreheshin për «kalinmin paqësor» me anën e reformave, me anën e parlamentit borgjez. Lenini u ngrit me forcë kundër këtyre pikëpamjeve revisioniste duke thënë:

«Vetëm maskarenjtë ose budallenjtë mund të mendojnë se proletariati në fillim duhet të fitojë shumicën në votimet e bëra nën shtypjen e borgjezisë, nën shtypjen e skllavërisë së punës me mëditje dhe pastaj ta marrë pushtetin. Ky është kulmi i mendjeshkurtësisë ose i hipokrisisë, ky është një zëvendësim i luftës së klasave dhe i revolucionit me zgjedhje nën regjin e vjetër, nën pushtetin e vjetër»¹.

Tezat e Hrushovit në lidhje me rrugët e kalimit për socializëm, kishin të bënin me marrjen ose jo të

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 48.

pushtetit nga ana e proletariatit në vendet kapitaliste dhe në ato koloniale e të varura, nëse do të ngrihej ose jo ai në revolucion për të marrë fuqinë, nëse do të ngriheshin ose jo në luftë popujt për të penguar shpërthimin e një lufte të re nga ana e imperialistëve. Të ndiqje rrugën e Hrushovit donte të thoshte të hiqje dorë nga rruga e Revolucionit të Tectorit, të cilin ai e cilësoi «të drejtë vetëm për ato kushte historike»! Prandaj tezën e Hrushovit, që zhvilloi në Kongresin XX të PK të BS, mbi rrugën paqësore të kalimit në socializëm, e mbështetin të gjithë elementët oportunistë e revizionistë në radhët e partive komuniste e punëtore. Si pasojë, u krijuar një periudhë qetësie në vendet kapitaliste, ra hovi revolucionar i komunistëve, u hoq dorë nga rruga revolucionare, nga rruga e marrjes së pushtetit me dhunë. Ja, pra, ç'dëm të madh solli teza revizioniste e Hrushovit për marrjen e pushtetit me rrugë paqësore, ajo çarmatosi partitë komuniste e punëtore dhe lëvizjen revolucionare punëtore në vendet kapitaliste. Shkurt, Hrushovi, duke predikuar rrugën parlamentare, për të shuar lëvizjen greviste, hovin revolucionar të partive komuniste në vendet kapitaliste, u përpoq të impononte pikëpamjen që të hiqet dorë nga lufta për marrjen e pushtetit.

Partia jonë ka një koncept dhe qëndrim të drejtë për rrugët e kalimit në socializëm. Ne e kuptojmë këtë çështje në mënyrë marksiste. Teza kryesore së cilës i përbahet Partia jonë është se revolucioni me dhunë përbën një ligj të përgjithshëm të revolucionit proletar. Detyrën e revolucionarëve në këtë drejtim e ka përcaktuar Lenini, kur thotë:

«Nevoja për t'i edukuar në mënyrë sistematike masat me këtë ide dhe pikërisht me këtë ide të revolucionit me dhunë, është baza e gjithë doktrinës së Marksit dhe Engelsit»¹.

Duke vënë theksin rruga e revolucionit me dhunë, ne nuk e mohojmë rrugën e kalimit paqësor për në socializëm, por këtë e kuptojmë ashtu siç e kanë trajtuar klasikët e marksizëm-leninizmit, si një mundësi shumë të kufizuar, që ndeshet jashtëzakonishë rrallë, në kushte e rrethana historike krejt të veçanta. Për këtë dëshmon fakti që deri më sot, historia nuk njeh asnjë rast që ndonjë vend të ketë kaluar në socializëm me rrugë paqësore. Borgjezia nuk ia dorëzon vullnetarisht pushtetin proletariatit. Proletariati do ta pranonte që ta merrte pushtetin në rrugë paqësore, por kjo s'do të thotë që ky ta presë këtë ditë duke qenë i çarmatosur përpara borgjezisë të armatosur deri në dhëmbë. Përkundrazi, proletariati duhet të jetë i armatosur, i pregatitur për revolucionin me dhunë edhe sikur në kushte të caktuara historike të ndonjë vendi ta marrë pushtetin me rrugë paqësore. Ndryshe nuk mund të kuptohet as vetë rruga paqësore. Në kushtet e sotme, kur imperializmi ka shtuar përpjekjet e tij për të mbajtur popujt nën shtypje, kur ai kryen më tepër akte agresioni, zhvillon si asnjëherë garën e armatimeve, mban në këmbë një aparat të madh ushtarak e policor, shton buxhetin ushtarak, shkon drejt reaksionit në të gjitha fushat e jetës etj., të reklamosh rrugën paqësore, do të thotë të heqësh dorë nga revolucioni, ta tradhtosh atë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 473.

Largimit të popujve nga revolucioni i shërbën edhe teza tjetër e Hrushovit «për çarmatimin e plotë e të përgjithshëm». Kjo tezë shpie ujë në mullirin e imperializmit, sepse çarmatos popujt përballë imperializmit të armatosur.

Ne e kemi të qartë se imperializmi është burim i luftës, se derisa ekziston imperializmi ekziston edhe rreziku i luftës. Por ç'thonë revizionistët? Revisionistët thonë se burim i luftës janë armët, është gara e armatimeve, prandaj sipas tyre, që të mos ketë luftë, duhen zhdukur armët! Duke u nisur nga kjo pikëpamje e gabuar, ata dalin me parullën e «çarmatimit të plotë e të përgjithshëm». Mirëpo, në kushtet e imperializmit parulla e «çarmatimit të plotë e të përgjithshëm» që predikon me kaq zell Hrushovi, është një mashtrim i madh për popujt. Për këtë çështje, ne duhet të udhëhiqemi nga mësimi i Leninit, sipas të cilit:

«Përderisa në botë ka të shtypur e të shfrytëzuar, ne duhet të kërkojmë jo çarmatimin, por armatimin e përgjithshëm të popullit. Vetëm ai do ta sigurojë plotësisht lirinë. Vetëm ai do ta mposhtë plotësisht reaksionin. Vetëm po që se bëhet ky transformim, do të gëzojnë me të vërtetë liri miliona punonjës dhe jo vetëm një grusht shfrytëzuesish»¹.

Ne jemi për çarmatim, por këtë nuk e bëjmë pa u çarmatosur imperializmi. Mirëpo imperializmi nuk

¹ V. I. Lenin, Veprat, vëll. 10, f. 48.

i hedh armët. Po të çarmatosej imperializmi, atëherë nuk do të ishte më imperializëm. Ne jemi të armatosur e imperializmi ndërmerr akte agresioni e organizon komplotë, po sikur të çarmatosemi, merret me mend se ç'do të bëjë ai. Prandaj, në këto rrethana, si mund të çarmatosemi? Në asnje mënyrë!

Meqenëse ne i përbahemi kësaj pikëpamjeje të drejtë, revisionistët na akuzojnë se qenkemi luftënxitës! Pse jemi të tillë, cilin vend kemi kërcënuar? Përkundrazi, të tjerë na kanë kërcënuar dhe janë përpjekur të na pushtojnë. Ne kemi luftuar dhe luftojmë kurdoherë për të mbrojtur atdheun. Dhe për këtë na duhen armët, prandaj kemi të armatosur jo vetëm ushtrinë, por të gjithë popullin dhe barutin e mbajmë të thatë, sytë e veshët të hapur. Parulla jonë është të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në njérën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën.

Teza tjetër e Hrushovit është ajo e bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore. Këtë tezë nuk e shpiku Hrushovi. Lenini, porsa lindi pushteti sovjetik, megjithëse i rrëthuar nga shtete armiqësore kapitaliste, batoi dekretin e parë mbi paqen, domethënë kundër luftës. Me këtë ai u tha shteteve kapitaliste që shteti i ri socialist dëshiron të bashkëjetojë me to në bazë të parimeve të mosndërhyrjes, të respektit reciprok etj., etj. Këtë politikë leniniste e kザbatuar gjithë jetën e tij Stalini, por ai nuk e shoi asnjeherë luftën ideologjike. Studioni veprat e Stalinit dhe do të shihni se edhe për këtë çështje ai shpeshherë citon Leninin. Pra Stalini, çdo veprim të tij e mbështet te Lenini. Edhe për bashkekzistencën paqësore midis

shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore ai flet gjatë në veprat e tij. Fjalët e tij të fundit në Kongresin XIX të PK të BS janë për këtë çështje dhe për paqen.

Tani N. Hrushovi na doli si një njeri me pikëpamje «të reja» dhe plot bujë për paqen. Por ai nuk është marksist që ta kuptojë si duhet çështjen e paqes, ai në fakt mendon si një pacifist borgjez. Prandaj çështjen e bashkekzistencës në Kongresin XX e shtroi në mënyrë të atillë që qëndronte jashtë binarëve të marksizëm-leninizmit, sepse mohohet lufta e klasave, të cilën ai e zbuti, derisa hoqi dorë fare.

Në Mbledhjen e 81 partive në Moskë Hrushovi u përpoq që çështja e bashkekzistencës paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore të shtrohej në platformën e tij revizioniste, ashtu si e kuptonte ai. Ai u përpoq të mos flitej për luftën e popujve të shtypur e kolonialë, si edhe për luftën e proletariatit kundër kapitalistëve, të mos flitej sidomos kundër kolonialistëve të rinj, imperialistëve amerikanë, bile për një kohë shtypi sovjetik nuk përmendte imperializmin amerikan, por atë gjerman. Ky ishte qëllimi i tij kryesor. Parulla e bashkekzistencës i duhej Hrushovit për të shuar gjithashtu luftën nacionalçirimtare të vendeve koloniale e të varura. Pra, këto parulla janë hedhur nga N. Hrushovi me plan dhe me qëllim, prandaj Partia jonë, duke demaskuar thelbin reaksionar të tyre, ka treguar pozitën e saj revolucionare duke u nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit për këto çështje.

Përsa i përket politikës së jashtme të N. Hrushovit, të gjitha orvatjet, udhëtimet dhe fjalimet e tij nuk dhanë asnjë rezultat. Asnjë nga propozimet e Bashkimit

Sovjetik nuk e penguan imperializmin amerikan, sate-litët e tij, bile edhe Gjermaninë e Bonit të armatosen deri në dhëmbë. Asnjë nga problemet më të ngutshme ndërkom-bëtare nuk po gjen zgjidhje. Vihet pyetja: Pse të ndodhë kështu, kur udhëheqja e Bashkimit Sovjetik na ndjekka një vijë të drejtë? Sipas tezave të Kongresit XX të PK të BS, që na qenkan marksiste-leniniste, ne duhej të kishim rezultate në politikën e jashtme, duhej t'u impononim imperialistëve pikëpamjet tona. E vërteta është se tezat e Kongresit XX nuk janë marksiste-leniniste, mobilizuese, përkundrazi ato janë demobilizuese. Partia jonë në çdo rast ia ka sinjalizuar Hrushovit dobësitë dhe përbajtjen negative të tezave të tij, por ai as që i llogariste fare vërejtjet tona. Ai mendonte se «shqiptarëve ua rregulloj unë qej-fin». Por u gabua rëndë. E keqja i erdhin nga s'e pandehu.

Në politikën e brendshme, sidomos në çështjet e bujqësisë, po duken pasojat negative të punës revizioniste të N. Hrushovit. Fakti është se në BS ka mungesa të prodhimeve ushqimore si gjalpë, sheqer, sallam, vezë etj. Kjo gjendje në lëmin e bujqësisë është rezultat i politikës ekonomike antimarksiste të Hrushovit, i cili, në qoftë se përpara e quante veten «specialist të bujqësisë», tani hiqet se është «specialist i të gjithave», edhe «babai» i raketave. Hrushovi luftoi «kultin e Stalinit» për të ngritur kultin e vet.

Shkaku kryesor që në bujqësinë e BS nuk ka rezultate të mira qëndron në vijën antimarksiste të Hrushovit. Mjafton të përmendim masat për «riorganizimin e bujqësisë» që arriten deri te kalimi i SMT-ve nga pronë shtetërore, në pronë e grupit kolkozian, që është

një formë më e ulët prone, në krahasim me pronën socialiste të të gjithë popullit. Kjo i ka sjellë dëme të mëdha bujqësisë sovjetike. Kjo do të thotë të çohet prapa zhvillimi i bujqësisë. Për çështjen e SMT-ve Hrushovi bëri të kundërtën e atyre që shkruan Stalini në veprën e tij «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS». Në këtë libër trajtohen çështje të rëndësishme për ndërtimin e socializmit. Në të flitet edhe për probleme të zhvillimit të bujqësisë, për SMT-të, të cilat duhet të janë kurdoherë në dorën e shtetit etj., teza të cilat janë plotësisht të drejta, por që Hrushovi i errësoi, i shkeli dhe ndërtoi një vijë tjetër politike, ekonomike, që është thellësisht antimarksiste.

Hrushovi ngriti me të madhe çështjen e hapjes së tokave të reja. Mirëpo këto toka nuk kanë dhënë atë rentabilitet që ka trumpetuar Hrushovi. Në BS, ka zona që marrin rendimente të larta në drithëra, pambuk etj., sepse ujiten me teknikë moderne, kurse kjo nuk ndodh në tokat e reja. Fjalët e Hrushovit për bollëkun e këtyre tokave mbeten një zhurmë nga ana e tij, mburrje e premtive boshe. Hrushovi ka deklaruar se BS kishte vënë rezerva në grurë, por kur ne i kërkua mëna ndihmonte, se ishim pa bukë, ai këtë nuk e bëri, përkundrazi tha se «jemi në vështirësi për vete». Vështirësi për bukë ka vërtet në Bashkimin e sotëm Sovjetik, por drithë sa për ne ata kishin, megjithatë nuk na dhanë, se donin të na gjunjëzonin. Ne e kemi të qartë se duhet të luftojmë me të gjitha forcat tona, që prodhimin e drithërave ta sigurojmë vetë në vend dhe do të vijë dita që kësaj t'ia arrijmë.

Hrushovi ka menduar se të gjithë duhej të ndiqnin

rrugën e tij. Mirëpo komunistët nuk janë budallenj, ata në çdo vend janë nga njerëzit më të ngritur politikisht, më energjikët, që i gjykojnë drejt problemet, në dritën e mësimeve të marksizëm-leninizmit. Komunistët me punën e tyre influencojnë në politikën e vendit, jo vetëm atje ku partitë janë në fuqi, por edhe në vende të tjera. Prandaj ata ndiqnin veprimet e Hrushovit dhe situatën që krijoi ai në Bashkimin Sovjetik dhe në lëvizjen komuniste ndërkontinentare. Kjo situatë bëhej çdo ditë më e vështirë për Hrushovin. Sa kohë që kalonte pas Kongresit XX, pengesa gjithnjë e më të mëdha dilnin në rrugën e tij revisioniste, aq shumë sa demaskimi i tij po shtohej, jo vetëm nëpërmjet disa kritikave të drejta e të matura, po edhe me anë kritikash më të forta e më të ashpra. Kjo tregonte se kundërshtarët e Hrushovit po shtoheshin. Në këtë situatë, ai mendoi: «Me shqiptarët jam me të vërtetë në kundërshtim, por ata nuk kanë ç'të më bëjnë, ata rrojnë me lëmoshat tona. Pastaj vetë udhëheqësit shqiptarë kanë punuar në favorin tim, sepse në popullin e tyre ata kanë ngjallur një dashuri të madhe për BS dhe për PK të BS. Veç kësaj, në Bashkimin Sovjetik kanë studjuar shumë kuadro shqiptarë që një zë t'u bëj dhe i vënë minat udhëheqjes. Pra me shqiptarët e rregulloj punën. Po si t'ia bëj Kinës?».

Kështu u prengatit puçi i Bukureshtit. Nuk dihej se çfarë do të bëhej në Mbledhjen e Bukureshtit. Delegatët e partive komuniste e punëtore zyrtarisht dinin se shkonin për të përshëndetur Kongresin III të PP të Rumanisë, sepse qysh më parë ishte vendosur që për problemet aktuale ndërkontinentare do të bëhej një mbledhje

e partive komuniste e punëtore. Sipas marrëveshjes, në Bukuresht, meqë ishin përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore do të bëhej një takim i parëndësishëm, për të shkëmbyer ndonjë mendim vetëm për të caktuar vendin dhe datën e mbledhjes së ardhshme të partive komuniste e punëtore. Byroja Politike e KQ të Partisë sonë e pa me vend që të dërgonte delegacionin e vet të kryesuar jo nga Sekretari i Parë, por nga shoku Hysni Kapo, i cili ishte i autorizuar të përfaqësonte plotësisht Partinë tonë.

Në orët e vona të natës, disa orë përpëra mbledhjes, pjesëmarrësve iu shpërnda një «material informativ» prej 65 faqesh, që në të vërtetë s'kishte as kohë të mjaftueshme për ta lexuar. Materiali ishte në gjuhën ruse, përbante sulme kundër PK të Kinës. Partitë e tjera dhe Partia jonë, përveç atyre të vendeve të demokracisë popullore të Evropës, nuk kishin dërguar në Rumania sekretarët e parë, por ndonjë anëtar ose kandidat të KQ. Shumë prej tyre nuk ishin as të autorizuar për të folur kundër PK të Kinës. Prandaj u vunë në pozita shumë të vështira. Pastaj shumica nuk dinin as gjuhën ruse. Shoku Hysni kritikoi ata që i dorëzuan materialin se ai po jepej shumë vonë, pastaj problemi ishte me rëndësi shumë të madhe, duhej pyetur edhe udhëheqja e Partisë për të dhënë mendim. Por a ishte e mundur të njoftohej përbajtja e një materiali prej 65 faqesh? Për këto arsyen Hysniu tha se do të ishte mirë që kjo çështje të shqyrtohej në Mbledhjen e Moskës që të kishin kohë partitë të mendonin, por i thanë se ishte vendosur që të shqyrtohej tani.

Kështu u bë mbledhja dhe përfaqësuesit e partive

të vendeve të demokracisë popullore të Evropës u ngritën me radhë dhe goditën PK të Kinës.

Shoku Hysni Kapo u ngrit e tha se organizimi i kësaj mbledhjeje ishte bërë në kundërshtim me normat leniniste, prandaj Partia jonë nuk e pranon një gjë të tillë, nuk është dakord që një çështje kaq e rëndësishme të vendoset me ngut, të presim Mbledhjen e Moskës, që e kemi vendosur. Hrushovi u tërbua nga qëndrimi i Partisë sonë, por as ai, as shokët e tij nuk dinin ç'vendim të merrnin, u vunë në një pozitë qesharake, iu prish plani që kishin kurdisur. Delegatët e shumë partive të tjera u lëkundën, të dilnin kundër Bashkimit Sovjetik e kishin vështirë, të kritikonin PK të Kinës edhe këtë nuk e bënин dot, prandaj heshtën dhe u habitën shumë kur përfaqësuesi i PPSH doli me një qëndrim të qartë e të prerë. E gjithë kjo u mbyll me një komunikatë që nuk ishte as mish, as peshk. Mbledhja e Bukureshtit ishte një goditje e rëndë për Hrushovin, i cili filloi të hakmerrej kundër Partisë sonë që i prishi planin.

Ç'falsifikatorë të poshtër janë Hrushovi me shokët e tij! Pas dy muajsh rumunët na dërguan materialct e mbledhjes krejt të zbukuruara. Atje nuk ishin shkruar ato që u thanë, prandaj ua kthyem se ishin të rreme.

Komploti i Bukureshtit nuk ishte i rastit. Hrushovi ka pasur një plan të gjerë për shkatërrimin e komunizmit dhe këtë plan ai e ka preqatitur shumë kohë përpara kësaj mbledhjeje. Përsa i përket Partisë sonë, pas Bukureshtit, Hrushovi mendonte se kishte ardhur koha që udhëheqësit shqiptarë ose t'i bënte të nënshtroheshin ose t'i rrëzonte.

Dhe sulmin kundër nesh e filloi nga çështjet ushtarake, shkeli të gjitha marrëveshjet në këtë fushë dhe preu furnizimin me armatime. Po ushtria jonë nuk mbeti keq e pa armë, ajo vazhdoi pandërpërprerë punën e saj. Pastaj për të mbajtur qoshet na bëri edhe disa letra që t'i nxirrte më vonë si argumente, na ftoi të shkonim në Moskë në një takim dypalësh, për të zgjidhur gjoja keqkuptimet që lindën në Bukuresht, në mënyrë që PPSH, e cila ka qenë kurdoherë besnikë e marksizëm-leninizmit, të shkonte në Mbledhjen e Moskës në një mendje me udhëheqjen sovjetike. Ne i dhamë përgjigje stesës, dhe theksonim se PPSH nuk e ka zakon të vijë në një takim dypalësh dhe të flasë kundër një partie që nuk është e pranishme. Në letër theksuam se Partia jonë do ta thotë fjalën e saj në Mbledhjen e Moskës, ku do të jetë edhe delegacioni i PK të Kinës.

Kështu filloi presioni i gjithanshëm si në Moskë, ashtu edhe nga njerëzit sovjetikë që ishin në Shqipëri dhe puna arriti deri atje sa ambasadori sovjetik në Tiranë, Ivanov, u bëri pyetjen provokuese oficerëve tanë me fjalët: «Kujt do t'i jetë besnikë ushtria shqiptare?». Ata u përgjigjën me vendosmëri se e hedhin poshtë këtë provokacion të ambasadorit, i cili duhet ta dijë se ushtria jonë u qëndron besnikë Partisë së Punës të Shqipërisë, marksizëm-leninizmit, atdheut të vet, RP të Shqipërisë.

Partia jonë e kishte shumë të qartë se Hrushovi ishte në rrugën e tradhtisë, prandaj për të gjitha këto çështje duhej të flitej medoemos në Mbledhjen e Moskës. Kështu vendosi Komiteti Qendror i Partisë se këto

ishin çështje shumë të rëndësishme dhe jetike për Partinë tonë dhe për të gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ky vendim ishte shumë i drejtë. Ne, si marksistë dhe aq sa na lejohej, duhej të thoshim fjalën tonë në këtë mbledhje.

Duhet të ishe në Moskë, për të parë nga afër ç'njerez të ulët janë në krye të PK dhe të shtetit sovjetik, ç'intrigantë të paturpshëm, ç'shantazhe e presione të poshtra përdorën kundër nesh, si i ndërronin fjalët për të mashtruar njerëzit. Por ne nuk na gënjen dot. Ata bënë të gjitha përpjekjet të mësonin përmbajtjen e Fjalimit tonë ose të na detyronin ta ndryshonim atë duke na bërë gjithfarë lajkash e premtimesh. Qëllimi ishte që të gjenin mjetet e metodat për të na kthyer nga rruga jonë. Këto qëllime të tyre ne i shikonim qartë.

Më parë ata dërguan në takim me ne disa shokë të Presidiumit të KQ të PK të BS me Mikojanin në krye, që të mësonin ç'përmbante Fjalimi dhe për të na marrë me të mirë¹. Kur ne i thamë për veprimtarinë e ambasadorit Ivanov në Tiranë, Mikojani tha se «këto gjëra nuk duhen lejuar, kurrë nuk kam menduar që ambasadori të arrijë deri këtu». Ai pastaj na tha: «Keni të drejtë të thoni pikëpamjen tuaj edhe në qoftë se nuk jeni dakord me politikën tonë të jashtme, po na thoni ç'duhet të bëjmë që të rregullohen marrëdhëni tona. Ambasadorin do ta ndërrojmë». Këto lëshime ata i bënин, sepse e panë që ne nuk lëviznim nga pozita jonë, nga çështjet parimore dhe nuk thyheshim as nga veprimet e tyre antimarksiste kundër vendit tonë.

¹ Shih Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 358.

U përpoqën të na mbushnin mendjen që të mos preknim fare marrëdhëni tona. Ne mbajtëm gjakftohtësinë, por mbledhja u nxeh aq sa Susllovi u ngrit dhe u tha rojeve sovjetike që qëndronin në korridor të largohe-shin. Por nga ky takim asnë rezultat nuk arritën.

Pastaj erdhën edhe një herë dhe na propozuan të bënim një takim me Hrushovin¹. Ne shkuam në këtë takim. Të nesërmen ne do të mbanim Fjalimin tonë në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore. Kur ne mbajtëm Fjalimin tonë, shumë udhëheqës revizionistë, si Gomulka me shokë, na sulmuani me lloj-lloj epitetesh: «trockistë», «vagabondë» etj., por ne qëndronim të patundur si shkëmbi, se ata asnë fakt,asnë argument nuk ishin në gjendje të sillnin kundër nesh.

Mbledhja e Moskës ka historinë e vet. Para se të zhvillohej kjo mbledhje, shokët kinezë, shokët tanë dhe shokët e gjashtë partive të tjera për 18-20 ditë me radhë kanë luftuar dhe kanë punuar nga 10-12 orë në ditë për korrigjin e projektdeklaratës sovjetike, që ishte një dokument revizionist nga kreua deri në fund. Së fundi, ky dokument, që Hrushovi synonte ta bënte si një platformë, në bazë të së cilës të ecte e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, u hodh poshtë. Meqenëse plani i Hrushovit në Bukuresht nuk u realizua, atëherë ai, me projektdeklaratën e pregetitur për Mbledhjen e Moskës, kishte ndër mend t'i lidhët këmbët lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe, ata që nuk do ta pranonin, t'i akuzonte si përqarës të kampit socialist. Por Partiajonë ishte e pregetitur për të luftuar kundër këtij plani,

¹ Shih Enver Hoxha, Vepra, vëll. 19, f. 372.

shokët që dërguam para Mbledhjes së Moskës, në komisionin e redaktimit, e kishin të qartë çdo gjë.

Në këtë komision u bë një luftë e rreptë, nuk kalonte paragraf pa u diskutuar dhe pa iu bërë vërejtje. Dhe lufta jonë u kurorëzua me sukses. Delegatët sovjetikë detyroheshin shpesh të pranonin vërejtjet tona në komision. Po të nesërmen, me sa duket, pasi u hiqte veshin Hrushovi, kërkonin të bëhen ndryshime përato që kishte aprovuar komisioni.

Sido që kundërshtarët tanë përbënин shumicën dhe ne ishim pakica, ata u detyruan të pranonin shumë teza ashtu si i propozuam ne dhe shokët kinezë. E vetmja çështje themelore për të cilën ne nuk ishim dakord, por që u detyruam të bëjmë lëshim për hir të unititetit, është përmendja në Deklaratë e Kongresit XX. Po vlerësimin e Kongresit XX Partia jonë e bëri në Fjalimin e mbajtur në Mbledhjen e Moskës.

Unë dhe Mehmeti u larguam nga Moska më përpalla, se na kishin vënë në survejim të plotë. Në shtëpinë ku na priten ishin vendosur aparate përgjimi, por edhe ne kishim një aparat që zbulonte ku ishin vendosur aparatet e tyre. Duke qenë të survejuar u larguam nga shtëpia që na kishin vënë në dispozicion dhe shkuam për të banuar në ambasadën tonë. Në kohën kur po largoheshim një djalë i ri sovjetik i organeve të sigurimit u tha shokëve tanë se «shokët Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu bënë shumë mirë që ikën se nga tanët po bëhen gjëra të poshtra». Por kur shkuam në ambasadë zbuluam se edhe atje ishin vendosur aparate përgjimi. Në takimin që patëm me Hrushovin ia përplasëm në fytyrë mjetet dhe metodat që kishin përdorur

ndaj nesh. I vumë në dukje se ku kishte arritur poshtërsia e tyre, duke na vënë ne në përpunim. Kur i thamë se «baza e Vlorës është jona dhe do të mbetet jona», dhe se «ne ju respektojmë, duhet edhe ju të na respektoni», Hrushovi u përgjigj se «kështu me mua ka dashur të fliste Makmilani». Në çast ne u ngritëm në këmbë pér të ikur. Kur po largoheshim, Mehmeti iu kthye Hrushovit dhe i tha vënçe: «Mos ngri dorën kundër Shqipërisë se do të të pijë e zeza!». Dhe u larguam. Ramizi u kthye se kishte harruar një letër dhe dëgjoi Hrushovin që i thoshte Mikojanit: «Po tani ç'të bëjmë me këta shqiptarët?...».

Para se të mbahej Fjalimi ynë në Mbledhjen e Moskës, na bënë edhe shumë presione të tjera. Hrushovi u kishte thënë delegatëve kinezë se «me shqiptarët do të sillemi si me jugosllavët», kurse e vërteta është që me jugosllavët ai e ka grurë. Pastaj shtoi «është e vërtetë që ne humbëm Shqipërinë, por edhe ju nuk fituat ndonjë gjë të madhe». Në Mbledhjen e Moskës ne e dënuam këtë pikëpamje dhe i thamë Hrushovit se Shqipëria nuk është plaçkë tregu. Këto ishin disa nga orvatjet e Hrushovit dhe të pasuesve të tij, të cilët kishin menduar se me Shqipërinë nuk ka rrugë tjetër veçse ta gjunjëzojnë ose ta dobësojnë, dhe, po të mos dorëzohet, atëherë të marrin vendimin e fundit.

Pas Mbledhjes së Moskës, Hrushovi e dendësoi veprimtarinë armiqësore ndaj vendit tonë. Kështu ai filloi të marrë masa pér likuidimin e bazës ushtarake-detare të Vlorës, të krijuar pér sigurimin e mbrojtjes së Shqipërisë dhe të kampit socialist. Ne kishim nënshkruar një marrëveshje, sipas së cilës, të gjitha anijet

që do të vendoseshin atje, me kohë do t'i merrnim ne në dorëzim dhe qysh me daljen në ujërat tonë ato do të ishin pronë e shtetit shqiptar. Mirëpo gjatë punimeve të Mbledhjes së Moskës, Hrushovi thoshte se «nëndetëset janë tonat, prandaj do t'i tërheqim». Ne iu përgjigjëm se «nuk keni të drejtë të merrni asnje anije, se në bazë të marrëveshjes ato janë pronë e popullit shqiptar». I thamë gjithashtu se nuk kishin asnje të drejtë të prishnin bazën në mënyrë të njëanshme, se anijet janë pronë e shtetit shqiptar dhe me to mbrohet Shqipëria dhe kampi socialist. Ai kujtonte se duke na bërë presion me likuidimin e bazës, ne do të ngrinim duart, por ai nuk i njeh mirë shqiptarët!

Për likuidimin e bazës, e gjeti «arsyen e madhe», shqiptarët gjoja trajtonin keq marinarët sovjetikë, ua bënин këtyre jetën të pamundur, se një polic në rrugën për në Pashaliman, duke kontrolluar një autobus me të cilin udhëtonin edhe tri gra sovjetike, u kishte kërkuar atyre pasaportën dhe ky na qenkej një ofendim i madh. Ja edhe një «arsye tjetër», kalamajtë e Dukatit na ishin zënë me disa fëmijë sovjetikë dhe kjo na qenkësh një «incident» tjetër. Këto gjëra i kanë përdorur në dokumentet e tyre udhëheqësit sovjetikë si «argumente» për të provuar se njerëzve sovjetikë në Shqipëri u është bërë jeta e pamundur. Për këto arsyen, sipas tyre, «baza e Vlorës u duhej dorëzuar sovjetikëve dhe komanda duhej të ishte sovjetike». Kjo do të thotë që në truallin tonë ne shqiptarët «ta kishim kufirin te thana» dhe kur të donim të shkonim në Vlorë të kërkoni autorizim në komandën e marinës sovjetike. Me një fjalë në Vlorë të komandonte një garnizon sovjetik.

Po si mund të lejohej një gjë e tillë? Kjo as mund të mendohej e jo të lejohej!

Hrushovi kishte ndër mend të përsëriste manovrën e revisionistëve jugosllavë, që kërkonin të futnin në Shqipëri divizionet e tyre, gjoja për të na mbrojtur nga një sulm i monarko-fashistëve grkë. Partia jonë i hodi poshtë të tilla kërkesa antimarksiste, ajo i tha Hrushovit: kërkesa të tilla nuk janë aspak të drejta, se njerëzit tanë janë në gjendje të drejtojnë anijet e luftës dhe të mbrojnë brigjet e Adriatikut, interesat e atdheut dhe të kampit socialist. Vlora me rrethin e vet është e Shqipërisë, dhe e Shqipërisë ka për të mbetur gjithë jetën. Ato që thoni se marinarëve sovjetikë u është bërë jeta e padurueshme në Vlorë nuk kanë asnje bazë, ne i hedhim poshtë me neveri.

Partia dhe Qeveria jonë e kishin parashikuar me kohë se Hrushovi me shokë do të arrinin deri në këtë pikë. Përsa u përket mjeteve detare që drejtoheshin nga ekipazhet tona, ato qëndruan e nuk lëvizën nga vendi dhe për të mos hapur ndonjë konflikt lejuam të largoheshin ato anije që drejtoheshin nga ekipazhe sovjetike, megjithëse ligjërisht ato ishin tonat dhe ne ishim të gatshëm për t'i marrë në dorëzim dhe për t'i pasur në gatishmëri të plotë e jo si i kishin lënë të dërguarit e Hrushovit. Për këtë qëndrim të drejtë na quajtën «piratë», se mbajtëm anije që drejtoheshin nga marinarët tanë.

Për çështjet ekonomike Hrushovi mendoi se mbetëm në mes të rrugës dhe do t'i nënshtron heshim atij. «Ejani në Moskë, na thoshte, që të rishikojmë ato që kemi vendosur». Mirëpo përsë të venim në Moskë, derisa

marrëveshjet ishin të përfunduara e të firmosura nga të dyja palët? Në fakt, Hrushovi donte që unë dhe shoku Mehmet të shkonim në Moskë dhe të pranonim ato që do të na thoshte ai dhe pastaj të nxirrnim ndonjë komunikatë sipas oreksit të tij. Ne, për të mbrojtur nderin dhe vijën e Partisë sonë, iu përgjigjëm Hrushovit se nuk kishim përsë të venim në Moskë për probleme që janë nënshkruar marrëveshje, prandaj të gjitha këto ishin presione për të përulur popullin shqiptar dhe Partinë e tij të Punës. Por partitë marksiste-leniniste nuk e kanë zakon të përulen. Meqenëse ne refuzuam të shkonim në Moskë, ata pezulluan kreditë duke qenë të ndërgjegjshëm se kështu na sabotonin ekonominë. Por planet tona nuk u penguan, ato u realizuan, bile po tejkalojen. Republika Popullore e Kinës na ka akorduar kredi të mjaftueshme.

Hrushovi, si e pa që edhe me pezullimin e kredive dhe të furnizimeve nuk arriti të na nënshtrojë, atëherë urdhëroi largimin e specialistëve sovjetikë nga Shqipëria. Sa të paturpshëm janë treguar revisionistët sovjetikë! Ne donim që specialistët sovjetikë të qëndronin akoma dhe për këtë kemi letrat që i kemi dërguar udhëheqjes sovjetike, po ajo nuk mori parasysh kërkosat tona dhe më në fund shpifi se ishim ne ata që i dëbuam. Dokumentet tona do të vijë koha që të botohen dhe ata që i besojnë N. Hrushovit do të binden g'revisionist i ndyrë është. Ai me shokë janë nga ata që, si thotë populli ynë, «të vrash natën dhe të qajnë ditën».

N. Hrushovi preu edhe bursat e studentëve tanë, që ndiqnin shkollat e larta sovjetike. Ai ka vendosur

një bllokadë të plotë kundër Shqipërisë. Për Shqipërinë asnjë fjalë nuk shkruhet në shtypin sovjetik dhe as në atë të vendeve të demokracisë popullore të Evropës. Kurse gazetat tona shkruajnë për Bashkimin Sovjetik ose për vendet e tjera socialiste. Kjo që bëjmë ne është një politikë e drejtë. Natyrisht ne shkruajmë edhe për probleme ku i dhemb Bashkimit Sovjetik dhe lëvizjes komuniste ndërkontinentare, domethënë demaskojmë veprimet e grupit revizionist të Hrushovit. Ky qëndrim i tërbon revizionistët.

Hrushovit me shokë, ndofta u shkon mendja se, me masat që morën, do të na detyrojnë të ndjekim një vijë tjetër, të gjunjëzohemi, të shkojmë pas qerres së tyre revizioniste. Ata mendojnë kështu sepse janë vetë revizionistë. Ne flasim për dashurinë ndaj popujve dhe komunistëve sovjetikë, por në të njëjtën kohë s'mund të rrimë pa demaskuar Hrushovin dhe shokët e tij. Këtë e bëjmë në bazë të parimeve marksiste-leniniste dhe me dokumente, kurse Hrushovi dhe miqtë e tij vetëm shpifin kundër nesh.

Si u bindën që Partia jonë jo vetëm nuk përulej, por përkundrazi qëndronte në rrugën marksiste-leniniste, që populli shqiptar jo vetëm nuk mbeti pa bukë, por realizon dhe tejkalon me sukses planin e këtij viti, Hrushovi me shokë vendosën të na sulmojnë haptazi në Kongresin XXII të PK të BS. Ata morën parasysh edhe diskreditimin që do të pësonin përpëra popullit sovjetik dhe lëvizjes komuniste ndërkontinentare me këtë veprim, po s'kishin si të bënin ndryshe, sepse nga dita në ditë po bëhej më e rëndë situata për N. Hrushovin, teoritë e tij revizioniste vazhdimesht po demaskoheshin.

Kongresi XXII i PK të BS në rendin e ditës kishte kryesish diskutimin dhe aprovimin e programit të ndërtimit të komunizmit në Bashkimin Sovjetik. Por nën maskën e këtij programi, Hrushovi avancoi shumë teza të tij revizioniste, duke i parashtruar aty për t'i aprovar kongresi.

Në planin e Hrushovit parashikohej që Kongresi XXII të diskutonte edhe një herë çështjen e kultit të individit. Me këtë çështje Hrushovi lidhi edhe Partinë e Punës të Shqipërisë, që nuk e ka kuptuar gjoja rëndësinë e pasojave të kultit të individit. Ai duhej të goditte fort kundërshtarin, për të trembur partitë e tjera, për të evituar largimin e tyre nga rruga e Hrushovit. Kështu Hrushovi me një gur kishte ndër mend të vriste dy zogj: Të dënone Shqipërinë dhe të frikësonte të tjerët, duke u thënë: E patë se ç'i bëra Shqipërisë, kështu do t'ua bëj edhe juve, pra, ose ejani me ne, ose do ta pësoni si PPSH. Gjithashtu Hrushovi kërçenonte edhe partitë komuniste dhe punëtore që kanë filluar ta ndiejnë si qëndron e vërteta dhe t'i rezistojnë. Ai dhe grupi i tij u thonë udhëheqësve të këtyre partive: «Hapni sytë, ndërroni rrugë se do ta pësoni si udhëheqësit shqiptarë. Edhe ju kundërrevolucionarë kudo që jeni, në Bullgari, në Rumani e në çdo vend të demokracisë popullore, ju Koçi Xoxe, Liri Belishovëra e Koço Tashkora, në rast se ndonjë nga udhëheqësit tuaj luan bishtin nga via e Kongresit XXII, ngrehuni kundër tij se më keni mua mbështetje, unë do t'ju marr nën sqetull!» Shikoni ç'bëhet, të gjithë kundërrevolucionarët, agjentë të imperializmit, të gjithë ata që u dënuan si armiq të socializmit në kohën e Stalinit,

Hrushovi i shpalli «viktimë» dhe do t'u ngrejë edhe një përmendore në Moskë.

Kështu Kongresi XXII në vend që të bëhej një tribunë për problemet e ndërtimit të komunizmit, u kthye në një tribunë kundër kultit të individit, grupit «antiparti» dhe ku shpërtheu urrejtja e revisionistëve kundër PPSH. Këto tri çështje u bënë objekt i luftës së Hrushovit dhe i pasuesve të tij. Çështja u bë aq skandaloze saqë gazetat «Pravda», «Ymanite» dhe «Unita» filluan të tërheqin vëmendjen e shtypit borgjez se nuk po flitej për programin e ndërtimit të komunizmit por vetëm për çështjet e «kultit të individit», të grupit «antiparti» dhe të Shqipërisë. Kështu grupi i N. Hrushovit e pa edhe vetë se kishte devjuar shumë, por borgjezia ndërkombëtare, për interesat e saj e kapi dhe e shfrytëzoi si duhet këtë gjendje, ajo i hodhi benzinë zjarrit, u gëzua shumë që Hrushovin e kishte sjellë në rrugën e vet.

Ky ishte plani që kishte N. Hrushovi në Kongresin XXII. Ai e dinte se me ngritjen e këtyre tri çështjeve do të kishte reaksion. Në këtë kongres ai nuk ftoi delegacion nga Partia jonë, sepse atje do të na akuzonte dhe parashikonte dy mundësi: ose delegacioni ynë në shenjë proteste do të largohej nga kongresi, ose do të duronte dhe pastaj do të kërkonte të thoshte mendimin e vet. Të dyja këto ishin të rrezikshme për Hrushovin, prandaj nuk na ftoi. Atë q'kishte për ta bëré, ai e bëri në kongresin e partisë së vet dhe pati frikë të propozonte një mbledhje të re të partive, sepse e pa q'pësoi vitin e kaluar në Mbledhjen e Moskës. Qëllimi i tij ishte të mobilizonte të gjitha partitë komuniste e pu-

nëtore kundër nesh dhe indirekt edhe kundër PK të Kinës dhe të siguronte sa më shumë pasues, që t'u këndonin «duanë» tezave të Kongresit XXII dhe projektprogramit të PK të BS. Pra të arrinte atë që nuk arriti dot në Mbledhjen e Bukureshtit e më vonë në Mbledhjen e Moskës. Po edhe kjo nuk i doli.

Në Kongresin XXII u ngrit përfaqësuesi i PK të Kinës dhe i quajti antimarksiste sulmet e Hrushovit kundër Partisë sonë. Kjo ishte një goditje shumë e rëndë për Hrushovin dhe pasuesit e tij. Me fjalimin e tij përfaqësuesi i PK të Kinës i dha të kuptojë Hrushovit se veprimet e tij janë antimarksiste dhe u shërbjnë vetëm armiqve të socializmit. Në shtypin kinez janë botuar Deklarata e KQ të PPSH dhe artikujt e «Zërit të popullit», mbi sulmet e revisionistëve sovjetikë kundër PPSH në Kongresin XXII të tyre, bile në faqe të parë. Qysh kur filloi Kongresi XXII i PK të BS nga dy faqe të gazetës «Zhenminzhibao» ishin plot me materiale për Shqipërinë dhe për sukset e saj. Kur u festua 20-vjetori i themelimit të Partisë sonë, shtypi kinez njoftoi se «shoku Enver Hoxha ka mbajtur një fjalim shumë të rëndësishëm» dhe pas disa ditësh këtë shokët kinezë e botuan në gjuhën e tyre. Përveç kësaj për 20-vjetorin e themelimit të Partisë na dërguan telegram urimi me plot konsiderata për rrugën e drejtë të Partisë sonë. Me këto qëndrime PK e Kinës i thoshte Hrushovit se nuk është aspak dakord me qëndrimin që mban ndaj PPSH.

Partia jonë është e re, por e regjur në luftëra, ajo nuk i nxori në publik mosmarrëveshjet siç bëri Hrushovi dhe pasuesit e tij. Kështu pa kaluar shumë kohë

nga Mbledhja e Moskës, Valter Ulbrihti akuzoi publikisht Partinë tonë si «sektare» dhe «dogmatike» me qëllim që të na nxiste ne të ngriheshim dhe ta bënim këtë një problem ndërkombetar, të prebatitej terreni pér atë që donte ai. Por ne nuk folëm, i bëmë vetëm një letër KQ të PSB të Gjermanisë, me të cilën hidhnik poshtë sulmet e ulëta të Ulbrihit. Më vonë na sulmoi Toliat, por këtij as letër nuk i bëmë. Shtojmë se në udhëheqjen e PK të Italisë ka pikëpamje që jo vetëm PK e BS, por çdo parti tjetër e ka të drejtën të denoncojë politikën e një partie tjetër. Në këtë parti, ka mjaft komunistë që janë «me vijën e Stalinit», siç shprehen ata. Në gjirin e KQ ka kundërshtime, por fjalimet që boton gazeta «Unita» janë të rregulluara, pér të treguar gjoja unitetin e partisë, që në të vërtetë nuk ekziston. Dhe unitet nuk mund të ketë, se këto janë çështje shumë të mëdha. Hrushovi ka hapur një hendek të madh, në të cilin do të bjerë vetë brenda. Çdo ditë që kalon vepra e tij demaskohet, atë do ta demaskojë qëndrimi i drejtë i Partisë sonë, i PK të Kinës dhe i partive të tjera marksiste-leniniste. Prandaj veprimtaria e tij revizioniste do të vijë vazhdimisht duke u bërë më e theksuar dhe komunistët e popujt e botës do të shohin më qartë çështë ky grup, ku e çon lëvizjen komuniste dhe kujt i shërbën politika e tij.

Me qëndrimet e drejta të saj, Partia jonë, sado e vogël që është, ka fituar gjithnjë e më shumë përkrahjen dhe respektin e komunistëve revolucionarë në botë, të cilët kudo që janë po reflektojnë, sepse shohin se ato që thotë PPSH po dalin si në politikën e jashtme,

ashtu dhe në politikën e brendshme. Kurse Hrushovi po dështron, pavarësisht nga avokatët mbrojtës re-visionistë.

Titoja mbajti këto ditë një fjalim në Shkup. Ai foli për Kongresin XXII të PK të BS dhe për Shqipërinë. «Ne i kemi ndjekur me vëmendje punimet e Kongresit XXII dhe kemi lexuar ato që na prekin ne, pamë se u sulmuam, por këtë e pritëm në mënyrë të qetë». Thotë kështu Titoja, sepse kritika ndaj tij ishte e butë. Hrushovi ka thënë vetë se e ka paralajmëruar Titon që të mos zemërohet kur është i detyruar ta kritikojë ca. Prandaj Titoja nuk kishte si të mos i priste «në mënyrë të qetë» këto «sulme». Ai deklaroi: «Nuk dimë kur do të pushojnë këto sulme. Megjithëkëtë në punimet e Kongresit XXII ne kemi parë edhe një kurs pozitiv, që ka filluar të pasqyrohet efektivisht në zhvillimin e mëtejshëm jo vetëm të BRSS, por edhe të vendeve të tjera socialiste. Prandaj Kongresi XXII i PK të BS ka rëndësi të madhe për ecjen e mëtejshme drejt një zhvillimi me të vërtetë demokratik përparimtar, jo vetëm në BRSS po edhe në vende të tjera të botës. Nuk mund të flas për perspektivat e mëtejshme të zhvillimit të komunizmit, kjo është një çështje studimi, por mund të them vetëm se ne e përshëndesim një kurs të tillë si ai që filloi në Kongresin XXII.».

Teodor Zhivkovi pas Kongresit XXII doli në televizionin e Moskës dhe deklaroi paturpësisht se të gjitha partitë komuniste e punëtore duke qenë unanime me PK të BS, sulmuan ashpër Partinë e Punës të Shqipërisë, shhangjet e saj. Kurse Titoja, në fjalimin

e vet në Shkup tha: «Unë nuk dua të hyj në çështjen, nëse kanë ekzistuar apo ekzistojnë mosmarrëveshje midis BRSS dhe RP të Kinës, por është e qartë se askush nuk do të pajtohet me mendimin se qëndrimi i Kinës është pozitiv dhe të kthehem i në kursin që duan ata. Kjo do të dëmtonte shumë jo vetëm BRSS, por edhe të gjitha vendet e tjera socialiste dhe bile gjithë zhvillimin e shpejtë të socializmit në botë». Me këtë Titoja do të thotë se është dakord me Hrushovin.

«PPSH, tha Titoja në Shkup, përfaqëson pikëpamjet e PK të Kinës në këtë pjesë të Evropës dhe nuk thotë të vërtetën për ne. Fjalimi që mbajti Enver Hoxha me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë është plot shpifje kundër Jugosllavisë dhe trillon mbi rrezikun që i kërcënohet nga ne. Me një fjalë ka një përmbajtje të tillë saqë njeriu duhet të mendojë rrëth tij dhe të pyesë: mos vallë përbahet ndonjë provokacion kundër vendit tonë, se dimë që një gjë e ngjashme është bërë edhe në kohën e Stalinit kur kundër nesh pregetiteshin provokacione. Prandaj ne mendojmë se udhëheqësit shqiptarë përbëjnë një rrezik të madh për paqen, në këtë zonë të botës, sepse nëpërmjet Enver Hoxhës e Mehmet Shehut krijohet një vatër e re e rrezikut të luftës. Mendojmë, vazhdoi ai, se një pjesë e sulmeve të udhëheqësve shqiptarë u drejtohen shokëve në Moskë, Hrushovit dhe të tjerëve dhe një pjesë na referohen neve. Por ne do të jemi vigjilentë dhe nuk do të lejojmë që asnjë vend, qoftë edhe Shqipëria ta çojë punën deri në atë pikë saqë të rrezikohet paqja në Ballkan. Ne i urojmë të mirën popullit shqiptar, asgjë nuk kemi kundër tij, nuk kemi dashur as ta

robërojmë as ta bashkojmë Shqipërinë me forcë. Ne duam që në Shqipëri të pushojë derdhja e gjakut të një-rëzve të pafajshëm. Ne kurrë nuk do t'u zgjatim dorën udhëheqësve të tillë si Enver Hoxha e Mehmet Shehu dhe kurrë nuk do të pajtohem me ata, duart e të cilëve janë lyer me gjakun e bijve më të mirë të populilit shqiptar, siç kanë qenë Koçi Xoxe e të tjerë, që kanë ndihmuar në krijimin e PK Shqiptare»!

Siq shihet, Titoja me Hrushovin, si shokë që janë, mendojnë se ka ardhur koha që të luajnë me letra të hapëta. Si ato që thotë Hrushovi, dhe këto që tha Titoja në Shkup tregojnë se të dy këta ndjekin të njëjtën rrugë.

Por kjo luftë, shokë, që bëjmë ne kundër revizionistëve, natyrisht nuk është as e lehtë, as e shkurtër. Nuk duhet të kemi iluzione se me kaq sa kemi bërë dhe hrushovizmi u shkatërrua. Lufta do të jetë e gjatë, veçse ajo do të zhvillohet vazhdimisht në favorin tonë, në favorin e socializmit.

Partia jonë është e armatosur për ta përfunduar me fitore këtë luftë dhe është e bindur se e ka drejt. Pastaj ne nuk jemi vetëm, ata që janë me ne përbëjnë shumicën dérrmuese të komunistëve. Megjithatë ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, të ruajmë si sytë e ballit unitetin e Partisë, sepse shigjetat janë drejtuar kundër Partisë sonë. Është një nder i madh për Martinë tonë që mbron me lavdi e vetëmohim jo vetëm lirinë dhe pavarësinë e atdheut, por edhe çështjen e madhe të marksizëm-leninizmit.

Po Partisë sonë nuk i rritet mendja. Partia jonë është e re, por ajo ka bërë një luftë të paprerë 20-vjeçare marksiste-leniniste, që e ka kalitur dhe e ka bërë

të pamposhtur. Partia jonë ka krijuar një unitet real dhe të çeliktë, që duket në çdo kohë në të gjitha anët e atdheut. Ç'entuziazëm, ç'unitet të fortë ka në të gjithë Partinë tonë që nga baza e deri lart! Ç'unitet të çeliktë ka midis komunistëve dhe popullit! Sa më të vështira janë momentet, aq më i fortë bëhet uniteti popull-parti. Kjo tregon aprovin e vijës së drejtë të Partisë sonë nga ana e popullit, kjo tregon sa drejt ka punuar Partia për edukimin e masave, të cilat e kanë provuar në jetë drejtësinë e vijës së saj në çdo sektor, prandaj e mbështetin pa rezerva Partinë e tyre.

Hrushovi e di këtë, prandaj u përpoq ta çante unitetin e Partisë sonë nëpërmjet Liri Belishovës e Koço Tashkos, por nuk mundi. Megjithatë, të mos mendojmë se ai do t'i hedhë armët. Hrushovi do të përpinqet me çdo mjet të godasë unitetin e Partisë sonë, por do të dështojë si kurdoherë. Edhe armiqjtë tanë, të gjithë, po sidomos këta që kemi rrëth e rrötull, do të na bëjnë si gjithnjë provokacione. Prandaj ta ruajmë me shumë kujdes unitetin tonë dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit me durim e heroizëm, duke i sqaruar njerëzit. Po kur ka njerëz që nuk duan të ndreqen, t'u tregojmë vendin. Diktatura e proletariatit rron, ajo vigjelon dhe vepron. Ato që thotë Hrushovi se «në BRSS nuk ka diktaturë, se te ne nuk është nevoja të jepen dënimë e të futen njerëz në burgje», janë profka. Atëherë përsë e ngriti edhe një herë çështjen e Stalinit, pas vdekjes? Këtë ai e bëri se Stalinin nuk e harron njeri, ai udhëhoqi Bashkimin Sovjetik për 30 vjet pas vdekjes së Leninit.

Një shqiptar udhëtonte me tren në Azerbajxhan

dhe kur një plak, pasi e pyeti dhe mësoi që ishte shqiptar, i tha: «Ne ju duam shumë ju dhe bëni shumë mirë që jeni me Stalinin, ai ka qenë njeri i madh», u hodh një sovjetik tjetër aty afër e tha: «Dakord ashtu është, po ka bërë edhe gabime Stalini». «Po unë jam bolshevik i vjetër, vazhdoi përsëri plaku, dhe e njoh më mirë se ti Stalinin». Muhabeti u nxeh dhe plaku tha: «Dëgjoti, shqiptar, në rrugët e Bakusë ka krisur mitralozi, kur deshën të hiqnin monumentin e Stalinit, sepse doli populli dhe kundërshtoi me demostratë, kështu njerëzit e Hrushovit u tërhoqën me bisht në shalë».

Çështja e Stalinit dhe e veprës së tij nuk është një çështje e vogël, ajo tërheq shumë njerëz, që bëhen kundërshtarë të Hrushovit, dhe ky i godet kur i zbulon, prandaj le të thotë sa të dojë se në BS nuk ka diktaturë dhe të burgosur politikë. Për ne është e qartë: në BS s'ka vërtet diktaturë të proletariatit, por atje ka diktaturë fashiste, që burgos bolshevikët e njerëzit e ndershëm dhe liron kundërrevolucionarët.

Situata na dikton që në vendin tonë të forcohet më tej diktatura e proletariatit, e cila duhet të veprojë kundër atyre që do të mundohen të ngrihen kundër unititetit të Partisë me popullin dhe kundër interesave të atdheut tonë e të socializmit. Prandaj vigjilanca duhet të qëndrojë si detyrë e dorës së parë për ne, Partia të jetë kurdoherë e gatshme dhe të vihet në krye të popullit për kryerjen e detyrave politike, ideologjike, ekonomike, për mbrojtjen e atdheut dhe të pastërtisë së marksizëm-leninizmit. Ta kalitim gjithnjë më shumë besimin e popullit për Partinë, për çështjen e drejtë që që mbron Partia se nuk jemi vetëm. Bashkë

me Partinë tonë në këtë rrugë ecin të vendosur PK e Kinës dhe parti të tjera. Kina Popullore luan një rol të madh në lëvizjen komuniste ndërkombejtare. PK e Kinës qëndron në pozita të shëndosha marksiste-leniniste. Ajo është një parti e madhe dhe me një eksperiencë të gjatë që e tmerron Hrushovin. Me ne janë jo vetëm parti komuniste e punëtore të vendeve të Azisë, por edhe parti të Amerikës Latine.

Ka njerëz që ngatërrojnë Bashkimin Sovjetik me udhëheqjen aktuale sovjetike, në të cilën mbështetet N. Hrushovi. Hrushovi thotë, ashtu si Koço Tashkoja, që nuk mund të ndahet udhëheqja sovjetike nga partia dhe nga populli sovjetik, prandaj kush e do PK të BS dhe BRSS ai duhet të dojë edhe Hrushovin. Ky arsyetim është absurd. Kur është fjala për Stalinin, revizionistëve hrušovianë nuk u leverdis ta parashtrojnë çështjen sipas kësaj «logjike», kurse kur është fjala për veten e tyre ata thonë se «kush nuk do Hrushovin, ai nuk do as BS»! Ne themi të kundërtën, përderisa në kokën e BRSS kanë ardhur në fuqi disa tradhtarë, këta duhen luftuar, sepse kështu ndihmohet në fakt edhe BRSS edhe lëvizja komuniste ndërkombejtare.

Organizata e Partisë e Gjirokastrës është një organizatë e shëndoshë. Me realizimin e planeve ju nuk keni dalë keq, pavarësisht nga thatësira, drithërat janë bërë mirë. Në përgjithësi Komiteti Qendror i Partisë ka mendimin se organizata e Partisë e rrethit tuaj është një nga organizatat më të mira, me komunistë trima dhe të vendosur qind për qind, luftëtarë të papërkultur dhe kam bindjen se ajo në krye të punonjësve, do t'i realizojë me sukses detyrat ekonomike si edhe çdo detyrë që ka të

bëjë me mbrojtjen e Partisë dhe të popullit, me mbrojtjen e kufijve dhe të lirisë së atdheut. Veçanërisht ju që jeni një rrëth kufitar duhet t'i bëni një luftë të vazhdueshme propagandës që zhvillojnë monarko-fashistët grekë me shtyp e sidomos me radio. Ju keni të gjitha mundësitë ta luftoni me sukses këtë propagandë, keni zotësinë, zgjuarsinë dhe pjekurinë për të plotësuar më së miri çdo detyrë që do t'ju ngarkojë Partia.

Nuk dua të zgjatem më tepër. Ju uroj, shokë, suksesë në punën tuaj kudo që jeni!

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RRUGA PËR NË SOCIALIZËM NUK ËSHTË E SHTRUAR ME LULE

Fjala në mitingun me popullin e Delvinës

16 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe,

Jam shumë i gjëzuar që vij sot këtu në mes jush për t'ju sjellë përshëndetjet më të përzemërtë të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë dhe t'ju uroj për festën e madhe të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të dashur! Kanë kaluar 20 vjet që kurse u themelua Partia jonë, e cila mori mbi supet e saj akoma të njoma, barrën e rëndë për drejtimin e popullit shqiptar në luftën e madhe të çlirimit të atdheut nga pushtuesit fashistë, nga bejlerët, agallarët, kapitalistët dhe tradhtarët.

Në fillim Partia jonë ishte e vogël, por e fuqishme se kishte dalë nga gjiri i popullit të vuajtur, se ajo kishte me vete tërë popullin, i cili dëshironë të çlirohej një herë e përgjithmonë nga pushtuesit fashistë italianë dhe gjermanë dhe kishte luftuar në shekuj për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut.

Pushtuesit fashistë dhe tradhtarët e vendit kujtuan

se Partia jonë nuk do ta kishte të gjatë, sepse, siç thoshin ata, komunistët nuk janë veçse disa «rrugaçë dhe kalamaj». Por nuk kaluan veç disa muaj dhe ata e panë mirë cilët ishin komunistët, që goditën me guxim dhe me trimëri në të katër anët e vendit armiqjtë e armatosur gjer në dhëmbë. Nëpërmjet luftës së ashpër për jetë a për vdekje 200 anëtarët e parë të Partisë u bënë më vonë mijëra, për arsy se Partia u lidh më ngushtë me popullin, luftoi për popullin, përfaqësonte dëshirat e tij. Komunistët dhe partizanët u mbajtën, u ruajtën dhe u ushqyen nga populli. Kështu nga një grusht i vogël njerëzish, që ishin në fillim, ata u bënë një ushtri e madhe, që theu pushtuesit italianë e gjermanë si dhe tradhtarët e vendit dhe i dha popullit lirinë, e bëri atdheun tonë sovran, i siguroi pavarësinë. Kështu u bë e mundur që populli të merrte fuqinë në dorë dhe nën udhëheqjen e Partisë filloi rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit.

Këtë muaj, i gjithë populli shqiptar kujtoi ato ditë të vështira, por heroike, kur u themelua Partia jonë e dashur. Që atëherë deri tani kanë kaluar 20 vjet, kohë kjo gjatë së cilës janë bërë ndryshime të mëdha në Shqipëri, që nuk mund të bëhen as për shekuj me radhë në të kaluarën, sepse fuqinë atëherë nuk e kishte në dorë populli, në krye nuk ishte një udhëheqje e dalë nga gjiri i tij. Ndryshe është tani, populli ka ardhur në fuqi dhe udhëhiqet nga Partia, prandaj edhe fitoi. Pikërisht për këtë arsy janë bërë gjithë këto ndryshime të mëdha në vendin tonë.

Pas Çlirimt, në Shqipëri, në fillim u rindërtua çdo gjë që ishte shkatërruar, u bënë reforma të shumta e

të rëndësishme, Reforma Agrare në radhë të parë. Fshatarëve iu dha toka, se ata e kishin punuar gjithë jetën, mbi atë tokë kishin lënë djersën dhe koskat e tyre gjyshërit e stërgjyshërit tanë. Megjithëse fshatari e punonte tokën, kur vinte koha e prodhimeve, e vjetjes së grurit, misrit, frutave etj., beu i merrte të tretën, qeveria të dhjetën dhe taksat e tjera, fajdexhiu borthet me kamatë të rëndë dhe bujku mbetej kështu me gisht në gojë. Tani fshatarësia jonë, që u hodh e tëra pa rezerva në Luftën Nacionallirimtare, në aleancë të shëndoshë me klasën punëtore, u bë e zonja e tokës. Shteti konfiskoi, për t'i vënë në shërbim të popullit, të gjitha pasuritë e pasanikëve, bankat, minierat, fabrikat, automjetet, portet, pyjet, tokat dhe pallatet; i detyroi ata t'i paguanin popullit deri në një ato që ia kishin rrëmbyer e ia kishin vjedhur gjatë shekujve, duke i pirë edhe pikën e fundit të gjakut.

Krahas punës për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta filloi edhe ndërtimi i bazave të socializmit. Realizimet e derisotme, që bëri ky popull fukura, nën udhëheqjen e Partisë, janë të mëdha. Bejlerët dhe agallarët thoshin: «Populli bën vetëm për të mbaratur gurë, se nuk ka tru në kokë». Tru vetëm ata na paskeshin! E vërteta është se ata nuk kishin as tru, as duar dhe as zotësi, por jetonin si parazitë në kurriz të popullit. Zotësia, mençuria e vërtetë janë te populli, dhe ja erdhi koha që ai u çlirua dhe bëri të gjitha këto që shikojmë sot. Bejlerët e agallarët dërgonin disa nga djemtë e tyre nëpër shkolla, sikur ata gjoja ishin më të zgjuar e të mësuar, që të bëheshin avokatë, për të mbrojtur regjin e tyre shtypës. Këta njerëz nuk bënë

asnje përpjekje që ky popull bujar dhe trim të shihte një ditë të mirë.

Tani populli u bë zot i fateve të tij, ai i vuri shpatullat punës. Vetë populli me Partinë në krye iu përvesh punës së madhe të rindërlimit të atdheut të shkattërruar dhe të ndërtimit të socializmit. Vendi ynë u ndihmua nga Bashkimi Sovjetik, atdheu i madh i Leninit dhe i Stalinit, ai u ndihmua edhe nga vendet e tjera të demokracisë popullore. Kjo ishte një ndihmë internacionaliste e domosdoshme dhe jo lëmoshë. Populli shqiptar është nga ata që nuk pranon lëmosha. Vendet socialiste, që udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi, e kanë kurdoherë për detyrë të ndihmojnë njërit-tjetrin. Prandaj në rast se kjo ndihmë ndërpritet për njërin ose për tjetrin vend socialist, kjo nuk është marksiste-leniniste.

Tani te ne janë ndërtuar me dhjetëra fabrika, uzina, hidrocentrale, që punojnë për t'i dhënë popullit sa më shumë prodhime, për të cilat ai ka nevojë. Këto vepra të reja moderne i vënë në lëvizje djemtë dhe vajzat tona, që i mësoi dhe i edukoi Partia, i vënë në lëvizje ata bij dhe ato bija punëtorësh dhe fshatarësh, që përpara ruanin lopët dhe nuk dinin të hidhnin as firmën. Këta njerëz tani kanë marrë kulturë të përgjithshme e teknike dhe punojnë që industria jonë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë të zhvillohen çdo vit e më shumë.

Edhe bujqësia ka marrë një hov të madh në Shqipëri. Tani te ne pothuajse është realizuar kolektivizimi, që është rruga e shpëtimit të fshatarësisë sonë. Kolektivizimi jep mundësi të shtohen të ardhurat e fshatarë-

sisë, për të përmirësuar jetën e fshatarit tonë. Tani fshatari prodhon më shumë, jo vetëm për veten e tij, por për gjithë kolektivin. Fushat tona janë zbuluar, janë tharë me dhjetëra kënela e moçale, kodrat po vi-shen me pemë, vreshta e ullinj.

Të gjitha këto vepra i bëri populli i udhëhequr nga Partia, e cila ndjek një rrugë të drejtë.

Edhe Delvina juaj e bukur dikur ka qenë prona e disa agallarëve. Kur më ka qëlluar të kaloja nga qyteti juaj në kohën e Zogut, kam parë rrëth e rrötull stre-hëve të dyqaneve njerëz pa punë, të leckosur e të mjerë, që u qanin fëmijët nëpër kolibe, që nuk dinin si do ta ngrysnin ditën. Tani Delvina ka ndryshuar dhe në një të ardhshme jo të largët ajo do të jetë shumë më e bukur se ç'është, se i ka edhe të gjitha kushtet, në radhë të parë ka njerëzit e saj të mirë dhe dihet se njerëzit bëjnë çdo gjë. Delvina ka klimë dhe tokë shumë të mirë. Partia dhe Qeveria e kanë ndihmuar dhe e ndihmojnë çdo vit, që të gjitha këto kodra të zhveshura të mbushen me ullinj, portokalla e limona, që fushat tuaja të prodhojnë më shumë e më me bollëk grurë e misër për të mirën tuaj dhe të të gjithë vendit.

Një e ardhshme më e gëzuar dhe më e lumtur e pret popullin tonë. Kur e thotë Partia këtë e ka matur dhe e ka peshuar mirë, ajo nuk qëndron në hava, por mbështetet fort në tokë, ajo më parë i mat gjërat, pastaj i futet punës. Ju keni dijeni për planin e tretë pe-sëvjeçar, sepse ai është bërë gjaku dhejeta juaj. Me-gjithëqë akoma jemi në fillim të punës, mund të themi se viti i parë i pesëvjeçarit të tretë, jo vetëm te ju, por

në gjithë Shqipërinë po realizohet e po tejkalohet në sektorin e industrisë. Në bujqësi, me përjashtim të dritërave, që na u dëmtuan nga thatësira dhe të duhanit nga vrugu, kulturat e tjera kanë dalë mirë. Kjo ka bërë qëjeta e popullit të përmirësohet.

Ju e keni parë vetë se popullit nuk i ka munguar asgjë, përkundrazi ka pasur me bollëk mallra industriale, dyqanet kanë qenë plot edhe me prodhime ushqimore dhe të një cilësie të mirë. Tregu ynë është furnizuar në kohën e duhur me të gjitha mallrat e nevojshme.

Plani i tretë pesëvjeçar është një plan me rëndësi shumë të madhe për popullin tonë, ai do të realizohet me sukses dhe brenda një kohe më të shkurtër, ky është vullneti i klasës punëtore, i fshatarësisë punonjëse, i inteligjencës popullore dhe i Partisë sonë. Prandaj, me besim të patundur, ne duhet të ecim përpara me një vrull akoma më të madh se deri tani, për të kapërcyer çdo vështirësi e pengesë që do të na dalë përpara. Në punë e në jetë ka edhe vështirësi e pengesa, rruga për në socializëm nuk është e shtruar me lule, gjatë kësaj rruge ka edhe ferra, por këto nuk na kanë penguar e nuk na pengojnë dhe ne e dimë se çdo fitore do të arrihet me luftë dhe me punë.

Ju e dini se po s'punove s'fiton gjë, po lidhe duart s'ke për të ngrënë, ky është ligj në socializëm. Kështu që realizimi i planit madhështor të pesëvjeçarit të tretë kërkon një mobilizim të gjithanshëm. Nga ana financiare ky plan është plotësisht i siguruar, pavarësisht se N. Hrushovi dhe shokët e tij ia prenë kreditë Shqipërisë. Me këtë ai tregon se nuk është në binarët e

marksizëm-leninizmit, por në rrugën revizioniste. Për planin tonë të tretë pesëvjeçar çdo gjë është siguruar, tani realizimi i tij varet kryesisht nga mobilizimi, nga organizimi dhe puna që do të bëjmë vetë dhe ne do ta realizojmë atë, sepse asgjë s'na mungon, tani kemi edhe eksperiencë më shumë dhe popullit do t'ia japim ato që i kemi thënë.

Shqipëria vërtet është një vend i vogël, por ajo jeton në një epokë të madhe, në shekullin e triumfit të leninizmit, që është një shekull i lavdishëm, shekulli i klasës punëtore, i marksizëm-leninizmit, përpara të cilit nuk mund të ketë asnjë pengesë. Popullit, klasës punëtore dhe marksizëm-leninizmit asgjë nuk mund t'u rezistojë, sado e fortë që të jetë.

Kapitalizmi nga mesi i shekullit të kaluar ishte në kulmin e forcës së tij, dhe i madhi Karl Marks i vetëm ishte kur shkroi «Kapitalin» e famshëm, që u bë fener ndriçues i rrugës që duhej të ndiqte proletariati botëror. Në këtë vepër monumentale K. Marks përgjithësoi gjithë eksperiencën e grumbulluar deri në atë kohë për luftën e klasës punëtore, zbuloi kalbësirën e kapitalizmit, ligjet e tij dhe u tha proletarëve të ecin përpara.

Sipas mësimeve të Karl Marks-it u ngrit në këmbë proletariati heroik i Parisit në kohën e Komunës, me gjithëse ishte një pakicë përballë forcës së madhe të borgjezisë dhe të ushtrisë gjermane, që kishte rrethuar Parisin. Por proletariati i Parisit, siç tha Karl Marks-i, sulmoi qiejt dhe flamuri i tij u bë flamur për çlirim nga shfrytëzimi.

Më 1917 në Rusi fitoi Revolucioni Socialist i udhëhequr nga Lenini i madh. Si bisha të uritura iu vërt-

sulën shtetit të ri sovjetik 14 shtete kapitaliste për ta mbytur, por asgjë nuk mundën t'i bënin, revolucioni atje triumfoi dhe u krijua Bashkimi Sovjetik. Ç'nuک kanë bërë shtetet kapitaliste për ta thyer shtetin sovjetik, e jo vetëm nuk ia arritën qëllimit, por Bashkimi Sovjetik u bë çdo vit më i fuqishëm. Kur pllakosi pushtimi hitlerian u ngritën në këmbë si një trup i vetëm të gjithë popujt sovjetikë dhe nën udhëheqjen e Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik me Stalinin e madh në krye i shkatërruan ushtritë hitleriane që mbaheshin më të fortat në botë dhe që deri atëherë kishin robëruar gjithë Evropën. Bashkë me të gjithë popujt e tjerë të robëruar, në luftë për jetë a për vdekje, u ngrit edhe populli ynë i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë. Ushtritë fashiste gjermane, italiane dhe ato militariste japoneze u shkatërruan dhe Lufta e Dytë Botërore përfundoi me fitore për popujt. Nga kjo luftë lindi kampi socialist, potenciali i të cilit, gjatë viteve të pasluftës, u rrit politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Ne u bëmë më të fortë se kampi imperialist. Kjo e shqetëson imperializmin dhe pikërisht për këtë qëllim ai armatoset, për ta hedhur edhe një herë botën në luftë. Prandaj kundër këtyre orvatjeve ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, t'i bëjmë sytë katër, të mbajmë pushkët të pastra dhe barutin të thatë ose si thotë Partia në njëren dorë të mbajmë kazmën dhe në tjetrën pushkën, çdo armiku që do të përpiqet të lëvizë t'i biem kokës. Në këto kushte të mobilizojmë të gjitha forcat për realizimin e planeve për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Imperialistët amerikanë përvcq që armatosen vetë, armatosin dita-ditës edhe aleatët e tyre e në radhë të parë Gjermaninë Perëndimore. Imperializmi në luftën e tij kundër vendeve socialiste dhe marksizëm-leninizmit përdor edhe një armë tjeter të fshehtë, revizionizmin. Revisionistët modernë i përdor për të na përqarë e për të na dobësuar, për të shpartalluar partitë komuniste dhe punëtore, por ata janë goditur e janë demaskuar dhe do të luftohen vazhdimisht deri në shpartallimin e tyre të plotë.

Revizionizmi ka lindur si reaksion ndaj shkencës fitimtare të komunizmit, marksizmit, kur idetë e tij kishin triumfuar në lëvizjen punëtore. Revisionistët janë një rrymë borgjeze në gjirin e kësaj lëvizjeje për ta përqarë e për ta minuar atë nga brenda, duke u maskuar me parulla pseudomarksiste. Këta tradhtarë të klasës punëtore i luftoi dhe i shpartalloi V. I. Lenini. Më vonë pas lindjes së Bashkimit Sovjetik dolën trockistët, buharinistët, zinovievistët, të cilët u vunë në shërbim të imperialistëve e të forcave reaksionare, për të penguar ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik. Por Partia e Leninit, me Stalinin në krye, u dha një grusht për vdekje këtyre armiqve të pakorrigjueshëm dhe i shpartalloi. Pas Luftës së Dytë Botërore dolën në shesh revisionistët jugosllavë, për të cilët ju keni dëgjuar dhe e dini mirë se cilët janë. Ata fshihen prapa disa parullave pseudomarksiste, por që tanimë edhe këtyre u është hequr maska. Klika e Titos është përpjekur ta robëronte Shqipërinë, ta shkatërronte Partinë tonë dhe më në fund ta copëtonte vendin tonë me Greqinë. Por këto plane armiqësore dhe veglat e Titos

në Shqipëri si Koçi Xoxe me shokë, Partia jonë i shpartalloi.

Tani në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombe-tare e të PK të BS doli një klikë tjetër revizioniste, grupi i N. Hrushovit, që me një mijë e një dredhi dhe duke i fshehur mirë qëllimet e veta, mori pushtetin sovjetik dhe trilloi gjithë ato shpifje kundër personit të Stalinit. Hrushovi i bëri këto për të përhapur idetë e tij revizioniste në Bashkimin Sovjetik. Ai akuzoi J. V. Stalinin për shumë krime, ato u kurdisën se i duhej Hrushovit të diskreditonte veprën e Stalinit. Po të kishte ngjarë si thotë Hrushovi, Bashkimi Sovjetik nuk do të kishte ekzistuar dhe nuk do të kishte fituar, ai nuk do t'u bënte dot ballë hordhive të Hitlerit, që popujt e luftëtarët sovjetikë i shpartalluan, duke luftuar me heroizëm e durim e me Stalinin në gojë.

Ai shpifi gjithashtu kundër Partisë sonë, se e pa që ajo ishte një parti marksiste-leniniste, që nuk i nënshtrohej vijës së tij të shtrembër, sepse vija e Hrushovit çon ujë në mullirin e imperializmit. Partia na ka mësuar t'i mbrojmë deri në fund intercesat e klasës punëtore, të popullit tonë, të lëvizjes komuniste ndërkombe-tare kundër cilitdo qoftë, i madh apo i vogël, i fortë ose i dobët. Në qoftë se nuk do të vepronim kështu, atëherë çdo fitore jona do të ishte në rrezik.

N. Hrushovi nuk i bën luftë imperializmit në mënyrë revolucionare, ai u fërkon krahët krerëve të tij dhe kërkon që çdo gjë ta zgjidhë në rrugën e bisedimeve. Ne nuk jemi kundër bisedimeve, por ai ka varur shpresa të mëdha te përfaqësuesit më të mëdhenj të

monopoleve kapitaliste, të cilët nuk janë gjë tjetër veçse këlyshë të verbër të imperializmit.

Titoja na qenka i kënaqur nga këto veprime të N. Hrushovit. Në fjalimin që mbajti këto ditë në Shkup, pasi i erdhi gjahu në shteg, midis të tjerave ai u shpreh se është plotësisht i kënaqur dhe dakord me vijën që ndjek N. Hrushovi. Por edhe ne jemi të kënaqur me fjalimin e Titos se u vërtetua ajo që ka thënë e thotë Partia jonë se vija që ndjek Hrushovi është një vijë revizioniste. Në fjalimin e tij Titoja thotë se Hrushovi e sulmoi në kongres, por ai me shokët e tij e printën me gjakftohtësi sulmin. Ta merr mendja se kritikat e Hrushovit për Titon ishin goditje me pambuk. Duke akuzuar Shqipërinë në këtë fjalim, Titoja doli po në atë shteg që ka dalë edhe N. Hrushovi, që Shqipëria nuk ecën në rrugën që duhet, sepse në krye janë Enver Hoxha, Mehmet Shehu dhe shokët e tyre. Ne nuk u çuditëm aspak kur i dëgjuam këto sulme nga goja e Titos, po çështjen e kam se Titoja me Hrushovin janë të një mendimi, kanë të njëjtat plane.

Edhe Titoja shpifi përsëri për Stalinin. Ai deklroi sikur J. V. Stalini i paska propozuar «ta robërojë Shqipërinë», por këtë propozim nuk e paskan pranuar udhëheqësit jugosllavë. Po Titoja e di më mirë se kushdo tjetër se ç'qëndrim të prerë ka mbajtur Stalini kur iu dërgua propozimi i udhëheqësve të Beogradit përfutjen e divizioneve jugosllave në Shqipëri. Stalini na këshilloi të mos pranojmë në asnjë mënyrë ardhjen e ushtrisë jugosllave në Shqipëri. Ky do të ishte hapi i parë për pushtimin e vendit tonë. Prandaj në këtë çështje Titoja shpif kundër Stalinit dhe revizionis-

tët shpifjet i kanë zanat. Dhe, për të mbushur mendjen e të tjerëve, Titoja na thotë se e refuzoi propozimin për pushtimin e Shqipërisë «për shkak se në atë mënyrë do të thyhej parimi i vetëvendosjes së popujve».

Nga ana tjetër Titoja deklaron në këtë fjalim se paska një dashuri të madhe për popullin shqiptar, se ai do që ky të rrojë i lumtur dhe i gjëzuar etj. Ka një gjë që Titoja nuk arrin deri atje ku arrin N. Hrushovi, i cili i bën thirrje për kryengritje popullit shqiptar; por në një formë tjetër ai e nxit popullin tonë kur thotë se ai nuk do t'u japë kurrë dorën as Enver Hoxhës, as Mehmet Shehut. Me një fjalë ai u bën thirrje shqiptarëve të ngrihen kundër udhëheqjes.

Po atë që nuk e tha N. Hrushovi, e tha Titoja. Në fjalim ky tha se çështja shqiptare është bërë një rrezik i madh për Ballkanin, sepse Enver Hoxha e Mehmet Shehu po kurdisin komplotë për sulme kundër Jugosllavisë.

Shqipëria nuk është bërë rrezik për asnjë popull, por vetëm për revizionistët. Kjo akuzë është si përralla e vjetër e ujkut që e dinë të gjithë. N. Hrushovi tani ka mbyllur gojën, ai do që ta fshehë lodrën e tij, mirëpo këtë ia zbulon shoku i tij, Titoja, në fjalimin e Shkupit, me të cilin i thotë Hrushovit se është dakord me rrugën e tij.

Pasi foli për veprimet revizioniste e antimarksiste të N. Hrushovit në Mbledhjen e Bukureshtit e në atë të Moskës, që u zhvilluan në vitin 1960, për akuzat e për shpifjet e tij kundër Partisë sonë në Kongresin XXII të PK të BS dhe për qëndrimet revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha tha:

Vija e Partisë sonë është një vijë e drejtë marksiste-leniniste. Mund të ketë ndonjë që të thotë: «E ç'na u desh neve të dalim kundër Hrushovit, jemi të vegjël, më mirë të rrnim urtë, të merrnim edhe kreditë, se nuk jemi ne ata që do të ndreqim botën». Të tilla pikëpamje nuk janë të drejta, këta njerëz nuk mendojnë mirë. Sipas tyre atëherë duhej të kishim mbajtur po ato qëndrime edhe ndaj monarko-fashistëve grekë e revizionistëve jugosllavë, sepse edhe ata janë të mëdhenj. Sikur t'u kishim bërë rrugë kërcenimeve të tyre, populli shqiptar sot nuk do të ishte i lirë, ai do të ishte robëruar me kohë. Pra edhe me këtë rast, po ta linim Hrushovin të livadhiste si të donte ai, jo vetëm populli ynë do të ishte në rrezik, por shumë dëm i bëhej edhe lëvizjes komuniste e punëtore e vetë çështjes së komunizmit. Prandaj ne bëmë shumë mirë që mbajtëm këtë qëndrim, sepse kështu mbrojtëm interesat e popullit, lirinë dhe pavarësinë e atdheut e të marksizëm-leninizmit.

Ne do të fitojmë se jemi në rrugë të drejtë. Veçse lufta jonë kundër revizionizmit është e gjatë, shokë, fitorja nuk do të arrihet lehtë dhe me sot e me nesër. N. Hrushovi dhe shokët e tij nuk i hedhin armët, por ata do t'i mposhtë me siguri lufta parimore konsekutive e partive komuniste e punëtore, që po e shtojnë çdo ditë që kalon më shumë rezistencën e tyre, lufta e vetë komunistëve dhe e popujve sovjetikë, që do të bëjnë kundër kësaj rryme të rrezikshme antimarksiste, që ka filluar të lëshojë rrënje atje. Duke bërë një luftë të tillë, pozitat e revizionistëve dhe e të gjithë armiqve të hapët ose të fshehtë të komunizmit do të tronditen,

do të dobësohen dhe në mos sot nesër, pra, më në fund, do të shpartallohen.

Prandaj me besim të madh në forcat tona, me besim të madh te Partia, te lëvizja komuniste ndërkom-bëtare, të ecim përpara të ndriçuar nga ideologjia e pavdekshme e proletariatit, marksizëm-leninizmi e, duke mbajtur në njëren dorë pushkën dhe në tjetrën kazmën, të punojmë pa u lodhur për realizimin e planeve tona! Populli shqiptar asnjëherë nuk është alarmuar se e di që ecën drejt, se e di që drejtësia është me të, se është trim, i guximshëm dhe i vuajtur dhe nuk i trembet syri nga askush, pastaj ai e di se me miliona komunistë, punëtorë e njerëz të ndershëm në botë janë me ne dhe është i sigurt në fitoren përfundimtare.

Përpara në rrugën e drejtë të Partisë!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i Delvinës!

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TE VAZHDOJME PUNEN ME RITME EDHE ME TE LARTA

*Nga biseda në mbledhjen e Byrosë së Komitetit
të Partisë të Rrethit të Sarandës*

17 nëntor 1961

Në përgjithësi, nga të dhënrat që ka Komiteti Qendror, si dhe nga ato që na informoi këtu sekretari i parë i komitetit tuaj, punët në rrethin e Sarandës shkojnë mirë në të gjitha drejtimet. Siç shihet Saranda ka bërë përparime të dukshme. Kjo u detyrohet edhe punës që kanë zhvilluar organizatat-bazë të Partisë, mobilizimit të tyre dhe të vetë udhëheqjes së Partisë të rrethit. Ju jeni shokë të vjetër dhe me eksperiençë të gjatë, shumica keni mbaruar shkolla partie ose ekonomike.

Këtë vit rrethi juaj paraqitet mirë nga ana ekonomike. Sigurisht në punën tuaj ka suksese, ka edhe të meta, ju mund të bënët edhe më shumë, këtë ne do ta themi çdo vit, se vazhdimisht rriten forcat prodhuese, po rriten edhe kërkuesat.

Rrethi juaj e ka realizuar, bile e ka tejkular detyrën e planit të drithërave, që është një çështje më

shumë rëndësi. Gjithashtu keni tejkaluar planin e hammaulloreve, pra edhe kjo është një gjë shumë e mirë. Por ju nuk keni realizuar rendimentin në grurë, mundet të jetë një shkak edhe thatësira, por një rënie nga 10,2 kv për ha në 8 kv për ha nuk është e justifikueshme.

Është e domosdoshme të tregoni kujdes në çështjen e qarkullimit bujqësor. Ky duhet të vendoset dhe të zbatohet. Kooperativistët ta kuptojnë mirë edhe rëndësinë e kanaleve kulluese. Në disa rrethe bëhet një punë shumë e mirë për kullimin e ujërave nga arat, prandaj këtë çështje ta kemi kurdoherë parasysh se në dimër, si në këtë kohë, kemi shumë reshje, që na i kalbin ose na i dobësojnë drithërat. Prandaj në drejtim të kullimit të tokave duhet punuar më shumë.

Kujdes të madh duhet të tregoni për farërat. Ne do të marrim masa nëpërmjet qendrës së seleksionimit të farërave, por komiteti ekzekutiv dhe kryesitë e kooperativave bujqësore duhet të tregojnë shumë kujdes që farërat t'i siguroni vetë në vend. Në rast se këtë problem e ndjek mirë që nga fillimi e deri në fund çdo kooperativë, do të bëhet një hap i madh përpara. Çdo kooperativë duhet të nxjerrë vetë konkluzionin, se cila farë bën më mirë për kushtet dhe për tokat e saj. Kësaj çështjeje, pra, i duhet vënë kujdes në bazë.

Të luftojmë veçanërisht për shtimin e prodhimit të drithërave të bukës, sepse jemi të detyruar të sjellim grurë me shumicë nga jashtë. Për ne është akoma e vështirë të evitojmë importin e drithit, por puna është ta zvogëlojmë sa më shumë këtë import. Pra, të bëjmë luftë serioze për bukën. Ne duhet të luftojmë të

realizojmë akoma më mirë planet tona në të gjitha drejtimet dhe jo vetëm në industri, por edhe në bujqësi, si për shembull planin e qumshtit, që ju e keni realizuar në mënyrë të kënaqshme, të leshit, të ullinjve, për të evitar importimin e yndyrnave etj. Kështu, do të forcojmë ekonominë e do të rritim mirëqenien.

Orientimet janë përcaktuar dhe ato ju i keni të qarta, vetëm duhet luftuar më shumë për t'i zbatuar në jetë, të zhdukim dobësitë që ekzistojnë, si fjala vjen, ato që keni ju në fidanishtet. Këto orientime kanë një rëndësi të madhe, si për zhvillimin e ullishtave, ashtu edhe të agrumeve. Dhe me të vërtetë rrathi i Sarandës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e ullinjve, të agrumeve dhe frutave të tjera. Populli i do e i kultivon mirë ato, sepse i sjellin shumë të ardhura. Me një punë më të mirë në drejtim të fidanishteve dhe të sektorëve, ku ju keni akoma dobësi, prodhimi do të rritet.

Një kujdes më të madh të tregoni për problemin e ujitjes. Për këtë çështje shteti ka bërë investime të mëdha. Shpenzime të mëdha janë bërë e po bëhen edhe për tharjen e Vurgut dhe për ujitjen e fushave të këtij rrathi. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe ishte e domosdoshme të bëhej, por nga kooperativat bujqësore duhet të bëhet më shumë për shfrytëzimin maksimal të ujërave për ujitje me të gjitha mënyrat dhe ta ngrëmë më shpejt përqindjen e tokave të ujitura. Në rrethin tuaj qysh tanj ujiten 60 për qind të sipërfaqeve të punueshme. Kjo nuk është keq po të krahasohet me mesataren, e cila për të gjithë Republikën në vitin 1965 do të jetë 42 për qind, po ju duhet të luftoni ta

ngrini akoma përqindjen me hauze dhe deri me vija të vogla.

Duhet parë nëse mund të bëhet diçka gjatë këtij plani pesëvjeçar për ngritjen e ujërave në disa vende më të larta, me qëllim që të zgjerohet mbjellja e agrumeve në kodra. Në plan ne parashikonim që Bullgaria të na ndihmonte në këtë drejtim duke na dërguar një sasi motopompa. Por udhëheqësit bullgarë, me anën e një letre që na kanë dërguar, na bëjnë të ditur se marrëdhëniet me vendin tonë këtej e tutje do t'i ndërtojnë mbi baza të tjera. Kurse udhëheqësit çekoslovakë na njoftuan se kreditë që u akorduan nga qeveria e tyre nuk u ratifikuan nga Asambleja Kombëtare, me një fjalë nuk na i japin.

Në këtë situatë që është krijuar ka rëndësi të madhe që Partia të mobilizohet, për të mbajtur në nivelin e duhur gjendjen moralo-politike të popullit, për të ngritur akoma më shumë frymën e lartë patriotike të popullit tonë. Partia duhet ta zbatojë me këmbëngulje politikën e saj të drejtë për kalitjen e radhëve të saj dhe për forcimin e unitetit me popullin përpara këtyre situatave të vështira, duke organizuar sa më mirë punën për luftën kundër armiqve të fshehtë e të maskuar këtu brenda, ose kundër armiqve të jashtëm, si edhe luftën për realizimin e planeve tona ekonomike. Kjo ka një rëndësi të madhe.

Në momentet që po kalojmë kemi edhe mungesa e vështirësi në fushën ekonomike, që janë shkaktuar si pasojë e situatës së krijuar, por kemi edhe suksese, të nxitura nga kjo situatë në drejtim të ngritjes së hovit të madh patriotik revolucionar të masave punonjëse.

Organizatat e Partisë, duke u mbështetur në këto suksese, të luftojnë akoma më shumë për të qenë kurdoherë në ballë të situatës. Deri tani Partia jonë asnjeherë nuk ka qëndruar në bisht të situatës, ajo vazhdimisht ka qenë në ballë të luftës, atje ku vështirësitë kanë qenë më të mëdha. Prandaj në këtë rrugë të ecet edhe këtej e tutje. Këtë e theksoj që komunistët të mos flenë mbi dafina, të dehen nga sukseset e arritura dhe të mos aktivizohen, të mos i ndjekin punët si duhet në këto kushte që na janë krijuar. Të mos mendojmë se nuk do të kemi vështirësi, se situatat që janë krijuar nuk janë të mira as për ne, as për komunizmin ndër-kombëtar.

Ne duhet të jemi realistë. Deri tani lëvizja komuniste ndërkombëtare ka pasur armiq të hapur revizionistët e Beogradit, të cilët pas një lufte të ashpër u demaskuan. Mirëpo tani kemi të bëjmë me një grup të fuqishëm revisionist jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në vendet e demokracisë popullore të Evropës. Në partitë komuniste e punëtore të këtyre vendeve ka një bërthamë revisionistësh, që janë solidarizuar me grupin revisionist sovjetik, të kryesuar nga N. Hrushovi. Ne jemi të bindur se në udhëheqjet e partive komuniste e punëtore të vendeve të demokracisë popullore të Evropës ka komunistë që janë në kundërshtim me këto grupe revisionistësh. Duhet kuptuar se situata për ta është e vështirë, megjithëkëtë ata duhet ta bëjnë detyrën e tyre si marksistë.

Nga grupet revisioniste në këto parti ne do të kemi telashe, ashtu sikurse do të kemi edhe nga armiqtë rreth e rrotull nesh. Ne e dimë se ndërsa N. Hrushovi

flet kundër nesh dhe i bën thirrje hapur popullit shqiptar për kryengritje, titistët veprojnë në mënyrë aktive dhe me metoda të rafinuara kundër vendit tonë. E njëjtë gjë ndodh edhe me monarko-fashistët grekë.

Shovinistët grekë, sipas logjikës së tyre, mendojnë se, për të bërë punë armiqësore kundër vendit tonë, kanë minoritetin. Ky është një gjykim shovinist reaksionar, sepse realiteti qëndron krejt ndryshe. Pakica kombëtare greke në Shqipëri qëndron në pozita të shëndosha, ajo është e lidhur ngushtë me popullin shqiptar dhe jo vetëm tani në rendin e demokracisë popullore, por që gjatë Luftës së Parë Botërore, kur ushtritë e Venizellosit pushtuan Korçën e Gjirokastër, në kohën e Zogut, në atë të okupacionit grek të Shqipërisë së Jugut më 1940, edhe gjatë Luftës Nacional-çlirimtare. Është fakt historik se edhe në ato kohë të trubullta minoriteti nuk ka rënë në pozitat shoviniste greke. E kam fjalën për popullin, jo për tregtarët e krerët reaksionarë si Vasil Shahinët. Masat nuk kanë qenë asnjëherë në pozitat e shovinizmit grek. Kur erdhën grkët në Shqipërinë e Jugut, minoritarët fare lehtë mund t'u kthenin krahët shqiptarëve, por ata, me gjithëse vuanin për vete, bukën e ndanin së bashku dhe ua çonin deri në Gjirokastër. Ky është fakt. Tani propaganda dhe shtypi reaksionar grek përpilen ta ndajnë minoritetin grek nga populli shqiptar. Reaksiuni grek, përdor një mijë e një dredhira, duke shfrytëzuar sidomos radion, gjuhën greke dhe muzikën, prapa së cilës nuk mungon edhe propaganda helmuese, për të trullo sur mendjet e njerëzve. Prandaj duhet të tregohet shumë kujdes që t'i ruajmë njerëzit tanë

nga propaganda e armikut. Në këtë drejtim është kryesisht propaganda reaksionare greke që duhet luftuar.

Kjo kërkon që puna e propagandës së Partisë, sidomos me minoritetin, edhe në rrithin tuaj duhet të forcohet. Të forcohet veçanërisht puna me rininë, sepse rinia është një nga objektet kryesore të armiqve tanë, revisionistëve modernë, monarko-fashistëve grekë dhe imperialistëve. Natyrisht armiku përpinqet që puna e tij të zërë vend edhe në njerëzit e tjerë, por këta janë të rrahur në jetë e me eksperiencë, kurse të rinjtë nuk kanë eksperiencën e duhur dhe, po të mos kujdesemi për ta, atëherë mund të gjenjehen nga iluzione që propagandon e servir armiku. Kështu, propaganda reaksionare dëshirat dhe hovin revolucionar të rinisë i drejton në rrugë të këqija. Për këtë qëllim armiku përdor parulla demagogjike, premton pozita dhe një jetë «më të mirë» me një fjalë e çorienton rininë, me qëllim që ajo të bëhet mbështetje për rrugën e tij.

Në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokratisë popullore rinia është duke u futur në rrugën e degjenerimit, kurse në Shqipëri një fenomen i tillë nuk ekziston, sepse vija e Partisë sonë është e drejtë dhe rinia rritet e shëndoshë në punë dhe në luftë. Por duhet parë edhe ana tjetër e çështjes, dëfrimi i rinisë, se edhe kjo ka rëndësi. Prandaj të mbahet parasysh edhe kjo çështje dhe brenda mundësive, për dëfrimin e çlodhjen e kulturuar të rinisë të bëjmë ç'është e mundur me mjetet që disponojmë. Puna e edukimit të rinisë nëpërmjet filmave, parashikojmë se do të vëstirësohet. Dihet se filmi është një ushqim i madh shpir-

tëror për të gjithë. Te ne shfaqeshin vazhdimisht filma sovjetikë, për arsyen se ata kishin cilësi të lartë dhe përputheshin me vijën e Partisë sonë. Ndërsa tanë duhet të shohësh shumë filma sovjetikë për të zgjedhur ndonjë, sepse sa më shumë kohë kalon, aq më tepër bëhet e theksuar vija oportuniste revizioniste edhe në këtë sektor. Sovjetikët e dinë që ne nuk kemi industri kinematografike, prandaj krijojnë pengesa.

Pra duhet të na preokupojë edhe problemi i dëfritimit të rinisë, prandaj të mos e neglizhojmë këtë çështje, kur kemi mundësi të organizojmë grupe korale, orkestrale, valltarësh, skuadra lojnash me top, grupe atletësh dhe t'u sigurojmë të rinjve edhe bazën minimale materiale, të bëhen terrenet sportive vende për edukimin dhe për dësrimin e rinisë në rrugë të drejtë. Partia jonë t'i shfrytëzojë këto mundësi, për të përballuar vështirësitë që mund të hasim, dhe do të hasim nga ana politike, ideologjike, se kështu do të ndihmohem më tepër për të kapërcyer edhe vështirësitë ekonomike, që do të na dalin gjatë realizimit të planeve tona.

Komiteti Qendror ju ka vënë vazhdimisht në korent të situatës, se si po zhvillohen marrëdhëniet me udhëheqjen e BS. Në fjalimin që u mbajt me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PPSH sintetizohet qëndrimi i Partisë sonë ndaj udhëheqësve sovjetikë dhe pa-suesve të tyre. Grupi i N. Hrushovit është në fuqi në BS. Ai është një grup revizionist, që shfrytëzon forcën e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake të BS, autoritetin e madh të PK të BS, me të cilin ky grup mbulon fytyrën e vet revizioniste dhe vepron. Duket qartë se qëllimi i këtij grupi është të shkatërrojë socializmin

në BS, të likuidojë të gjitha fitoret e arritura nën udhëheqjen e PK të BS dhe ta kthejë shtetin sovjetik në rrugën e një shteti borgjez, ashtu sikundër kanë bërë edhe titistët në Jugosllavi. Derisa ky grup të likuidohet, jo vetëm ideologjikisht, po edhe si grup, pjesëtarët e tij do të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë, të ruajnë maskën dhe të krijojnë përshtypjen sikur punojnë dhe luftojnë për socializmin.

N. Hrushovi i ka mbrojtur dhe i mbron titistët jugosllavë. Por kur Titoja vepron në një mënyrë të tillë që duhet demaskuar, atëherë edhe N. Hrushovi, i shtrënguar nga rrethanat, detyrohet ta atakojë atë dhe ta quajë «kalë i Trojës» etj. Kurse tani Hrushovi deklaron se «Jugosllavia po ndërton socializmin! Duket që të dyja palët ndjekin një kurs revisionist.

N. Hrushovi akuzon Berian se gjoja donte të hynte në takime me Rankoviçin. Pojeta tregon se këtë ai e ka përdorur si armë kundër Berias dhe me siguri, Hrushovi ka rënë në ujdi me Rankoviçin për këtë çështje, ashtu siç duhet të kenë biseduar me Titon dhe për tezat e zhvillimin e Kongresit XX të PK të BS, sepse çështjet kryesore të ngritura në këtë kongres janë trajtuar duke u mbështetur në tezat e njoitura revisioniste. Të tilla janë tezat mbi luftën dhe paqen, mbi ndryshimin e natyrës agresive të imperializmit, mbi rrugën e kalimit paqësor për në socializëm, për çështjen e Stalinit etj. Të ndalemi pak në këtë të fundit që ka qenë edhe objekti kryesor i luftës së Titos.

Sipas Titos, pushteti sovjetik, është një sistem që ka lindur kultin e individit, siç është «kulti i Stalinit», prandaj partitë komuniste e punëtore nuk duhet të

ecin në rrugën e Bashkimit Sovjetik, por të ndjekin një kurs të ri! Ky është kursi revizionist.

Edhe Hrushovi me tezat e tij për çështjen e Stalinit, doli në të njëjtën rrugë me Titon. Në raportin e tij «sekret» që mbajti në Kongresin XX, ai manipuloi dokumente dhe shpifje për të hedhur poshtë emrin dhe veprën e Stalinit. Kjo u bë nga grapi i N. Hrushovit për të krijuar një situatë të trubullt në BS, për të tronditur ndërgjegjen e komunistëve e të popullit sovjetik, për të shkurorëzuar leninizmin, për ta shndërruar PK të BS në një parti liberale, revizioniste, për të tronditur besimin e punonjësve dhe të komunistëve të botës ndaj fitoreve të mëdha historike, që u arritën në BS në kohën e Stalinit. Kështu, puqen Titoja e Hrushovi edhe në çështje të tjera, për të cilat tezat dhe qëndrimet e tyre janë revizioniste.

Më poshtë, pasi foli për disa çështje që kanë të bëjnë me qëndrimet e partive komuniste e punëtore dhe me marrëdhëni midis tyre, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Se çfarë do të ngjasë më vonë nuk dihet, po me siguri do të nxehen gjakrat. E drejta ka depërtuar dhe depërton kudo, megjithëse situata është e vështirë. Por sulmi kundër Partisë sonë nga udhëheqjet e disa partive, që ndjekin N. Hrushovin, në vetvete është shenjë dobësie dhe diskreditimi për ata.

Presionet, që na bëjnë revizionistët, do të dështojnë se qëndrimi ynë është i patundur. Ne jemi një forcë e madhe dhe kompakte. Veprimtaria anti-marksiste që zhvillojnë revizionistët dhe demaskimi që u bëjmë e do t'u bëjmë edhe në të ardhshmen, do t'i

zhveshë akoma më shumë përpara syve të popujve. Ky është një proces në zhvillim, sepse këto grupe jo vetëm që veprojnë kundër marksizëm-lininizmit, por edhe në çdo fushë të jetës do të veprojnë në rrugën e tyre antimarksiste, prandaj në momente e në situata të ndryshme do të duket qartë kalbësira e tyre.

Në këto çështje që shtrohen sot përpara lëvizjes komuniste ka kontradikta të mëdha. Vetë zhvillimi i ngjarjeve i vë partitë përpara përgjegjësisë. Secila duhet të mbajë qëndrim për këto probleme të mëdha që ka vënë përpara jeta.

Lufta jonë kundër revizionizmit do të jetë e gjatë, por ne e dimë se fitorja do të jetë jona, veçse nuk do të jetë e lehtë, këtë ta kemi parasysh. Me vigjilencën e mprehtë dhe patriotizmin e lartë të popullit tonë, me vijën e drejtë të Partisë ne do t'i realizojmë me siguri planet tona, kurse Hrushovi me pasuesit e tij do të dështojnë. Në veprimtarinë që kanë filluar, ata do të demaskohen dhe vazhdimisht do të dobësohen politikisht dhe ideologjikisht. Hrushovi dhe ata që e pasojnë mund të organizojnë edhe aventura kundër nesh, por në këto situata aventurat janë shumë të rrezikshme për ta. Hrushovi me shokë në luftën e tyre kundër nesh kanë për qëllim që të dobësojnë unitetin tonë, të na kriohen vështirësi dhe në radhë të parë vështirësi ekonomike. Ata e dinë mirë se uniteti i popullit tonë është i shëndoshë, se shpifjet e tyre nuk zënë vend në Shqipëri, atëherë ata, për të realizuar qëllimet e tyre, shtojnë masat për intensifikimin e luftës ekonomike kundër nesh. Por ne jemi të sigurt se edhe këtu lufta e tyre nuk do të ketë sukses, sepse ne do të na ndih-

mojë RP e Kinës. Sidoqoftë ata do të përpinqen që, krahës luftës politike dhe ideologjike, të nxitin revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë, që të futin spiunë e diversantë, do të përpinqen të aktivizojnë agjenturat e tyre dhe, kur ne t'i kapim e t'i asgjësojmë, atëherë do të bërtasin se «në Shqipëri ka terror, bëhen vrasje» etj. Për të na tërhequr vëmendjen mund të përdorin edhe shumë mënyra të tjera me qëllim që ne të lëmë pas dore detyrat ekonomike dhe të influencojnë me këto veprime që planet tona të dështojnë. Qëllimet e tyre ne i dimë, por sidoqoftë edhe ushtrinë ne e kemi në gatishmëri të plotë në roje të kufijve të atdheut dhe të punës paqësore të popullit tonë.

Por rëndësi ka fakti që gjendja e brendshme e vendit tonë është e shëndoshë. Ky vit ka qenë një vit mobilizimi i paparë ndonjëherë dhe me rezultate të mira ekonomike, populli ka mbetur i kënaqur se është furnizuar në rregull. Por ne duhet të vazhdojmë të punojmë me ritëm edhe më të lartë, sidomos në punimet e stinës. Të përpinqemi të shfrytëzojmë momentet, për të përfunduar me sukses mbjelljet e vjeshtës dhe në pranverë të krijojmë kushte që t'i futemi mirë punës dhe të ecim akoma më mirë se këtë vit. Ndihmën e Komitetit Qendror do ta keni vazhdimisht, prandaj mobilizohuni me të gjitha forcat për realizimin e detyrave në bazë të direktivave të Partisë dhe s'ka dyshim që çdo gjë do ta realizojmë me këtë popull të mrekullueshëm e kaq shumë të lidhur me Partinë.

Duke ardhur nga Gjirokastra për në Sarandë vija re fushës njerëz që punonin, të qeshur e të gëzuar. Atyre u shndrisnin sytë. Entuziazmi që tregon populli,

siç e dimë dhe e pamë edhe gjatë gjithë këtyre vizitave e takimeve në rrethin tuaj, provon edhe një herë sa i lidhur është populli me Partinë. Kjo është një fitore e madhe, është fryt i punës së palodhur që ka bërë Partia.

*Botohet për herë të parë me
disa shkurttime, sipas originalit
që gjendet në Arkirin Qendror
të Partisë*

SARANDA ËSHTË NJË KRAHINË ME PERSPEKTIVË TË MADHE

*Nga fjala në mitingun me popullin e rrëthit
të Sarandës*

18 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe, punëtorë, kooperativistë, të rinj e të reja, ushtarë, marinare dhe pionierë të rrëthit të Sarandës,

Ju falënderoj nxehtësisht për këtë dashuri të madhe dhe entuziazëm të papërshkruar që ju shprehni sot, ashtu si kurdoherë, për Partinë e lavdishme të Punës, për pushtetin tonë popullor! Në këtë dashuri të sinqertë e të madhe në mes popullit, Partisë e pushtetit popullor, ka qëndruar, qëndron dhe do të qëndrojë kurdoherë forca e madhe e Republikës Popullore të Shqipërisë. Pse ishte e tillë kjo forcë, prandaj 20 vjet më parë, populli i vuajtur shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste, të dalë nga gjiri i tij, u quanë luftën e ashpër kundër pushtuesve dhe fitoi.

Juve ju kujtohen ato kohë të errëta për atdheun tonë, ju kujtohet regjimi skllavërues i Zogut, i bejle-

rëve dhe i agallarëve, që sundonin mbi shpinën e këtij populli heroik, që i pinin gjakun çdo ditë punëtorit dhe fshatarit shqiptar dhe më në fund e tradhtuan. Në këtë çështje ata nuk bënë ndonjë përjashtim nga gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre bejlerë e feudalë, nga klasa e tyre, që kurrë nuk ia ka dashur të mirën popullit. Ata kurdoherë janë mahur me gjakun dhe me djersën e vegjëlisë dhe për interesat e tyre kanë shitur në treg interesat e popullit.

Juve ju kujtohet sigurisht koha e zezë e pushtimit. Mbi vendin tonë pllakosi rrebeshi fashist, që kishte për qëllim ta kolonizonte e ta skllavëronte Shqipërinë dhe popullin shqiptar. Po pushtuesit nuk ia arritën dot këtij qëllimi. Ata e njihnin mirë kush ishte populli ynë, e kishin njojur në të kaluarën, mië 1920, kur shqiptarët, me dyfekun lidhur me gjalmë dhe të armatosur me një vullnet të çeliktë, i hodhën në det. Prandaj kur erdhën edhe një herë për të pushtuar Shqipërinë, dridhmat nuk u ishin larguar dhe për këtë nuk u gënjen. Qysh ditët e para kur futën këmbët në vendin tonë, populli shqiptar i priti me krismat e pushkëve të Mujo Ulqinakut me shokë. Fashistët italianë e panë edhe më vonë me ç'popull kishin të bënin.

Populli ynë filloi rezistencën e organizuar pas themelimit të Partisë, e cila në krye të masave punonjëse do t'i dërrmonte pushtuesit fashistë italianë dhe gjermanë, bashkë me veglat e tyre tradhtarët shqiptarë, bejlerët dhe agallarët. Është e vërtetë se ne komunistët kur themeluam Partinë Komuniste të Shqipërisë ishim vetëm 200 veta, por bashkë me ne ishte i gjithë populli shqiptar.

Tradhtarët shqiptarë, të grumbulluar në organizatat reaksionare të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» etj., u lidhën që në fillim me pushtuesit dhe talleshin me ne duke u çjerrë: «Ç'janë këta leckamanë dhe këmbëzbathur, që mendojnë të luftojnë kundër Italisë, që është një fuqi e madhe e armatosur deri në dhëmbë?». Por ata nuk i bënë mirë llogaritë, Partia jonë ishte një parti, e cila pati në programin e vet revolucionar luftë të pamëshirshme kundër pushtuesve e tradhtarëve për çlirimin e atdheut. Kjo ishte një çështje jashtëzakonisht e madhe dhe e çmueshme, që do të mobilizonte të gjitha masat e popullit. Partia kishte në programin e vet detyrën që t'i jepte popullit lirinë, pavarësinë dhe të gjitha të drejtat, për të cilat luftonte dhe ajo që ishte kryesorja ta sillte vetë popullin në fuqi. Të 200 komunitet e parë kishin besim të patundur se populli shqiptar do t'i ndiqte ata në këtë mision të lartë historik. Dhe kështu ndodhi.

Shqiptarët u ngritën të tërë në luftë kundër pushtuesve, se ata ishin trashëgimtarë të Skënderbeut, që luftoi vite me radhë kundër hordhive otomane dhe nuk u mund asnjëherë. Ishin stërgjyshërit tanë luftëtarë, që u udhëhoqën nga Skënderbeu dhe u bënë atëherë shpresa e gjithë popujve për të shpëtuar qytetërimin evropian, kur mjaft popuj të tjerë shumë më të mëdhenj e më të fuqishëm iu gjunjëzuan osmanllinjve. Më vonë, rilindasit tanë dhe çetat e tyre heroike, dolën maleve për të fituar lirinë. Ishin stërnipërit e denjë të Skënderbeut ata që ngritën flamurin në Vlorë më 1912 dhe i treguan gjithë botës se në këtë vend jeton një popull që lufton për liri e për pavarësi.

Edhe komunistët, që ishin pasardhës të këtij populli, me një histori të shkëlqyer, në programin e tyre shprehnin interesat, dëshirat dhe vullnetin e popullit shqiptar. Ju mbani mend mirë se si çetat e para u bënë batalione e pastaj brigada, divizione e korparmata, të cilat u dhanë grushte të forta fashistëve italianë e më vonë edhe nazistëve gjermanë. Malet, fushat dhe lugina e Shqipërisë, çdo kasolle, u bënë streha e partizanëve. Pas përpjekjesh të mëdha, më në fund më 29 Nëntor të vitit 1944 në të gjithë truallin shqiptar u valëvit i lirë flamuri i kuq shqiptar, me shkabën dy-krenare, flamuri i vegjëlisë, flamuri i Partisë.

Partia fitoi se populli u lidh i téri me të. Fituan se me ne ishte Bashkimi Sovjetik, me ne ishte J. V. Stalini, që udhëhoqi me lavdi në fitore Ushtrinë e Kuqe heroike, e cila shpartalloi nazi-fashizmin, shpëtoi vetë Bashkimin Sovjetik, çlroi popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe ndihmoi edhe popullin shqiptar për çlirim nga zgjedha fashiste.

Kështu pas Luftës së Dytë Botërore ngjarjet morën një drejtim të ri. Në shembullin e Bashkimit Sovjetik popujt që fituan lirinë, ndërmjet tyre edhe populli shqiptar, ndërmorën luftën për rindërtimin e vendit, bënë reforma të mëdha ekonomike e shoqërore, duke kriuar në këtë mënyrë kushtet për ndërtimin e socializmit.

Edhe Partia jonë në krye të popullit e duke pasur përpara një program të qartë iu përvesh punës si kurrë ndonjëherë tjetër. Populli shqiptar doli nga lufta akoma më i fortë, më i zoti nga sa kishte qenë përpara, atij i qe shtuar besimi për fitore të reja dhe këtë besim

ia forcoi Partia. Qysh në kohën e luftës Partia i tha popullit se me luftë e me sakrifica çdo pengesë do të kapërcehet dhe u kapërcye. Ju e mbani mend si ishte Shqipëria në fillim. Ne erdhëm nga malet të zhveshur, me dhjetëra mijëra shtëpi në fshatra e në qytete ishin djegur, rrugët, urat, punishtet e çdo gjë ishin shkatërruar.

Armiqtë atëherë kishin frikë të na sulmonin haptazi, por qosheve ashtu si e kanë zakon, thoshin me njëri-tjetrin se «këta e kanë të shkurtër, 2-3 muaj dhe do të përbysen se janë injorantë, nuk kanë haber nga drejtimi i shtetit, prandaj do të falimentojnë! Sa gënjejeshin këta zotërinj! Ata mendonin për vete se diçka ishin dhe diçka bënin, por në fakt asgjë s'kanë bërë për popullin. Ka qenë ky popull që bënte çdo gjë, ata dinin vetëm të hanin e të grabitnin në kurriz të popullit. Dhe si kaloi ca kohë, panë me keqardhje se ëndrrat e tyre i mori era.

Populli shqiptar iu përvesh punës dhe brenda një kohe të shkurtër rindërttoi me forcat e veta gjithçka ishte djegur e ishte shkatërruar nga lufta, sepse në atë kohë nuk kishte as edhe ndonjë ndihmë. Çdo gjë e bëmë me duart tona dhe me djersën tonë. Krahas rivendosjes së jetës normale, u bënë reforma të mëdha, si Reforma Agrare, që i dha tokën fshatarit, një nga reformat më të rëndësishme që janë bërë në vendin tonë, sepse Shqipëria ishte një vend agrar i prapambeetur, por me një fshatarësi nga më revolucionaret, e cila ka qenë kurdoherë në ballë të luftërave për tokë, përliri dhe pavarësi. Prandaj edhe në Luftën Nacionalçlirimtare fshatarësia e vendit tonë u gjend krah për

krah me klasën punëtore, së bashku luftuan dhe fituan. Klasa punëtore dhe Partia e saj si dhe fshatarësia punonjëse e zbatuan me sukses Reformën Agrare, sepse e dinin që me këtë masë do të zhvillohej bujqësia, do të rriteshin prodhimet bujqësore e blegtorale, për të cilat populli kishte nevojë të madhe. Me rindërtimin e vendit u ringjalljeta normale në Shqipërinë e vuajtur, të djegur e të plaçkitur nga lufta.

Qysh prej asaj kohe, shokë të dashur, shikoni ç'është bërë në vendin tonë! Ata që s'e kanë jetuar atë kohë as që mund të bëjnë dot krahasimin. Anembanë Shqipëria është mbushur me fabrika, me uzina e kombinate, që prodrojnë për popullin. Ato i drejtojnë dhe i vënë në lëvizje bijtë dhe bijat e popullit që më parë nuk dinin shkrim e lexim, por vetëm të ruanin bagëtitë. Partia ata i mësoi, u dha dituri, i bëri të zot e me eksperiencë, ata morën në dorë drejtimin e shtetit dhe të ekonomisë. Fabrikat dhe uzinat që u ndërtuan filluan të prodrojnë më shumë e më mirë për popullin. E tillë është forca e popullit, kur drejtohet nga Partia. Bejlerët dhe agallarët mendonin se ata dhe djemtë e tyre mund të drejtonin, se vetëm ata ishin të zgjuar, vetëm ata mund të mësonin nëpër shkolla. Por Reforma e madhe Arsimore që zbatoi Partia, bëri që nga gjiri i popullit të dalin njjerëz të tillë që brenda një kohe të shkurtër t'ia shndërronin faqen Shqipërisë. Të gjithë ata që sot punojnë në fabrika, uzina, miniera, shkolla e kudo janë bijtë e bijat e këtij populli, të punëtorëve dhe të fshatarëve.

Në këtë fazë të ndërtimit të socializmit ne patëm një ndihmë të madhe nga ana e BS dhe e vendeve të

demokracisë popullore. Ishte fare e natyrshme të na jepej kjo ndihmë dhe duhej të na jepej, sepse kështu mëson marksizëm-leninizmi, një për të gjithë dhe të gjithë për një. Ndihamat që vendet socialiste i japin njëri-tjetrit janë detyrë internacionaliste, e detyrueshme për ata që kanë krijuar një bazë ekonomike dhe janë më të fuqishëm. Kurse ata që nën maskën e komunizmit fshehin ftyra të tjera dhe ndihmën e japin kur ua do qejfi dhe me paramendim, nuk janë veçse armiq, që bëjnë punë armiqësore antimarksiste. Ndihamat, që i janë dhënë Shqipërisë nga ana e Bashkimit Sovjetik, më të shumtata i takojnë kohës kur jetonte J. V. Stalini, i cili e donte me gjithë shpirt popullin shqiptar. Le të lehin sa të duan armiqëtë kundër Stalinit. Ishte Stalini ai që për interesat dhe për mbrojtjen e popullit shqiptar ua tregoi kusinë te thana titistëve. Në vitin 1948 klika titiste donte të dërgonte në Shqipëri divizione jugosllave gjoja për të na mbrojtur, por në fakt për të likuiduar Partinë tonë, mirëpo Partia jonë dhe J. V. Stalini i thanë: «Ndal!». Pra ndihma që na u dha nga BS ishte një ndihmë internacionaliste, ajo shërbeu edhe për të ngritur gjithë këto vepra të niëdha ekonomike.

Por sa vlerë mund të ketë një ndihmë, sado e madhe që të jetë, në qoftë se ajo nuk do të përdoret si duhet? Sidoqoftë kjo ndihmë, s'ka asnjë vlerë në qoftë se do të mungojë puna e vetë popullit, që është faktori kryesor. Fabrikat, uzinat, kombinatet, minierat, hekurudhat, urat, rrugët, portet, hidrocentralet dhe çdo gjë tjetër, i bëri populli shqiptar me zotësinë dhe me forcën e tij, i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Pu-

nës. Ndihmën që na u dha, populli dhe Partia jonë e përdorën fare mirë.

Përveç industrisë edhe bujqësia jonë eci përpara. Ne mund të themi se brenda këtyre 17 vjetëve janë bërë ndryshime shumë të mëdha në bujqësinë tonë. Këto i bëri patriotizmi, vullneti dhe zotësia e fshatarësisë sonë, e cila e kuptoi drejt qëllimin e Partisë, që fshatarin ta bënte të lumtur. Për pasojë fshatarësia jonë përqafroi me shpejtësi e me vendosmëri edhe direktivën e Partisë për kolektivizimin e bujqësisë.

Shumë nga ju, shokë dhe shoqe fshatare, me gjithë besimin e madh që kishit dhe keni te Partia, në fillim thoshit, «Ja të rri edhe një vit akoma pa hyrë në kooperativë», dhe e shtynit këtë punë nga viti në vit. Partia i këshillonte komunistët, që janë bijtë dhe bijat tuaja, të kishin durim dhe të prisnin derisa populli të bindej dhe kur ai bindet, se hyrja në kooperativë është rruga më e drejtë, nuk ka forcë që e lëkund. Kështu na ka mësuar Lenini, këtë e ka theksuar vazhdimisht edhe Stalini. Kështu kooperativat e para bujqësore ngriheshin rrallë në fillim, ndërsa më vonë filluan të ngriheshin njëra pas tjetrës. Tani kolektivizimi në Shqipëri thuajse ka përfunduar gjë që përbën një nga sukceset më të mëdha të pushtetit tonë popullor.

Kolektivizimi ka sjellë ndryshime rrënjosore në fshat, në radhë të parë ai ka ndryshuar njerëzit. Fshatarët u bindën edhe një herë se bashkimi bën fuqinë, se toka e punuar me metodat e vjetra nuk jep sa duam ne, që nevojat në rritje të fshatarit të plotësohen, që fshatari nuk mund dhe nuk duhej të rronte

më në kasolle, se i vettuar nuk mund të ekte përpara dhe të plotësonë të gjitha nevojat. Në këtë pikëpamje ndryshuan njerëzit dhe zbatuan me besim të madh ato që tha Partia. Tani ne shohim se arat janë zbuluar, janë tharë me mijëra e dhjetëra mijëra hektarë këneta e moçale, po bëhet kudo sistemimi i tokave dhe nuk do të jetë e largët ajo ditë që në Shqipëri nuk do të ketë më toka të pasistemuara e të pakulluara, nuk do të mbeten më këneta e moçale dhe sipërfaqet e ujitshme do të rriten vazhdimesht. Shikoni pra, ç'po bën bashkimi, kolektivizimi.

Duke qenë të bashkuar në kooperativa bujqësore edhe ndihma e pushtetit populor do të jetë më e madhe dhe fondet do të përdoren më me efekt. Dhe në fakt në Shqipëri kanë ardhur mijëra traktorë, që kanë zë-vendësuar punën e qeve dhe jo vetëm kaq, por tani toka punohet si duhet, gjë që ka bërë që edhe prodhimet të shtohen dhe vazhdimesht po shtohen çdo vit. Lë të shohim rrëthin tuaj. Këtu janë bërë punime të shumta bonifikimi, shteti ka investuar miliona për këtë qëllim, dhe mirë ka bërë, se nuk mund t'i linte fshatarët e Vurgut të vuanin për bukë dhe të mbyteshin nga lumi dhe nga balta. Investimet që janë bërë po japin frytet. Sot rrathi i Sarandës zë një nga vendet kryesore në Republikë përsa i përket bujqësisë. Këtë vit rrathi juaj ka dalë mirë me planin e drithërave. Kjo ka shumë rëndësi. Është i vetmi rreth, që e ka realizuar planin e drithërave me një ndryshim fare të vogël, megjithëse edhe te ju pati thatësirë. Po kooperativat tuaja bujqësore manovruan përsa u përket të lashtave, ato mbollën edhe misër hamullor dhe kështu arritën të realizojnë

drithërat. Ju patët rezultate të mira edhe në blegtori. Me kohë ju keni realizuar planin e qumshtit, gjë që është shumë e mirë për ju dhe për gjithë Republikën. Sivjet keni siguruar të ardhura të mira nga frutat; të ardhura të mira do të keni edhe nga ullinjtë e agrumet, të cilat po përhapen me shumicë dhe me shpejtësi te ju. Kjo do t'ju sjellë begati të madhe. Pra Saranda është një krahinë me perspektivë të madhe.

Prandaj përvishjuni akoma më shumë punës në këtë drejtim, sidomos për krijimin e fidanishteve, përhapni kudo ullirin dhe agrumet, veçanërisht në kodrina, duke ruajtur kurdoherë të paprekura tokat e bukës, sepse buka ka rëndësi të dorës së parë. Ne duhet të luftojmë për të prodhuar bukë sa më shumë, që të ketë në radhë të parë për popullin dhe të krijojë edhe shteti rezerva, për të përballuar çdo situatë të vështirë, që mund të na dalë përpara. Vitin e kaluar ne nuk dolëm dhe aq mirë me drithërat, por buka nuk i mungoi popullit dhe kurrë nuk do t'i mungojë, sepse Partia dhe Qeveria mendojnë dhe marrin masa me kohë për këtë problem.

Rezervat e shtetit tonë për drithëra nuk kanë qenë kurrë kaq të mëdha sa tani. Në këtë drejtim ne na ndihmojnë miqtë tanë të vendeve socialiste dhe kryesisht Republika Popullore e Kinës, që e ndihmon pa u kusyer popullin tonë. N. Hrushovi dhe shokët e tij kujtuan se, duke prerë kreditë, do të dëmtonin RP të Shqipërisë, por u gabuan se Shqipëria nuk është e vetme, por ka miq kudo në botë. Ju uroj që edhe ju ta realizoni plotësisht dhe para afatit planin e këtij viti, që do të shërbejë si një mbështetje e fuqishme për realizimin e planeve të ardhshme!

Kështu si te ju edhe në të gjitha rrethet e tjera të Republikës ka një mobilizim dhe entuziazëm të papërshkruar, që nuk është parë kurrë. Për herë të parë në vendin tonë planet realizohen dhe tejkalohen në të gjitha degët e industrisë. Kjo bëri të mundur që vendimet e Kongresit IV të Partisë të zbatohen në kohën e duhur.

Ju e shihni në jetën e përditshme se asgjë nuk ka munguar në treg. Sikur plani në bujqësi të ishte realizuar sipas parashikimeve, do të kishte akoma më shumë prodhime. Megjithatë popullit asgjë nuk i ka munguar dhe asgjë nuk do t'i mungojë se për atë mendon Partia dhe vetë populli është nikoqir i mirë, di ta ekonomizojë atë që ka. Ne do të vazhdojmë ta zhvillojmë e ta modernizojmë më tej bujqësinë. Kur ju, shokë kooperativistë të Sarandës, do të merrni plehra kimike për t'i hedhur tokës dhe do ta punoni atë me metodat e përparuara agroteknike, atëherë me siguri do të arrini rendimente shumë më të larta në prodhimet bujqësore. Që tani ju mund të merrni mesatarisht rreth 15 ndofta dhe 20 kv/ha misër ose mbi 25 kv/ha oriz. Ullinjtë, që tani nuk u hidhni fare pleh, bile shumë nga ju as që i krasitin, kur t'u bëni këto shërbime, do të japid me siguri më shumë. Kështu mund të themi edhe për të gjitha kulturat e degët e tjera të bujqësisë.

Ky vit do të na shërbejë shumë përvitet e ardhshme të pesëvjeçarit, që do të kenë një plan të ngjeshur dhe me rëndësi të madhe përvendin tonë.

Pastaj, pasi foli përvit e gjera të zhvillimit ekonomik të vendit, përvbulimin e burimeve të reja e të mineraleteve të çmuara nga gjeologët tanë,

për realizimin e planit të naftës, për zhvillimin dhe për modernizimin e mëtejshëm të bujqësisë, për marrjen e rendimenteve më të larta në prodhimin e drithërave të bukës etj., shoku Enver Hoxha tha:

Sigurisht, që të realizojmë planin duhet të punojmë dhe puna nuk na ka trembur kurrë, sidomos tani që punojmë për veten tonë dhe për të ardhshmen e fëmijëve tanë. Ne do të realizojmë planin pesëvjeçar, sepse ai si materialisht ashtu edhe financiarisht është sigruar, por edhe sepse populli ynë, i madh e i vogël, e ka kuptuar që socializmi nuk ndërtohet pa mësuar. Toka nuk mund të punohet si përpara, nuk mund të vihen në lëvizje e të shfrytëzohen në maksimum gjithë këto fabrika e makineri pa zotëruar teknikën, pa u bërë të aftë për profesionet e caktuara. Në të katër anët e Shqipërisë po mësohet, vullneti për punë është kudo i madh dhe ndihma financiare e shtetit nuk mungon. Për të gjitha këto arsyе plani ynë pesëvjeçar do të realizohet me sukses në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe të heroizmit të popullit shqiptar.

Shokë, të gjithëve na intereson të dimë në përgjithësi si është situata në vendin tonë. Situata në vendin tonë është e fortë, e shëndoshë, për arsyé të moralit të lartë të popullit tonë dhe të unitetit të çeliktë të tij rrëth Partisë, është e fortë sepse fitoret e popullit tonë i ruan me vigjilencë populli ynë i lavdishëm, ushtria janë trime, e vendosur dhe besnikë e popullit dhe e Partisë, ajo qëndron kurdoherë në gatishmëri për të mbrojtur interesat e atdheut, lirinë dhe pavarësinë e Republikës sonë Popullore; situata e vendit tonë është e çeliktë, sepse të çelikta janë organet e diktaturës sonë

të proletariatit, Sigurimi i Shtetit dhe rojet e kufirit ku shërbejnë bijtë tuaj nga më të mirët, të cilët luftojnë dhe vigjelojnë për mbrojtjen e popullit. Të gjithë këta faktorë bëjnë që vendi ynë, Republika Popullore e Shqipërisë, të ketë një situatë të brendshme të fuqishme. Asnjë veprimtari armiqësore nuk mund t'i shpëtovë syrit vigjilent të popullit dhe armëve të diktaturës së proletariatit, ato zbulohen që në embrion dhe likuidohen.

Në vendet socialiste populli është në fuqi. I udhëhequr nga një parti marksiste-leniniste atij i jepen mundësi të zhvillojë të gjitha talentet dhe forcat e tij krijuese, ndërsa në vendet kapitaliste, populli është i skllavëruar nga kapitali, sepse në krye të këtyre vendeve sundojnë milionerët dhe miliarderët, që, për të mbushur xhepat e tyre, shfrytëzojnë deri në palcë popujt dhe i çojnë në mjerim euri. Pikërisht për arsyet e tillë në këto vende populli nuk është me milionerët dhe miliarderët, por kundër tyre.

Kapitalizmi do të zhduket, ky është ligji i zhvillimit historik të shoqërisë, që e ka argumentuar shkencërisht në veprat e tij Karl Marks, parashikimet e të cilit po realizohen, sepse janë nxjerrë nga eksperiencia e madhe e proletariatit botëror. Prandaj imperialistët armatosen, në mënyrë të ethëshme, me shpresë se do t'i shpëtovë fundit të tyre të sigurt. Imperialistët amerikanë po armatosin Gjermaninë Perëndimore, Japoninë dhe vende të tjera, për t'i ndërsyer për luftëra agresive.

Partia jonë ka ndjekur me besnikëri vijën marksiste-leniniste për çështjen e mbrojtjes së paqes dhe për çarmatimin. Imperialistët ndjekin rrugën e kundërt.

Grupi i N. Hrushovit, me politikën e tij oportuniste dhe revizioniste, i jep mundësi imperializmit të fitojë kohë të armatoset dhe të bëhet kështu një rrezik i madh për njerëzimin. Ai kërkon t'u mbushë mendjen popujve se problemet e mëdha të njerëzimit mund të zgjidhen në rrugën e bisedimeve midis personaliteteve shtetërore, domethënë mjafton që N. Hrushovi të takohet e të merrret vesh me Ajzenhauerin ose me Kenedin për zgjidhjen e problemit të paqes. Ne themi se edhe bisedime mund të bëhen, por duhet të kemi një vijë të tillë revolucionare, që të ngrihen në këmbë masat popullore kudo në botë, për t'u ndalur dorën imperialistëve, për të demaskuar intrigat e tyre, për t'i detyruar ata që të mos vazhdojnë garën e armatimeve. Kjo është rruga e drejtë që duhet ndjekur.

Mirëpo N. Hrushovi thotë se ne duhet të bashkëjetojmë me vendet kapitaliste, por bashkëjetesën ai e kuption së prapthi, që klasa punëtore dhe të shfrytëzuarit e vendeve kapitaliste të mos bëjnë greva, të mos i luftojnë kapitalistët e vendeve të tyre, por të pajtohen me ta dhe pushtetin të përpilen ta marrin me anën e votimeve. Kështu, sipas Hrushovit, proletariati me anën e votimeve do të dërgojë përfaqësuesit e tij në parlament, do të fitojë atje shumicën e vendeve dhe do të bëjë ligjet e veta. Këtej del se borgjezia një mëngjes të bukur do t'ia dorëzojë vullnetarisht pushtetin proletariatit! Mirëpo kjo pikëpamje është shumë e dëmshme, se i vë popujt në gjumë, vë në gjumë edhe klasën punëtore. Ja, pra, ku të çon politika oportuniste e N. Hrushovit.

Le të marrim, për shembull, partinë EDA në Greqi.

Dihet se ajo është një parti përparimtare. Komunistët dhe patriotët grekë kishin arritur që në parlamentin grek të kishin 75 deputetë. Por tamam në kohën kur N. Hrushovi shpalli tezën e tij revizioniste, qeveria greke shtrëngoi vidhat më shumë, nxori një ligj, që e kufizoi edhe më tepër mundësinë e përfaqësimit të shtresave demokratike të popullsisë në parlament. Kështu në zgjedhjet e fundit që u bënë në Greqi, Partia EDA, nga 75 deputetë që kishte, tanë ka vetëm 20 deputetë dhe heroi i popullit grek Manolis Glezos, që populli e zgjodhi, vazhdon të dergjet në burgun e Korfuzit, me gjithëse ai mori vota më shumë se çdo deputet tjeter. Kjo tregon se ata që janë sot në fuqi në Greqi nuk pyesin aspak për vullnetin e popullit.

Me politikën e tij të gabuar N. Hrushovi i ka shkaktuar një të çarë të madhe kampit socialist. Pikërisht për këtë arsyе Partia jonë, nuk është dhe nuk mund të jetë kurrë dakord me N. Hrushovin, ashtu si nuk është dakord edhe me qëndrime të tjera revizioniste.

Përse, për shembull, N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë filluan t'i hedhin baltë Stalinit? Sigurisht, qëllimi i N. Hrushovit është t'u bëjë qejfin borgjezisë reaksionare, imperialistëve e revizionistëve të tjerë pa u qederosur për dëmin e madh që i sjell Bashkimit Sovjetik, duke hedhur baltë jo vetëm mbi Stalinin, por mbi fitoret që kishte arritur populli sovjetik. Gjithashtu kjo i duhej Hrushovit për të fituar besimin e mbështetjen e armiqve të jashtëm e të brendshëm të BS e të komunizmit, si dhe të revizionistëve e të oportunistëve në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore; i duhej për të vendosur e për të forcuar pushtetin e tij personal. Për

30 vjet me radhë, nën udhëheqjen e Stalinit, Bashkimini Sovjetik u bë një forcë kolosale ekonomike, politike dhe ushtarake, në saje të kësaj force u shpartalluan nazi-fashistët. Dhe N. Hrushovi, duke qenë njeri pa kurrfarë karakteri, që t'u pastrojë rrugën pikëpamjeve të tij, vetëm pasi Stalini vdiq filloi pa turp të thotë se Stalini na paska qenë i frikshëm, kriminel, vrasës etj., etj. epitete poshtëruese, të cilat s'ka se si të mos indinjojnë dhe të mos revoltojnë jo vetëm revolucionarët, por edhe të gjithë popujt përparimtarë të botës.

Një nga çështjet që Hrushovi u përpoq të zgjidhët ishte rehabilitimi i klikës revizioniste të Beogradit, të cilën ne e njohim fare mirë, që përbëhet nga tradhtarë të marksizëm-leninizmit, të shitur te imperializmi. Ju e dini se N. Hrushovi në vitin 1955 shkoi zyrtarisht në Beograd dhe i quajti «shokë» revizionistët jugosllavë. Atje ai deklaroi se J. V. Stalini na paskësh gabuar, sepse «shokët» jugosllavë na qenkan njerëz «të mirë», «marksistë» dhe nën udhëheqjen e tyre në Jugosllavi po ndërtohet «socializmi»!

Partia jonë nuk ka qenë dhe kurrë nuk do të jetë dakord me këtë vijë të N. Hrushovit. Por ky qëndrim nuk i pëlqeu N. Hrushovit, prandaj ai dhe shokët e tij, duke parë se Partia jonë dhe PK e Kinës po i bëheshin pengesë e madhe, organizoi komplotin e Bukureshtit, i cili kishte për qëllim që RP e Kinës të përjashtohej nga kampi dhe PK e Kinës të dënohej nga lëvizja komuniste e punëtore. Por në Bukuresht Partia jonë mbajti një qëndrim të drejtë marksist dhe i tha Hrushovit se këto mënyra të shtruari të çështjeve që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet në mes partive

komuniste e punëtore janë të papranueshme dhe në kundërshtim me normat marksiste, se PK e Kinës është një parti e lavdishme, prandaj nuk mund të lejohet që të trajtohen me kaq lehtësi probleme të mëdha të lëvizjes komuniste botërore dhe të kampit socialist. Qëndrimi i Partisë sonë në Bukuresht u prishi planet N. Hrushovit dhe atyre që e pasojnë. Pastaj erdhi Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore që u zhvillua në Moskë, ku Partia jonë ia numëroi Hrushovit një nga një të gjitha ato që kishte bërë. Kjo ishte rruga e vetme e drejtë: marksizmi duhej mbrojtur, sepse kush mbron marksizmin ai mbron popullin, lirinë dhe pavarësinë e atdheut të vet.

Në luftën tonë të drejtë kundër grupit të Hrushovit na mbështetin PK e Kinës, parti të tjera dhe shumë komunistë në vende të ndryshme të botës. Të marrim PK të Francës. Nuk kanë kaluar veçse dy javë pas Kongresit XXII të PK të BS, ku edhe udhëheqja e PK të Francës doli kundër nesh. Tani që Moris Torezi është kthyer në Francë dhe këto çështje po i shtron në parti, komunistët francezë nuk janë dakord me udhëheqjen e partisë së tyre për dënimin e Shqipërisë. Ata kërkojnë të dinë përse u fol në Moskë kundër Shqipërisë, përse udhëheqja e partisë mban fshehtazi nga komunistët e vet pikëpamjet e Partisë së Punës të Shqipërisë, përse u dënuia përsëri në Kongresin XXII të PK të BS, J. V. Stalini, përse u hoq trupi i Stalinit nga mauzoleumi. Për të gjitha këto pyetje të ligjshme të komunistëve francezë udhëheqja e PK të Francës nuk di ç'të thotë. Shumë komunistë francezë u kanë thënë njerëzve tanë se janë me Partinë tonë, se aprovojnë

qëndrimin heroik të Partisë sonë dhe, po t'i ndodhë gjë Shqipërisë, janë gati të na vijnë në ndihmë.

Më poshtë, pasi foli për masat që mori Hrushovi kundër vendit tonë, duke hequr specialistët sovjetikë, për sulmin e tij publik në Kongresin XXII ndaj PPSH dhe udhëheqjes së saj, për vijën e drejtë të ndjekur kurdoherë nga Partia jonë dhe për ngjarjet ndërkombëtare të kohës, shoku Enver Hoxha tha:

Me kohë, shokë dhe vëllezër, çdo gjë do të bëhet e qartë për të gjithë. Për ne komunistët dhe popullin shqiptar çështja e N. Hrushovit është më se e qartë, ne tani e dimë se me ç'armiq kemi të bëjmë. Është një fatkeqësi e madhe që një gjë e tillë ndodhi në kampanin socialist, por kemi besim se komunistët sovjetikë dhe të vendeve të demokracisë popullore të Evropës do ta kuptojnë se në ç'greminë po i çon via e N. Hrushovit.

Sulmet antimarksiste të Nikita Hrushovit kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj i kanë kënaqur armiqtë tanë rreth e rrotull. Kjo është e natyrshme. Në fjalimin që mbajti në Shkup këto ditë, Titoja u shpreh se është plotësisht dakord me kursin që ka ndërmarrë Hrushovi dhe e përshëndet atë. Një gjë e tillë vërteton atë që thotë Partia jonë se rruga që ndjek Nikita Hrushovi është një kurs revisionist. Në këtë fjalim Titoja gjoja ankohet se në Kongresin XXII Nikita Hrushovi e paska kritikuar. «Por këtë sulm ne e pritëm të qetë», thotë ai. Sigurisht ashtu është, sepse kritikat e Nikita Hrushovit kundër Titos janë si boçë pambuku, që të qëllojnë e s'të plagosin. Pastaj Titoja e priste këtë farë kritike, sepse Hrushovi

e kishte vënë në dijeni qysh me kohë dhe i kishte thënë se, kur të ishte i detyruar, do t'i bënte Titos edhe «ndonjë» kritikë. Këtë e ka deklaruar vetë Nikita Hrushovi.

Gjithashtu në fjalimin e tij mbajtur në Shkup, Titoja thotë me hipokrizi se «ushqen një dashuri të madhe për popullin shqiptar dhe prandaj i dëshiron atij të mirën». Populli ynë e di fort mirë se ç'varr kërkonin t'i bënин revizionistët jugosllavë Shqipërisë; këtë e kanë treguar qartë gjyqet e popullit kundër armiqve dhe tradhtarëve të vendit. Titoja flet për «parimin e vetë-vendosjes së popujve» e të tjera dokrra të tilla, por ne i themi atij «të mos i qajë hallin kalorësit pse i varen këmbët». Populli shqiptar s'ka nevojë për avokatë të falimentuar. Do të ishte më mirë që ai të shikonte hallet e popullit të tij dhe për «parimin e vetëvendosjes» të pyesë më parë popullin e shumëvuanjtur shqiptar të Kosovës, pastaj të mendojë për të tjerët.

Gjithashtu, Josif Broz Tito thekson se Shqipëria na qenka bërë një rrezik i madh për Evropën dhe vëçanërisht për popujt e Ballkanit, se «po organizoka komplotë për të sulmuar Jugosllavinë»! Kjo është përralla e vjetër e ujkut. Ne u themi Titos dhe shokëve të tij: «Planet tuaja djallëzore nuk do të na gjejnë në gjumë dhe mos guxoni të hyni në aventura kundër Shqipërisë se do ta pësoni keq». Republika Popullore e Shqipërisë, jo vetëm që është një shtet socialist paqedashës, por ajo është një vend i vogël, që kurrë nuk ka kërcënuar dhe është absurde të mendohet që kërcënon ndonjë vend tjetër. Rrezik për Titon dhe miqtë e tij është vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, që demaskon veprimtarinë armiqësore, antimarksiste dhe anti-

shqiptare të titistëve, dhe të të gjithë revizionistëve të tjerë. Titoja, sigurisht, do ta presë «me gjakftohtësinë e tij shembullore» çështjen që Nikita Hrushovi dhe shokët e miqtë e tij nuk do t'i bëjnë aspak publicitet kësaj pjese të fjalimit të tij në Shkup, se çështë shumë komprometues për ta. Edhe këtë gjest të shokëve të tij Titoja do ta kuptojë dhe nuk do të zemërohet. Do të kënaqet me atë që ata nuk e sulmojnë dhe nuk do ta sulmojnë më «shokun» Tito, por do të marrin çdo masë që të afrohen me të, dhe kështu të zhduket çdo «keq-kuplum» në mes tyre. Por ata të mos harrojnë se planet e tyre me siguri do të dështojnë, se janë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin.

Shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra,

Çështja jonë është e drejtë se ne luftojmë për triumfin e marksizëm-leninizmit. Dhe ne do ta mbrojmë çështjen tonë pa marrë parasysh asgjë se, kur mbron marksizëm-leninizmin, ke mbrojtur jetën e popullit dhe lirinë e atdheut tënd. Sot është shekulli i marksizëm-leninizmit. Prandaj armiqtë e marksizëm-leninizmit do të mposhten.

Pra, me gjithë vështirësitë e mëdha që po kalojmë, situata jonë e brendshme është e çeliktë dhe gjendja e jashtme e Shqipërisë është më e fortë se kurrë. Kjo u detyrohet vijës së drejtë të Partisë, heroizmit të popullit tonë dhe unitetit të tij të çeliktë me Partinë. Armiqtë tanë do të përpiqen që ta çajnë këtë unitet. Por kjo nuk do të arrihet kurrë sepse nuk ka forcë që ta çajë këtë unitet të popullit dhe të Partisë.

Prandaj, të shtrëngojmë sa më fort radhët rreth Partisë, ta duam Partinë me të gjitha forcat e zemrës. Të duam njëri-tjetrin. Në këto situata të vështira të lëmë mënjanë gjërat e vogla dhe të shohim të mëdhatë, interesin e popullit dhe të atdheut, realizimin e planeve që kemi përpara, që ta bëjmë jetën e popullit tonë të lumtur dhe të begatshme.

Shokë komunistë e pa parti, punëtorë, fshatarë, intelektualë, me besim të patundur në forcat tona, në drejtësinë e vijës së Partisë sonë dhe të marksizëm-le-ninizmit të ecim përpara, të realizojmë detyrat dhe planet tona, se fitorja është jona!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i rrethit të Sarandës!

Rroftë rinia, rrrofshin pionierët!

Botohet për herë të parë si-pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

BREGDETI SHQIPTAR DO TË KTHEHET NË NJË KOPSHT TË LULEZUAR

Fjala në mitingun me popullin e Himarës

19 nëntor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe, nëna dhe motra, pionierë të shkollave të Himarës dhe të Bregdetit tonë të bukur,

Jam jashtëzakonisht i gëzuar që ndodhem sot në mes tuaj dhe që kam rastin t'u sjell luftëtarëve përlirinë dhe përvavarësinë e atdheut dhe luftëtarëve të sotëm për ndërtimin e socializmit, përshëndetjet më të përzemërta revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë!

Çdo shqiptar, që nuk është nga Bregu i Detit, kur e sjell puna të vijë këtej, kur i ngarkohet ndonjë detyrë ose kur i thuhet të vijë përvushuar në anët tuaja, e ndien veten jashtëzakonisht të lumtur, sepse bregdeti ynë jugor është një nga vendet më të bukura të Shqipërisë, jo vetëm se këtu është afër detit, jo vetëm se këtu rriten ullinjtë, agrumet, vreshtat dhe fiqtë, por sepse në këtë vend si kudo në Shqipëri edhe njerëzit janë të

mirë, patriotë dhe punëtorë të zotë, që e kanë bërë këtë vend malor kaq të bukur, kështu siç vazhdoni ta bëni edhe ju, vëllezër dhe motra. Njerëzit, që kanë rastin të vijnë këtej, marrin forca të reja, u shtohet optimizmi dhe nxiten të punojnë më shumë, që e gjithë Shqipëria të bëhet e bukur, kështu si Bregdeti ynë i mrekullueshëm.

Dhe Shqipëria sot, në të katër anët, është bërë me të vërtetë e bukur, se e udhëheq Partia e Punës, partia e klasës punëtore heroike, partia e socializmit dhe e komunizmit. Prandaj derdhën gjakun e tyre të kulluar me mijëra komunistë dhe patriotë në Luftën Nacional-çlirimtare, prandaj edhe nga Vunoj, nga Himara dhe nga të gjitha fshatrat e Bregut të Detit, djemtë dhe vajzat më të mira rrrokën armët me thirrjen e Partisë dhe luftuan për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut.

Ju e dini se në fillim komunistët ishin të paktë, por nuk e ndienin veten të dobët, sepse ishin të sigurt që me ta ishte i gjithë populli, sepse Partia e komunistëve përfaqësonte dhe përfaqëson dëshirat, aspiratat dhe vullnetin e popullit. Që kur lindi Partia i deklaroi popullit se komunistët luftojnë për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit fashistë dhe pastaj për kryerjen e reformave të mëdha ekonomike dhe shoqërore, të cilat i donte populli ynë, sepse për ato kishte luftuar në shekuj, po kurrë nuk i kishte arritur. Prandaj, kur populli mësoi se cili ishte programi i Partisë, e rrethoi këtë me një dashuri të madhe.

Armiqtë e popullit, që nga pushtuesit fashistë italjanë e deri te feudalët, agallarët, tregtarët, kapitalistët,

ballistët e zogistët, të lidhur ngushtë me ta, kur dëgjuan për luftën e komunistëve dhe për programin e tyre, na tallën dhe na shanë, na thanë se jemi leckamanë, pa rrobe në trup e pa këpucë në këmbë etj. Në të vërtetë ashtu ishim, se ashtu na kishin lënë ata, të varfër e të mjerë, na kishin pirë gjakun gjithë jetën, por kësaj radhe, më 1941 kur u krijuar Partia, ata do të mësonin se pikërisht këta «leckamanë», që shpesh nuk kishin të hanin as edhe një herë në ditë dhe vetëm një krohdë bukë, do t'u bënин varrin bejlerëve, agallarëve dhe mbrojtësve të tyre, fashistëve italianë. Populli e pa shpejt se komunistët ishin djemtë dhe vajzat e tij, që nuk luftonin për veten dhe interesat e tyre, por për interesat e larta të popullit dhe të atdheut.

Djali i plakut të nderuar¹ që kam këtu pranë, dhe vëllai² i kësaj motre luftuan me guxim dhe me ndjenja të pastra, sakrifikuam edhe jetën për interesin e përgjithshëm, për çlirimin e popullit dhe të atdheut. Prandaj populli ynë i deshi me gjithë shpirt partizanët dhe i kujton me respekt të thellë dëshmorët e rënë në luftën për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Nga pak partizanë që ishim në fillim, u shtuam, u krijuan çetat e para, të cilat më vonë u kthyen në batalione, brigada e korparmata dhe kështu arritëm të çlirohemi nga fashistët italianë, nazistët gjermanë dhe veglat e tyre, ballistë, zogistë, bejlerë dhe kapitalistë.

Por pas Çlirimt për popullin tonë u hap një front i ri lufte akoma më i madh e më i vështirë, fronti i luftës

¹ I drejtohet babalt të ish-partizanit të vjetër dhe komunistit Fane Bollano.

² Është fjalë për herolin e popullit Zaho Koka.

për rindërtimin e Shqipërisë së djegur e të përvëluar, të lënë në mjerim nga regjimi antipopullor i Ahmet Zogut dhe që më pas u shkatërrua e u bë hi nga pushtuesit italianë e gjermanë. Mbeturinat e reaksionit filluan përsëri të fërkojnë duart pas mbarimit të luftës me shpresë se përsëri do të vinin në fuqi, duke menduar se ne që bëmë luftën «nuk dinim të hanim as bukë» e jo më të drejttonim punët e popullit. Po këta njerëz shpejt u bindën se dituria dhe zotësia nuk qëndronin në kokën e djemve dhe të vajzave të bejlerëve e të agallarëve, por në kokën e bijve të popullit. Edhe në kohën kur sundonin ata, populli punonte e prodhonte, ai mbillte e kultivonte ullinjtë, portokallat, lëronte arat dhe mbarështron-te bagëtinë, ndërsa bejlerët dhe agallarët dinin vetëm të mblidhnin yshyret, të tretën dhe të dhjetën e nganjëherë gjithë prodhimin. Kush i ndërtonte shtëpitë, ku ata kapardiseshin me hanëmet e tyre? Populli, punëtorët. Kush ua prebatiste ato mobilje të bucura e luksoze, ku ata uleshin rehat-rehat, bënин muhabet e pinin cigare? Populli, marangozët shqiptarë.

Pas Çlirimit Partia i tha popullit se pushtuesit, feudalët dhe kapitalistët i mundëm me forcat tona dhe po me forcat tona të ndërtojmë jetën tonë. Populli me besim në forcat e tij, iu përgjigj thirrjes së Partisë për të rindërtuar çdo gjë që ishte djegur dhe ishte shkatërruar nga lufta. Gjithë punonjësit e vendit tonë, zbathur e zhveshur, ngrënë e pa ngrënë, në qytete e në fshatra, nën udhëheqjen e Partisë iu përveshën punës dhe brenda dy vjetëve rindërtuan atdheun. Njëkohësisht u shtetëzuan të gjitha pasuritë e bejlerëve, të agallarëve e të kapitalistëve, të cilët mendonin se pas Çlirimit ne do të

mbeteshim me gisht në gojë, nuk do të kishim as mjete, as para, as zotësi. Por u gabuan. Ata nuk e rimorën dot pushtetin siç ëndërronin në fillim dhe jo ne, po ata mbetën me gisht në gojë, kurse populli i udhëhequr nga Partia, me punën e tij filloi të përmirësojë jetën çdo vit e më mirë.

Rruja, që i tregoi Partia popullit ishte e vështirë, programi i Partisë ishte madhështor dhe zbatimi i tij kërkonte punë e sakrifica, sepse duhet të ngriheshin në vend fabrika e kombinate, të hapeshin toka të reja, të thaheshin kënela e moçale, të ndërtoheshin rezervuarë e kanale ujilëse, të zhdukeshin gjerdhet e ferrat, të shtohej blegtoria etj., me një fjalë të shtohej prodhimi dhe populli të kishte çdo gjë për të jetuar, në radhë të parë të kishte shtëpi ku të fuste kokën. Programin e Partisë populli e aprovoi, se për atë ai kishte luftuar me Partinë në krye.

Partia pregetti planet e para pesëvjeçare, që populli i realizoi me sukses. Në vendin tonë pörpara importohej çdo gjë, siç i thonë një fjale që nga peri e deri te gjilpëra, gjë që u sillte të ardhura të mëdha tregtarëve. Për të likuiduar një gjendje të tillë, Partia në programin e vet kishte ndërtimin e një industrie të re socialiste në vendin tonë, të cilën sot e kemi në këmbë. Për këtë gjë një ndihmë të madhe internacionaliste na dhanë Bashkimi Sovjetik me Stalinin dhe vendet e demokracisë popullore. Kjo për atë kohë ishte një ndihmë e domosdoshme për vendin tonë, ajo ishte një ndihmë internacionliste dhe jo lëmoshi.

Sado e madhe që të ishte ndihma e miqve, në rast se Partia dhe populli ynë nuk do të dinin ta përdornin

si duhet këtë ndihmë, ajo do të shkonte kot. Ne ditëm ta shfrytëzonim atë më së miri. Me zotësinë, diturinë dhe përpjekjet tona ngritëm gjithë këtë industri të madhe. Industria jonë është e re dhe moderne, atë e vënë në lëvizje djemtë dhe vajzat e popullit, të cilët më parë nuk do ta bënin dot kurrë një gjë të tillë, se regjimet antipopullore i kishin lënë në errësirë.

Përpara në Shqipëri kishte disa miniera, po ato i shfrytëzonin italianët. Një pjesë e tyre u dogj e u shkattërrua gjatë luftës. Sa u çliruam, i rindërtuam dhe gjatë këtyre 17 vjetëve, ato janë zhvilluar më tej dhe janë bërë një pasuri e madhe për popullin. Pra, nën drejtimin e Partisë, populli u mobilizua dhe në punë u mësua, u edukua, u specializua, ndërtoi miniera e fabrika, uzina e hidrocentrale, kanale e hekurudha, shkolla e spitale për begatinë dhe për lumturinë e vet.

Rëndësi të madhe i ka vënë Partia edhe bujqësisë. Pas Çlirimt duhej bërë Reforma Agrare, i duhej dhënë toka fshatarit se fshatarët tanë ishin djegur për një copë tokë e për ca rrënë jë ullinj. Nga varfëria fshatarin do ta shpëtonte kolektivizimi i bujqësisë. Mirëpo në fillim kjo ishte e vështirë, duhej bindur fshatarësia për rëndësinë e kolektivizimit. Pra Partia në fillim eci ngadalë në këtë çështje. Gjatë periudhës para kolektivizimit pushteti popullor u dha kredi fshatarëve individualë, i ndihmoi me që, me farëra, me bagëti të racës etj., pra, i ndihmoi me ato mjete e mundësi të pakta ekonomike që kishte shteti ynë në atë kohë.

Më vonë, kur shteti ynë u forcua ekonomikisht, u tha fshatarëve se mund t'i ndihmonte më tepër, por kjo ndihmë nuk ishte e mundur të jepej në kushtet e eko-

nomisë individuale. Përdorimi i traktorëve kërkonte parcela të mëdha, të cilat mund të hapeshin me shpejtësi dhe të punoheshin më mirë. Kështu fshatarësia dalngadalë e kuptoi rëndësinë e kolektivizimit, u organizua në kooperativa dhe tanë kjo çështje, të cilën ne e konsiderojmë një fitore kolosale për popullin dhe për Partinë, ka përfunduar në përgjithësi.

Kolektivizimi i dha mundësi fshatarësisë të punojë tokën me mjete moderne, shteti thau moçale e këneta, ndërtoi kanale, u dha kredi kooperativave, u hapën toka të reja, u shpërndanë damazë race dhe fidane pemësh frutore kudo. Kështu, me kolektivizimin, ne arritëm objektivin e dytë pas zhvillimit të industrisë socialiste, u fut bujqësia dhe masa e fshatarësisë përfundimisht në rrugën e socializmit.

Por Partia kishte edhe objektivin e tretë, revolucionin kulturor, që njerëzit të mos mbeteshin me mendimet e vjetra. Prandaj edhe kësaj detyre iu vumë të gjithë për ta kryer. Kështu kudo u hapën shkolla dhe sot mijëra e mijëra kuadro të mesëm e të lartë kanë mbushur qytetet dhe fshatrat tona, drejtojnë shtetin dhe ekonominë.

Le të marrim një shembull. Në qytetin tim të Lindjes, në Gjirokastër, ku kam kryer gjysmën e shkollës së mesme, kishte vetëm një shkollë. Regjimi i Zogut edhe atë donte ta prishte, megjithëse qyteti ynë hiqej si vend i intelektualëve, i kadilerëve dhe i avokatëve. Shikoni sot në Shqipëri nuk ka fshat pa shkollë filllore, 7-vjeçaret janë me qindra dhe gjatë këtij pesëvjeçari arsimi 7-vjeçar do të bëhet kudo i detyrueshëm. Pastaj janë me dhjetëra teknikumet e shkollat e mesme dhe

tani përveç disa instituteve të larta kemi edhe universitetin tonë. Është pikërisht kujdesi i Partisë që brenda 17 vjetëve ne arritëm suksese kaq të mëdha edhe në lëmin e arsimit e të kulturës.

Të gjitha këto që thashë u bënë vetëm për mirëqenien e popullit, që është qëllimi kryesor i Partisë. Por Partia thotë të mos kënaqemi me kaq, të ecim akoma më përparrë. Plani i ri pesëvjeçar do ta bëjë Shqipërinë akoma më të bukur. Industria janë do të zgjerohet më tej, do të ndërlohen fabrika dhe kombinate të reja.

Si kudo në Shqipëri edhe në lokalitetin tuaj po ndërtohen shtëpi të reja. Por edhe këto janë pak se popullsia shtohet me shpejtësi.

Më poshtë, pasi foli për disa nga veprat që do të ngrihen në vendin tonë gjatë këtij pesëvjeçari, shoku Enver Hoxha tha:

Shokët e komitetit të Partisë të rrëthit tuaj më njof-tuan për sukseset që janë arritur edhe te ju në bujqësi. Këto suksese Partinë dhe mua na gjelqojnë shumë. Gjatë këtij viti ju keni realizuar prodhime të bollshme. Por dëshira e Partisë dhe juaja është që të tilla prodhime si këtë vit të mos realizohen në 3-4 vjet një herë, por çdo vit. Dëshira e Partisë dhe juaja është që Himara dhe gjithë Bregdeti i bukur i Shqipërisë së Jugut me këto pasuri të mëdha që kanë si ullinj, agrume, rrush, fiq etj., të prodrojnë vazhdimisht, çdo vit, bile çdo vit i ri të japë një prodhim më të madh se viti i kaluar. Për të arritur këtë, duhet të mobilizohemi të gjithë dhe t'u bëjmë bimëve shërbimet e duhura agroteknike. Atëherë do të jemi të sigurt se prodhimet tona do të dyfishohen e do të trefishohen. Përdorimi i pleh-

rave kimike do të rritë prodhimet bujqësore në gjithë Shqipërinë kudo që ato do të përdoren e do të shfrytëzohen mirë.

Rëndësi për ne ka që të prodrojmë sa më shumë drithëra buke nö vend. Ju, kooperativistë, të lokalitetit të Himarës, të luftoni që të prodhoni sa më shumë ullinj, agrume, rrush e siq, pasi këtu kushtet janë më të mira për ta, kurse zonat fushore të Shqipërisë do të përpilen të prodrojnë sa më shumë drithëra buke. Dhe s'ka dyshim se ne do të korrim suksese në realizimin e këtyre detyrave shumë të rëndësishme, sepse fshatarësia jonë tani është e bashkuar në kooperativa, ka një eksperiencë të pasur në punë, ka përvetësuar agroteknikën moderne, prandaj edhe prodhimet bujqësore çdo vit që kalon shtohen.

Te ne, në treg dyqanet janë plot, ka pasur vazhdimishit mish, qumësht, sheqer, yndyrna e çdo gjë tjetër. Nënat dhe motrat thonë se tani, përveç burrave punojmë dhe vetë, para kemi dhe gjen ç'të duash. Ka vende të tjera ku gjendja nuk paraqitet si te ne, megjithëse janë vende më të përparuara e më të pasura. Kjo ndodh se te ne punët shkojnë mirë, Partia dhe Qeveria që përbëhet nga bijtë e këtij populli nuk e kanë mendjen në erë, por dinë ta qeverisin mirë vendin dhe ekonominë, shqiptari nuk e hedh bukën nga penxherja, ai kur ulet për të ngrënë, e puth bukën. Populli ynë është i vuajtur dhe punon vazhdimishit për ta bërë gjithnjë e më të bukur jetën e tij, ndërsa te të tjerët, kur vijnë situata të vështira, krijohet alarmi.

Revolucioni popullor, Partia, pushteti popullor neve na dhanë gjithë këto të mira. Pra rruga e revolucionit

është kryesorja, që populli të fitojë, të vendosë pushtetin e tij dhe të ecë në rrugën e socializmit.

Po ç'thotë N. Hrushovi lidhur me këtë çështje?

Kur u bë Kongresi XX i PK të BS, N. Hrushovi shpalli tezën revisioniste, sipas së cilës duhet pritur që pushteti të merret me rrugën parlamentare, me anën e votimeve. Kjo pikëpamje ul fryshten revolucionare të komunistëve, të patriotëve revolucionarë dhe të njerëzve përparimitarë në vendet kapitaliste e koloniale. Nga kjo tezë u gabuan edhe shumë parti. Të marrim, për shembull, PK të Francës, që është një nga partitë më të mëdha në Evropë. Përpara, kjo parti kishte në parlamentin francez 180 vende, kurse tanë që ndjek vijën revisioniste të N. Hrushovit është katandisur të ketë vetëm 10 deputetë në parlament. Ja, pra, se si mund «të merret» pushteti e «të çlirohet» proletariati dhe të gjithë punonjësit me rrugën revisioniste të N. Hrushovit, me të cilën ne nuk kemi qenë asnjëherë dakord.

Pasi foli për pikëpamjet e tjera të revisionizmit hrušovian e për veprimet e tyre armiqësore e antimarksiste si dhe për luftën, që zhvillon PPSH në mbrojtje të parimeve marksiste-leniniste, shoku Enver Hoxha tha:

Partia jonë ka zgjedhur një rrugë të drejtë, prandaj fiton e do të fitojë kurdoherë. Shqipëria është një shembull për popujt e tjerë. Ka popuj që akoma s'janë në fuqi dhe nuk gëzojnë të mirat e socializmit siç ndodh në vendin tonë. I tillë është, për shembull, populli grek, i cili e do lirinë, demokracinë, socializmin dhe do të vijë dita që edhe ai të ndërtojë socializmin, si në vendin tonë. Ne e duam popullin grek se është një popull i mirë, i ndershëm dhe me kulturë. Ne jemi në kundërshtim me reak-

sionin dhe me qeverinë monarko-fashiste greke. Megjithatë ne duam të bashkëjetojmë me shtetin grek, të kemi marrëdhëniet e finqnjësisë së mirë me të, por udhëheqësit e këtij shteti nuk e duan këtë se janë fashistë, ata thonë se janë në gjendje lufte me Shqipërinë dhe kanë pretendime tokësore mbi Shqipërinë, po kur të shohin majën e veshit, atëherë do t'i kënaqin kërkesat e tyre.

Ne i kemi paralajmëruar, qoftë monarko-fashistët grekë, qoftë klikën titiste që të mos bëjnë aventura me Shqipërinë. Shqipëria kurdoherë ka qenë një kala e pamposhtur, aq më shumë sot, që populli është në fuqi dhe udhëhiqet nga një Parti besnikë e popullit dhe e marksizëm-leninizmit. Armiqtë ne nuk do të na gjejnë kurrë në gjumë, ne kemi një popull të mrekullueshëm dhe të armatosur mirë. Në Shqipëri popull e Parti janë një e të pandarë. Ne kemi një ushtri të fortë, sepse ajo përbëhet nga bijtë tuaj, nga bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve shqiptarë, që dinë përse luftojnë, se mbrojnë lirinë dhe të drejtat e tyre që janë fituar me gjak. Ne kemi Armën e Sigurimit të Shtetit, kemi repartet e kufirit, roje besnikë dhe vigjilente të atdheut e të popullit tonë. Nga ana tjetër, të mos pandehin armiqtë se Shqipëria është vetëm, ajo ka miq kudo në botë, të cilët do të ngrihen në këmbë, po të preken kufijtë tanë. Prandaj çdo armik duhet ta dijë mirë me kë ka të bëjë.

Vëllezër dhe motra të Himarës, punoni të qetë se një perspektivë të bukur keni përpara, e ardhshmja e lumtur i buzëqesh gjithë Shqipërisë. Prandaj kultivoni sa më shumë ullinjtë dhe agrumet, vreshtat dhe fiqtë dhe u bëni atyre të gjitha shërbimet e nevojshme, sepse kështu

do të keni më shumë prodhime, gjë që do të thotë të kri-joni mundësitë për të blerë sa më shumë bukë, mish, gjalpë, mallra industriale. Pastaj ju e dini se me ullinjtë, vajin, agrumet dhe frutat tuaj furnizoni qytetet, shton eksportin. Partia e di se në lokalitetin e Himarës ka një popull të vendosur dhe heroik, ka një organizatë partie të fortë dhe jam i sigurt se me forcat tuaja dhe me ndihmën e pushtetit, brenda këtij pesëvjeçari lokaliteti juaj do të fillojë të kthehet në një kopsht me të vërtetë të lulëzuar. Kështu do të bëhet i gjithë Bregdeti i mreku-llueshëm i vendit tonë.

Nga ana tjetër të jemi vigjilentë kundrejt veprimtarisë së çdo armiku, i brendshëm ose i jashtëm qoftë ai. Armiqtë e jashtëm dhe ndonjë i brendshëm, duke parë se tani është krijuar një situatë ndërkombëtare e vësh-tirë, kujtojnë se erdhi koha për ta dhe u ngrihet mendja. Megjithëkëtë ata kanë edhe frikë se u kujtohet fati i shokëve të tyre, që, kur janë dërguar si spinë ose si diversantë në Shqipëri, u është gjetur vendi. Sidoqoftë ne u themi këtyre zotërinjve të rrinë rchat, të mos u ngrihet mendja, po të shikojnë punën. Ata, gjithashtu, le të kenë parasysh se Partia jonë sytë i ka kurdoherë hapur, prandaj le të punojnë ndershmërisht, ta lënë prapa të kaluarën dhe të përpilen të fitojnë bu-kën me djersë. Këto fjalë të Partisë le t'i futin në kokë, sepse Partia nuk lejon të merren nëpër këmbë interesat e popullit dhe të atdheut, se pikërisht për mbrojtjen e këtyre interesave është derdhur lumë gjaku i popullit dhe jo vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por gjatë gjithë shekujve.

Prandaj, nëna dhe motra, shokë dhe vëllezër, me

besim të patundur në forcat e popullit e të Partisë, të ecim përpara si një trup i vetëm për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë, të realizojmë me sukses dhe të tejkalojmë çdo ditë planet tona! Kjo do të jetë një fitore shumë e madhe, që do të na shërbejë për të shkuar sa më shpejt në socializëm e pastaj në komunizëm!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i krahinës së Himarës!

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PRERJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE MIDIS BASNIKIMIT SOVJETIK DHE SHQIPËRISË — NJË AKT ARMIQËSOR I NIKITA HRUSHOVIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

5 dhjetor 1961

Sikurse jeni në dijeni, qeveria sovjetike i preu marrëdhëniet diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë. Ky është një nga aktet më armiqësore të qeverisë sovjetike, me në krye Hrushovin, ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Prerja e këtyre marrëdhënieve nga ana e revisionistëve sovjetikë nuk është e rastit, por e paramenduar me kohë.

Pas Mbledhjes së Bukureshtit, qëndrimi i N. Hrushovit dhe i pasuesve të tij ndaj Shqipërisë socialiste ka qenë plotësisht armiqësor. Tani nuk ka mbetur gjë tjeter veçse përjashtimi i Shqipërisë nga Traktati i Varshavës dhe pastaj Hrushovi t'i japë urdhër Ushtrisë Sovjetike

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi prerjen e marrëdhënieve diplomatike midis BRSS dhe RPSH nga ana e udhëheqjes revolucionare sovjetike.

të sulmojë Republikën Popullore të Shqipërisë. Por këtë nuk e ka lehtë ta bëjë, për arsy se në këtë rast komprometohet para syve të të gjithë botës. Sidoqoftë, një gjë është e qartë: në krye të qeverisë sovjetike sot janë elementë fashistë, të cilët përpiken me çdo mënyrë të kurdisin lloj-lloj planesh kundër popullit shqiptar.

Ne kemi bërë të gjitha përpjekjet që marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik të përmirësohen në rrugën marksiste-leniniste, dhe jo duke iu përulur diktatit të N. Hrushovit. Nuk është nevoja të përmendim fakte, sepse të gjithë shokët e Byrosë Politike janë në dijeni të të gjitha çështjeve.

Akti armiqësor i Nikita Hrushovit, duke prerë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, me siguri do të ngjallë një urrejtje të thellë të re të popullit shqiptar ndaj udhëheqjes revizioniste sovjetike. Një nga qëllimet e Hrushovit që mori këtë masë është: të nxitë elementët armiq dhe antiparti brenda vendit që të ngrenë krye kundër Partisë dhe pushtetit tonë popullor, gjë që s'do të mund ta arrijnë kurrë. Nga ana tjetër Hrushovi synon të diskreditojë Partinë dhe Qeverinë tonë në opinionin ndërkombëtar, duke u mbështetur në autoritetin e Bashkimit Sovjetik dhe njëkohësisht të kërcënojë të tjerët duke u thënë: «Po të mos jeni dakord me Bashkimin Sovjetik, do t'ua bëjmë si Shqipërisë». Pra, këtë akt, Hrushovi do që ta përdorë si mjet frikësimi. Kështu i bën ai llogaritë, pikërisht si revizionist, kurse marksizëm-leninizmi do të bëjë punën e vet.

Lidhur me këto çështje, në udhëheqjet e vendeve-

socialiste të Evropës, në byrotë politike të tyre, ne nuk kemi ndonjë shpresë, kurse në komitetet qendrore të partive të tyre mund të ketë elementë që nuk janë dakkord me udhëheqjet përkatëse, por nuk guxojnë të flasin. Koha do të tregojë se dcri ku i ka me vete Nikita Hrushovi këto vende. Në mos sot, nesër ai do të ngrejë dorën edhe kundër tyre. Hrushovi harron se prerja e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë do të bëjë që vendi ynë të fitojë edhe më shumë simpatinë e popujve të botës, sepse ne luftojmë për një çështje të drejtë. Nuk mund të ketë njeri të ndershëm në botë që të mos e presë me përbuzje dhe me indinjatë këtë gjest të ulët dhe armiqësor të Nikita Hrushovit. Me këtë akt bie poshtë edhe politika e tij për bashkekzistencën paqësore që predikon me aq bujë, sepse Shqipëria nuk është Gjermania Federale e Adenauerit, me të cilën ai ka marrëdhëniet. Të gjithë e kuplojnë se këto masa ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë merren sepse ajo nuk u nënshtrohet pikëpamjeve e qëndrimeve antimarksiste të Nikita Hrushovit. Në fakt Bashkimi Sovjetik i ka prerë të gjitha marrëdhëniet me ne, duke përfshirë edhe marrëdhëni tregtare, por tanjai e bëri këtë de jure.

Në këtë gjendje, të krijuar si rezultat i qëndrimeve revizioniste të udhëheqjes sovjetike, ne duhet të marrim masa, për të térhequr nga Bashkimi Sovjetik të gjithë studentët dhe njerëzit e tjerë që kemi atje, ndërsa këshilltari i ambasadës sonë, të kthehet i fundit. Sovjetikët kanë thënë se do të lënë në Shqipëri tre veta për të mbajtur godinën e ambasadës. Këta njerëz nuk do të bëjnë asnje punë, nuk do të kenë as shifrën, po do të

merren vetëm me mirëmbajtjen e godinës. Për këtë ne duhet të vendosim. Kjo çështje mund të shikohet, ne edhe mund të pranojmë që të mbeten në Tiranë 2-3 veta dhe po të njëjtin numër njerëzish të lëmë edhe ne në ambasadën tonë në Moskë. Kjo është një praktikë ndërkombëtare e njohur, që mund të zbatohet edhe në rastin konkret.

Përsa i përket çështjes së grave sovjetike, që janë martuar me njerëzit tanë, mendoj se shumica e tyre kanë për të kërkuar të largohen, natyrisht nga ne nuk do të pengohen. Burrat e tyre shqiptarë do ta kuptojnë këtë se kjo është rezultat i punës armiqësore që po zhvillojnë revizionistët sovjetikë në dëm të atdheut tonë. Megjithatë, në qoftë se ndonjë grua sovjetike do të qëndrojë në vendin tonë, duke marrë shtetësinë shqiptare, gjithashtu mendoj të mos pengohet.

Na propozohet që ne t'i japim përgjigje notës së qeverisë sovjetike. Nota jonë duhet t'i përshtatet notës së tyre. Ata, me anën e zëvendësministrit të Punëve të Jashtme, Firjubin, i bënë komunikim verbal këshilltarit të ambasadës sonë në Moskë, kurse ne mendojmë që notën tonë ta bëjmë me shkrim, pavarësisht nëse ata do ta marrin ose jo. Të dyja këto nota, bashkë me një artikull, të botohen në shtyp. Nota jonë mendoj të jetë një notë e gjerë, politike, ku të përmendet se si kanë qenë marrëdhëni tona me Bashkimin Sovjetik, si u acaruan këto marrëdhënie për mosmarrëveshje ideologjike, si Nikita Hrushovi kaloi në akte armiqësore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe prandaj ai mban përgjegjësi; të theksohet qëndrimi që do të mbaj-

më ne paskëtaj ndaj Bashkimit Sovjetik etj. Pastaj të hidhen poshtë konkretisht e me argumente të gjitha ato që thonë sovjetikët për ambasadorin e tyre, për marrëdhëni të tregtare etj.

Sonte janë njoftuar të vijnë këtu sekretarët e parë të komiteteve të Partisë, të cilët do të informohen për këtë çështje dhe për mënyrën se si do të veprohet pas botimit të materialeve në shtyp. Komitetet e Partisë do të marrin menjëherë masa për të zhvilluar mbledhjet e organizataave-bazë të Partisë. Pas botimit të materialeve në gazetë do të zhvillohen nibledhjet e kolektiveve punonjëse, të cilat me siguri do të shprehen njëzëri dakord me qëndrimin e drejtë të Partisë dhe të Qeverisë sonë dhe do të dënojnë ashpër veprimet armiqësore të Nikita Hrushovit.

Ka të ngjarë që vendet e tjera socialiste të Evropës të ndjekin vijën e Nikita Hrushovit. Po të ndodhë kësh-tu, kjo nuk do të jetë e favorshme për ta, sepse do të duket sheshit që udhëheqja e tyre është satelite e Nikita Hrushovit. Në qoftë se Nikita Hrushovi do të vazhdojë sulmet kundër nesh, edhe ne këtu jemi. Prandaj gjatë kësaj periudhe të prepatit të gjitha materialet që kemi dhe të jemi gati. Një artikull në gazetë u botua, tani do të prepatitet edhe një tjetër dhe pastaj do të fillohet të botohen me radhë edhe dokumentet e tyre dhe tonat, ku të dalë e vërteta se kush është përgjegjës për prishjen e marrëdhënieve në mes të Bashkimit Sovjetik dhe të Shqipërisë, ne apo ata.

Për çdo eventualitet duhet që e gjithë Partia, i gjithë populli, Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të forcojnë vigjilencën, sepse

nga grupi i Hrushovit, nga revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë, mund të pritet çdo gjë. I gjithë vendi duhet të jetë plotësisht i siguruar.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

STERVITJET USHTARAKE FUQIZOJNE AFTESINE MBROJTËSE TË ATDHEUT TONE

*Fjala me ushtarakët që morën pjesë në stërvitjen
«Shqiponja e malit»*

7 dhjetor 1961

Të dashur shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Komiteli Qendror i Partisë, Qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes Popullore u kushtojnë rëndësi stërvitjes ushtarake, zgjidhjes së problemeve të pregetitjes për mbrojtje, aftësimit të shtabeve dhe oficerëve. Me këtë rast më lejoni t'ju përshëndes dhe t'ju uroj nga zemra për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitjeje!

Partia dhe populli mburren me ju, mburren për zotësinë dhe mprehtësinë tuaj, për guximin dhe heroizmin tuaj, për shpirtin tuaj të lartë patriotik. I gjithë populli shqiptar është krenar për ushtrinë e tij. Populli ynë në shekuj ka luftuar për ditët e sotme, për lirinë dhe pavarësinë. Gjatë Luftës Nacionaçlirimtare, ai lutftoi me heroizëm për vendosjen e pushtetit populor dhe sot vazhdon të luftojë me vetëmohim për ndërtimin e

socializmit, të jetës së begatshme. Lufta Nacionalçlırimtare qe epopeja më e lavdishme e historisë së popullit tonë. Në Luftën Nacionalçlırimtare që i dha lirinë atdheut, u farkëtua Ushtria e lavdishme Popullore, e cila tanë është bërë një ushtri moderne dhe e pamposhur, e gatshme për të përballuar çdo rrezik që mund t'u turret atdheut, popullit, vendit tonë socialist. Dhe s'mund të ishte ndryshe. Ushtria jonë përbëhet nga bij të popullit, nga bij të punëtorëve dhe të fshatarëve, që kanë pushtetin në dorë.

Oficerët e ushtrisë sonë kanë mbaruar dy shkolla: shkollën e madhe të Luftës Nacionalçlırimtare, e cila është një thesar i paçmuar për ta dhe për gjithë ushtrinë tonë dhe janë perfekcionuar në shkollat e larta ushtarake, kanë mësuar shkencën ushtarake, pra, janë në gjendje të zgjidhin çdo problem, në çdo kohë dhe në çdo situatë, të zgjidhin me sukses detyrat luftarake. Prandaj, populli ynë është i lumtur që ka një ushtri të tillë, që ka oficerë të tillë, që ka kuadro të tillë, të cilët, duke zbatuar porositë e Partisë, stërvitin ushtrinë tonë, e bëjnë të gatshme për gjithçka. Ata kanë dashurinë dhe respektin tuaj të madh, shokë ushtarë. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme. Oficeri duhet të fitojë zemrën e ushtarit, të jetojë pranë ushtarit dhe, po ta dojë nevoja, të japë edhe jetën bashkë me ushtarin për lirinë e atdheut dhe të popullit.

Oficerët tanë duhet që gjithë zotësinë dhe diturinë e tyre t'ua japid ushtarëve, të mos lodhen e të mos mërziten, të ngrenë nivelin moralo-politik dhe tekniko-ushtarak të ushtarëve tanë. Kjo është një detyrë e dorës së parë. Lidhja e fortë në mes ushtarëve dhe oficerëve e

bën Ushtrinë tonë Popullore të pathyeshme përpara çdo tentative të armikut, që eventualisht mund të kërcënоже vendin tonë. Prandaj, shokë oficerë dhe ushtarë, kurrë tē mos kënaqeni me ato që keni mësuar dhe keni bërë, se çështja e mbrojtjes së atdheut socialist është e lavigjime. Kjo është vija, këto janë mësimet që ju jep Partia juve, ushtarëve dhe oficerëve.

Arti ynë ushtarak është zhvilluar në shkallë tē lartë. Ushtria jonë është pajisur me tē dhe me armët më moderne, por ky art dhe këto armë na duhen për një qëllim tē lartë: përmblotjen e atdheut dhe tē popullit.

Armiqtë i kemi rrëth e rrotull kufijve tanë dhe pas tyre është imperializmi amerikan. Ata janë tē armatosur dhe po armatosen çdo ditë. Ju e dini, shokë, se tani përdoren armë nga më modernet. Pra, tē bëjmë përpjekje që këto armë t'i përvetësojmë sa më mirë dhe armët që disponojmë t'i përdorim me efikasitetin më tē madh. E përsëris, duhet t'i përvetësojmë këto armë, me cilësi tē lartë. Tani me armët moderne veprimet nuk numërohen me ditë, bile as me orë, por numërohen me minuta e sekonda, prandaj duhet tē jemi në lartësinë e këtyre detyrave.

Ju e dini që në rast se armiku do tē na sulmojë, qëllimi i tij kryesor do tē jetë likuidimi i forcave tē gjalla tē ushtrisë dhe pushtimi sa më parë i territorit. Edhe ne duhet tē kemi qëllimet tona: tē asgjësojmë forcat e armikut, t'i shkatërrojmë ato plane që ai mendon se janë në avantazhin e tij, si përmblotja befasia edhe forcat më tē mëdha në numër që ai disponon. Ne kemi avantazhet tona që na sigurojnë fitoren. Territorin e kemi tē vogël dhe e njohim atë më mirë se armiku, pran-

daj qëllimit të tij për të pushtuar shpejt vendin tonë e me sa më pak humbje, ne duhet t'i përgjigjemi me luftë të tillë, që ai të mos mund të vërë këmbën në tokën tonë, t'i shkaktojmë atij humbje të mëdha dhe t'ia prishim planet e tentativat e shpejtësisë e të befasisë. Ka shumë rëndësi morali i popullit dhe i ushtrisë sonë që është jashtëzakonisht i lartë dhe as mund të krahasohet me moralin e ushtrive të armiqve, që eventualisht mund të sulmojnë vendin tonë. Ne gjithashtu kemi armë moderne si dhe armiku. Të gjitha këto na bëjnë që të jemi të gatshëm, në çdo drejtim. Tokën e shenjtë të atdheut ta mbrojmë me çdo kusht, t'i krijojmë armikut të atilla pengesa, që ai të gozhdohet në vend dhe të asgjësohet. Prandaj kanë rëndësi të madhe detyrat dhe stërvitjet tuaja, shokë ushtarë dhe oficerë. Tjetër është t'i mësosh gjërat në letra, në libra, në kabinete, në harta, por tjetër është që këto detyra t'i zbatosh në jetë, në terren, në shi e në dëborë ose në ditë të nxehtha, kur të përvëlon dielli. Stërvitjet ushtarake e fuqizojnë aftësinë mbrojtëse të Ushtrisë sonë Popullore.

Në këto stërvitje ju zbatoni në praktikë ato që mësoni në teori. Vetë kjo praktikë ju mëson më shumë, ajo verifikon edhe sa të drejta janë mësimet teorike dhe i korrigjon ato. Në këtë drejtim iniciativa në zbatimin e detyrave ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Është e domosdoshme të zbatohen urdhrat me përpikëri, me pjekuri, me zgjuarsi, duke shfrytëzuar çdo moment, çdo kodër, çdo gërxh, çdo qafë e çdo gur. Mund të ndodhë që armikut në fillim, të mos ia kemi kuptuar si duhet taktikën dhe strategjinë e tij, por duke pasur moralin të lartë, duke njobur mirë terrenin, duke përvetë-

suar si duhet armën, duke vepruar me guxim, me iniciativë etj. do t'i kuptojmë armikut qëllimet, taktikat e manovrat dhe do të ndërtojmë me hollësi kundërgoditjen për asgjësimin e tij.

Në të ardhshmen, ne do të kemi në duar armë më moderne e më të fuqishme akoma, prandaj ushtarët dhe oficerët duhet t'i shfrytëzojnë këto si duhet, të mësojnë më shumë e të veprojnë më tepër me iniciativën e tyre, nga eksperiencia e jetës. Për shembull, në rast se ka plasur ose nuk ka plasur një predhë mortaje nuk është e nevojshme të vijë e ta shohë medoemos specialisti përkatës, por fare mirë, këtë punë mund dhe duhet ta mësojë ushtari, i cili të dijë dhe ta kuptojë nëse ka plasur apo jo predha, natyrisht duke evitar çdo aksident. Prandaj çështja e përvetësimit të armëve dhe e përdorimit të tyre me shpejtësi të madhe duhet të futet në gjak, se armiku në çdo kohë me mjete moderne nuk pret, pse veprimet, siç thamë, maten me minuta e sekonda. Në qoftë se aparaturat tuaja nuk mund të parashikojnë, për shembull, ardhjen e flotës ajrore të armikut, brenda disa minutave, atëherë armiku të është futur në tokën tënde dhe të ka bombarduar. Shumë armë dhe aparatura punojnë në mënyrë automatike dhe duan njerëz të kulturuar, që të mund t'i vënë ato në përdorim, sepse kështu do të thyejmë në kohë çdo sulm, çdo tentativë të armikut. Pra ju, oficerë, duhet të vini të gjitha dituritë tuaja, t'i përvetësoni arnët që ju kanë dhënë në duar Partia dhe pushteti popullor dhe të bëni që ato t'i përvetësojnë të gjithë ushtarët dhe i gjithë populli.

Ne mund të themi se ushtria jonë ka bërë përparrime kolosale. Ajo është tanë në gjendje të përballojë çdo

armik që do të tentojë të cenojë kufijtë e atdheut tonë, ajo është në gjendje ta asgjësojë atë, se ka mbështetjen dhe dashurinë e madhe të popullit shqiptar.

Duke ju uruar me gjithë zemër për sukseset që ju keni në punën tuaj, ju siguroj për përkrahjen dhe kujdesin më të madh të Partisë e të Qeverisë. Vazhdoni punën tuaj të shenjtë, për të qenë në çdo moment të gatshëm për të mbrojtur atdheun tonë të shtrenjtë socialist e të gjitha fitoret e popullit tonë që ka arritur nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Punët në vendin tonë, shokë ushtarë dhe oficerë, shkojnë mirë, ekonomia ecën përpëra dhe ne çdo ditë korrim fitore. Planet tona pesëvjeçare janë realizuar me sukses dhe këto kanë bërë që niveli i jetesës i popullit tonë të ngrihet vazhdimisht. Këto janë rezultat i vijës së drejtë të Partisë sonë, i patriotizmit të popullit tonë. I gjithë vendi ynë ka tanë një industri të zhvilluar, që nuk e kishte parë dhe nuk e kishte ëndërruar populli në të kaluarën. Shumë armiq s'besuan se në Shqipëri do të ngrihet kjo industri, por ja që në të katër anët e Shqipërisë filluan të punojnë fabrika të ndryshme, të cilat drejtohen nga bijtë e punëtorëve e të fshatarëve dhe kurdoherë realizojnë e tejkalojnë planet.

Gjithashtu u ndryshua krejtësisht faqja e fshatit tonë, u realizua në përgjithësi kolektivizimi, kjo ishte një detyrë e rëndë, por e domosdoshme, që u plotësua në saje të vijës së drejtë të Partisë, të patriotizmit dhe të kuptimit të drejtë nga ana e fshatarësise të politikës së Partisë për shndërrimin socialist të bujqësisë. Jo vetëm që u ngriten kooperativat bujqësore, por janë tharë kë-neta, janë hapur kanale nga të katër anët etj. Këto janë

vepra të mëdha, të cilat e kanë bërë tokën shumë më pjellore nga ç'ka qenë në të kaluarën. Tani në fushat tona punojnë mijëra traktorë, me mijëra të tjerë do të vijnë në të ardhshmen. Në të katër anët e vendit tonë janë hapur shkolla, pse pa shkollë, pa dituri nuk mund të ndërtohet socializmi, nuk mund të punojnë fabrikat, nuk mund të punohen arat, nuk mund të drejtohen traktorët, siç nuk mund të përdoren armët moderne që kanë në duar ushtria dhe populli shqiptar. Prandaj populli shkon në shkolla ditën dhe natën, të gjithë mësojnë dhe kjo tregon se sa përparimtar është shteti ynë, se sa e drejtë është vija e Partisë sonë, sa shumë e do populli Partinë dhe mobilizohet me të gjitha forcat për të zbatuar direktivat e saj. Në rast se vija e Partisë sonë nuk do të ishte marksiste-leniniste, ne nuk do të kishim këto rezultate që gjëzojmë sot, nuk do të ishte kjo dashuri e zjarrtë që ka populli për Partinë. Pa Partinë, pa vijën e saj të drejtë, nuk mund të arriheshin të gjitha këto fitore, nuk mund të zhvillohen më tej këto fitore, nuk mund të ruhet liria dhe pavarësia e atdheut tonë socialist.

Vendi ynë, i udhëhequr nga Partia ecën në rrugën e socializmit. Republika Popullore e Shqipërisë ka qenë, është dhe do të mbetet kurdoherë besnikë e marksizëm-leninizmit. Për këtë arsyе Shqipëria, Partia e Punës e Shqipërisë kanë fituar dashurinë dhe besimin e popujve përparimtarë të botës e të partive komuniste e punëtore. Dashuria dhe admirimi për Partinë tonë, për politikën e saj të drejtë, janë një dëshmi e qartë se ne jemi në rrugë të drejtë, mbajmë një qëndrim parimor. Natyrisht kjo i tërbon armiqtë imperialistë e revisionistë, të

cilët janë përpjekur vazhdimisht ta dobësojnë Republikën Popullore të Shqipërisë, sepse është bërë një ferrë në këmbët e tyre.

Armiku i popujve është në radhë të parë imperializmi amerikan, i cili ka për qëllim zhdukjen e socializmit dhe të komunizmit dhe rivendosjen e pushtetit të kapitalit kudo në botë. Për këtë arsyе ai armatoset përvete, armatos satelitet e tij e në radhë të parë revanchistët e Bonit, nazistët. Kundër vendit tonë imperializmi amerikan kurdoherë ka pasur qëllime agresive. Ai ka nxitur lakejtë e tij rreth e rrotull Shqipërisë, revisionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë, që të organizojnë provokacione e komplotë, përtatë mbytur Republikën Popullore të Shqipërisë. Por qëndrueshmëria e fortë e popullit tonë, uniteti i tij rreth Partisë, ka bërë që të shpartallohen të gjitha kompletet dhe intrigat e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Partia e populli ynë 20 vjet me radhë kanë luftuar dhe luftojnë dhëmb për dhëmb me armiq të egër. I madhe i vogël te ne i dinë qëllimet e përhershme të armiqve rreth kufijve tanë. Ata në çdo moment kanë dashur ta pushtojnë Shqipërinë dhe përkrahjen e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjera. Por ata nuk kanë mundur e nuk do të mundin dot kurrë t'i arrijnë qëllimet e tyre djallëzore për copëtimin e Shqipërisë.

Renegati Tito, nën maskën e komunistit, që kur luftohej në malet tona kundër pushtuesve, pregetiste komplotë përtë gllabëruar Shqipërinë. Pas Çlirimit ai e intensifikoi punën e tij armiqësore, organizoi agjenturën brenda në Partinë tonë, grumbulloi njerëz të ulët jashtë

Partisë për të rrëzuar pushtetin popullor, për të shkatërruar Partinë tonë dhe për ta bërë Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Mirëpo Partia jonë qëndroi e patundur, populli ynë qëndroi i bashkuar rreth Partisë dhe të gjitha komplotet e revizionistëve jugosllavë dësh-tuan, u shpartalluan dhe Republika Popullore e Shqipërisë, e udhëhequr nga Partia, ecën përpara kryelartë e ndërton socializmin në qytet dhe në fshat. Lufta kundër revizionizmit jugosllav që po bën Partia jonë është një luftë e lavdishme. Komunizmi ndërkombëtar nuk do ta harrojë kurrë këtë luftë parimore që bën Partia jonë.

Por sot lufta nuk zhvillohet vetëm kundër revizionizmit jugosllav. Përveç revizionizmit jugosllav, në kokë të Bashkimit Sovjetik ka lindur një grup i rrezikshëm revizionist me në krye Nikita Hrushovin. Ky dhe Titoja, kokë më kokë veprojnë kundër socializmit, kundër kam-pit socialist, kundër komunizmit. Prandaj lufta jonë kundër revizionizmit të sotëm ka rëndësi jetike për lë-vizjen komuniste në botë. Në këtë luftë kundër revizionizmit ne nuk jemi vetëm. Me ne është Partia Komuniste e Kinës së Mao Ce Dunit, janë komunistët e vërtetë në vetë Bashkimin Sovjetik dhe në të gjithë botën. Kina dhe Shqipëria mbajnë lart flamurin kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern.

Imperializmi me në krye atë amerikan dhe revizionistët Hrushov-Tito e të tjerë, përpiken që të përcajnë kampin socialist, lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Imperialistët synojnë që popujt e vendeve socialiste të humbasin lirinë e fituar me gjak, të humbasin fitoret socialiste. Ata duan të sundojnë kudo. Revisionistët modernë, Nikita Hrushovi e grapi i tij, të gjithë ata udhë-

heqës të tjerë të vendeve të demokracisë populllore që i pasojnë, mbulohen me fraza marksiste dhe flasin për paqen për të gënjiyer popujt. Por ata janë pseudomarksistë, pseudopaqësorë. Kështu ka vepruar edhe socialdemokracia. Për paqen nuk kanë munguar të flasin edhe fashistët. Prandaj, të jemi si kurdoherë vigjilentë, të jemi të armatosur kundër imperializmit gjakatar, të demaskojmë me të gjitha forcat qëllimet agresive të tij.

Revisionistët modernë, Hrushovi dhe grupei i tij na akuzojnë ne, shqiptarët, si «luftënxitës», si njerëz që gjoja nuk i kuptojmë situatat ndërkombëtare, nuk kuptojmë zhvillimin e ngjarjeve, që jemi «sektarë», «dogmatikë», jemi të izoluar nga bota, kurse ata na qenkan të qartë për situatën dhe s'janë të izoluar, por të lidhur me gjithë botën.

Të gjitha këto janë blofe. Ata shpifin kundër nesh. Partia jonë e ka thënë kurdoherë se socializmi ecën vazhdimisht përpara dhe imperializmi po kalbëzohet e shkon drejt varrit. Por kjo nuk do të thotë se imperializmi, me atë amerikan në krye, s'paraqit ndonjë rrezik. Ai dhe miqtë e tij thurin intriga, janë për luftën. Kjo duket në garën që zhvillon imperializmi për armatime. Hrushovi e sheh këtë, por thotë se «imperializmi e ka ndryshuar natyrën e tij, nuk është më agresor!» Përkundrazi, ne themi se imperializmi nuk është për paqen, por për luftën. Kësaj tendencë të tij i duhet prerë hovi i zhvillimit. Duhet të ngrihen popujt në kömbë kudo në botë që t'i ndalin dorën gjakatare imperializmit amerikan. Në rast se në të gjitha vendet kapitaliste zhvillohet me të vërtetë një luftë revolucionare nga klasa punëtore dhe popujt, për ta penguar imperializmin në garën e shfrenuar të

armëve, atëherë ai do të gjendet përpara një force të madhe frenuese brenda në strofkën e tij.

Nikita Hrushovi nuk predikon një luftë të tillë revolucionare të popujve, që ta bëjë zap imperializmin. Politika e tij është thellësisht revisioniste. Që nga Kongresi XX ai ka bërë që në shumë parti komuniste dhe punëtore të Evropës dhe të Amerikës të zhvillohet revisionizmi. Për shembull, në Partinë Komuniste të Italisë s'ka unitet. Si i thonë fjalës «njëri i bie gozhdës e tjetri patkoit», njëri shan sistemin sovjetik, tjetri është me Stalinin, njëri është me Hrushovin, tjetri kundër tij. Në këtë gjendje reaksiuni italian fërkon duart e vepron për të shpartalluar Partinë Komuniste. Kjo ndodh edhe në Partinë Komuniste të Francës, ku njëri shprehet kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, tjetri thotë: «Jam me Partinë e Punës të Shqipërisë». Kështu ngjet edhe në vende të tjera kapitaliste, ku partitë komuniste e punëtore, në rast se nuk e marrin veten dhe nuk u vënë fre disa elementëve në udhëheqje të tyre që ndjekin rrugën revisioniste të Nikita Hrushovit, do të kenë humbje të mëdha.

Në disa parti, ka «komunistë» që i mbajnë ison Hrushovit dhe thonë, për shembull, që «udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë mohojnë ndihmën që i ka dhënë Bashkimi Sovjetik Shqipërisë». Po cila është e vërteta? Kurdoherë udhëheqja e Partisë, Partia dhe populli ynë flasin me mirënjojje për ndihmën që i ka dhënë Bashkimi Sovjetik vendit tonë në kohën e Stalinit. Por në të njëjtën kohë ne i themi Nikita Hrushovit: Kjo ndihmë është dhënë nga populli sovjetik, kurse ti, Nikita Hrushov, ke menduar e mendon se si t'u bësh

presion Partisë dhe popullit tonë që vendi ynë të shkojë në rrugën revisioniste, të puthet me tradhtarët e popullit, me tradhtarët e Shqipërisë, me tradhtarët e marksizëm-leninizmit. Jo, kjo nuk do të ndodhë kurrë! Qëllimet e ndyra të Nikita Hrushovit ne i hedhim poshtë. Por ne kujtojmë me mirënjohje ndihmën e singertë internacionaliste që na dha Bashkimi Sovjetik me Stalinin në krye, të cilin sot Hrushovi e merr nëpër këmbë, e quan «tradhtar të komunizmit», «kriminel», «mik të fashistëve hitlerianë» etj. Nikita Hrushovi e grapi i tij, duke shpisur kundër Stalinit, synojnë të errësojnë fitoret e Bashkimit Sovjetik në ndërtimin e socializmit, të shkurorëzojnë leninizmin. Kjo, shokë të dashur, është e kuptueshme, pavarësisht që Nikita Hrushovi mban emrin e komunistit. Tradhtarë ka në Bashkimin Sovjetik dhe tradhtarështë Nikita Hrushovi, i cili vepron nën rrogoz që Bashkimi Sovjetik të rikthehet në kapitalizëm. Ai mendon që Bashkimi Sovjetik të lidhet me Amerikën, me Francën, me Anglinë, me Gjermaninë e Bonit etj., gjoja nën maskën e paqes, por qëllimi i tij nuk është paqja, përkundrazi, ai kërkon të kthejë prapa rrötën e historisë, ta kthejë BS në një shtet partner të shteteve kapitaliste dhe të pengojë revolucionin komunist në botë. Por a do t'uua arrijë këtyre Nikita Hrushovi? Përkohësisht mund edhe të arrijë diçka, por me siguri marksizëm-leninizmi do të triumfojë. Tradhtarët janë klika, janë grupe, kurse marksistët janë shumica dërrmuese dhe do të mbajnë lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Shikoni, shokë të dashur, sa me egërsi vepron Nikita Hrushovi! Ka organizuar rreth vendit tonë një

bllokadë që s'është parë kurri. As imperialistët nuk kanë arritur të bëjnë një bllokadë të tillë kaq të egër. Nikita Hrushovi i ka prerë vendit tonë të gjitha ndihmat ekonomike, duke menduar se ne do të gjunjëzoheshim. Por për fat të keq të tij, populli dhe Partia jonë nuk u gjunjëzuan, përkundrazi brenda këtij viti kemi arritur suksese të papara në ekonominë tonë. Kudo janë realizuar planet ekonomike. Në industri detyrat janë tejkaluar. Në bujqësi, me gjithë kohën e keqe, janë arritur rezultate shumë më të mira sesa vitin e kaluar. Prandaj Nikita Hrushovi, që preu të gjitha ndihmat, nuk ua arriti dot qëllimeve të tij. Ai mori edhe masa të tjera, mori masa të shëmtuara në rrugën ushtarake, sepse në nuk iu gjunjëzuam qëllimeve të tij të errëta, u përpoq tok me vendet e tjera të Traktatit të Varshavës të na frikësonte dhe körkoi që baza e Vlorës të bëhej sovjetike, domethënë ne shqiptarët të mos kishim të drejtë të hynim fare në Vlorë, në qytetin tonë heroik. Por Partia e Punës e Shqipërisë i tha Nikita Hrushovit: «Ndal, Vlora ka qenë, është dhe do të jetë jona!». Oficerët dhe marinarët tanë janë sot në gjendje t'i marrin përnjëherësh në dorëzim anijet e bazës së Vlorës, t'i drejtojnë si duhet ato dhe të jenë në gatishmëri të plotë, për të shpartalluar çdo tentativë të armikut nga deti.

Nga ana tjetër, Nikita Hrushovi hoqi të gjithë specialistët, që ishin në Shqipëri. Ai mendoi se tash Shqipëria mbaroi, industria shqiptare do të mbetet. Por u gabua, sepse industria jonë nuk pushoi, por eci përpara, ajo tash ka një bilanc të pasur. Propozime të mahnitshme për shpikje e për racionalisime kanë bërë punëtorët, teknikët dhe inxhinierët tanë. Ndërmarrje pas

ndërmarrjesh po ndërtohen te ne. Ndërmjet gjeologëve sovjetikë që kishin ardhur për të na ndihmuar, ka pasur edhe nga ata që kanë sabotuar, sepse të tilla ishin udhëzimet e udhëheqjes së tyre revizioniste. Ata kanë vepruar në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë. Direktivat që u ishin dhënë atyre nga Nikita Hrushovi kishin për qëllim të diskreditonin Partinë e Punës të Shqipërisë, Qeverinë dhe popullin shqiptar, të dobësonin ekonominë tonë. Në fakt, shumë gjëra mbajnë këto malet tonë, por, kur Nikita Hrushovi hoqi specialistët, nuk mendoi se gjeologët shqiptarë do t'i zbulojnë, do të veprojnë me patriotizëm të zjarrtë. Te ne tani janë zbuluar minerale shumë të rëndësishme, të cilat do të vihen në shfrytëzim dhe do të jenë për popullin shqiptar një pasuri e madhe, për të forcuar ekonominë e fuqinë mbrojtëse të vendit e për të ngritur mirëqenien e popullit. Kështu që veprimet tradhtare të Nikita Hrushovit edhe në këtë drejtim dështuan. Duke parë se Partia e Punës e Shqipërisë po u bënte ballë presioneve e bllokadave ekonomike të Nikita Hrushovit, ai bëri edhe bllokadën politike. Në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore nuk flitet fare për sukseset e Shqipërisë, por edhe kur shkruan shtypi i tyre, vetëm shpif dhe asgjë tjetër.

Ju e dini përsë ngjanë gjithë këto gjëra, vëllezër. Këto ndodhën që pas Mbledhjes së Bukureshtit. Në Bukuresht grupi i Nikita Hrushovit kurdisi një komplot të madh për të goditur Partinë Komuniste të Kinës. Nikita Hrushovi arriti deri atje sa të propozojë që RP e Kinës të përjashtohej nga kampi socialist dhe PK e Kinës të dënohej nga lëvizja komuniste ndërkombëtare. Në këtë

çështje kaq të madhe e jetike, Partia e Punës e Shqipërisë nuk ishte dakord me Nikita Hrushovin dhe i tha se veprimi i tij është antimarksist, antisocialist, është i papranueshëm, prandaj nuk mund të merrëj një vendim i tillë, duhet të dëgjohet edhe PK e Kinës pastaj të jepen gjykime. Meqenëse Nikita Hrushovit iu prishën planet e iu demaskuan qëllimet e tij, atëherë, pas Bukureshtit, ai sulmoi Partinë e Punës të Shqipërisë. Ky tradhtar i marksizëm-leninizmit, ruajti dhe zhvilloi në zemrën e tij një mëri të madhe kundër Partisë sonë. Por Partia jonë eci përpëra me besim të plotë në fitore. Ajo shkoi në Mbledhjen e Moskës dhe përpëra 81 partive komuniste e punëtore të botës ia numëroi në sy gjithë ato që kishte bërë kundër Partisë e vendit tonë, kundër marksizëm-leninizmit.

Shikoni sa larg shkoi Hrushovi: këto ditë ai preu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, në një kohë kur ai afrohet dita me ditë me imperializmin amerikan dhe me revizionizmin jugosllav. Përse e bën ai këtë gjë? Këtë gjë ai e bën që të na frikësojë, që të krijojë në popullin shqiptar «trubullira», por gabohet rëndë. Populli shqiptar do të bashkohet akoma më fort me Partinë e tij, sepse ai shikon se sa e drejtë është vija e Partisë kundër këtij tradhtari të bashkuar me Titon dhe me Venizellosin, të bashkuar me imperialistët amerikanë, për të shkatërruar vendin tonë dhe kampin socialist. Hrushovi i preu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë edhe për të trembur partitë komuniste dhe udhëheqjet e vendeve socialiste. Nikita Hrushovi u thotë vendeve të demokracisë popullore dhe partive të tjera komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste se në rast se ju ngrini

krye kundër nesh, atëherë do të ngjasë po kjo që i ngjet Shqipërisë. Por këto çështje nuk do të kalojnë si në vaj. Nikita Hrushovi ka frikë se do të dështojë, prandaj merr masat paraprake, por këto masa nuk do të kenë sukses jo vetëm në Shqipëri, por as në lëmin e komunizmit ndërkombojtëtar.

Detyra jonë është që të mbrojmë Partinë me të gjitha forcat tona, të mbrojmë unitetin e saj, sepse armiqtë revisionistë dhe imperialistë kurdoherë synojnë goditjen e Partisë. Në qoftë se ata do të godasin Partinë, në qoftë se ata do të shpartallojnë unitetin e saj, atëherë çështja e pavarësisë së vendit dhe e fitoreve të popullit, rrezikohen. Përkundrazi, po të jetë Partia e fortë, monolite, në rrugën marksiste-leniniste, çdo tentativë e armiqve, qoftë me propagandë e agitacion, qoftë me diversion, qoftë dhe me luftë të hapur, është e destinuar të likuidohet. Prandaj të ruajmë Partinë si sytë e ballit, ta mbrojmë Partinë, të vëmë mbi çdo gjë interesat e Partisë, që janë interesat e popullit. Që ta ruajmë Partinë duhet të edukohemi me fryshtë revolucionare, siç na ka mësuar kurdoherë Partia, t'i shohim çështjet me fryshtë revolucionare. Momentet që kalojmë kërkijnë gjallëri në punë, në mësimë, në stërvitje, prandaj duhet që çdo gjë ta shohim në dritën e interesave të atdheut e të Partisë. Po vepruam kështu në çdo kohë, çdo armik do të thyejë kokën përpara Republikës Popullore të Shqipërisë. Prandaj, shokë, të jemi vigjilentë, vigjilentë në sektorin civil, vigjilentë në çështjet ushtarake. Sidomos në çështjet ushtarake të keni kurdoherë një disiplinë të ndërgjegjshme, të ruajmë si dritën e syrit kërkuesat ushtarake, duhet që armiku të mos gjejë te

ne asnjë të çarë. Kjo kërkon që të ekzistojë një dashuri e ngrrohtë, e singertë, në mes të gjithë trupës, në mes trupës dhe oficerëve. Të jemi si një familje e madhe, e mbrujtur me një patriotizëm, me një moral, me një edukatë të shëndoshë, politike e ideologjike, ashtu siç është e siç duhet të jetë e denjë për Partinë tonë, për ushtrinë tonë, për popullin tonë. Kështu do të jemi në gjendje kurdoherë të thyejmë çdo armik.

Ushtria jonë ka përkrah gjithë popullin shqiptar. Populli ynë është trim dhe qëndron i patundur përpara këtyre dallgëve të mëdha që rrezikojnë paqen në botë, që rrezikojnë socializmin dhe komunizmin. Shqipëria është në ballë të luftës kundër armiqve të tërbuar. Ne do të hasim vështirësi të mëdha, por këto vështirësi do t'i kapërcejmë, se me ne është e drejta. Populli dhe Partia Komuniste e Kinës, në këto momente të bllokadës, na erdhën menjëherë në ndihmë, duke na plotësuar nevojat ekonomike, që na sabotuan revisionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre. Plani ynë pesëvjeçar do të realizohet. Me ndihmiën e Kinës Popullore do të ndërtojmë fabrika të reja, uzina të plehrave, që sa më parë bujqësia jonë të japë rendimente të larta, të shtohet prodhimi i drithërave etj. Veprat e reja industriale do të fuqizojnë ekonominë tonë popullore. Planet e Nikita Hrushovit dhe të veglave të tij kundër Shqipërisë do të dështojnë. Ne do të fitojmë mbi imperialistët dhe revisionistët modernë.

Të dashur shokë ushtarë dhe oficerë, ju kryeni një shërbim të madh dhe fisnik në roje të atdheut tonë dhe të socializmit. Armiku, sa më të fortë të na shikojë ne, aq më pak aventura do të guxojë të bëjë kundër

vendit tonë. Sidoqoftë detyra juaj është të jeni kurdo-herë në gatishmëri të plotë, që populli të punojë i qetë, të realizojë planet me entuziazëm, dhe ne t'i japim atij jo vetëm ato që i kemi premtuar, por edhe më shumë. Ne këto do t'i realizojmë patjetër, çdo gjë është e llogaritur, e parashikuar dhe e mundshme për t'u kryer. Kështu do të jemi edhe më të fortë politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht, do të mbrojmë popullin, do të mbrojmë Republikën Popullore të Shqipërisë, do të mbrojmë marksizëm-leninizmin.

Rroftë Partia e lavdishme e Punës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Ushtria jonë heroike!

Rroftë marksizëm-leninizmi!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

NJË AKT I PASHEMBULLT ARMIQESOR KUNDER RPSH DHE POPULLIT SHQIPTAR¹

10 dhjetor 1961

Me nxitjen e N. Hrushovit, qeveria sovjetike vendosi të tërheqë gjithë personelin e ambasadës sovjetike nga Tirana dhe të kërkojë largimin e gjithë personalit të ambasadës shqiptare nga Moska. Ky akt i pashembullt armiqësor kundër Shqipërisë socialiste dhe popullit shqiptar është një veprim i padëgjuar në historinë e marrëdhënieve midis vendeve socialiste, një grusht i rëndë kundër unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Një akt i tillë fyen ndjenjat e miqësisë së thellë vëllazërore, që ushqejnë komunistët dhe popujt sovjetikë për Partinë dhe për popullin tonë, ai revolton me të drejtë çdo shqiptar dhe çdo njeri të ndershëm në botë. N. Hrushovi, duke ndërmarrë këtë veprim, gëzon vetëm armiqëtë dhe u jep atyre armë, për të diskredituar Partinë Komuniste të BS, shtetin sovjetik dhe politikën e tyre tradicionale të miqësisë midis popujve. Kjo tregon se deri në ç'shkallë

¹ Kryeartikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» me titull: «Një akt i pashembullt në marrëdhëniet midis vendeve socialiste».

kanë arritur ndjenjat armiqësore të N. Hrushovit ndaj PPSH, RPSH dhe popullit shqiptar, të cilët kanë qenë dhe janë miq besnikë të Bashkimit Sovjetik.

20 vjet të veprimtarisë së PPSH dhe 17 vjet të ekzistencës së RPSH, janë dëshmia më e gjallë e ndjenjave të miqësisë e të dashurisë së pakufishme për PK të BS dhe për popujt e Bashkimit Sovjetik. Miqësia e popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik është farkëtuar nga PPSH në zjarrin e luftës për liri, për pavarësi kombëtare, për ndërtimin e socializmit. Ajo është mbrujtur me gjakun e bijve trima të popujve sovjetikë dhe të partizanëve shqiptarë të rënë në luftën e përbashkët kundër armiqve të përbashkët. PPSH i ka edukuar anëtarët e saj dhe gjithë punonjësit e vendit me frymën e dashurisë së pakufishme e të besnikërisë së patundur ndaj Partisë Komuniste të Lenin-Stalinit dhe ndaj popuve sovjetikë. PPSH dhe populli shqiptar e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë miqësinë me Bashkimin Sovjetik, përkrahjen dhe ndihmën e tij internacionliste, si faktorin e rëndësishëm të jashtëm për çlirimin e vendit, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare, dhe për këto kanë qenë dhe janë mirënjohës. Marrëdhëniet e RPSH me Bashkimin Sovjetik kanë qenë kurdoherë më se shembullore dhe ndërmjet dy vendeve tona nuk ka pasur kurrë re të zeza. Qeveria e RPSH ka përkrahur e ka mbështetur me të gjitha forcat politikën e jashtme të Bashkimit Sovjetik, propozimet dhe hapat e tij për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme ndërkombëtare në interes të paqes e të sigurimit të popujve, në interes të çështjes sonë të përbashkët. Miqësia shqiptaro-sovjetike nuk është rezul-

tat i ndonjë kombinacioni diplomatik, por është miqësi e thellë popujsh, që e ka burimin në rrugën e përbashkët të socializmit e të komunizmit, në interesat dhe në qëllimet e përbashkëta, në luftën kundër imperializmit, në ideologjinë e marksizëm-leninizmit dhe në parimet e larta të internacionalizmit proletar.

Eshtë e çuditshme dhe c pakonceptueshme për çdo njeri të ndershëm se si N. Hrushovi arriti deri atje sa të presë edhe marrëdhëniet shtetërore diplomatike me një vend të vogël mik e vëlla, me një vend socialist, që lufton pa u përkulur, në kushtet e rrethimit kapitalist e revisionist, që, mban lart flamurin e socializmit në brigjet e Adriatikut, që në çdo moment e rrethanë me vepra ka treguar besnikërinë e tij të pakufishme ndaj atdheut të madh të Leninit. Nuk mund të mos shkaktojë habi ky qëndrim ndaj Shqipërisë socialiste në një kohë kur N. Hrushovi predikon me bujë të madhe politikën e afrimit e të bashkëpunimit me të gjitha shtetet, edhe me ato më reaksionaret, të cilat zhvillojnë një politikë armiqësore konsekuente kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, në një kohë kur N. Hrushovi u shtrin dorën dhe përpinqet të krijojë lidhje të ngushta edhe me miliarderët më reaksionarë, edhe me princërit e mbretërit e ndryshëm, pa përmendur këtu afrimin e përqafimin me revisionistët jugosllavë e përshëndetjet e përzemërtë dhe urimt që i dërgon edhe Papës së Romës. Këto fakte do të bindin jo vetëm çdo komunist, por çdo njeri të ndershëm në botë, për të parë se sa armiqësor është akti i N. Hrushovit kundër RPSH, se kujt i shërben në të vërtetë ky akt.

Për tërheqjen e gjithë personelit të ambasadës so-

vjetike nga Tirana, N. Hrushovi gjeti si pretekst se gjoja Qeveria Shqiptare zhvilloka një fushatë armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik dhe acaroka marrëdhëniet midis dy vendeve, pengoka veprimtarinë normale të ambasadorit sovjetik në Tiranë dhe krijoka një gjendje të padurueshme për diplomatët sovjetikë etj. Të gjitha këto shkaqe «serioze» që e shtynë N. Hrushovin për një veprim të tillë janë fund e krye pa baza, janë shpifje dhe trillime, që hidhen poshtë nga gjendja reale e ngjarjeve. Kush njihet sado pak me shtypin dhe me realitetin në vendin tonë shikon se në të nuk ka asnë fjali, asnë shprehje, as frymën më të vogël të armiqësisë kundër Bashkimit Sovjetik. Përkundrazi janë N. Hrushovi dhe pasuesit e tij ata që krijojnë shpifje e trillime, për të mbjellë armiqësi e urrejtje kundër popullit tonë. Duke ecur në këtë rrugë, disa ditë më parë, në një artikull të gazetës «Pravda» datë 2 dhjetor 1961, shkruar nga J. Andropovi, thuhet se gjoja në një kryeartikull të gazetës «Zëri i popullit» botuar në prangun e Kongresit XXII të PK të BS, shkruhej se udhëheqësit shqiptarë «marrëdhëniet e tyre me Bashkimin Sovjetik këtej e tutje nuk do t'i zhvillonin veçse në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore të shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore». Ky është një falsifikim dhe shtrembërim i së vërtetës. Në «Zerin e popullit», në asnë numër, artikull apo kryeartikull të tij dhe nëasnë gazetë tjetër shqiptare, asnëherë nuk është thënë një gjë e tillë. Ja, mbi ç'trillime N. Hrushovi mbështet «argumentet» e tij. Ç'hipokrizi! Neve na sulet me akuzën e trilluar se jemi gjoja për marrëdhënie të bashkekzistencës paqësore me Bashkimin Sovjetik dhe

revoltohet për këtë, kurse vetë në fakt shkon shumë më larg edhe nga trillimi i tij dhe arrin deri në mbylljen e ambasadës sovjetike në Tiranë dhe në largimin e personelit të ambasadës shqiptare nga Moska, veprim ky, që s'ka asgjë të përbashkët jo më me parimet internacionaliste të marrëdhënieve midis vendeve socialistë vëllezër, por bille as me parimet e bashkekzistencës paqësore, për të cilat ai bën një zhurmë aq të madhe.

Përsa i përket pretekstit se gjoja në Shqipëri është krijuar një gjendje e padurueshme për diplomatët sovjetikë e për veprimtarinë normale të ambasadorit, as nuk ia vlen barra qiranë që të hidhet poshtë një shpifje e tillë. N. Hrushovi dhe grupei i tij, ashtu si vetë diplomatët sovjetikë e kanë të qartë se në të vërtetë në Shqipëri atyre u kanë qenë krijuar kushtet më se normale për zhvillimin e veprimtarisë, se ambasadori sovjetik, të cilit, gjoja sidomos kohët e fundit, i qenkan krijuar pengesa të mëdha në punë, qysh në datën 19 gusht 1961 ndodhet në Moskë e jo në Shqipëri. Është me të vërtetë e çuditshme që ambasadori Shikin, nga Moska, ka konstatuar pengesat, që i janë krijuar atij kohët e fundit në Shqipëri!

Nuk qëndron në këmbë as preteksti i N. Hrushovit se gjoja Qeveria e RPSH paska shkelur normat e së drejtës ndërkombëtare duke kërkuar shkurtimin e organikës së personelit të ambasadës sovjetike në Tiranë. Përse Qeveria e RPSH kërkoi që personeli i dy ambasadeve respektive të vihej në baza reciprociteti? Dihet se qysh pas Mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960 N. Hrushovi, në mënyrë sistematike e me paramendim, ka ndjekur politikën e presioneve e të shantazheve, me

qëllim që të gjunjëzojë e të nënshtrojë PPSH dhe popullin shqiptar. Duke shkelur marrëveshjet e nënshkruara më parë, ai ndërpreu të gjitha kreditë që Bashkimi Sovjetik i pat akorduar vendit tonë, tërhoqi të gjithë specialistët sovjetikë nga Shqipëria, ndërpreu pothuajse plotësisht marrëdhëniet tregtare në bazë të kleringut, u preu bursat të gjithë studentëve shqiptarë civilë e ushtarakë, që studjonin në Bashkimin Sovjetik, u vuri kryq të gjitha planeve të bashkëpunimit kulturor e tekniko-shkencor midis dy vendeve, vendosi bllokadën e rreptë të heshtjes e të izolimit politik kundrejt RPSH e popullit shqiptar, shkeli marrëveshjet në fushën e marrëdhënieve ushtarake, me një fjalë vendosi «kordonin sanitari» rreth Republikës Popullore të Shqipërisë. Dhe pas të gjitha këtyre a nuk është plotësisht e justifikueshme dhe e drejtë kërkesa e Qeverisë së RPSH për ta vënë personelin e dy ambasadave në baza reciprociteti nga pikëpamja numerike? Ç'do të bënин në këto kushte rreth 80 veta të ambasadës sovjetike në Tiranë, kur sfera e veprimtarisë së tyre u ngushtua së tepërmë, duke marrë parasysh masat e njëanshme restiktive ekonomike, kulturore e politike që vendosi N. Hrushovi ndaj RPSH?

Shkaku i vërtetë, që e shtyu N. Hrushovin deri në këtë akt ekstrem, nuk janë akuzat e trilluara që merr ai si pretekst. Shkaku i vërtetë duhet kërkuar te pikëpamjet revisioniste të N. Hrushovit dhe te orvatjet e tij antimarksiste për t'ua imponuar ato me çdo mjet partive të tjera. Duke filluar qysh nga Mbledhja e Bukureshtit e sidomos pas Mbledhjes së Moskës të 81 partive komuniste e punëtore, ku PPSH shprehu hapur mendimin e

saj dhe kritikoi në mënyrë parimore e me guxim pikëpamjet oportuniste dhe veprimet antimarksiste të N. Hrushovit, si hakmarrje për këtë dhe me qëllim që t'i mbylli gojën Partisë sonë, ta nënshtrojë atë dhe t'i japë mësim kujdo që do të guxonë ta kundërshtonte, N. Hrushovi i shtriu mosmarrëveshjet ideologjike në fushën e marrëdhënieve shtetërore dhe filloi të sillet me RPSH si ndaj një vendi armik. Ai, pasi zbatoi njërën pas tjetrës, në mënyrë sistematike, bllokadën ekonomike, bllokadën e heshtjes dhe të izolimit politik etj., për të gjunjëzuar Partinë tonë, arriti deri atje sa të sulmojë botërisht në Kongresin XXII me shpifje e me akuza nga më të ulëtat Partinë e Punës të Shqipërisë e udhëheqësit e saj dhe të bëjë thirrje të hapur kundërrevolucionare përrëzimin e udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit shqiptar, duke ndërhyrë kështu brutalisht në punët e brendshme të një vendi socialist, sovran, mik e aleat. Dhe, pasi dështoi në të gjitha këto orvatje e nuk ia arriti dot qëllimit të tij, ai kreuz edhe aktin tjetër armiqësor kundër RP të Shqipërisë duke prerë marrëdhëniet diplomatike. Mbyllja e ambasadës sovjetike në Tiranë dhe kërkesa përlargimin e gjithë personelit të ambasadës shqiptare nga Moska është një përfundim logjik i rrugës antimarksiste e antishqiptare, që po ndjek prej disa kohësh N. Hrushovi ndaj PPSH, RPSH dhe popullit shqiptar. Por, me këtë akt të pasembullt armiqësor, N. Hrushovi demaskon më tej vetveten jo vetëm para popullit shqiptar dhe popullit sovjetik, por edhe para tërë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, para opinionit publik botëror.

Ky akt i pasembullt në marrëdhëni midis vendeve socialiste hedh drithë mbi konceptet antimarksiste

të N. Hrushovit mbi barazinë e pavarësinë e partive komuniste dhe të shteteve socialiste, qofshin këto të vogla apo të mëdha, mbi të drejtën e tyre të pamohu-eshme për të pasur pikëpamjen e vet dhe për ta shprehur atë lirisht. Parimet leniniste të barazisë, të pavarësisë dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit në gojën e N. Hrushovit janë vetëm blofe, sepse në fakt mjaftoi që PPSH të shprehte pikëpamjen e saj për disa çështje të zhvillimit të sotëm botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombe të në kundërshtim me konceptet revizioniste të N. Hrushovit, që mbi të të rrokulliseshin të gjithë gurët dhe të përdoreshin të gjitha metodat deri në ato që kanë zbatuar e zbatojnë imperialistët e forcat e tjera më reaksionare.

Ç' llogarit të arrijë N. Hrushovi me këtë akt të ri armiqësor kundër RPSH? Duke ndjekur të njëjtin kurs e të njëjtat qëllime, si edhe më parë, edhe me këtë akt ai synon të trembë e të nënshtrojë PPSH, ta largojë atë nga pozitat e saj revolucionare marksiste-leniniste, të lëkundë besimin e popullit tonë te PPSH dhe te udhëheqja e saj, të tronditë ndjenjat e miqësisë të popullit shqiptar ndaj Bashkimit Sovjetik, të minojë miqësinë dhe dashurinë e popullit sovjetik për PPSH. RPSH dhe popullin shqiptar, të krijojë vështirësi të reja në rrugën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Pa dyshim, N. Hrushovi bën llogari edhe për më tutje. Në planin ndërkombe tar ai synon të kërcënojë dhe të paralajmërojë çdo parti e vend tjetër që do të merrte guximin të kundërshtonte pikëpamjet e veprimet e tij, që i sjellin një dëm të madh çështjes së marksizëm-leninizmit dhe të socializmit.

Por më kot e ka N. Hrushovi. Këto qëllime ai nuk do t'i arrijë kurrë. Populli shqiptar është i lidhur si mishi me koskën me Partinë e tij, sepse nga vetë eksperiencia e jetës është bindur për udhëheqjen e urtë të PPSH, për vijën e saj të drejtë, për besnikërinë e saj të pakufishme ndaj çështjes së popullit e të socializmit, për politikën e saj të miqësisë së singertë me Bashkimin Sovjetik. Nën udhëheqjen e PPSH populli shqiptar gjatë këtyre 20 vjetëve ka korrur fitore historike: çlroi vendin nga pushtuesit fashistë dhe vendosi pushtetin popullor, rindërtoi vendin e shkatërruar nga lufta, likuidoi prapambetjen shekullore dhe arriti suksese të mëdha në ndërtimin e shoqërisë socialiste, shkatërroi çdo provokacion e komplot të imperialistëve e të armiqve të tjera të popullit tonë, mbrojti lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë. Uniteti i popullit dhe i Partisë sonë, i kalitur në luftë e në pünë është sot më i fortë se kurrë. Nuk ka intrigë e presion, komplot e shantazh që mund ta prekë këtë unitet të çeliktë. Para tij do të dështojnë me turp, siç kanë dështuar deri sot, të gjitha përpjekjet e armiqve imperialistë dhe të revisionistëve modernë.

Sulmet, shpifjet dhe veprimet armiqësore të N. Hrushovit, duke përfshirë edhe aktin e tij të fundit, nuk do të prekin ndjenjat e pastra të miqësisë që ushqen populli ynë për popujt vëllezër sovjetikë, për komunistët e vërtetë sovjetikë...

Populli shqiptar dhe PPSH do të ecin me vendosmëri në rrugën e tyre të drejtë të ndërtimit të socializmit dhe të mbrojtjes së atdheut. Vështirësitë e përkohshme nuk do të na ndalin në rrugën tonë. Ne jemi të sigurt për të ardhshmen. Detyrat e planit të tretë

pesëvjeçar do të realizohen e do të tejkalohen, pavarësisht nga pengesat që orvaten të na krijojnë N. Hrushovi dhe pasuesit e tij. Shqipëria socialiste do të rrojë e papërkulur e do të lulëzojë çdo ditë e më shumë. Garanci e sigurt për këtë janë patriotizmi dhe shpirti revolucionar i popullit tonë, udhëheqja e drejtë e PPSH dhe ndihma e përkrahja internacionale e miqve, solidariiteti ndërkombëtar i punonjësve.

Populli shqiptar dhe PPSH nuk e njohin frikën. Ata nuk tremben nga presionet e shantazhet e N. Hrušovit e të miqve të tij. Republika Popullore e Shqipërisë ashtu si deri sot, si vend socialist, do të ketë në themelin e politikës së saj të jashtme përpjekjet për forcimin e miqësisë e të bashkëpunimit vëllazëror me vendet sociale, në bazë të parimeve të marksizem-ljeninizmit e të internacionalizmit proletar. Edhe në të ardhshmen Partia e Qeveria jonë do të vazhdojnë palëkundje luftën e tyre të vendosur parimore për demaskimin e planeve dhe të veprimeve luftënxitëse e aggressive të imperializmit, me atë amerikan në krye, do të luftojnë revizionizmin modern dhe do të mbajnë kurdoherë lart vigjilencën e tyre revolucionare. Partia dhe Qeveria jonë do të ndjekin në mënyrë konsekiente politikën e tyre të bashkekzistencës paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme politike e shoqërore, do të luftojnë për uljen e tensionit në marrëdhënet midis shteteve dhe do të japid kontributin e tyre për zgjidhjen paqësore të problemeve, që preokupojnë popujt paqedashës. Si dhe më parë, Partia dhe populli ynë do të përkrahin pa rezerva luftën e shenjtë të popujve për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror.

Partia dhe populli shqiptar, të revoltuar në kulm, protestojnë me indinjatë të thellë kundër aktit të ri të pashembullt armiqësor të N. Hrushovit kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Ata janë thellësisht të bindur se ndodhen në rrugë të drejtë dhe se me ta janë popujt dhe komunistët sovjetikë kundër këtij akti fatal jo për ne, por për vetë grupin e Hrushovit.

Partia jonë lufton për një çështje të madhe, për të vërtetën e marksizëm-leninizmit, për triumfin e çështjes sonë të përbashkët të socializmit, të paqes dhe të lirisë së popujve, për ruajtjen dhe për forcimin e unitetit të shëndoshë të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare kundër revizionizmit modern, kundër shtrembërimeve oportuniste, revizioniste dhe veprimeve përçarëse të N. Hrushovit. Në këtë rrugë, duke ecur krah për krah me partitë motra marksiste-leniniste dhe me popujt vëllezër të vendeve socialiste, si dhe me të gjitha forcat revolucionare të botës, Partia dhe populli ynë do të korrin fitore të plotë mbi armiqëtë imperialistë dhe revizionistë. Marksizëm-leninizmi nuk mposhtet! Socializmi dhe komunizmi do të triumfojnë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
Nr. 297 (4140), 10 dhjetor 1961*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

JO TË KENAQEMI ME REZULTATET E ARRITURA, PO TË SHIKOJMË ÇFARE DUILLET BËRE ME TEJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 dhjetor 1961

Jam dakord me ato që thanë shokët në këtë mbledhje, por desha të shtoj diçka për çështjen e iniciativeve të reja. Ka shumë rëndësi fakti që po merren një radhë iniciativash. Nga propozimet e ndryshme që bëhen, del se ka prej tyre që janë të komplikuara, ka dhe që janë të thjeshta. Klasa jonë punëtore dhe teknikët tanë kanë fituar eksperiencë dhe mund të bëjnë shumë gjëra dhe me vlerë të madhe. Natyrisht, për këto nuk duhet bërë bujë, por punë konkrete, për të zbatuar propozimet, për të filluar prodhimin e sendeve të nevojshme për popullin tonë.

Nuk çshtë puna të mburremi me rezultatet e arritura deri më sot, por të shikojmë akoma se çfarë mund të bëhet më tej në të ardhshmen. Katër muaj më parë,

¹ Në këtë mbledhje u diskutua lidhur me zbatimin e vendimit të KQ të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit».

unë kam parë vetë prodhimin e xhamit, më kanë thënë se kanë filluar të prodhohen bateri e shumë sende të tjera. Këto janë gjëra të mira, por ajo që ka rëndësi është që propozimet të ndiqen e të mos lihen në mes të rrugës. Organet shtetërore të japid urdhër që të fillojë prodhimi i sendeve në reparte ose në linja të reja. Rëndësi të veçantë ka këtu organizimi i punës.

Mua më duket se dikasteret, që kanë në vartësi ndërmarrjet ku janë marrë iniciativa për prodhimin e sendeve të reja, duhet të tregojnë një kujdes më të madh. Ka sende që mund të prodhohen për përdorim të ngushtë, por ka të tjera që duhen për përdorim të gjerë, prandaj këto të shikohen dhe të merren masat, sepse kanë rëndësi të madhe për plotësimin e nevojave të popullit.

Në sektorin e industrisë, të minierave dhe në sektorët e tjerë është punuar mirë edhe në drejtim të prodhimeve të reja, por të mos kënaqemi me këto që janë arritur, prandaj propozimet kaq të vlefshme për ekonominë tonë, t'i organizojmë gjithnjë e më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tarit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE SIIKRUUAJNE NE SIITYP SA ME SHUME KUADRO E PUNONJES

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1961

Edhe unë jam dakord me ato që tha shoku Ramiz, po desha të shtoj se ju, shokë të gazetës «Zëri i popullit», duhet jo vetëm të vini në Drejtorinë e Agjitationit e të Propagandës për të marrë orientime, por të veproni edhe vetë, duke synuar që ta bëni sa më mirë punën që ju është ngarkuar. Drejtoria e Agjacionit dhe e Propagandës mund t'ju orientojë, që të theksohen disa probleme politike nga më kryesoret, të cilat i shikon të arsyeshme Byroja Politike. Por ju duhet të jeni në korent të zhvillimit të ngjarjeve politike dhe t'u jepni bashkëpunëtorëve idetë kryesore për shkrimet e ndryshme.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth relationit të Drejtorisë së Agjacionit e të Propagandës pranë aparatit të KQ të Partisë «Mbi punën e gazetës «Zëri i popullit» dhe të revistave «Rruga e Partisë» e «Ylli»».

Në përgjithësi janë shkruar mjaft artikuj interesantë për problemet aktuale, të cilët e kanë bërë gazeten «Zëri i popullit» më tërheqëse e të dashur, jo vetëm brenda vendit, por edhe në botën e jashtme. Dhe kështu duhet. Situata është e tillë që gazeta «Zëri i popullit» është e domosdoshme të shkruajë jo vetëm për popullin tonë, por edhe për vende të tjera. Natyrisht, duhet mbajtur parasysh se ka artikuj të gazetës «Zëri i popullit» ose të gazetës «Bashkimi» që merren nga agjencitë e huaja dhe transmetohen, gjë për të cilën ne kemi nevojë, sepse sot revisionistët jugosllavë dhe Nikita Hrushovi me pasuesit e tij, zhvillojnë një punë të madhe armiqësore kundër vendit tonë. Ne nuk duam që shkrimet tona të përhapen nëpërmjet shtypit borgjez, por është fakt se kjo bëhet shpeshherë dhe, në këtë mënyrë, shkrimet tona që botohen në faqet e shtypit borgjez, lexohen nga komunistët e vendeve të tjera. Kuptohet që borgjezia nuk shkruan të gjitha ato që themi ne dhe ka raste që bën edhe shtrembërimë e interpretime sipas interesave të saj, pra agjencitë e Perëndimit i përdorin materialet tona për qëllimet e tyre. Mundet që këta artikuj të janë shkruar nga redaktorët tuaj, por ka prej tyre që janë shkruar edhe nga shokë të Drejtorisë së Agjizacionit e të Propagandës, të cilët kanë gjetur kohë dhe i kanë shkruar këta artikuj, por në qoftë se ata do të ngarkoheshin të shkruanin të gjithë artikujt që botohen, kjo është e pamundur, sepse duhet menduar edhe për gazetat e tjera si «Bashkimi» etj. Prandaj, është e domosdoshme që të shkruajnë sa më shumë kuadro e punonjës.

Revistën «Ylli» ne mund ta kritikojmë për të me-

tat, që u vunë në dukje, por të mos harrojmë se ajo ka vetëm një vit që ka filluar të dalë. Duke marrë parasysh këtë dhe kuadrot e paktë që ka, mendoj se revista «Ylli» nuk del keq. Është fakt që kjo revistë kërkohet e lexohet mjافت.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë

*Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NE KUSHITET E SOTME PROBLEMET POLITIKE JANE TE MPREHTA

*Nga letra dërguar të gjitha komitetet e
të Partisë të rretheve¹*

29 dhjetor 1961

Të dashur shokë,

Sic keni konstatuar edhe vetë, kohët e fundit çësh-tjet politike kanë tërhequr më shumë vëmendjen e Partisë. Kështu, në mbledhjet e byrove të komitetet e Partisë janë shqyrtuar më shumë probleme të punës politike, nga shumë komitete partie janë bërë plenumet e veçanta, ku është analizuar gjendja e rrethit, në mbledhjet e organizatave-bazë janë bërë më shpesh sqarime për çështje politike dhe të gjithë komunistët janë aktivizuar për sqarimin e masave. Pa dyshim kjo është gjë e mirë dhe rezultatet janë të dukshme. Masat janë sqaruar dhe kanë shtrënguar edhe më shumë radhët e tyre rreth Partisë, është bërë mobi-

¹ Kjo letër u miratua në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH të datës 16 dhjetor 1961, ku u diskutua mbi punën politike me masat.

lizimi më i madh i punonjësve dhe janë arritur suksese në të gjitha fushat e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës.

Vija e drejtë e Partisë e përcaktuar në Kongresin IV të saj dhe letrat e Komitetit Qendror për mosmarrëveshjet me udhëheqjen e sotme sovjetike, e kanë ngritur në një nivel më të lartë punën politike me masat. Me gjithë vështirësitë politike dhe ekonomike që na janë nxjerrë nga N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë, gjendja e brendshme e vendit është forcuar, mobilizimi në punë është shtuar dhe vigjilanca e gatishmëria për mbrojtjen e atdheut tonë socialist janë rritur.

Shokët e kuptojnë pse Komiteti Qendror i Partisë tregon tani një kujdes të veçantë për punën politike e svaruese me masat. Janë kushtet e sotme, është vetëjeta, që nre tani para Partisë probleme të mprehta politike, të cilat ajo duhet t'i kuptojë drejt, duhet t'i përballojë, duhet të tregojë edhe shkathtësi për t'u dalë përpara ngjarjeve. Cilat janë këto kushte?

E para, gjendja e sotme ndërkomëtare, ashpërsimi i luftës midis dy sistemeve, pregetitjet e ethëshme të imperializmit për ta hedhur njerëzimin në një kasaphanë të re dhe sidomos lufta e hapur, që udhëheqja e sotme sovjetike filloi në Kongresin XXII të PK të BS kundër Partisë sonë, kërkijnë ngritjen në një shkallë më të lartë të veprimtarisë politike të Partisë, shtrojnë domosdoshmërinë e një pune të dendur svaruese me njerëzit.

E dyta, hyrja e vendit tonë në një etapë të re zhvillimi, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socia-

liste, kërkon gjithashtu ngritjen në një shkallë më të lartë të veprimtarisë së ndërgjegjshme të masave, shtron para Partisë domosdoshmérinë e një pune të dendur politike dhe edukuese me njerëzit, për têrheqjen e tyre gjithmonë më tepër në ndërtimin socialist të vendit dhe për kalitjen e njeriut të ri të shoqërisë socialiste.

Puna politike me masat është një sektor i rëndësishëm i veprimtarisë së Partisë. Gjithnjë Partia jonë ka bërë një punë të gjerë politike me masat, por kush-tet në të cilat punon e lufton Partia jonë sot, bëjnë që, krahas problemeve ekonomike, të marrin një rëndësi të dorës së parë edhe çështjet politike.

Me gjithë përmirësimin që duket në drejtim të punës politike me masat, është e domosdoshme që komitetet e Partisë dhe organizatat-bazë t'i konsiderojnë çështjet e punës politike jo si çështje më vete, por të lidhura ngushtë me të gjitha detyrat e tjera. Nuk mund të ketë as rezultate ekonomike, as forcim të punës së Partisë, pa një punë të mirë politike. Duhet luftuar akoma ndaj rasteve të ndarjes së punës politike nga puna ekonomike ose organizative. Është e palejueshme, për shembull, që instruktorët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit, ndërsa dinë me hollësi pasuritë e kooperativave bujqësore të zonave të tyre, prodhimin dhe rendimentin për çdo kulturë, shumë pak janë në dijeni të gjendjes politike, të punës politike ose të aktivitetit kulturoro-artistik në ato kooperativa.

Në drejtimin e punës politike me masat nga ana e komiteteve të Partisë vërehen të meta edhe në këto

dy drejtime: *Së pari*, disa komitete partie, kur shqyrtojnë punën politike, përqëndrohen kryesisht në analizën e formave të punës politike, në funksionimin e tyre dhe nuk shikojnë efektin, bëjnë këshfu mjetet qëllim në vetvete. *Së dyti*, disa byro të komitetave të Partisë të rretheve në analizën që i bëjnë gjendjes politike të rrethit në çdo tre muaj, sipas vendimit të Sekretariatit të Komitetit Qendror, nuk mbështetën si duhet në të dhënat e organizatave-bazë të Partisë etj.

Këtej del se duhet të organizojmë më mirë akoma punën politike me masat, duke u udhëhequr gjithmonë nga disa parime kryesore, të cilat rrjedhin nga vëlëbazat organizative të ndërtimit të Partisë.

1) Organizata-bazë e Partisë duhet të bëjë një jetë të dendur politike, të sigurojë që të gjithë komunistët të rrojnë me problemet e Partisë dhe, duke përdorur format e mjetet më të përshtatshme, të sqarojë masat.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, siç e ka përsëritur shpeshherë Partia, duhet që të gjithë komunistët, pa përjashtim, të lexojnë rregullisht shtypin e Partisë dhe të rrojnë me zhvillimin e ngjarjeve jashtë e brenda vendit. Organizatat-bazë të Partisë dhe, në mënyrë të veçantë, sekretari i saj, duhet të kontrollojnë si e plotëson këtë detyrë çdo komunist, herë pas here, të flitet në organizatën-bazë për gjendjen politike të jashtme e të brendshme, duke e vënë këtë si pikë të veçantë në rendin e ditës. Deri disa kohë më parë kjo nuk bëhej, tani ka filluar të praktikohet dhe rezultatet janë të dukshme; kushtet e sotme kërkojnë që të bëhet më mirë.

Që të bëhet mirë puna politike së qaruese me masat, është e domosdoshme që organizata-bazë e Partisë të njohë mirë territorin apo ndërmarrjen, ku ajo ushtron veprimtarinë e saj, të dijë përbërjen e popullsisë së fshatit, të kooperativës ose të punonjësve të ndërmarrjes, problemet e territorit ose të qendrës së punës, çfarë bisedojnë ose për çfarë interesohen njerëzit, me një fjalë të ketë në dorë gjithë gjendjen. Vetëm atëherë organizata-bazë do të mund të përcaktojë drejt masat që duhet të marrë, çfarë e si duhet të flasë, format e punës politike më të efektshme që duhet të përdorë për të së qaruar njerëzit, për t'i mobilizuar ata në zbatimin e vijës së Partisë.

Një rëndësi të veçantë ka gjithashtu që organizatat-bazë të Partisë të kenë iniciativë dhe të tregohen të shkallhta për t'i kapur çështjet shpejt dhe të mos presin që çdo gjë t'u thuhet nga lart. Organizata-bazë përgjigjet për qendrën e punës ose për fshatin ku ushtron veprimtarinë e saj, prandaj duhet të organizojë të gjithë punën, pra, edhe punën politike, si të jetë më mirë. Dhe të mos ndodhë ashtu si në rrethin e Lushnjës, ku, nga një kontroll, doli se 14 organizata-bazë e kishin bërë zakon që, për punën politike me masat, të prisnin rekomandimet e komitetit të Partisë për leximin e ndonjë artikulli, të prisnin edhe konferencierët e komitetit të Partisë.

Partia jonë ka një eksperiencë të pasur në punën politike me masat. Çdo komunist te ne ka ardhur në Parti si agjитator dhe çdo komunist, duke filluar nga kuadrot kryesorë të Partisë dhe të shtetit e deri te anëtari më i thjeshtë i Partisë në fshat ose në ndërmarrje,

e quan si detyrë të rëndësishme partie të flasë para masës. Kjo është një traditë e mirekullueshme e Partisë sonë, të cilën duhet ta ruajmë e ta zhvillojmë më tej. Prandaj nuk është e lejueshme që të ketë sekretarë të Partisë, anëtarë të byrosë ose kuadro të tjerrë kryesorë të rrethit që nuk flasin para masave. Veçanërisht kjo duhet mbajtur mirë parasysh nga shokët që merren me pushtetin dhe punojnë në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, të cilët shpesh i shmangen kësaj detyre. Aktivizimi i kuadrove të Partisë për punën politike me masat është një detyrë e rëndësishme e komiteteve të Partisë. Herë pas here ata duhet të flasin përpara masave për çështje të ndryshme të politikës së jashtme dhe të brendshme. Gjithashtu duhet të aktivizohen për punën politike me masat edhe shokët e qendrës, qoftë të organizatave të masave, qoftë edhe të dikastereve, kur shkojnë me punë në bazë. Ata duhet t'u flasin masave të sektorëve të tyre edhe për çështje politike.

2) *T'u themi masave kurdohërë të vërtetën dhe të analizojmë gjendjen në mënyrë objektive.* Gjithmonë Partia ka folur hapur me masat dhe u ka thënë atyre të vërtetën, ka folur për vështirësitë dhe për fitoret, ka vlerësuar drejt si armikun ashtu edhe forcat e veta, ka treguar pengesat që duhen kaluar dhe perspektivat. Kurrë Partia nuk e ka paraqitur rrugën e saj shesh me lule, nuk e ka zbukuruar realitetin tonë, as nuk i ka zmadhuar pengesat që ka pasur, por, duke analizuar gjendjen në mënyrë objektive, ka folur edhe për vështirësitë, edhe për sukseset.

Eksperienca tregon se, duke folur hapur për vështirësitë, masat as nuk janë trembur, as nuk janë lar-

guar nga Partia, përkundrazi kanë shtrënguar më shumë radhët rreth Partisë dhe kanë qenë më të pregatitura për t'i kapërcyer ato. Realiteti ynë është i tillë që nuk ka nevojë për asnjë zbulim. Ngjarjet jashtë vendit zhvillohen në dobi të socializmit dhe ato brenda vendit në rrugën e përcaktuar nga Partia për ndërtimin e socializmit. Sukseset janë të mëdha. Por në rrugën tonë ka vështirësi, të cilat na shkaktohen nga armiqjtë imperialistë dhe shërbëtorët e tyre revizionistë, nga mbeturinat e klasave të përmbyshura dhe armiqjtë e ndryshëm të Partisë; ka edhe vështirësi të rritjes, të ecjes përpara. Partia porosit se për kalimin e këtyre vështirësive ka vetëm një rrugë të drejtë: të mos mbyllësh sytë përpara tyre, t'i njoftesh ato, të flasësh për ato me popullin dhe t'i përballosh me guxim. Partia nuk ua fshahu masave edhe mosmarrëveshjet që ka me udhëheqjen e sotme të Bashkimit Sovjetik, nuk ua fshahu edhe disa vështirësi, që i krijojen vendit tonë nga presionet politike, ekonomike e ushtarake të Hrušovit dhe të atyre që e pasojnë, i tha hapur popullit edhe akuzat shifëse që bëri ai në Kongresin XXII të PK të BS. Përfundimi shihet sot nga të gjithë: populli i shtrëngoi edhe më shumë radhët rreth Partisë, ngriti vigjilencën e tij revolucionare dhe u mobilizua edhe më shumë për të realizuar planet në të gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës.

Por nuk është e drejtë t'u flasësh masave vetëm për vështirësitë. Në qoftë se do të veprohej kështu do të gabonim, sepse do të krijonim artificialisht një gjendje të rëndë, pesimiste, që do të ishte shumë e dëmshme. T'u thuash masave të vërtetët do të thotë t'u

flasësh atyre edhe për sukseset e mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat, t'u flasësh edhe për perspektivat, të cilat nuk janë aspak premtimë boshe, por janë e ardhshmja e sigurt e bazuar në planet tona, në ligjet e zhvillimit të shoqërisë sonë, në punën e popullit tonë. T'u thuash masave të vërtetën do të thotë gjithashtu t'u flasësh jo vetëm për rrezikun e imperializmit dhe për pregatitjen e tij për luftë, por edhe për forcën e pathyeshme të socializmit dhe mundësinë që kanë popujt t'u ndalin dorën imperialistëve ose t'i shkatërrojnë në qoftë se ata fillojnë luftën. T'u thuash masave të vërtetën do të thotë, më në fund, t'u flasësh edhe për punën e armikut të brendshëm e të jashtëm kundër vendit dhe pushtetit popullor, por në të njëjtën kohë edhe për forcën tonë dhe për luftën që bëjnë masat nën udhëheqjen e Partisë kundër armiqve. Duke folur edhe për sukseset, edhe për perspektivat, edhe për forcën e socializmit, edhe për forcën e pushtetit dhe të Partisë, në masat krijohet besimi për të ardhshmen, ngjallet entuziazëm dle optimizëm, arrihet edhe një mobilizim më i mirë në punë.

3) *Puna politike e Partisë të përballojë çdo situatë.* Komitetet e Partisë dhe organizatat-bazë duhet të kërkojnë nga të gjithë komunistët që, duke u bazuar në vijën e përgjithshme të Partisë, të flasin me masat pa u lodhur për politikën e Partisë, të përballojnë çdo problem politik; t'u japid përgjigje çështjeve që ngrihen nga poshtë, të sqarojnë njerëzit me durim dhe të luftojnë hapur kundër propagandës së armikut. Në punën politike me masat duhet të jemi gjithmonë në sulm dhe asnjëherë në pritje ose në tërheqje:

Së pari, iniciativa të jetë kurdoherë në dorën tonë dhe të jemi ne ata që shtrojmë para masave problemet kryesore politike qoftë për gjendjen ndërkontaktare, qoftë për atë të brendshme. Kësaj i thonë të jesh në krye të situatës. Byroja e komitetit të Partisë ose organizata-bazë duhet të térheqë vëmendjen e masave në ato çështje që ajo i quan kryesore. Një udhëheqës i mirë politik duhet të nuhatë dhe të parashikojë zhvillimin e ngjarjeve, t'u dalë përparrë dhe t'i sqarojë me kohë masat.

Disa herë ndodh që komiteti i Partisë ose organizata-bazë ndërhyjnë për sqarimin e një çështjeje, pasi ajo është bërë problem. Por duhet thënë se çështjet mund të bëhen problem atëherë kur masat nuk sqarohen me kohë. Veç kësaj, kohët e fundit shokët flasin shpesh se një nga format më të mira për sqarimin e masave është biseda me anë të pyetjeve e të përgjigjeve. Këtu ka një keqkuptim. Përdorimi i kësaj forme bisede me masat nuk do të thotë t'i nënshtrohesh spontaneitetit. Rregullisht duhet që konferencieri të shtrojë përparrë çështjet, që Partia kërkon të sqarojë në masat dhe pastaj t'u përgjigjet pyetjeve që mund t'i bëhen. Çdo mbledhje mund të përfundojë me pyetje dhe përgjigje.

Së dyti, të mos u shmangemi çështjeve që ngrihen nga masat dhe të mbrojmë kurdoherë vijën e Partisë. Komunisti nuk mund të ngrejë supet dhe të justifikohet se për këtë ose atë çështje nuk e ka sqaruar Partia. Gjithashtu nuk duhet t'u bëjë bisht pyetjeve me fjalë të përgjithshme. Ai ka vijën e përgjithshme të Partisë dhe në bazë të saj, duke u orientuar çdo ditë nga shtypi,

të luftojë e të sqarojë masat. Të përballojë, pra, çdo situatë dhe çdo problem dhe të mos rrrijë me gojë mbyllur. Ai ka të drejtën me vete, vijën e përgjithshme të Partisë, të cilën duhet ta propagandojë dhe ta mbrojë kurdoherë. Për gjërat, që me të vërtetë nuk i di, duhet të thotë hapur se këto çështje do t'i sqarojë më vonë dhe pasi të pyesë në komitetin e Partisë të vejë dhe të përgjigjet.

Të mos përballosh çështjet do të thotë ta lësh hapur rrugën për lloj-lloj interpretimesh. Kjo nuk duhet të ndodhë, sepse, atje ku nuk dëgjohet fjala jonë, mund të dëgjohet ajo e armikut. Sidomos duhet përballuar çdo situatë kur kemi përpara armikun, parullat e tij. Ndodh që komunisti hesht kur ndeshet me to, duke u justifikuar se nuk e dinte si ishte çështja. Kjo është e palejueshme. Ai e ka për detyrë të mbrojë Partinë kudo e kurdo, në çdo situatë që të gjendet, qëndrimi i tij duhet të jetë i vendosur dhe të mos lejojë që fjala e armikut të zërë vend. Kjo ka një rëndësi të veçantë, sidomos në kushtet e sotme.

Së treti, të luftohet hapur kundër propagandës armike, kundër parullave dhe sulmeve, që i bëhen Partisë dhe vijës së saj nga elementë armiq ose njerëz të gabuar. Të kemi parasysh se në situatat e tanishme armiku është vënë në lëvizje, radiot e huaja shpifin shumë kundër Partisë sonë, armiq të hedhin parulla, bëjnë presion në masat, duan të ngjallin pasiguri dhe përpiken të krijojnë lëkundje në njerëzit, për t'i vënë ata në opozicion me Partinë; elementë të ndryshëm antiparti ngrenë gjithashtu kokën, nga ana tjetër Hrušovi dhe ata që e pasojnë do të përpiken të ushtrojnë

një presion të madh ideologjik e politik kundër Partisë sonë. Eksperienca ka treguar se, kur janë demaskuar hapur parullat ose shpifjet e propagandës së huaj, kjo ka ndihmuar që të demaskohen më mirë armiqtë, që të gabuarit të njohin gabimet e tyre, që të paqartët të sqarohen, ka ndihmuar edhe masat që të kuptojnë më mirë si vepron armiku. Disa kohë më parë në Uzinen e Naftës në Cërrrik u bë një mbledhje, ku u demaskuan dy njerëz jo të mirë, që përhapnin parulla të ndryshme armiqësore. Mbledhja pati shumë efekt, punëtorët treguan çfarë kishin dëgjuar prej tyre dhe arritën në përfundim se duhet të forcojnë më shumë vigjilencën. Mbledhje të tillë të organizuara mirë mund të praktikohen dhe kanë efekt.

Por këtu duam të theksojmë se duhet bërë gjithnjë dallimi midis parullave të armikut dhe mendimeve e pikëpamjeve të gabuara të njerëzve që nuk kanë qëllime të këqija. Mendimet e pikëpamjet e shtrembra duhen sqaruar me durim e me takt, pa u vënë atyre gjithfarë epitetesh si reaksionare, armiqësore, revizioniste etj. dhe pa ofenduar e pa prekur njerëzit. Nuk mund të pranohet se të gjithë njerëzit pa përjashtim duhet të jenë të qartë për të gjitha gjërat, të kenë mendime të drejta për të gjitha çështjet. Po të ishte kështu, nuk do të kishte nevojë për kurrfarë pune politike, për sqarimin e për bindjen e masave. Prandaj, krahas me karakterin dhe me fryshtën luftarake, puna politike e Partisë duhet të jetë shoqërore, e ngrohtë dhe e afërt për punonjësit. Kështu ajo do të bëjë edhe më shumë efekt, njerëzit do të binden se ajo nuk synon të goditë njérin e tjetrin, por t'i sqarojë ata, t'i

bindë, t'i vërë në rrugë të drejtë. Puna politike e Partisë duhet të jetë bindëse, sepse bindja është një nga metodat kryesore të udhëheqjes. Partia jonë ka pasur kurdoherë me vete masat, për arsyen se ajo ka mundur t'i bindë ato dhe t'i bëjë të ndërgjegjshme për vijën e saj. Njerëzit duhen sqaruar dhe duhen bindur edhe kur kërkesat dhe propozimet e tyre nuk mund të plotësohen. Dhënia e përgjigjeve të prera bën që njerëzit të mos pyesin, të mos diskutojnë dhe të mos propozojnë, pra, edhe të mos sqarohen. Konferencierët, lektorët dhe agjitarët duhet të pregaqiten mirë në mënyrë që t'i përgjigjen nivelit politik të masave, që gjithmonë vjen duke u ngritur. Ata duhet të janë të pregaqitur për diskutime e debate dhe për t'i dhënë përgjigje çdo pyetjeje.

Për punën politike me masat Partia përdor një sërë formash, të cilat i ka nxjerrë vetë jeta dhe janë provuar në praktikë. Në përcaktimin e formave të punës politike me masat duhet të nisemi kurdoherë nga këto dy parime:

a) *Ato nuk janë qëllime në vetvete.* Format e punës politike Partia i përdor në përshtatje me kushtet konkrete, sipas vendit, kohës dhe vetë çështjeve që ngrë përparrë masave.

b) *Ato nuk janë diçka e dhënë një herë e përgjithmonë dhe të pandryshueshme.* Në eksperiençën e përditshme disa forma kanë më shumë sukses dhe disa më pak, me kohë lindin forma të reja, kurse disa prej tyre zhduken.

Më poshtë në letër flitet konkretisht për format kryesore të punës politike të Partisë me masat siç janë:

fjala e gjallë, agjitacioni i vogël individual, kolektivet e agjitatorëve, puna me leksione, puna e diferencuar, aktivitetet kulturore etj.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 22-të V—IX

1961

PPSH LINDI, JETOI E JETON NË RRETHIM AR-MIQËSOR, LUFTON DHE FITON NË BETEJA KUN-DËR FRONTIT TË GJERË REVIZIONIST — Fjala në Plenumin V të KQ të PPSH (12 tetor 1961)	1—20
PARTIA JONË RINOHET VAZHDIMISHT, ATË E PËRTËRIT RINIA — Nga fjala në mbledhjen e përbashkët të Plenumit të Komitetit të Partisë dhe të Plenumit të Komitetit të Bashkimit të Rinisë të Rrethit të Durrësit (14 tetor 1961)	21—38
AKTIVIZIMI I GRAVE NË PUNËT E KOOPERATI-VËS ÇON PËRPARA PRODHIMIN — Nga biseda në takimin me një grup fshatarësh të kooperativës bujqësore të Bajzës të rrethit të Shkodrës (17 tetor 1961)	39—41
PARTIA KA LUFTUAR E LUFTON QË GRUAJA TË JETË E LIRE, E PAVARUR, E NDERUAR DHE E ZHVILLUAR SI DIHE BURRI — Fjala me të rejat e dalluara të rrethit të Lezhës në Pallatin e Brigadave (17 tetor 1961).	42—54
T'U JAPIM PËRGJIGJEN E MERITUAR SULMEVE TË HAPURA TË REVIZIONISTËVE SOVJETIKË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSII (20 tetor 1961)	55—58

RENDI I DITES — MOMENT KYÇ I PUNËS SË ORGANIZATËS-BAZË TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 tetor 1961)	59—61
MBLEDHJET E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË NË USHTRI TË JENË LUFTARAKE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 tetor 1961).	62—64
TË RUHET E TË MIREMBAHET ME KUJDES MAKINERIA USHTARAKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 tetor 1961)	65—66
KOOPERATIVAT BUJQËSORE T'I FORCOJMË DHE NIVELIN E JETESËS TË FSHATARËVE TË MOS E DOBËSOJMË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 tetor 1961)	67—69
PARTIA JONË NUK KA AS ILUZIONIN MË TË VOGËL PËR GRUPIN E HRUSHOVIT — Shënimë nga biseda me një mik të huaj (28 tetor 1961)	70—73
TË DEMASKOHET DHE TË LUFTOHET ME DURIM DHE ME PRINCIPIALITET VEPRIMTARIA ANTIMARKSISTE DHE ANTISHQIPTARE E REVIZIONISTËVE MODERNE — Letër dërguar të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve (1 nëntor 1961)	74—79
NJËZET VJET JETË DHE LUFTHË REVOLUCIONARE — Fjalim në mbledhjen solemne kushtuar 20-vjetorit të themelimit të PPSH (7 nëntor 1961)	80—171
NAFTËTARËT KANË QENË DHE JANE NË RADHËT E PARA TË LUFTËS E TË PËRPJEKJEVE TË POPULLIT TONË PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT — Nga fjala në mitingun me naftëtarët e Qytetit «Stalin» (9 nëntor 1961)	172—184

ASHTU SI ËSHTË POPULLI I DREJTË, I FORTË DHE I PAPERKULUR, ASHTU ËSHTË EDHE PARTIA — Nga fjala në mitingun spontan me popullin e qytetit të Beratit (10 nëntor 1961)	185—193
PARTIA JONË KA LUFTUAR ME VENDOSMËRI DHE KURDOHERË KA FITUAR — Nga fjala me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të rrethit të Beratit (10 nëntor 1961)	194—207
TE ECIM PËRPARA PA E HEQUR PUSHKËN NGA KRAHU — Fjala në mitingun me popullin e lokalitetit të Tërpanit të rrethit të Beratit (11 nëntor 1961)	208—216
TE JEMI KURDOHERË ORGANIZATORE TE MIRE NE PUNËN E PARTISË DHE TE EKONOMISË — Nga biseda në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Përmetit (11 nëntor 1961)	217—226
FITORET SIGUROHEN ME LUFTË, ME PUNË, ME VIGJILENCË — Nga biseda me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të rrethit të Përmetit (12 nëntor 1961)	227—239
KUSH PREK POPULLIN KA PREKUR PARTINË DHE KUSH PREK PARTINË KA PREKUR POPU- LLIN — Fjala në mitingun me popullin e rrethit të Përmetit në Këlcyrë (13 nëntor 1961)	240—254
VIGJILENCËN TA KEMI NË RENDIN E DITES, ARMËT TI MBAJMË GATI DHE BARUTIN TË THATE — Fjala në mitingun me popullin e rrethit të Gjirokastrës (14 nëntor 1961)	255—283
RINIA ËSHTË THESAR I MADH I POPULLIT DHE I PARTISË — Fjala me nxënësit dhe me pedagogët e gjimnazit të Gjirokastrës (15 nëntor 1961)	284—292

DIKTATURA E PROLETARIATIT NË SHQIPERI RRON, VIGJELON DIHE VEPRON — Fjala me kua- drot e rrëthit të Gjirokastrës (15 nëntor 1961)	293—339
RRUGA PER NË SOCIALIZËM NUK ËSHTË E SHTRUAR ME LULE — Fjala në mitingun me popu- llin e Delvinës (16 nëntor 1961)	340—353
TE VAZHDOJMË PUNËN ME RITME EDHE MË TE LARTA — Nga biseda në mbledhjen e byrosë së Ko- mitetit të Partisë të Rrëthit të Sarandës (17 nëntor 1961)	354—366
SARANDA ËSHTË NJË KRAHINE ME PERSPEK- TIVË TE MADHE — Nga fjala në mitingun me popullin e rrëthit të Sarandës (18 nëntor 1961)	367—387
BREGDETI SHQIPTAR DO TE KTHEHET NË NJË KOPSHT TE LULËZUAR — Fjala në mitingun me popullin e Himarës (19 nëntor 1961)	388—400
PRERJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE MIDIS BASHKIMIT SOVJETIK DHE SHQIPERISE — NJË AKT ARMIQËSOR I NIKITA HRUSHOVIT — Disku- tim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 dhjetor 1961)	401—406
STËRVITJET USHTARAKE FUQIZOJNË AFTËSINË MBROJTËSE TE ATDHEUT TONE — Fjala me ush- tarakët që morën pjesë në stërvitjen «Shqiponja e malit» (7 dhjetor 1961)	407—424
NJË AKT I PASHEMBULLT ARMIQËSOR KUNDER RPSH DHE POPULLIT SHQIPTAR (10 dhjetor 1961)	425—435
JO TE KËNAQEMI ME REZULTATET E ARRITU- RA, PO TE SHIKOJMË ÇFARË DUHET BËRE MË TEJ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 dhjetor 1961)	436—437

TE SHKRUAJNE NË SHTYP SA MË SHUMË KUADRO E PUNONJËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 dhjetor 1961)	438—440
NË KUSHTET E SOTME PROBLEMET POLITIKE JANË TE MPREHTA — Nga letra dërguar të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve (29 dhjetor 1961) ..	441—453